

20220901079

LIGJ I SHËRBIMEVE TË PAGESAVE DHE I SISTEMEVE TË PAGESAVE (*)

Pjesa e parë Dispozita të përgjithshme

Kapitulli I Dispozitat themelore

Lënda

Neni 1

Me këtë ligj rregullohen llojet e shërbimeve të pagesave, leja e dhënies së shërbimeve të pagesave, emetimi i parave elektronike, transparenca e kushteve dhe e detyrimeve për informim në lidhje me shërbimet e pagesave, të drejtat dhe detyrimet e ofruesve dhe të përdoruesve të shërbimeve të pagesave, hapja dhe përdorimi i shërbimeve të pagesave, bartja e llogarisë së pagesës, transparenca dhe krahasimi i kompensimeve në lidhje me llogaritë dhe shërbimet e pagesave, procedurat e zgjidhjes së kontesteve të krijuara gjatë ofrimit të shërbimeve të pagesave, sistemet e pagesave dhe finalizimin e shlyerjeve, mbikëqyrja e institucioneve të pagesave, e institucioneve të parave elektronike dhe e operatorëve të sistemeve të pagesave, vendosjen dhe mbajtjen e regjistrit të vetëm të llogarive si dhe çështje të tjera që lidhen me shërbimet e pagesave dhe sistemet e pagesave.

Përkufizime

Neni 2

(1) Shprehje të caktuara të përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:

1. **“Autentifikimi”** është procedurë që i mundëson ofruesit të shërbimeve të pagesave që ta vërtetojë identitetin e përdoruesit të shërbimeve të pagesave ose përdorimin e vlefshëm të instrumentit të caktuar të pagesës, duke përfshirë edhe përdorimin e veçorive të sigurisë së përdoruesit.

2. **“Autenticiteti”** është cilësi e shërbimeve në lidhje me pagesat që me të vërtetë përfaqësojnë atë që konstatohet se përfaqësojnë;

3. **“Autorizimi”** është procedurë që kontrollon nëse përdoruesi i shërbimeve të pagesave ose ofruesi i shërbimeve të pagesave ka të drejtë të kryejë veprime të caktuara;

(*) Me këtë ligj bëhet harmonizimi me Direktivën 32015L2366 të Parlamentit European dhe të Këshillit të Bashkimit European për shërbimet e pagesave në tregun e brendshëm (CELEX nr. 32015L2366), Direktivën 32009L0110 të Parlamentit European dhe të Këshillit të Bashkimit European të parave elektronike (CELEX nr. 32009L0110), Direktiva 01998L0026-20190627 e Parlamentit European dhe e Këshillit për Finalizimin e Shlyerjeve dhe Sistemeve të Shlyerjes së Letrave me Vlerë (CELEX nr. 01998L0026-20190627), dhe Direktivës 32014L0092 së Parlamentit European dhe Këshillit për Krahasim të Kompensimeve në lidhje me llogaritë e pagesave, bartjen e llogarive të pagesave dhe qasjen në llogaritë e pagesave me funksione themelore (CELEX nr. 32014L0092), Rregullativa 32015R0751 e Parlamentit European dhe e Këshillit të Bashkimit European për kompensimet e zëvendësimit për transaksionet e pagesave me kartelë (CELEX nr. 32015R0751) dhe Rregullativa 02012R0260-20140131 e Parlamentit European dhe e Këshillit të Bashkimit European për krijimin e kërkesave teknike dhe afariste për transfere kreditore dhe debitime direkte në euro (CELEX nr. 02012R0260-20140131).

4. **“Agjenti”** është shoqëri tregtare ose tregtar individ që vepron në bazë të marrëveshjes, në emër dhe për llogari të institucionit të pagesave në ofrimin e shërbimeve të pagesave ose në emër dhe për llogari të institucionit të parave elektronike në aktivitetet e shpërndarjes dhe blerjes së parave elektronike dhe/ose dhënien e shërbimeve të pagesave;

5. **“Agjent i shlyerjes”** është person juridik që pjesëmarrësve në sistemin e pagesave, pjesëmarrësve në sistemin e shlyerjes së letrave me vlerë dhe/ose palës kontraktuese qendrore u siguron llogari për shlyerje nëpërmjet së cilës shlyhen urdhëresat për bartje në kuadër të sistemit të pagesave ose sistemit të shlyerjes së letrave me vlerë dhe sipas rastit, për qëllimin e shlyerjes mund t'u miratojë kredi pjesëmarrësve në sistemin e pagesave, pjesëmarrësve në sistemin e shlyerjes së letrave me vlerë dhe/ose palëve kontraktuese qendrore;

6. **“Aktivitete procesimi”** janë kryerje shërbimesh procesimi të transaksioneve të pagesave nëpërmjet veprimeve të nevojshme për trajtimin e urdhërpagesës ndërmjet ofruesit të shërbimit të pagesave që pranon transaksionet e pagesave dhe ofruesit të shërbimit të pagesave që lëshon instrumentin e pagesës në bazë të kartelës;

7. **“Bankomati”** është pajisje elektromekanike që u mundëson përdoruesve të autorizuar të tërheqin para nga llogaritë dhe/ose u siguron atyre qasje në shërbime të tjera;

8. **“Lidhje të ngushta”** janë kur dy dhe/ose më shumë persona fizikë dhe/ose juridikë lidhen nëpërmjet pjesëmarrjes, në formën e pronësisë direkte ose indirekte të të paktën 20% të numrit të përgjithshëm të aksioneve ose të aksioneve të lëshuara me të drejtë vote ose nga pjesa e institucionit të pagesës, institucion të parave elektronike ose operator të sistemit të pagesave, ose nëpërmjet kontrollit, dhe/ose kur dy ose më shumë persona juridikë kontrollohen nga i njëjti person fizik dhe/ose juridik;

9. **“Llogaria e bllokuar e pagesës”** është llogari e pagesës e përdoruesit të shërbimeve të pagesave për të cilën është evidentuar urdhërpagesë e përealizuar për arkëtim të detyrueshëm ose ka të njëjtin numër të vetëm tatimor, përkatësisht numrin e vetëm amë të identifikimit të qytetarit për persona fizikë me llogari për të cilin ka të evidentuar urdhërpagesë të përealizuar për arkëtim të detyrueshëm;

10. **“Funksion i rëndësishëm operativ”** është funksion operativ që lidhet me ofrimin e shërbimeve të pagesave ose punën e sistemit të pagesës, kryerjen e parregullt ose ndërprerjen e realizimit të të cilit do të shkaktonte ndikim të rëndësishëm në mundësinë e institucionit të pagesave, institucionit të parave elektronike ose operatorit të sistemit të pagesave për plotësimin e kushteve lidhur me marrjen e lejes së punës në përputhje me ligjin, në përmbushjen e detyrimeve të tjera në përputhje me këtë ligj, për rezultatet e tyre financiare të punës ose për kryerjen e drejtë apo vazhdimësinë e shërbimeve të pagesave ose punën e sistemit të pagesave;

11. **“Numri referencues”** është numri i vetëm identifikues i ofruesit të shërbimeve të pagesave i cili caktohet nga Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut për krijimin e shenjës së vetme identifikuese në llogaritë e pagesave të përdoruesve të vet të shërbimeve të pagesave gjatë shlyerjes së transaksioneve të pagesave në sistemin e pagesave i menaxhuar nga Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut;

12. **“Grupi”** është grup i shoqërive të pavarura tregtare në të cilat shoqëria e caktuar tregtare (shoqëria amë) ka kontroll mbi një ose më shumë shoqëri (filiale) dhe përbëhet nga shoqëria amë, filialet e saj, shoqëritë me të cilat shoqëria amë apo filialet e saj janë të lidhura nëpërmjet pjesëmarrjes në kryegjënë themelore si dhe shoqëritë që lidhen me grupin e shoqërive nëpërmjet kontrollit ose kontrollohen nga e njëjta shoqëri që është e përfshirë në grup;

13. **“Ofruesi i shërbimeve të pagesave që mban llogarinë e pagesave”** është dhënësi i shërbimeve të pagesave që hap dhe mban llogarinë e pagesave të paguesit;

14. **“Ofruesi i shërbimeve të pagesave që kryen bartjen e llogarisë së pagesës”** është ofruesi i shërbimeve të pagesave nga i cili barten informacionet e nevojshme për zbatimin e shërbimeve të bartjes;

15. **“Ofruesi i shërbimeve të pagesave që pranon bartjen e llogarisë së pagesës”** është ofruesi i shërbimeve të pagesave të cilin barten informacionet e nevojshme për zbatimin e shërbimeve të bartjes;

16. **“Ofruesi i shërbimeve për dhënie të informacioneve për llogarinë e pagesës”** është ofruesi i shërbimeve të pagesave që kryen shërbime të dhënies së informacioneve për llogari të pagesave;

17. **“Ofruesi i shërbimeve për inicim të pagesave”** është ofruesi i shërbimeve të pagesave që kryen shërbime të inicimit të pagesave;

18. **“Data e valutës”** është koha e referencës që ofruesi i shërbimeve të pagesave e shfrytëzon për llogaritjen e interesit të parave të huazuara ose të miratuara të llogarisë së pagesave;

19. **“Kartelë afariste e pagesës”** është çdo instrument i pagesës i bazuar në kartelë e cila është e lëshuar për persona juridikë ose subjekte të sektorit publik ose për ushtruesit e pavarur të veprimtarisë, që kufizohet për përdorim vetëm për mbulimin e shpenzimeve afariste, ku për pagesat e realizuara me përdorimin e saj caktohet llogaria e personit juridik ose subjektit të sektorit publik ose e ushtruesit të pavarur të veprimtarisë të cilit i është lëshuar kartelë e tillë e pagesës;

20. **“Përmbajtje digjitale”** është produkt ose shërbim që prodhohet dhe dorëzohet në formë digjitale, përdorimi ose konsumi i të cilit është i kufizuar në pajisje teknike dhe që në asnjë mënyrë nuk përfshin përdorimin ose harxhimin e produktit ose shërbimeve në formë materiale;

21. **“Debitimi direkt”** është shërbimi i pagesës me të cilën debitohet llogaria e pagesës së paguesit, ku transaksioni i pagesës iniciohet nga pranuesi në bazë të pëlqimit të shprehur të paguesit;

22. **“Besueshmëria”** është cilësi e shërbimeve të lidhura me pagesat ose veçorive të sigurisë së përdoruesit që mundëson që informacionet të mos jenë të disponueshme ose mos të zbulohen nga persona fizikë, juridikë ose proceseve të paautorizuara;

23. **“Tejkalimi i lejuar”** është lidhje e marrëveshjes për kredi, sipas së cilës ofruesi i shërbimeve të pagesave i vë në dispozicion përdoruesit të shërbimeve të pagesave vlerë të mjeteve financiare që tejkalon saldon rrjedhëse të mjeteve financiare në llogarinë e pagesës;

24. **“Dokumenti për arkëtim të detyrueshëm”** është urdhëresë për përmbarim nga përmbarues ose dokument tjetër përmbarimor i miratuar nga organi kompetent në përputhje me ligjin, të cilat lëshohen/miratojnë në bazë të dokumentit përmbarimor të përcaktuar në Ligjin e Përmbarimit;

25. **“Shteti - anëtar”** është shteti anëtar i Bashkimit Europian;

26. **“Shteti - anëtar nikoqir”** është shteti anëtar i Bashkimit Europian, i cili nuk është shtet amë-anëtar, në të cilin ofruesi i shërbimeve të pagesave ka filial ose agjent ose në mënyrë të drejtpërdrejtë ofron shërbime të pagesave;

27. **“Numri i vetëm tatimor”** përcaktohet në përputhje me Ligjin e Procedurës Tatimore;

28. **“Shenja e vetme identifikuese”** është kombinim shkronjash, numrash ose simbolesh që ofruesi i shërbimeve të pagesave i cakton përdoruesit të shërbimeve të pagesave dhe e cila gjatë kryerjes së transaksionit të pagesës detyrimisht duhet të përcaktohet për shkak të identifikimit të padyshimtë ose në llogarinë e tij të pagesës nga ana e përdoruesit tjetër të shërbimeve të pagesave;

29. **“Regjistri i vetëm i llogarisë”** është sistem nacional, i centralizuar dhe elektronik i informacioneve dhe i të dhënave për llogaritë në denarë dhe deviza, depozita ose llogari të tjera, duke përfshirë instrumentet e pagesave që lidhen me to, për kasafortat e lëshuara si dhe për identitetin e pronarëve të llogarive dhe kasafortave, pronarëve të vërtetë, të përfaqësuesve ligjor dhe/ose personave të cilët janë të autorizuar për të punuar me të njëjtit;

30. **“Rrjeti i komunikimit elektronik”** përcaktohet në përputhje me Ligjin e Komunikimeve Elektronike;

31. **“Shërbimi i komunikimit elektronik”** përcaktohet në përputhje me Ligjin e Komunikimeve Elektronike;

32. **“Posta elektronike”** është çdo mesazh elektronik që përmban informacione në formën e tekstit, zërit, videos ose fotografisë, i cili dërgohet nëpërmjet rrjetit të komunikimit elektronik dhe që mund të ruhet në rrjet ose në pajisje të lidhura kompjuterike ose të ruhet në pajisjen terminale të pranuesit të mesazhit;

33. **“Transaksioni i pagesës elektronike”** është transaksion i pagesës i iniciuar dhe kryer online dhe nuk përfshin transaksionet e pagesave në formë të letrës ose udhëzime të dhëna nëpërmjet postës ose telefonit;

34. **“Vulë kohore elektronike”** përcaktohet në përputhje me Ligjin e Dokumenteve Elektronike, të Identifikimit Elektronik dhe të Shërbimeve Konfidenciale;

35. **“Nënshkrimi elektronik”** përcaktohet në përputhje me Ligjin e Dokumenteve Elektronike, të Identifikimit Elektronik dhe të Shërbimeve Konfidenciale;

36. **“Para elektronike”** është vlerë financiare që ruhet në formë elektronike, duke përfshirë edhe formën magnetike, e lëshuar në bazë të pranimi të mjeteve financiare me qëllim të kryerjes së transaksioneve të pagesave, e cila është e pranuar si mjet për pagesë nga person fizik ose juridik, i ndryshëm nga lëshuesi i parasë elektronike dhe që paraqet kërkesë financiare nga emetuesi i parave elektronike;

37. **“Sistemi elektronik i arkëtimit të detyrueshëm”** është sistem nëpërmjet të cilit përmbaruesit dhe organet kompetente, në përputhje me ligjin, dorëzojnë urdhërpagesat për arkëtim të detyrueshëm deri te ofruesit e shërbimeve të pagesave të cilëve Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut i ka caktuar numër referencues, ndërkaq ofruesit e shërbimeve të pagesave shkëmbejnë informacione të ndërsjella për qëllimet e arkëtimit të detyrueshëm dhe i informojnë përmbaruesit dhe organet kompetente në pajtim me ligjin, për statusin e realizimit të urdhërpagesave për arkëtim të detyrueshëm;

38. **“Përdorimi i përbashkët i brendeve”** (“Co-branding”) nënkupton përfshirjen e të paktën një brendi të pagesës dhe të paktën një brendi të përgjithshëm që nuk është brend i pagesës së të njëjtit instrument të pagesës së bazuar në kartelë;

39. **“Vendosje e përbashkët e brendeve të pagesave”** (co-badging) është përfshirja e dy ose më shumë brendeve të pagesave ose aplikacioneve të pagesave nga i njëjti brend i pagesës në të njëjtin instrument të pagesës së bazuar në kartelë;

40. **“Kompensimi i zëvendësimit”** (interchange fee) është kompensim i cili, në mënyrë të drejtpërdrejt ose tërthorazi, nëpërmjet palës së tretë, llogaritet dhe paguhet për çdo transaksion të pagesës të krijuar në kartelë nga ofruesi i shërbimeve të pagesave që realizon pranimin e transaksioneve në dobi të ofruesit të shërbimeve të pagesave që e ka lëshuar instrumentin e pagesës të krijuar në kartelë. Ky kompensim përfshin gjithashtu edhe kompensimin neto ose formë tjetër të ngjashme shpërblimi;

41. **“Autentifikimi i përforcuar”** është përcaktimi i identitetit nëpërmjet përdorimit të të paktën dy prej tre elementëve të pavarur: njohuri (diçka që e di vetëm klienti), zotërim (diçka që posedon vetëm klienti) dhe cilësi (diçka që klienti është) prej ku shkelja e njërit prej elementeve nuk çënon besueshmërinë e të tjerëve dhe janë të krijuara në mënyrë që të sigurojnë mbrojtjen e konfidencialitetit të të dhënave që janë lëndë e verifikimit të autentifikimit;

42. **“Emetimi i instrumenteve të pagesës”** është shërbimi i pagesës së ofruesit të shërbimeve të pagesave në bazë të marrëveshjes me paguesin për sigurimin e instrumentit të pagesës për iniciimin dhe përpunimin e transaksioneve të pagesave të kryera nga ana e paguesit;

43. **“Shoqëri investimi”** është person juridik, veprimtaria kryesore e të cilit është ofrimi i një ose më shumë shërbimeve investuese ndaj personave të tretë dhe/ose kryerja e një ose më shumë aktiviteteve investuese në bazë profesionale, në përputhje me ligjin;

44. **“Pjesëmarrës indirekt në sistemin e pagesës”** është ofrues i shërbimeve të pagesave, shoqëri investimi, agjent shlyerjeje, shtëpi kleringu, palë kontraktuese qendrore, operator i sistemit të shlyerjes së letrave me vlerë ose operator i sistemit të pagesave, që ka lidhur marrëveshje me pjesëmarrës në sistemin e pagesave me të cilin i mundësohet të realizojë urdhëresë për bartje nëpërmjet sistemit të pagesave, me kusht që pjesëmarrësi indirekt të jetë i njohur për operatorin e sistemit të pagesave;

45. **“Institucioni i parave elektronike”** është shoqëria tregtare që ka marrë lejen për emetimin e parasë elektronike, në përputhje me këtë ligj;

46. **“Integriteti”** është cilësi e shërbimeve të lidhura me pagesat ose e veçorive të sigurisë së përdoruesit që mundëson ruajtjen e saktësisë dhe të tërësisë së mjeteve, përfshirë edhe të të dhënave;

47. **“Sisteme ndërvepruese”** janë dy ose më shumë sisteme të pagesave dhe/ose sisteme të shlyerjes së letrave me vlerë, operatorët e të cilave kanë lidhur në mes veti marrëveshje që u mundësojnë pjesëmarrësve në sisteme urdhëresa për bartje të futur në njërin sistem për t'u realizuar në sistem tjetër;

48. **“Skema e kartelës së pagesës”** (payment card scheme) është përmbledhje e vetme e rregullave, praktikave, standardeve dhe/ose udhëzimeve për kryerjen e transaksioneve të pagesave të krijuara me kartelë, të kontraktuara ndërmjet ofruesve të shërbimeve të pagesave, veçmas nga cilado infrastrukturë ose sistem të pagesës që do të mbështeste punën e saj dhe që përfshijnë organ të caktuar për vendimmarrje, organizatë ose subjekt që bartin përgjegjësinë për funksionimin e skemës;

49. **“Pjesëmarrje e kualifikuar”** është zotërimi i drejtpërdrejtë ose i tërthortë i të paktën 10% të numrit të përgjithshëm të aksioneve ose të aksioneve të lëshuara me të drejtë vote ose nga pjesëmarrja në institucionin e pagesës, institucionin e parasë elektronike ose operatorin e sistemit të pagesave, ose pjesëmarrje që mundëson realizimin e ndikimit të rëndësishëm në menaxhimin e institucionit të pagesave, institucionit të parasë elektronike ose operatorit të sistemit të pagesave;

50. **“Kliring”** (clearing) është transferimi, harmonizimi dhe në disa raste konfirmimi i transaksioneve përpara shlyerjes së tyre, i cili mund të përfshijë netimin e këtyre transaksioneve dhe përcaktimin e kushteve përfundimtare të shlyerjes;

51. **“Shtëpi kleringu”** është person juridik përgjegjës për llogaritjen e pozicioneve neto të pjesëmarrësve në sistemin e pagesave ose pjesëmarrësve në sistemin e shlyerjes së letrave me vlerë, i cili mund të veprojë edhe si palë kontraktuese qendrore dhe/ose agjent për shlyerje;

52. **“Kontrolli”** është zotërim i drejtpërdrejtë ose i tërthortë i shumicës së depozitimeve ose shumicës së të drejtave të votës në personin tjetër juridik ose të drejtë për të emëruar ose shkarkuar shumicën e anëtarëve të organeve drejtuese të personit tjetër juridik ose e drejta për të realizuar ndikim të rëndësishëm të drejtpërdrejtë ose tërthorazi në menaxhimin e politikave dhe miratimin e vendimeve financiare dhe afariste të personit tjetër juridik. Për nevojat e këtij ligji, supozohet të arrihet ndikim i rëndësishëm në menaxhimin dhe vendimmarrjen, pa përjashtim, kur në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë zotërohen së paku 20% të numrit të përgjithshëm të aksioneve ose të pjesëmarrjes, përkatësisht të ketë të paktën 20% e të drejtës së votës në kuvendin e aksionarëve ose mbledhjen e aksionarëve të personit tjetër juridik;

53. **“Përdoruesi i shërbimeve të pagesave”** është personi fizik ose juridik që përdor shërbime të pagesave në cilësinë e paguesit ose pranuesit ose në të dyja cilësitë;

54. **“Përdoruesi i shërbimeve të pagesave - debitor”** është personi fizik ose juridik, i cili figuron si debitor në urdhërpagesën për arkëtim të detyrueshëm;

55. **“Veçoritë e sigurisë së përdoruesit”** janë veçoritë personale që ofruesi i shërbimeve të pagesave i jep përdoruesit të shërbimeve të pagesave për qëllime të autentifikimit;

56. **“Përdorimi i shërbimeve nga persona të jashtëm”** (outsourcing) është transferim i pjesshëm ose i plotë i kryerjes së funksioneve operative që lidhen me ofrimin e shërbimeve të pagesave ose funksionimin e sistemit të pagesës të personit të jashtëm i cili bëhet në bazë të marrëveshjes me në formë të shkruar ndërmjet institucionit të pagesës, institucionit të parasë elektronike ose operatorit të sistemit të pagesës me person të jashtëm që kryen funksione operative në lidhje me ofrimin e shërbimeve të pagesave ose funksionimin e sistemit të pagesës me të cilin pa një transferim të tillë, këto funksione operative do të kryheshin nga ana e institucionit të pagesave, institucionit të parasë elektronike ose nga operatori i sistemit të pagesave;

57. **“Transferimi i kredisë”** është shërbim i pagesës me të cilin paguesi udhëzon ofruesin e shërbimeve të pagesave që mban llogarinë e tij të pagesave për kryerjen e transaksioneve të pagesave ose një sërë transaksionesh të pagesave me të cilën aprovohet llogaria e pagesave të pranuesit;

58. **“Person me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta në operatorin e sistemit të pagesave”** është personi fizik që është anëtar i këshillit mbikëqyrës, anëtar i këshillit udhëheqës, anëtar i këshillit të drejtorëve, anëtar i këshillit të revizionit, anëtar i këshillit për menaxhim me rreziqet, anëtari i këshillit për shpërblime dhe/ose këshilleve të tjera, si dhe persona të tjerë udhëheqës në operatorin e sistemit të pagesave të përcaktuara me statutin e operatorit;

59. **“Mandati”** është shprehja e pëlqimit nga ana e paguesit dhe dhënia e aprovimit të pranuesit dhe dhënësit të shërbimeve të pagesave (drejtpërdrejtë ose tërthorazi nëpërmjet pranuesit), në bazë të së cilit pranuesi mund të iniciojë pagesë të mjeteve financiare nëpërmjet debitimit të drejtpërdrejtë të llogarisë konkrete të caktuar të paguesit dhe që i mundëson ofruesit të shërbimeve të pagesave që ndaj paguesit të veprojë në përputhje me udhëzimet e tilla;

60. **“Numri i amzës i qytetarit”** përcaktohet në përputhje me Ligjin e Numrave të Amzës;

61. **“Shteti Amë - anëtar”** është shteti anëtar ku ndodhet adresa e regjistruar e ofruesit të shërbimeve të pagesave dhe nëse ofruesi i shërbimeve të pagesave nuk ka adresë të regjistruar në përputhje me legjislacionin e tij nacional, atëherë ai është shtet-anëtar në të cilin është drejtoria qendrore e tij;

62. **“Masa ndaj subjekteve mbikëqyrëse”** janë veprimet e ndërmarra nga guvernatori i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejme: Guvernatori) për eliminimin e mangësive, mospërputhjeve dhe/ose mosrespektimit të dispozitave të këtij ligji në funksionimin e subjekteve të mbikëqyrjes;

63. **“Kompensimi shumëpalësh i zëvendësimit”** (ang. shumëpalësh interchange fee) është kompensim zëvendësimi për transaksionet e pagesave për debitimet direkte, e cila është lëndë e rregullimit me marrëveshje lidhur ndërmjet tre ose më shumë ofruesve të shërbimeve të pagesave për krijimin e skemës së pagesës për debitime direkte e;

64. **“Person i jashtëm”** është personi fizik ose juridik, të cilit, në bazë të marrëveshjes së lidhur me institucionin e pagesës, institucionin për paranë elektronike ose operatorin të sistemit të pagesave, i bëhet bartja e pjesërishme ose e tërësishme e funksioneve operative të lidhura me ofrimin i shërbimeve të pagesave ose funksionimin e sistemit të pagesave;

65. **“Kompensimi nga pranuesi i pagesës”** (merchant service charge) është kompensim që ofruesi i shërbimeve të pagesave që kryen pranimin e transaksioneve të pagesave e llogarit dhe paguan nga marrësi i pagesës, në lidhje me transaksionet e pagesave të bazuara në kartelë;

66. **“Kompensim”** janë të gjitha shpenzimet dhe dënimet, nëse janë parashikuar, që konsumatori ka paguar ose duhet t'i paguajë ofruesit të shërbimeve të pagesave, për ose në lidhje me shërbimet që lidhen me llogarinë e pagesës;

67. **“Urdhëresë bartjeje”** është çdo udhëzim nga pjesëmarrësi në sistemin e pagesave dhe/ose në sistemin e shlyerjes së letrave me vlerë, për të vënë në dispozicion të pranuesit të urdhëresës vlerën e mjeteve financiare nëpërmjet regjistrimit të tij në llogarinë e ofruesit të

shërbimeve të pagesave, palës kontraktuese qendrore ose agjentit për shlyerje ose çdo udhëzim tjetër që rezulton në ndërmarrjen ose shlyerjen e detyrimit për pagesë siç përcaktohet me rregullat e funksionimit të sistemit të pagesave, ose udhëzim nga pjesëmarrësi i autorizuar në tregun e letrave me vlerë për të bartjen e të drejtës së pronësisë ose interesin në lidhje me një ose më shumë letra me vlerë, nëpërmjet regjistrimit të tij në llogari të letrave me vlerë në regjistër ose në mënyrë tjetër të përshtatshme;

68. **“Llogari joaktive”** është: 1) llogaria e pagesave të konsumatorit të ofruesit të shërbimeve të pagesave në të cilën pa ndërprerë në periudhën prej të paktën 24 muaj nuk janë kryer transaksione të pagesave të autorizuar nga konsumatori ose transaksionet e pagesave hyrëse, me përjashtim të llogaritjes dhe pagesës/arkëtimit të interesit dhe/ose çdo transaksion tjetër i pagesës i cili është i kryer në dobi të ofruesit të shërbimeve të pagesave ose në lidhje me dhënësin e shërbimeve të pagesave që nuk ka pasur komunikim të dokumentuar me shkrim, elektronik dhe/ose komunikim të regjistruar telefonik me konsumatorin ose personat e autorizuar për funksionimin me llogarinë e pagesës ose me përfaqësuesin e tij ligjor ose 2) llogari depozituese në lidhje me të cilën ofruesi i shërbimeve të pagesave nuk ka pasur komunikim të dokumentuar me shkrim, elektronik dhe/ose komunikim të regjistruar telefonik me konsumatorin ose personat e autorizuar për të punuar me llogarinë ose përfaqësuesin e tij ligjor në periudhë të pandërprerë prej të paktën dhjetë vjetësh;

69. **“Vazhdimësia”** është cilësi e proceseve, veprimeve dhe mjeteve të nevojshme për kryerjen e shërbimeve të lidhura me pagesat, që mundëson qasje të plotë dhe funksionimin e e nivelit të pranueshëm të paracaktuar të shërbimeve të lidhura me pagesat;

70. **“Netimi”** nënkupton konvertimin e kërkesave dhe detyrimeve që rrjedhin nga urdhëresat e transferimit të cilat pjesëmarrësi ose pjesëmarrësit i lëshojnë ose i pranojnë nga një ose më shumë pjesëmarrës të tjerë, në një kërkesë të vetme neto ose një detyrim neto që mund të kërkohej ose huazohet;

71. **“Kompensimi neto”** është vlera e përgjithshme e mjeteve financiare, zbritjeve ose stimujve të tjerë që ofruesi i shërbimeve të pagesave ka lëshuar instrumentin e pagesës, i pranon nga skema e pagesës me kartelë, ofruesi i shërbimeve të pagesave që pranon pagesën ose nga çdo ndërmjetësues tjetër në lidhje me transaksionet e pagesave të bazuara në kartelë ose aktivitete të tjera të ngjashme, të reduktuara me vlerën e mjeteve financiare, zbritjet ose stimujt e tjerë që ofruesi i shërbimeve të pagesave që ka lëshuar instrumentin e pagesës me kartelë i jep skemës së pagesave me kartelë në lidhje me këto transaksione të pagesave dhe këto aktivitete;

72. **“Mirëmbajtja e llogarisë së pagesës”** është shërbim i ofruesit të shërbimeve të pagesave për mbajtjen e llogarisë së pagesës që nuk ka statusin e llogarisë së pagesës joaktive, në mënyrë që të mund të përdoret nga përdoruesi i shërbimeve të pagesave për qëllime të kryerjes së transaksioneve të pagesave;

73. **“Online”** (ang. Online) është mundësia për t'u lidhur nëpërmjet rrjetit të disponueshëm të komunikimit publik, siç është interneti, me qëllim shfrytëzimin e një shërbimi të caktuar;

74. **“Incident operativ dhe i sigurisë”** është rast i vetëm ose një sërë rastesh të lidhura të cilat nuk janë të planifikuara nga ana e ofruesit të shërbimeve të pagesave, të cilat kanë ose mund të ndikojnë negativisht në integritetin, konfidencialitetin, qasjen, origjinalitetin dhe/ose vazhdimësinë e shërbimeve që janë të lidhura me pagesat;

75. **“Rreziku operativ”** është rreziku i humbjes për shkak të proceseve të brendshme të dobëta dhe jo të përshtatshme, burimeve njerëzore ose sistemeve ose për shkak të rasteve të jashtme, duke përfshirë rrezikun ligjor, si dhe rrezikun e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;

76. **“Funksion operativ në lidhje me ofrimin e shërbimeve të pagesave”** është çdo proces, shërbim ose aktivitet, ose pjesët përbërëse të tyre, që i kryen ofruesi i shërbimeve të pagesave ose operatori i sistemit të pagesave për shërbimet që lidhen me pagesën ose funksionimin e sistemit të pagesave;

77. **“Operator i sistemit të pagesave”** është person juridik që është ligjërisht përgjegjës për menaxhimin dhe funksionimin e sistemit të pagesave, i cili mund të veprojë edhe si agjent shlyerjeje, palë kontraktuese qendrore ose shtëpi shlyerjeje;

78. **“Dërgesa financiare”** është shërbim i pagesës në të cilin pranohen mjete financiare nga paguesi, me qëllim të bartjes së vlerës së duhur të mjeteve financiare të marrësi ose një ofrues tjetër shërbimeve të pagesës që vepron në emër dhe për llogari të marrësit dhe/ose të cilit mjetet financiare pranohen në emër dhe për llogari të marrësit dhe vihen në dispozicion të tij, pa hapur llogari të pagesës në emër të paguesit ose të marrësit;

79. **“Mjete financiare”** janë para të gatshme (para të letrës dhe monedha), para elektronike ose kërkesa të tjera financiare nga ofruesi i shërbimeve të pagesave (mjete në llogari);

80. **“Norma pasive e interesit”** është norma me të cilën llogaritet dhe paguhet interesi i mjeteve financiare që përdoruesi i shërbimeve të pagesave i mban në llogarinë e tij të pagesës;

81. **“Brend pagese”** është emër material ose digjital, shprehje, shenjë, simbol ose kombinim i tyre me të cilin mundet të caktohet skemë e pagesës me kartelë brenda së cilës kryhen transaksionet e pagesave të bazuara me kartelë;

82. **“Aplikacion pagese”** është softuer kompjuterik ose ekuivalent, i vendosur dhe/ose i evidentuar në kartelë, celular, kompjuter ose çdo pajisje tjetër teknologjike, që mundëson fillimin e transaksioneve të pagesave të bazuara me kartelë dhe i mundëson paguesit të lëshojë urdhërpagesa;

83. **“Institucioni i pagesës”** është shoqëria tregtare që ka marrë lejen për të dhënë shërbime të pagesës, në përputhje me këtë ligj;

84. **“Kartelë e pagesës”** është lloj instrumenti i pagesës që i mundëson paguesit të iniciojë transaksion me kartelë debitore ose kreditore dhe që mund të përdoret nga poseduesi për të paguar mallra dhe shërbime dhe/ose për të tërhequr dhe/ose depozituar para të gatshme;

85. **“Kartelë e pagesës me parapagim (e ashtuquajtura “pripejd” kartelë e pagesës)”** është lloj instrumenti i pagesës në të cilin ruhen paratë elektronike;

86. **“Llogaria e pagesës”** është llogaria që e mban ofruesi i shërbimeve të pagesave në emër të një ose më shumë përdoruesve të shërbimeve të pagesave dhe që përdoret për të kryer transaksione të pagesave;

87. **“Llogaria e pagesës me të ardhura të rregullta mujore”** është llogaria e pagesës në të cilën transferohen mjete për të cilat, sipas Ligjit të Tatimit mbi të Ardhurat Personale, rregullohet tatimi dhe pagesa e tatimit mbi të ardhurat personale dhe për të cilën llogari të pagesës Drejtoria e të Hyrave Publike e Republikës së Maqedonisë së Veriut ose Fondi i Sigurimit Pensional dhe Invalidor i Republikës së Maqedonisë së Veriut ka informacion në sistemet e tij;

88. **“Transaksion i pagesës”** është depozitimi, tërheqja ose transferimi i mjeteve financiare të iniciuara nga paguesi ose në emër të paguesit ose pranuesit, pavarësisht nga detyrimet që rrjedhin nga marrëdhënia në mes paguesit dhe pranuesit;

89. **“Transaksion i pagesës me kartelë debitore”** është transaksion i pagesës me kartelë, duke përfshirë edhe transaksion të pagesës me kartelë kreditore me parapagim, i cili nuk është transaksion i pagesës i bazuar në kartelë kreditore, me të cilën për vlerën e çdo transaksioni të pagesës së kryer duke përdorur kartelën debitore menjëherë ose në fund të një periudhe të paracaktuar, zvogëlohet gjendja e mjeteve financiare të disponueshme në llogarinë e pagesave të përdoruesit të shërbimeve të pagesave;

90. **“Transaksion i pagesës me kartelë kreditore”** është transaksion i pagesës me kartelë, ku vlera e transaksionit, tërësisht ose pjesërisht, debitohet nga paguesi, në një datë të caktuar paraprakisht të muajit, në bazë të marrëveshjes së veçantë për kredi të disponueshme e lidhur ndërmjet ofruesit të shërbimeve të pagesave dhe shfrytëzuesit të shërbimeve të pagesave, me të cilin përcaktohet nëse, në çfarë mase dhe në çfarë mënyre do të llogaritet dhe paguhet interesi për vlerën e huamarrjes;

91. **“Transaksion i pagesës i bazuar në kartelë”** është shërbim që bazohet në infrastrukturën dhe rregullat për funksionimin e skemës së pagesave me kartelë, për qëllimin e kryerjes së transaksionit të pagesës duke përdorur çfarëdo kartelë, pajisje telekomunikacioni, digjitale ose informacioni që mund të përmbajë aplikacion të përshtatshëm të pagesës dhe që rezulton me kryerjen e transaksionit me kartelë debitore ose kartelë kreditore, përveç transaksion të pagesës të bazuar në lloje të tjera të shërbimeve të pagesave;

92. **“Transaksion i pagesës nëpërmjet mjeteve të komunikimit në distancë”** është transaksion i pagesës që inicohet nëpërmjet internetit ose nëpërmjet pajisjes që mund të përdoret për komunikim në distancë;

93. **“Skema e pagesave”** është tërësi e vetme e rregullave, praktikave, standardeve dhe/ose udhëzimeve për kryerjen e transaksioneve të pagesave të kontraktuara në mes ofruesve të shërbimeve të pagesave, të cilat janë veçmas nga çdo infrastrukturë ose sistem të pagesës që do të mbështeste funksionimin e saj;

94. **“Instrument i pagesës”** është pajisja dhe/ose tërësi e procedurave të kontraktuara në mes përdoruesit të shërbimeve të pagesave dhe ofruesit të shërbimeve të pagesave dhe që përdoren për iniciimin e urdhërpagesës;

95. **“Instrument i pagesës i bazuar me kartelë”** është çdo instrument i pagesës, duke përfshirë kartelën, telefonin celular, kompjuterin ose çdo pajisje tjetër teknologjike që përfshin aplikacion të përshtatshëm të pagesës që i mundëson paguesit iniciimin e transaksionit të pagesës së bazuar në kartelë, i cili nuk është transferim kreditor ose debitim direkt;

96. **“Urdhërpagesë”** është çdo udhëzim i paguesit ose pranuesit deri te ofruesi e tij të shërbimeve të pagesave me të cilin kërkohet realizimi i transaksionit të pagesës;

97. **“Urdhërpagesë e arkëtimit të detyruar”** është urdhërpagesë nga përmbaruesi ose organ kompetent në përputhje me ligjin deri te ofruesi i shërbimeve të pagesave, me të cilin kërkohet ekzekutimi i transaksionit të pagesës në bazë të dokumentit për arkëtim të detyrueshëm;

98. **“Sistemi i pagesave”** është sistem për transferimin e mjeteve financiare i bazuar në marrëveshje formale dhe të standardizuara dhe në rregulla të përbashkëta për përpunimin, kliringun dhe/ose shlyerjen e urdhëresave të transfereve ndërmjet pjesëmarrësve në sistem;

99. **“Pagesë me përlllogaritje”** është shlyerja e ndërsjellë e detyrimeve financiare dhe e kërkesave ndërmjet pjesëmarrësve në qarkullimin e pagesave me kompensim, asignacion, cedim, ndërmarrje të borxhit dhe forma të tjera të shlyerjes së ndërsjellë të detyrimeve dhe të pagesave;

100. **“Paguesi”** është personi fizik ose juridik që ka llogari të pagesës dhe pajtohet të ekzekutojë urdhërpagesë nga ajo llogari në rast kur llogaria e pagesës nuk ekziston, personi fizik ose juridik që lëshon urdhërpagesë;

101. **“Filial”** është person juridik i kontrolluar nga person tjetër juridik (shoqëri amë) dhe është jashtë selisë së regjistruar të personit juridik, përkatësisht nëse nuk ka seli të regjistruar jashtë vendit ku ndodhet drejtoria qendrore. Personat juridikë që konsiderohen filiale të filialit konsiderohen si filial e shoqërisë amë;

102. **“Shlyerje” (Settlement)** është transferimi i mjeteve financiare dhe/ose i letrave me vlerë në llogaritë për shlyerje me qëllim përmbushjen e detyrimeve ndërmjet pjesëmarrësve në sistemet e pagesave dhe/ose në sistemet e shlyerjes së letrave me vlerë;

103. **“Ofrues ndërmjetësues i shërbimeve të pagesave”** është ofrues i shërbimeve të pagesave që nuk është ofrues i shërbimeve të pagesave të paguesit ose ofrues i shërbimeve të pagesave të pranuesit dhe që pranon dhe transferon mjetet financiare në emër të ofruesit të shërbimeve të pagesave të paguesit, në emër të ofruesit të shërbimeve të pagesave të pranuesit ose në emër të ofruesit tjetër ndërmjetësues të shërbimeve të pagesave;

104. **“Konsumator”** është personi fizik i cili lidh kontratë për shërbime të pagesave në përputhje me këtë ligj, me qëllim arritjen e qëllimeve që nuk janë të lidhura me kryerjen e veprimtarisë ose të profesionit të tij;

105. **“Konsumator me qëndrim të ligjshëm”** është çdo person fizik i cili ka regjistruar vendbanimin dhe/ose vendqëndrimin në Republikën e Maqedonisë së Veriut në pajtim me ligjin, leje të fituar për qëndrim të përkohshëm ose të përhershëm në përputhje me ligjin, kërkesë të parashtruar për pranimin e të drejtës për azil në përputhje me ligjin ose dokumente të vlefshme të lëshuara nga organi përgjegjës në Republikën e Maqedonisë së Veriut, të cilat nuk përmbajnë të dhëna për adresën e përhershme të vendqëndrimin;

106. **“Transaksion ndërkufitar i pagesës ose shërbim ndërkufitar i pagesës”** është transaksion i pagesës ose shërbim i pagesës në ekzekutimin e së cilës, përkatësisht të ofrimit, vetëm njëri nga ofruesit e shërbimeve të pagesave, pavarësisht nëse është i paguesit apo të pranuesit, është themeluar dhe vepron në Republikën e Maqedonisë së Veriut;

107. **“Saldo e heshtur e detyrueshme”** është pranimi i heshtur i tejkallimit të saldოს aktuale në llogarinë e pagesave të përdoruesit të shërbimeve të pagesave, ku ofruesi i shërbimeve të pagesave vë në dispozicion të përdoruesit të shërbimeve të pagesave mjete financiare në vlerë që e tejkallon saldon aktuale të mjeteve të veta financiare në llogarinë e pagesës ose nëse kanë marrëveshje për tejkallim të lejuar, e tejkallon vlerën e lejuar të tejkallimit;

108. **“Transferim i llogarisë së pagesës”** ose “shërbim për bartje” është zbatimi i transferimit me kërkesë të konsumatorit, nga një ofrues te një ofrues tjetër i shërbimeve të pagesës së: informacioneve për të gjitha urdhëresat e caktuara të përhershme për transfere kreditore, debitime direkte të përsëritura dhe transfere hyrëse kreditore që kryhen në dobi ose në barrë të llogarisë së pagesës dhe/ose të saldოს pozitive të mjeteve të veta financiare nga njëra në llogarinë tjetër të pagesës, me ose pa mbylljen e llogarisë së pagesës nga e cila kryhet transferimi;

109. **“Kompetencë profesionale”** posedon personi fizik nëse:

- ka arritur të paktën arsimin e lartë dhe
- ka gjashtë vjet përvojë pune në fushën e shërbimeve të pagesave ose sistemeve të pagesave, bankave ose shërbimeve të tjera financiare ose veprimtari tjetër ose tre vjet përvojë pune si anëtar i organit drejtues ose ka qenë person udhëheqës te një person juridik në një prej këtyre aktiviteteve;

110. **“Pranues”** është personi fizik ose juridik për të cilin janë të caktuara mjetet monetare që janë objekt i transaksionit të pagesës;

111. **“Pranimi i transaksioneve të pagesave”** është shërbim i pagesës që e jep ofruesi i shërbimeve të pagesave në bazë të marrëveshjes me pranuesin për pranimin dhe përpunimin e transaksioneve të pagesave, që rezulton me transferimin e mjeteve financiare te pranuesi;

112. **“Vlera mesatare e parave të lëshuara elektronike të pashfrytëzuara”** është shuma mesatare totale e detyrimeve financiare të dhënësit të parasë elektronike në lidhje me paranë e lëshuar elektronike të papërdorur me gjendjen në fund të çdo dite kalendarike gjatë gjashtë muajve të mëparshëm kalendarik, duke llogaritur në ditën e parë kalendarike nga secili muaj kalendarik dhe që zbatohet për të njëjtin muaj kalendarik;

113. **“Ditë pune”** është dita në të cilën ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit ose ofruesi i shërbimeve të pagesave të pranuesit i përfshirë në kryerjen e transaksionit të pagesës është i hapur për punë për të mundësuar kryerjen e transaksionit të pagesës, përkatësisht periudhë e përcaktuar nga rregullat e funksionimit të sistemit të pagesave dhe sistemit të shlyerjes të letrave me vlerë i cili i përfshin të gjitha rastet gjatë kohës së ciklit të punës së këtyre sistemeve, pavarësisht në cilën periudhë të ditës dhe natës ndodhin shlyerjet;

114. **“Disponueshmëria”** është mundësia e qasjes dhe përdorimit të pandërprerë të shërbimeve të lidhura me pagesat nga përdoruesit e shërbimeve të pagesave;

115. “Mjetet e disponueshme financiare për arkëtim të detyruar” janë të gjitha mjetet financiare në llogaritë e përdoruesit të shërbimeve të pagesave - debitor të ofruesi i shërbimeve të pagesave, përveç mjeteve financiare në llogaritë për qëllime të veçanta të cilat janë të ndara në përputhje me ligjin ose rregulloren e miratuar në bazë të ligjit dhe mjetet financiare të miratuara sipas marrëveshjes për tejkalim të lejuar me ofruesin e shërbimeve të pagesave;

116. **“Regjistri i institucioneve të pagesave”** është libër publik që udhëhiqet nga Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut në formë elektronike dhe në të cilën përfshihen të dhëna për institucionet e pagesave, institucionet e pagesave me qasje të lehtësuara, agjentët e institucioneve të pagesave dhe institucionet e pagesave me qasje të lehtësuara në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe për degët e institucioneve të pagesave në shtet - anëtar nikoqir dhe/ose në shtet të tretë;

117. **“Regjistri i institucioneve të parasë elektronike”** është libër publik që udhëhiqet nga Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut në formë elektronike dhe në të cilën përfshihen të dhëna për institucionet e pagesave, institucionet e pagesave me qasje të lehtësuara, agjentët e institucioneve të pagesave dhe institucionet e pagesave me qasje të lehtësuara në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe për degët e institucioneve të pagesave në shtet - anëtar nikoqir dhe/ose në vend të tretë;

118. **“Regjistri i operatorëve të sistemit të pagesave”** është libër publik që udhëhiqet nga Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut në formë elektronike dhe i cili përfshin të dhëna për operatorët e sistemit të pagesave;

119. **“Reputacion”** nënkupton ndershmërinë, kompetencën, zellshmërinë dhe zotërimin e integritetit dhe cilësive personale që ofrojnë siguri se personi nuk do të ndikojë në drejtim të rrezikimit të stabilitetit dhe sigurisë së institucionit të pagesave, institucionit të parasë elektronike dhe/ose operatorit të sistemit të pagesave dhe që nuk do të dëmtojë reputacionin dhe besimin e publikut në institucionin e pagesave, institucionin e parasë elektronike, operatorin e sistemit të pagesave dhe/ose sistemin e pagesave;

120. **“Kurs devizor referent”** është kursi devizor që përdoret si bazë për përlllogaritjen gjatë blerjes ose shitjes së mjeteve të huaja të pagesave dhe që ofruesi i shërbimeve të pagesave e vë në dispozicion ose që buron nga një burim publikisht i disponueshëm;

121. **“Norma referente e interesit”** është norma e interesit që përdoret si bazë për çdo përlllogaritje të interesit dhe që vjen nga një burim publikisht i disponueshëm dhe që mund të kontrollohet nga të dyja palët kontraktuese në marrëveshjen e shërbimeve të pagesave;

122. **“Transaksioni R”** është transaksion i pagesës që nuk mund të kryhet në mënyrë korrekte dhe të saktë nga ofruesi i shërbimeve të pagesave ose që shkakton përpunim të pazakontë, mes të tjerash e shkaktuar nga mungesa e mjeteve monetare, revokimin e transaksionit të pagesës, shumën e gabuar ose datën e gabuar, mandat jo legjitim, llogari e gabuar ose e mbyllur e pagesës (transaksion i refuzuar, transaksion i hedhur, transaksioni i kthyer, transaksion i revokuar, transaksioni i ndërprerë, transaksion me të cilin është parashtruar kërkesë për anulim dhe Transaksion me kërkesë për kthimin e mjeteve financiare), përveç transaksionit i cili është i anuluar dhe nuk është ekzekutuar për shkak të zbatimit të masave dhe veprimeve për zbulimin dhe parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit nga ana e ofruesve të shërbimeve të pagesave;

123. **“Rreziku i sigurisë”** është rrezik që rrjedh nga procese jo të përshtatshme ose procese të dobëta të brendshme ose nga ngjarje të jashtme që kanë ose mund të kenë ndikim negativ në disponueshmërinë, integritetin dhe besueshmërinë e sistemeve të informacionit dhe të sistemeve të teknologjisë së komunikimit dhe/ose informacioneve që përdoren për ofrimin e shërbimeve të pagesave, duke përfshirë edhe rrezikun nga sulmet e hapësirës digjitale dhe sigurinë jo të përshtatshme fizike;

124. **“Sistemi i shlyerjes së letrave me vlerë”** është marrëveshje formale ndërmjet tre ose më shumë pjesëmarrësve të autorizuar në tregun e letrave me vlerë, të cilët janë persona juridikë, në të cilët nuk janë përfshirë operatori i sistemit, agjentët për shlyerje, palët kontraktuese qendrore, palët e kliringut, shtëpitë e kliringut dhe pjesëmarrësit indirekt, me rregulla të përbashkëta dhe marrëveshje të standardizuara të kliringut, pavarësisht nëse kliringu është nëpërmjet palës kontraktuese qendrore ose për ekzekutimin e urdhërësave të transferimit ndërmjet pjesëmarrësve të autorizuar në tregun e letrave me vlerë;

125. **“Llogaria e shlyerjes”** është llogari në Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në agjentin e shlyerjes ose në palën kontraktuese qendrore që përdoret për ruajtjen e mjeteve financiare ose letrave me vlerë dhe për shlyerjen e transaksioneve ndërmjet pjesëmarrësve në sistemin e pagesave ose në sistemin për shlyerjen e letrave me vlerë;

126. **“Bashkëpunëtor”** është personi fizik i cili së bashku me personin fizik ka për qëllim të fitojë pjesëmarrje të kualifikuar në përputhje me këtë ligj ose së bashku me personin fizik i cili është i propozuar për drejtues, anëtar të këshillit drejtues ose anëtar ekzekutiv të këshillit të drejtorëve të institucionit të pagesave, institucionit të parasë elektronike ose operatorit të sistemit të pagesave në mënyrë direkte ose indirekte dhe/ose nëpërmjet marrëveshjes, realizon kontroll mbi shoqërinë tregtare vendase ose të huaj;

127. **“Mjete për sigurim”** janë të gjitha mjetet që mund të shndërrohen në para, duke përfshirë, pa kufizim, sigurinë financiare siç përcaktohet me ligj, mjetet e lëna si kolateral (përfshirë mjetet financiare të lëna si kolateral), marrëveshje repo ose marrëveshje të ngjashme, ose të marra në mënyrë tjetër, ndërkaq për qëllimet e sigurimit të të drejtave dhe detyrimeve që potencialisht mund të dalin në lidhje me sistemin e pagesave ose me sistemin e shlyerjes së letrave me vlerë ose çfarëdo mjete të cilat janë dhënë si siguri e Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut në përputhje me Ligjin e Bankës Popullore të Republikës të Maqedonisë së Veriut;

128. **“Pajisje për komunikim në distancë”** është mjeti me të cilin mund të lidhet marrëveshje për shërbime të pagesave njëkohësisht pa praninë fizike të ofruesit të shërbimeve të pagesave dhe të përdoruesit të shërbimeve të pagesave;

129. **“Subjekti i mbikëqyrjes”** është çdo person juridik mbi të cilin Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut mbikëqyr punën në pajtim me këtë ligj;

130. **“Subjekt që kryen procesim”** është çdo person juridik që kryen veprimtari për procesimin e transaksioneve të pagesave të bazuara me kartelë;

131. **“Medium i përhershëm”** është çdo instrument që i mundëson që përdoruesi i shërbimeve të pagesave t'i ruajë informacionet që janë të drejtuara personalisht deri te ai në mënyrë që i mundësohet të jenë të disponueshme në periudhë të caktuar kohore të përshtatshme për qëllimet e përdorimit të tyre dhe që lejon riprodhim të pandryshueshëm të informacioneve të ruajtura;

132. **“Urdhëresë e përhershme”** është udhëzimi i dhënë nga pagesi i ofruesit të shërbimeve të pagesave që mban llogarinë e pagesave, për kryerjen e transfereve kreditore në intervale të rregullta kohore ose paraprakisht në data të caktuara;

133. **“Thesari”** është njësi organizative në kuadër të Ministrisë së Financave të Republikës së Maqedonisë së Veriut e cila në bazë të rregullores së veçantë menaxhon sistemin e llogarive të thesarit, siguron shërbime për shfrytëzuesit buxhetorë dhe kryen punë të tjera të përcaktuara me ligj;

134. **“Thesari i Fondit”** është njësi organizative në kuadër të Fondit për Sigurim Shëndetësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut e cila në bazë të rregullores së veçantë menaxhon sistemin e llogarisë së thesarit shëndetësor, ofron shërbime për institucionet publike shëndetësore dhe kryen veprimtari të tjera të përcaktuara me ligj;

135. **“Llogaria e Thesarit”** është llogari e pagesës që udhëhiqet në Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe e cila përfshin sistem të llogarive të pagesave të menaxhuara nga Thesari, nëpërmjet së cilës regjistrohen hyrjet dhe daljet për shfrytëzuesit buxhetorë;

136. **“Llogaria e thesarit të shëndetësisë”** është llogari e pagesës që udhëhiqet në Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe përfshin sistem të llogarive të pagesave të menaxhuara nga Thesari i Fondit nëpërmjet të cilit evidentohen hyrjet dhe daljet për institucionet publike shëndetësore;

137. **“Shteti i tretë”** është çdo vend deri në anëtarësimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në Bashkimin Europian, dhe pas anëtarësimit të çdo vendi që nuk është shtet-anëtar;

138. **“Skema e pagesave me kartelë me tripalëshe”** është skemë e pagesës me kartelë, në të cilën vetë skema e pagesave me kartelë ofron shërbime të pranimi të transaksioneve të pagesave dhe shërbime të lëshimit të kartelave të pagesave ndërkaq transaksionet e pagesave me kartelë kryhen nga llogaria e pagesës së paguesit drejt llogarisë së pagesës së marrësit në kuadër të asaj skeme, me përjashtim të rasteve kur skema e pagesave me kartelë në tre anë ka autorizuar ndonjë ofrues tjetër të shërbimeve të pagesave të lëshojë instrumente të pagesave të bazuara në kartelë dhe/ose pranimin e transaksioneve të pagesave të bazuara në kartelë ose i lëshon instrumentet e pagesave të bazuara në kartelë së bashku me partner të kontraktuar nëpërmjet përdorimit të përbashkët të brendeve ose i lëshon ato nëpërmjet përfaqësuesit, kur konsiderohet se është skemë e pagesës me kartelë me katër anë;

139. **“Shërbimi i dhënies së informacioneve të llogarisë së pagesës”** është shërbim online për ofrimin e informacioneve të përmbledhura për një ose më shumë llogari të pagesave të përdoruesit të shërbimeve të pagesave që mbahen nga një ose më shumë ofrues të tjerë të shërbimeve të pagesave;

140. **“Shërbimi i mbrojtjes së besueshmërisë gjatë transaksioneve elektronike”** përcaktohet në përputhje me Ligjin e Dokumenteve Elektronike, të Identifikimit Elektronik dhe të Shërbimeve Konfidenciale;

141. **“Shërbimi i inicimit të pagesës”** është shërbimi për inicimin e një urdhërpagese me kërkesë të përdoruesit të shërbimeve të pagesave nga llogaria e tij e pagesave të cilën e mban nga një ofrues tjetër i shërbimeve të pagesës;

142. **“Shërbime që lidhen me llogarinë e pagesave”** janë të gjitha shërbimet që kanë të bëjnë me hapjen, mirëmbajtjen dhe mbylljen e llogarisë së pagesave, duke përfshirë transaksionet e pagesave nga neni 3 paragrafi (1) pika 7 të këtij ligji si dhe me marrëveshje tejkalimin e lejuar si dhe saldon detyrimore heshturazi të toleruar;

143. **“Shërbime të lidhura me pagesat”** janë të gjitha shërbimet e pagesave të cekura në nenin 8 të këtij ligji, duke përfshirë të gjitha veprimet e mbështetjes teknike të nevojshme për kryerjen e saktë të shërbimeve të pagesave;

144. **“Filial”** është njësi organizative e institucionit të pagesave, përkatësisht institucionit të parasë elektronike, pa cilësinë e personit juridik dhe që kryen drejtpërdrejt një pjesë ose të gjitha shërbimet e pagesave që janë pjesë e veprimtarisë së institucionit të pagesave, përkatësisht institucioni për paranë elektronike, që vepron në fushën juridike në emër dhe për llogari të tyre;

145. **“Pala kontraktuese qendrore”** është person juridik që vepron në mes pjesëmarrësve në sistemin e pagesave ose ndërmjet pjesëmarrësve në sistemin e shlyerjes së letrave me vlerë si palë kontraktuese ekskluzive e pjesëmarrësve në lidhje me ekzekutimin e urdhrave të transferimit të tyre;

146. **“Skema katërpalëshe e pagesës me kartelë”** është skemë e pagesës me kartelë, në të cilën transaksionet e pagesave të bazuara në kartelë kryhen nga llogaria e pagesave të paguesit në llogarinë e pagesave të pranuesit nëpërmjet kësaj skeme, ofruesit të shërbimeve të pagesave që ka lëshuar kartelën e pagesës (në anën e paguesit) dhe ofruesit të shërbimeve të pagesave që bën pranimin e transaksionet e pagesave (në anën e pranuesit);

147. **“Të dhënat sensitive të pagesave”** janë të dhëna, duke përfshirë veçoritë e sigurisë së përdoruesit, që mund të përdoren për të kryer mashtrime, përveç të dhënave për emrin e pronarit, përfaqësuesit ligjor dhe/ose personave që janë të autorizuar për të operuar me llogarinë e pagesës si dhe numrin e llogarisë së pagesës gjatë kryerjes së shërbimeve për iniciimin e pagesës dhe shërbimet për dhënien e informacioneve për llogaritë e pagesave.

(2) Termet e përdorura në këtë ligj në raport me funksionimin e Portalit Nacional të Shërbimeve Elektronike dhe Platformës Nationale të Ndërveprueshmërisë, kuptimi i të cilave nuk është përcaktuar në paragrafin (1) të këtij neni, kanë kuptimin e përcaktuar me Ligjin e Dokumenteve Elektronike, të Identifikimit Elektronik dhe të Shërbimeve Konfidenciale dhe Ligjin e Menaxhimit Elektronik dhe të Shërbimeve Elektronike.

Shërbime dhe transaksione pagesash për të cilat nuk zbatohen dispozitat e ligjit

Neni 3

(1) Dispozitat e pjesës së dytë, të tretë, të katërt dhe të pestë të këtij ligji nuk zbatohen për:

1) transaksionet e pagesave që kryhen ekskluzivisht me para të gatshme, drejtpërdrejt nga pagesi te pranuesi, pa përfshirjen e ndërmjetësuesit;

2) transaksionet e pagesave ndërmjet pagesit dhe pranuesit nëpërmjet përfaqësuesit komercial, i cili në bazë të marrëveshjes me pagesin ose me pranuesit, është i autorizuar të negociojë dhe të lidhë marrëveshje për shitblerjen e mallrave ose shërbimeve vetëm në emër të pagesit ose vetëm në emër të pranuesit;

3) transportin fizik profesional të kartëmonedhave dhe monedhave të metalit, duke përfshirë edhe mbledhjen, përpunimin dhe dorëzimin e tyre;

4) transaksionet e pagesave që lidhen me grumbullimin dhe dërgimin joprofesional të parave të gatshme në kuadër të veprimtarisë jofitimprurëse ose bamirëse;

5) shërbimet ku marrësi i pagesës i jep para të gatshme pagesit si pjesë e transaksionit të pagesës me kërkesë të qartë të shfrytëzuesit të shërbimeve të pagesave të ofruara para ekzekutimit të transaksionit të pagesës në kuadër të pagesës gjatë blerjes së mallrave ose shërbimeve;

6) funksionimi i këmbimit që përbëhet nga blerja dhe shitja e parave të huaja për para të gatshme të brendshme, kur paratë e gatshme nuk ruhen në llogarinë e pagesave;

7) transaksionet e pagesave të bazuara në ndonjërin nga dokumentet e mëposhtme që janë të parashtruara për pagesë të ofruesit të shërbimeve të pagesave, me qëllim të vënies në dispozicion të mjeteve financiare për pranuesin e pagesës, përveç nëse me këtë ligj nuk është e rregulluar ndryshe:

a) çeket në letër dhe kambialet në letër në përputhje me Ligjin e Çeqeve dhe Ligjin e Kambialit;

b) çeket e huaja në letër që janë në përputhje me Konventën e Gjenevës të datës 19 mars 1931 e cila i referohet ligjit të njëjlojshëm për çeket, si dhe çeket në letër të rregulluara nga ligjet e vendeve të huaja që nuk janë palë të Konventës së Gjenevës të datës 19 mars 1931 dhe që në përmbajtjen dhe veprimin e tyre janë të ngjashëm me ato të nënpikës a) të kësaj pike;

c) kambialet e huaja në letër që janë në përputhje me Konventën e Gjenevës të 7 qershorit 1930 e cila i referohet ligjit të njëjtrajtshëm për kambialet trasuara dhe kambialet e veta si dhe kambialet në letër të rregulluara me ligjet e vendeve të huaja që nuk janë palë të Konventës së Gjenevës të datës 7 qershorit 1930, të cilat në përmbajtjen dhe efektin e tyre janë të ngjashme me ato të nënpikës a) të kësaj pike;

d) vauçerë në letër;

e) çekë udhëtimi në letër;

g) dërgesat postare në letër të përcaktuara nga Unioni Postar Botëror.

8) transaksionet e pagesave të kryera brenda sistemit të pagesave ose sistemit të shlyerjes së letrave me vlerë ndërmjet agjentëve të shlyerjes, palëve kontraktuese qendrore, shtëpive të kliringut dhe/ose bankave qendrore dhe pjesëmarrësve të tjerë në sistem, si dhe transaksionet e pagesave në lidhje me pjesëmarrjen në sistemet e pagesave ose sistemet e shlyerjes së letrave me vlerë që kryhen ndërmjet pjesëmarrësve në ato sisteme dhe ofruesve të shërbimeve të pagesave që nuk janë pjesëmarrës në sisteme, pa e vënë në pikëpyetje zbatimin e nenit 135 të këtij ligji;

9) transaksionet e pagesave që rrjedhin nga kujdestaria dhe shërbimet e ngjashme me letra me vlerë, duke përfshirë pagesën e dividendëve, interesit dhe pagesave të tjera në bazë të të drejtave që rrjedhin nga letrat me vlerë dhe transaksionet e pagesave që lidhen me blerjen ose shitjen e letrave me vlerë; nëse transaksionet e tilla kryhen nga personi i theksuar në pikën 8 të këtij paragrafi ose personi tjetër i cili në përputhje me rregulloret kryen shërbime investimi, menaxhim profesional me mjetet investuese, shërbime në llogari të fondeve investuese ose fondeve pensionale, si dhe shërbime të ruajtjes së pronës ose shërbime të ruajtjes së letrave me vlerë në pronësi të klientëve të tyre;

10) shërbime të siguruara nga ana e personave që ofrojnë shërbime teknike që mbështesin ofrimin e shërbimeve të pagesave, pa hyrë në asnjë moment në zotërim të mjeteve financiare që do të jenë lëndë e transaksionit, duke përfshirë shërbimet e përpunimit dhe ruajtjes së të dhënave, shërbimet për mbrojtjen e besueshmërisë gjatë transaksioneve elektronike dhe shërbimet për mbrojtjen e privatësisë, shërbimet për autentifikimin e të dhënave dhe personave, shërbimet për sigurimin e teknologjisë së informacionit dhe rrjetit të komunikimit, shërbimet për sigurimin dhe mirëmbajtjen e terminaleve dhe pajisjeve që përdoren për ofrimin e shërbimeve të pagesave, duke përfshirë shërbimet e nisjes së pagesave dhe shërbimet për dhënien e informacioneve për llogaritë e pagesave;

11) shërbime të bazuara në instrumente të pagesës, duke përfshirë edhe nëse paratë elektronike ruhen në këto instrumente të pagesës, të cilat mund të përdoren vetëm në mënyrë të kufizuar dhe që plotësojnë një nga kushtet e mëposhtme:

a) instrumentet i mundësojnë poseduesit të blejë mallra ose shërbime vetëm në ambientet e lëshuesit ose në rrjet të kufizuar të ofruesve të shërbimeve, të cilët kanë marrëveshje të tregtisë së drejtpërdrejtë me lëshuesin e instrumenteve;

b) instrumente që mund të përdoren vetëm për fitimin e një game shumë të kufizuar të mallrave ose shërbimeve;

c) instrumente të vlefshme vetëm në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, të lëshuara me kërkesë të personit juridik ose subjektit të sektorit publik dhe të rregulluara nga ana e organit i administratës shtetërore ose organit të njësisë të vetëqeverisjes lokale, për qëllime sociale ose tatimore, për blerjen e mallrave ose shërbimeve të caktuara nga furnizues që kanë marrëveshje me lëshuesin e instrumentit;

12) transaksionet e pagesave, duke përfshirë edhe transaksionet e pagesave me para elektronike, të cilat kryen nëpërmjet operatorit të rrjetit të komunikimeve elektronike ose ofruesit të shërbimit të komunikimeve elektronike, të cilat i ofrohen parapaguesit të rrjetit ose shërbimit si plotësim i shërbimeve të komunikimeve elektronike, pavarësisht nëse parapaguesi i rrjetit ose shërbimit paraprakisht ose më pas, i paguan mjetet e ofruesit të rrjetit të komunikimit elektronik ose të shërbimit me kusht që vlera e transaksionit individual të pagesës nga nënpikat a) ose b) nga kjo pikë të mos kalojë 3.000 denarë ose në kundërvlerë përkatëse në valuta të tjera dhe vlera e përgjithshme mujore e transaksioneve të pagesave të parapaguesit individual të mos e kalojë 18.000 denarë ose në kundërvlerë përkatëse në valuta të tjera si më poshtë:

a) për blerjen e përmbajtjes digjitale dhe shërbimeve zanore, pavarësisht nga pajisja që përdoret për blerjen ose konsumimin e përmbajtjes digjitale dhe që paguhen nëpërmjet dorëzimit të llogarisë ose faturës adekuate të parapaguesit ose

b) kryhen me ose nëpërmjet pajisjes elektronike, për qëllime bamirësie ose për blerjen e biletave hyrëse dhe paguhën së bashku me shërbimet e komunikimit elektronik dorëzimit të llogarisë ose faturës adekuate të parapaguesit;

13) transaksionet e pagesave të kryera ndërmjet ofruesve të shërbimeve të pagesave, agjentëve të tyre ose filialeve për llogari të tyre;

14) transaksionet e pagesave dhe me to shërbimet e ndërlidhura të kryera ndërmjet shoqërisë amë dhe filialit ose ndërmjet filialeve të së njëjtës shoqëri amë, pa ndërmjetësimin e ofruesit të shërbimeve të pagesave, me përjashtim të ofruesit të shërbimeve të pagesave që i përket të njëjtit grup të shoqërive të ndërlidhura;

15) Shërbimet e tërheqjes së parave të gatshme nëpërmjet bankomatëve që ofrohen nga ofruesit e shërbimeve që veprojnë në emër të një ose më shumë lëshuesve të kartelave të pagesës, ku këta ofrues të shërbimeve nuk janë palë kontraktuese në marrëveshjen kornizë me përdoruesin e shërbimeve të pagesave që tërheq para të gatshme nga llogaria e tij e pagesave dhe nuk zbatojnë shërbime të tjera të pagesave nga neni i këtij ligji, por janë të detyruar të informojnë shfrytëzuesin e shërbimeve të pagesave për të gjitha kompensimet e tërheqjes së parave të gatshme përpara kryerjes së transaksionit të pagesës për tërheqjen e parave të gatshme, në pajtim me nenet 45, 49, 51 dhe 52 të këtij ligji, si dhe gjatë tërheqjes së parave të gatshme, në vërtetimin që lëshohet në fund të transaksionit.

(2) Për transaksionet e pagesave që kryhen ekskluzivisht me para të gatshme, drejtpërdrejt nga paguesi te pranuesi, pa përfshirjen e ndërmjetësuesit, sipas paragrafit (1) pika 1) të këtij neni, zbatohet dispozita nga neni 77 paragrafi (5) nga ky ligj.

(3) Lëshuesi i instrumenteve të pagesës i cili ka për qëllim të lëshojë instrumentet e pagesës sipas paragrafit (1) pika 11 nënpikat a) dhe/ose b) të këtij neni është i detyruar:

1) para fillimit të lëshimit, të informojë Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejme: Banka Popullore), me përshkrim të shërbimeve të ofruara dhe shpjegim për përmbushjen e kushtit adekuat të përjashtimit që zbatohet për këto shërbime; dhe

2) pas lëshimit të instrumenteve të pagesës, në baza të rregullta vjetore dhe më së voni deri në fund të tremujorit të parë të vitit aktual, të informojë Bankën Popullore për vlerën e përgjithshme të transaksioneve të pagesave që janë kryer gjatë 12 muajve paraprak.

(4) Guvernatori në bazë të njoftimeve sipas paragrafit (3) të këtij neni dhe në bazë të kriterëve sipas paragrafit (1) pika 11 nënpikat a) dhe b) të këtij neni vlerëson përmbushjen e kushteve për kufizimin e rrjetit në paragrafin (1) pika 11 nënpika a) të këtij neni ose kufizimi i fushës së veprimit të mallrave ose shërbimeve të përmendura në paragrafin (1) pika 11 nënpika b) të këtij neni dhe në afat prej 90 ditësh nga dita e marrjes së njoftimit, e njofton parashtruesin lëshuesin e instrumenteve të pagesës sipas paragrafit (2) të këtij neni se:

1) mund të fillojë përkatësisht të vazhdojë me lëshimin e instrumenteve të pagesës ose

2) të parashtojë kërkesë për marrjen e lejes për ofrimin e shërbimeve të pagesave në pajtim me këtë ligj, në afat jo më të gjatë se 180 ditë nëse konstaton se instrumentet e pagesës nuk e plotësojnë kushtin për përjashtim të paragrafit (1) pika 11 nënpikat a) ose b) të këtij neni.

(5) Guvernatori gjatë zbatimit të vlerësimit sipas paragrafit (4) të këtij neni udhëhiqet nga nevoja për mbrojtjen e interesave të konsumatorëve si dhe të ofruesve të tjerë të shërbimeve të pagesave të cilët nuk duhet të vendosen në pozitë të papërshtatshme nga lëshuesi i instrumenteve të pagesës sipas paragrafit (3) të këtij neni.

(6) Operatori i rrjeteve të komunikimit elektronik ose ofruesi i shërbimeve të komunikimit elektronik është i detyruar ta informojë Bankën Popullore para se të fillojë të ofrojë shërbimet sipas paragrafit (1) pika 12 të këtij neni, e më së voni deri në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit aktual t'i dorëzojë Bankës Popullore mendimin e revizorit të pavarur me të cilin vërtetohet se në vitin paraprak është plotësuar kushti për përjashtim të paragrafit (1) pika 12 të këtij neni.

(7) Nëse nuk plotësohet kushti për përjashtim të paragrafit (1) pika 12 të këtij neni, operatori i rrjeteve të komunikimeve elektronike ose ofruesi i shërbimeve të komunikimeve elektronike do të paraqesë kërkesë për marrjen e lejes për ofrimin e shërbimeve të pagesave në pajtim me këtë ligj, në afat jo më gjatë se 180 ditë.

(8) Këshilli i Bankës Popullore me akt nënligjor më hollësisht e përcakton mënyrën e njoftimit nga paragrafët (3) dhe (6) të këtij neni, si dhe vlerësimin e përmbushjes së kushteve sipas paragrafit (1) pika 11 e këtij neni.

Njoftimi i Trupit Bankar European

Neni 4

Banka Popullore e informon Trupin Bankar European për shërbimet për të cilat ka marrë njoftim në pajtim me nenin 3 paragrafët (4) dhe (6) të këtij ligji duke theksuar se sipas cilit përjashtim nga neni 3 paragrafi (1) pikat 11 dhe 12 të këtij ligji kryhet veprimtaria.

Zbatimi subsidiar i ligjeve të tjera

Neni 5

(1) Në procedurën për miratimin e Aktvendimeve në pajtim me dispozitat e këtij ligji, në mënyrë të përshtatshme zbatohen dispozitat e Ligjit të Procedurës së Përgjithshme Administrative, përveç nëse me Ligjin e Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut ose me këtë ligj nuk është e rregulluar ndryshe.

(2) Parashtrimi i kërkesave dhe/ose njoftimeve në Bankën Popullore dhe dorëzimi i aktvendimeve, lejeve, njoftimeve dhe/ose pëlqimeve nga Banka Popullore deri te personat të cilëve u referohen të njëjtat, si dhe në procedurat për sigurimin e dokumenteve, të dhënave dhe / ose informacione nga ana e Bankës Popullore nga organet kompetente që ofrojnë shërbime administrative kryhen nëpërmjet Portalit Nacional të Shërbimeve Elektronike dhe Platformës Nacionale të Ndërveprueshmërisë dhe në mënyrë të përshtatshme zbatohen dispozitat e Ligjit të Menaxhimit Elektronik dhe të Shërbimeve Elektronike.

(3) Për çdo gjë që nuk është e rregulluar me këtë ligj në lidhje me themelimin e marrëdhënieve kontraktuale zbatohen dispozitat e Ligjit të Marrëdhënieve Detyrimore.

(4) Për të drejtat dhe detyrimet e përdoruesve të shërbimeve të pagesave që janë konsumatorë edhe të ofruesve të shërbimeve të pagesave zbatohen edhe dispozitat e Ligjit të Mbrojtjes së Konsumatorëve gjatë Marrëveshjeve për Kredi Konsumatore, Ligjit të Mbrojtjes së Konsumatorëve dhe Ligjit të Ofritit të Shërbimeve Financiare në Distançë.

(5) Për institucioneve të pagesave, institucioneve të parasë elektronike, operatorëve e sistemeve të pagesave zbatohen dispozitat e Ligjit të Shoqërive Tregtare, përveç nëse me këtë ligj nuk është e rregulluar ndryshe.

(6) Nëse me këtë ligj nuk është e rregulluar ndryshe për procedurën e falimentimit të institucioneve të pagesave, institucioneve të parasë elektronike, operatorëve të sistemit të pagesave dhe pjesëmarrësve në sistemet e pagesave, zbatohen dispozitat e Ligjit të Falimentimit përveç dispozitave për riorganizim dhe menaxhim personal.

(7) Për çdo gjë që nuk është e rregulluar me këtë ligj në lidhje me përmbarimin e detyrueshëm zbatohen dispozitat e Ligjit të Përmbarimit

(8) Për çdo gjë që nuk është e rregulluar me këtë ligj në lidhje me kundërvajtjet zbatohen dispozitat e Ligjit të Kundërvajtjeve.

Ndalimi i ofrimit të shërbimeve të pagesave dhe i lëshimit të parave elektronike pa leje

Neni 6

(1) Personi fizik ose juridik i cili nuk ka marrë leje të ofrojë shërbime të pagesave dhe/ose nuk është i regjistruar në Regjistrin e institucioneve të pagesave në pajtim me dispozitat e këtij ligji, nuk guxon të ofrojë shërbime të pagesave, përveç nëse nuk është i përfshirë me përjashtimet nga neni 3 i këtij ligji.

(2) Personi fizik ose juridik i cili nuk ka marrë leje për lëshimin e parave elektronike në pajtim me dispozitat e këtij ligji, nuk guxon të lëshojë para elektronike, përveç nëse nuk është i përfshirë me përjashtimet nga neni 3 i këtij ligji.

Ndalimi i përdorimit të fjalëve në emër të shoqërisë tregtare

Neni 7

(1) Fjalët “ofruesi i shërbimeve të pagesave”, “institucioni i pagesave”, “instrumenti i pagesës”, “shërbimet e pagesave”, “paratë elektronike”, “institucioni i parasë elektronike”, “sistemi i pagesave”, “pala kontraktuese qendrore”, “agjent i shlyerjes” dhe/ose “klering shtëpi”, apo fjalët e prejardhura prej tyre, pavarësisht nëse janë në gjuhën maqedonase apo në gjuhë të tjera, nuk mund të përdoren në emër të shoqërisë tregtare apo personit tjetër juridik dhe njërive të tyre organizative, nëse shoqëria tregtare nuk ka marrë leje për të ofruar shërbime të pagesës ose për lëshimin e parave elektronike ose për operator të sistemit të pagesave të lëshuar nga guvernatori.

(2) Shoqëria tregtare ose personi tjetër juridik dhe pjesët e tyre organizative me emër që i referohet “ofruesit të shërbimeve të pagesave”, “institucionit të pagesave”, “instrumentit të pagesës”, “shërbimeve të pagesave”, “parave elektronike”, “institucionit të parasë elektronike”, “sistemit të pagesave”, “agjent të shlyerjes” dhe/ose “klering shtëpi” dhe nuk ka marrë leje për të ofruar shërbime të pagesave ose për lëshimin e parave elektronike ose operator për sistem të pagesave të lëshuar nga guvernatori, nuk mund të regjistrohet në Regjistrin tregtar dhe Regjistrin e personave të tjerë juridikë që udhëhiqet në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Pjesa e dytë

INSTITUCIONE TË PAGESAVE DHE INSTITUCIONE TË PARAVE ELEKTRONIKE

Kapitulli I

Shërbimet e pagesave, ofruesit e shërbimeve të pagesave dhe emetuesit e parave elektronike

Shërbimet e pagesave

Neni 8

Shërbimet e pagesave në kuptim të këtij ligji janë:

1) shërbimet që mundësojnë vendosjen e parave të gatshme në llogarinë e pagesës, si dhe të gjitha aktivitetet që kanë të bëjnë me hapjen, mirëmbajtjen dhe mbylljen e kësaj llogarie;

2) shërbimet që mundësojnë tërheqjen e parave të gatshme nga llogaria e pagesës, si dhe të gjitha aktivitetet që kanë të bëjnë me hapjen, mirëmbajtjen dhe mbylljen e kësaj llogarie;

3) kryerja e transaksioneve të pagesave, duke përfshirë transferimin e mjeteve financiare në një llogari pagese tek ofruesi i shërbimeve të pagesave të përdoruesit të shërbimit të pagesave ose tek ofruesi tjetër i shërbimeve të pagesave:

a) kryerjen e debitimeve të drejtpërdrejta, duke përfshirë debitimet e njëhershme direkte;

b) kryerjen e transaksioneve të pagesave me kartela të pagesave ose pajisjeve të ngjashme telekomunikuese, digjitale ose informative dhe

c) kryerjen e transfereve kreditore, përfshirë urdhëresat e përhershme.

4) kryerja e transaksioneve të pagesave në të cilat mjetet financiare sigurohen me linjë kreditore për përdoruesit e shërbimeve të pagesave:

a) kryerja e debitimeve të drejtpërdrejta, duke përfshirë debitimet e njëhershme direkte;

b) kryerjen e transaksioneve të pagesave me kartela të pagesave ose pajisjeve të ngjashme telekomunikuese, digjitale ose informative dhe

c) kryerjen e transfereve kreditore, përfshirë urdhëresat e përhershme.

5) lëshimi i instrumenteve të pagesës dhe/ose pranimit të transaksioneve të pagesave;

6) remitanca;

7) shërbimet për inicimin e pagesave dhe

8) shërbime për dhënien e informacioneve për llogaritë e pagesave.

Ofruesit e shërbimeve të pagesave dhe emetuesit e parave elektronike

Neni 9

(1) Ofruesit e shërbimeve të pagesave në kuptimin e këtij ligji janë:

1) banka në përputhje me ligjin që rregullon themelimin dhe punën e bankave;

2) kursimorja në pajtim me ligjin me të cilin rregullohet themelimi dhe puna e kursimoreve;

3) filiali i bankës së huaj në përputhje me ligjin me të cilën rregullohet themelimi dhe puna bankave;

4) banka nga shteti anëtar që ka hapur filial ose në mënyrë të drejtpërdrejt kryen veprimtari financiare në Republikën e Maqedonisë së Veriut në pajtim me ligjin që rregullon themelimin dhe punën e bankave;

5) institucioni i pagesës që ka marrë leje për ofrimin e shërbimeve të pagesave nga guvernatori në pajtim me këtë ligj;

6) institucioni i pagesës ose nga shteti anëtar i cili ka hapur filial ose në mënyrë të drejtpërdrejt ofron shërbime të pagesave në Republikën e Maqedonisë së Veriut në pajtim me këtë ligj;

7) institucioni i parave elektronike i cili ka marrë leje për emetimin e parave elektronike në pajtim me këtë ligj;

8) institucioni i parave elektronike nga shteti anëtar i cili ka hapur filial ose në mënyrë të drejtpërdrejt emeton para elektronike në Republikën e Maqedonisë së Veriut në pajtim me këtë ligj;

9) Banka Popullore, kur nuk vepron me autorizime monetare në përputhje me ligjin që rregullon organizimin dhe punën e saj;

10) Thesari;

11) Thesari i Fondit dhe

12) Banka Qendrore Europiane dhe bankat qendrore të shteteve anëtare të Bashkimit European, kur nuk veprojnë me autorizime monetare.

(2) Emetuesit e parave elektronike në kuptimin e këtij ligji janë:

1) banka në përputhje me ligjin që rregullon themelimin dhe punën e bankave;

2) kursimorja në pajtim me ligjin me të cilin rregullohet themelimi dhe puna e kursimoreve;

- 3) filiali i bankës së huaj në përputhje me ligjin që rregullon themelimin dhe punën e bankave;
- 4) banka nga shteti anëtar i Bashkimit European që ka hapur filial ose në mënyrë të drejtpërdrejt kryen aktivitete financiare në Republikën e Maqedonisë së Veriut në pajtim me ligjin që rregullon themelimin dhe punën e bankave;
- 5) institucioni i parave elektronike që ka marrë leje për emetimin e parave elektronike nga guvernatori në pajtim me këtë ligj;
- 6) institucioni i parave elektronike nga shteti anëtar i Bashkimit European i cili ka hapur filial ose në mënyrë të drejtpërdrejt emeton para elektronike në Republikën e Maqedonisë së Veriut në pajtim me këtë ligj;
- 7) Banka Popullore, kur nuk vepron me autorizime monetare në përputhje me Ligjin e Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- 8) Banka Qendrore Europiane dhe bankat qendrore të shteteve anëtare të Bashkimit European, kur nuk veprojnë me autorizime monetare.

Qasja e institucioneve të pagesave dhe e institucioneve të parave elektronike në llogaritë e pagesave në banka dhe kursimore

Neni 10

(1) Ofruesi i shërbimeve të pagesave nga neni 9 paragrafi (1) pikat 1, 2, 3 dhe 4 të këtij ligji do të sigurojë kushte objektive, proporcionale dhe jo-diskriminuese për hapjen dhe përdorimin e llogarive të pagesave për institucionet e pagesave apo institucionet e parave elektronike që do të mundësojë ofrimin e pandërprerë dhe efikas të shërbimeve të pagesave nga institucionet e pagesave, përkatësisht emetimin e parave elektronike dhe/ose ofrimin e shërbimeve të pagesave nga institucionet për parave elektronike.

(2) Nëse ofruesi i shërbimeve të pagesave nga neni 9 paragrafi (1) pikat 1, 2, 3 dhe 4 të këtij ligji refuzon kërkesën për hapjen dhe përdorimin e llogarive të pagesave të institucionit të pagesave ose institucioni i parave elektronike është i detyruar menjëherë, por jo më vonë se tri ditë pune pas refuzimit, ta njoftojë Bankën Popullore me shkrim lidhur me arsyetimin e shkaqeve të refuzimit.

(3) Nëse Banka Popullore vlerëson se arsyet për refuzimin e kërkesës sipas paragrafit (2) të këtij neni janë të pajustificuara, do të urdhërojë ofruesin e shërbimeve të pagesave nga neni 9 paragrafi (1) pikat 1, 2, 3 dhe 4 të këtij ligji t'i lejojë institucionit të pagesave, përkatësisht institucionit të parave elektronike hapjen dhe përdorimin e llogarisë së pagesës .

Shërbime dhe veprimtari që mund të kryhen nga institucioni i pagesave dhe institucioni i parasë elektronike

Neni 11

(1) Institucioni i pagesës i jep shërbimet e pagesave nga neni 8 i këtij ligji, të cilat janë të cekura në lejen e lëshuar nga guvernatori.

(2) Institucioni i pagesës, përveç që ofron shërbime të pagesave nga neni 8 i këtij ligji, mund të kryejë edhe:

1) ofrim të shërbimeve operative dhe ndihmëse të lidhura me dhënien e shërbimeve të pagesave, ashtu siç mundësohet kryerja e transaksioneve të pagesave, shitblerja e devizave në tregun e devizave në përputhje me ligjin me të cilin rregullohet puna devizore dhe shërbimet e vendosjes, rruajtjes dhe përpunimit të të dhënave;

2) veprimtari të operatorit të sistemit të pagesave në përputhje me Pjesën e pestë të këtij ligji dhe

3) veprimtari të tjera që nuk përfaqësojnë shërbime të pagesave dhe nuk përfshihen nga pikat 1 dhe 2 të këtij paragrafi.

(3) Institucioni i parave elektronike, përveç emetimit të parasë elektronike, mund të kryejë edhe:

1) ofrim të shërbimeve të pagesave nga neni 8 i këtij ligji, të cilat janë të cekura në lejen e lëshuar nga guvernatori,

2) ofrim të shërbimeve operative dhe ndihmëse të lidhura me emetimin e parave elektronike dhe/ose me ofrimin e shërbimeve të pagesave nga pika 1 e këtij paragrafi, ashtu siç mundësohet kryerja e transaksioneve të pagesave, shitblerja e devizave në tregun e devizave në përputhje me ligjin me të cilin rregullohet puna devizore dhe shërbimet e vendosjes, rrualtjes dhe përpunimit të të dhënave;

3) veprimtari të operatorit të sistemit të pagesave ne përputhje me Pjesën e pestë te këtij ligji dhe

4) aktivitete të tjera që nuk paraqesin emetim të parave elektronike ose ofrim të shërbimeve të pagesave dhe nuk përfshihen nga pikat 1, 2 dhe 3 të këtij paragrafi.

(4) Institucioni i pagesës, përkatësisht institucioni i parave elektronike, në afat prej 30 ditësh para fillimit të ushtrimit të veprimtarisë sipas paragrafit (2) pikat 1 dhe/ose 3, përkatësisht paragrafi (3) pika 2 dhe/ose 4 të këtij neni, detyrohet ta njoftojë Bankën Popullore për ndikimin e veprimtarive të reja në gjendjen e tij financiare, strukturën organizative, sistemin e kontrolleve të brendshme dhe sistemin për mbrojtjen e mjeteve të përdoruesve të shërbimeve të pagesave.

(5) Institucioni i pagesës, përkatësisht institucioni i parave elektronike, nëse planifikon që të fillojë të kryejë veprimtari sipas paragrafit (2) pika 2, përkatësisht paragrafi (3) pika 3 e këtij neni, është e detyruar që gjatë dorëzimit të kërkesës për marrjen e lejes nga neni 138 paragrafi (2) i këtij ligji të bashkëngjit edhe vlerësimin për ndikimin e veprimtarisë që planifikon ta fillojë në gjendjen financiare, strukturën organizative, sistemin e kontrolleve të brendshme dhe sistemin për mbrojtjen e mjeteve të përdoruesve të shërbimeve të pagesave.

(6) Banka Popullore vlerëson nëse kryerja e veprimtarisë sipas paragrafit (2), përkatësisht paragrafi (3) të këtij neni prish ose mund ta prish stabilitetin dhe sigurinë e institucionit të pagesave, përkatësisht institucionin e parasë elektronike, ose të pengojë mundësinë që Banka Popullore të monitorojë punën dhe harmonizimin e institucionit të pagesave, përkatësisht institucionit të parave elektronike me kushtet e përcaktuara me këtë ligj dhe cakton masën për subjektet mbikëqyrëse nga neni 166 paragrafi (5) i këtij ligji.

Linja kreditore

Neni 12

(1) Linja kreditore në kuptim të këtij ligji është marrëdhënie kontraktuale ndërmjet ofruesit të shërbimeve të pagesave dhe përdoruesit të shërbimeve të pagesave, e cila përcakton vlerën e disponueshme të kredisë që përdoruesi i shërbimit të pagesave mund ta përdorë për kryerjen e transaksioneve të pagesave.

(2) Institucioni i pagesave, përkatësisht institucioni i parave elektronike miraton linjën kreditore për shërbimet e pagesave nga neni 8 paragrafi (1) pikat 4 dhe 5 të këtij ligji, nëse:

1) linja kreditore është ndihmëse dhe e miratuar veçanërisht për shkak realizimit të transaksioneve të pagesave;

2) kredia e miratuar gjatë ofrimit të shërbimeve të pagesave në territorin e vendit të tretë paguhet në afat prej jo më të gjatë se 12 muaj;

3) linja kreditore nuk miratohet as nga mjetet financiare që janë marrë ose ruhen për shkak të kryerjes së transaksioneve të pagesës, as nga mjetet financiare të marra në këmbim të emetimit të parave elektronike që ruhen në përputhje me nenin 32 të këtij ligji dhe

4) mjetet personale të institucionit të pagesave, përkatësisht institucioni i parave elektronike vazhdimisht janë në vlerë të përcaktuar në përputhje me nenet 29 dhe 30 të këtij ligji dhe janë përkatëse me vlerën e përgjithshme të linjave kreditore të miratuara.

(3) Gjatë lidhjes dhe realizimit të marrëveshjes për linjën kreditore zbatohen në mënyrë përkatëse dispozitat e Ligjit të Mbrojtjes së Konsumatorëve gjatë Lidhjes së Marrëveshjeve për Kredi Konsumatore.

Emetimi dhe blerja e parave elektronike

Neni 13

(1) Emetuesi i parasë elektronike nga neni 9 paragrafi (2) i këtij ligji, është i detyruar që menjëherë të emetojë para elektronike në vlerë të barabartë me vlerën nominale të mjeteve të pranuar financiare.

(2) Emetuesi i parave elektronike nga neni 9 paragrafi (2) i këtij ligji detyrohet me kërkesë të poseduesit të parave elektronike në çdo kohë në vlerë nominale të blejë vlerën financiare të parave elektronike që poseduesi i posedon.

Llogaritë e pagesave në institucionet e pagesave dhe institucionet e parave elektronike

Neni 14

Institucioni i pagesës, përkatësisht institucioni i parave elektronike, që ofron shërbime të pagesave nga neni 8 i këtij ligji mund të hap dhe të mbajë llogari të pagesave që përdoren për realizimin e transaksioneve të pagesave.

Ndalimi i grumbullimit të depozitave dhe i burimeve të tjera kthyese të mjeteve

Neni 15

(1) Institucioni i pagesave, përkatësisht institucioni i parave elektronike nuk guxon të grumbullojë depozita ose burime të tjera kthyese të mjeteve nga publiku në kuptim të dispozitave të ligjit që rregullon punën e bankave, as të reklamojë kryerjen e veprimtarisë së tillë financiare.

(2) Mjetet financiare që institucioni i pagesave i pranon nga përdoruesit e shërbimeve të pagesave me qëllim të ofrimit të shërbimeve të pagesave, nuk janë depozita apo burime të tjera kthyese të mjeteve nga publiku.

(3) Mjetet financiare që institucioni i parave elektronike i pranon për shkak emetimit të parave elektronike nuk janë depozita apo burime të tjera kthyese të mjeteve për sa i përket dispozitave të ligjit me të cilën rregullohen themelimi dhe puna e bankave.

(4) Emetuesi i parave elektronike nuk duhet të llogarisë dhe të paguajë interes ose të ofrojë ndonjë përfitim tjetër në lidhje me periudhën kohore gjatë së cilës poseduesi i parave elektronike i posedon paratë elektronike.

(5) Institucioni i pagesave është i detyruar që në marrëveshjet e lidhura kornizë me përdoruesit e shërbimeve të pagesave t'i shpalosë qartë se mjetet e pranuar financiare për shkak të ofrimit të shërbimeve të pagesave nuk konsiderohen si depozita apo burime të tjera kthyese të mjeteve nga publiku.

(6) Institucioni i parave elektronike është i detyruar në marrëveshjet e lidhura kornizë me poseduesit e parave elektronike t'i shpalosë qartë se mjetet financiare të pranuar për emetimin e parave elektronike nuk konsiderohen si depozita apo burime të tjera kthyese të mjeteve nga publiku.

Kapitulli II

Leje për ofrimin e shërbimeve të pagesave dhe emetimin e parave elektronike dhe aktvendim për regjistrim në regjistër

Kërkesë për marrjen e lejes dhe kërkesë për regjistrim në regjistër

Neni 16

(1) Shoqëria tregtare e themeluar në Republikën e Maqedonisë së Veriut, e cila synon të ofrojë një ose më shumë shërbime të pagesave nga neni 8 paragrafi (1) pikat 1, 2, 3, 4, 5, 6 dhe 7 të këtij ligji, përkatësisht të emetojë para elektronike, në Bankën Popullore parashtron kërkesë për marrjen e lejes për ofrim të shërbimeve të pagesave, përkatësisht për emetim të parave elektronike (në tekstin e mëtejshëm të këtij kapitulli: parashtruesi i kërkesës).

(2) Me kërkesën sipas paragrafit (1) të këtij neni, parashtruesi i kërkesës dorëzon dokumentet në vijim, të dhëna dhe/ose informacione:

1) dëshmi se është i regjistruar në Regjistrin tregtar që udhëhiqet nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut, i cili deri në ditën e parashtrimit të kërkesës nuk duhet të jetë më i vjetër se 30 ditë;

2) akt për themelimin e shoqërisë tregtare;

3) adresën e selisë së shoqërisë tregtare;

4) vërtetim se shoqëria tregtare në dispozicion ka kapital fillestar në përputhje me nenin 28 paragrafët (1), (2) dhe (4) të këtij ligji dhe dëshmi për burimet e mjeteve nga të cilat është siguruar kapitali fillestar;

5) program për punën me përshkrim të saktë të llojeve të shërbimeve të pagesave nga neni 8 i këtij ligji që shoqëria tregtare ka për qëllim t'i ofrojë, përkatësisht përshkrimin e emetimit të parave elektronike dhe punën me to;

6) plan afarist me projeksion të raporteve financiare, vëllimit dhe vlerës së projektuar të transaksioneve të pagesave, si dhe për veprimtaritë e tjera dhe që nuk përfaqësojnë shërbime të pagesave që i kryen ose do t'i kryej[tre vitet e para të punës afariste, në bazë të të cilave mund të konkludohet se shoqëria tregtare do të sigurojë plotësimin e kushteve përkatëse organizative, kadrovike dhe teknike për punë të qëndrueshëm dhe të sigurt;

7) mënyrën e mbrojtjes së mjeteve në para të përdoruesve të shërbimeve të pagesave në përputhje me nenet 31 dhe 32 të këtij ligji, me përjashtim të shoqërisë tregtare ka për qëllim të ofrojë veçanërisht shërbime të pagesave nga neni 8 paragrafi (1) pika 7 e këtij ligji;

8) sistemin e menaxhimit me autorizime dhe përgjegjësi të definuara qartë dhe sisteme të kontrollit të brendshëm, duke përfshirë procedurat administrative, procedurat e brendshme të menaxhimit të rreziqeve dhe procedurat e kontabilitetit;

9) procedurat për monitorim, zgjidhje dhe veprim ndaj paraqitjes së incidenteve të sigurisë, si dhe procedurat për veprim lidhur me kundërshtimet e shfrytëzuesve të shërbimeve të pagesave në lidhje me sigurinë, duke përfshirë edhe mekanizmat për raportim të incidenteve që marrin parasysh detyrimet për raportimin e incidenteve nga neni 123 të këtij ligji;

10) procedura për ruajtje, kontroll, monitorim dhe kufizim të qasjes në të dhënat sensitive të pagesave;

11) plan të vazhdimësisë së punës, duke përfshirë identifikimin e qartë të operacioneve kritike, planet e kushteve dhe procedurës të jashtëzakonshme për testimin dhe vlerësimin e rregullt të përshtatshmërisë dhe efektivitetit të planeve të tilla;

12) procedura dhe sisteme që zbatohen për grumbullimin e të dhënave statistikore mbi punën, transaksionet dhe mashttrimet;

13) politika e sigurisë, duke përfshirë vlerësimin e hollësishëm të rrezikut në lidhje me shërbimet e pagesave dhe një përshkrim të kontroleve të sigurisë dhe masave për zvogëlimin e rrezikut që ndërmerren për të mbrojtur në mënyrë përkatëse shfrytëzuesit e shërbimeve të pagesave nga rreziqet e identifikuar, duke përfshirë mashtrimin dhe shfrytëzimin e paligjshëm të të dhënave sensitive të pagesave dhe të dhënave personale;

14) procedura dhe sisteme të kontrollit të brendshëm në përputhje me Ligjin e Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit;

15) struktura organizative e shoqërisë tregtare, duke përfshirë, ku është e zbatueshme, përshkrimin e punës së planifikuar nëpërmjet filialeve dhe/ose agjentëve dhe përshkrimin e mënyrës së zbatimit të kontrollit në terren dhe jashtë terrenit të punës së tyre të cilat shoqëria tregtare është e detyruar që të kryejë të paktën një herë në vit;

16) për personat të cilët nëpërmjet personave me të cilët kanë marrëdhënie të ngushta posedojnë pjesëmarrje të kualifikuar në shoqërinë tregtare që parashtron kërkesën, duhet t'i kenë të paktën këto të dhëna në vijim:

a) për personin juridik:

- forma juridike
- struktura pronësore,
- marrëdhënie të ngushta,
- gjendja financiare,
- burimet e mjeteve për marrjen e pjesëmarrjes së kualifikuar dhe
- dëshmitë lidhur me nenin 19 paragrafi (6) të këtij ligji

b) për person fizik:

- identiteti,
- marrëdhënie të ngushta,
- përvojë profesionale,
- statusi pronësor, burimet e të ardhurave, burimet e mjeteve për marrjen e pjesëmarrjes së kualifikuar dhe
- dëshmitë lidhur me nenin 19 paragrafi (5) të këtij ligji

17) për personat që janë udhëheqës, anëtarë të këshillit drejtues, përkatësisht anëtarë ekzekutivë të këshillit të drejtorëve të shoqërisë tregtare:

- vërtetimin e identitetit,
- dëshmi të kompetencës profesionale dhe
- dëshmi lidhur me nenin 19 paragrafi (5) të këtij ligji;

18) vërtetim nga Drejtoria e të Hyrave Publike për pagesë të rregullt të tatimeve dhe kontributeve;

19) dëshmi për përzgjedhjen e shoqërisë për revizion që do të kryejë revizion në raportet financiare të shoqërisë tregtare për vitin në të cilin është paraqitur kërkesa;

20) lista e marrëdhënieve të ngushta dhe përshkrimi i mënyrës se si janë të lidhura;

21) shfrytëzimi i shërbimeve nga persona të jashtëm për bartjen e planifikuar të kryerjes së funksioneve operative lidhur me ofrimin e shërbimeve të pagesave, përkatësisht emetimin e parave elektronike dhe

22) pjesëmarrje e planifikuar në sistemet e pagesave vendase ose të huaja, nëse parashtruesi ka për qëllim të marrë pjesë në sistemet e pagesave.

(3) Me dokumentet, të dhënat dhe/ose informacionet sipas paragrafit (2) pikat 7, 8, 9 , 15 dhe 21 të këtij neni, parashtruesi i kërkesës duhet ta përshkruajë pozitën organizative dhe sistemet për kontroll të brendshëm dhe revizion dhe funksionet operative me qëllim të mbrojtjes së interesave të shfrytëzuesve të shërbimeve të pagesave dhe sigurimit të vazhdimësisë dhe sigurisë në ekzekutimin e shërbimeve të pagesave, përkatësisht emetimin e parasë elektronike.

(4) Me dokumentin sipas paragrafit (2) pika 13 të këtij neni, parashtruesi i kërkesës veçanërisht duhet t'i referohet mënyrës të së cilës do të sigurojë shkallë të lartë të sigurisë teknike dhe mbrojtjes së të dhënave, duke përfshirë edhe softuerin dhe sistemet e informacionit që do t'i shfrytëzojë ai dhe/ose personi i jashtëm të cilit pjesërisht apo plotësisht do t'i bartet kryerja e funksioneve të pagesës në lidhje me ofrimin e shërbimeve të pagesave, korniza me masat e duhura për zvogëlimin dhe mekanizmat e kontrollit për udhëheqjen e rreziqeve operative, sigurisë dhe procedurat për menaxhimin dhe klasifikimin e incidenteve të cilat duhet të jenë në përputhje me aktin nënligjor nga neni 123 paragrafi (9) të këtij ligji.

(5) Nëse kërkesa sipas paragrafit (1) të këtij neni ka të bëjë me marrjen e lejes për ofrimin e shërbimeve të pagesave nga neni 8 paragrafi (1) pika 7 të këtij ligji, përveç dokumenteve, të dhënave dhe/ose informacioneve sipas paragrafit (2) të këtij neni ndaj kërkesës dorëzohet dhe dëshmia e zotërimit të sigurimit të përgjegjësisë profesionale apo garanci tjetër e mbulimit të përgjegjësisë pa kundërshtim dhe e pagueshme në thirrjen e parë, i cili do të sigurojë përmbushjen e detyrimeve nga nenet 89, 102, 103, 104 dhe 106 të këtij ligji.

(6) Shoqëria tregtare e themeluar në Republikën e Maqedonisë së Veriut që ka për qëllim të ofrojë vetëm shërbimin e pagesës nga neni 8 paragrafi (1) pika 8 të këtij ligji në Bankën Popullore paraqet kërkesë për regjistrim në Regjistrin e institucioneve të pagesave nga neni 27 i këtij ligji, duke i bashkëngjitur kërkesës dokumentet, të dhënat dhe /ose informacionet sipas paragrafit (2) pikat 1, 2, 3, 5, 6, 8, 9, 10, 11, 13, 15, 16, 17, 18, 20 dhe 21 të këtij neni dhe dëshmi të zotërimit të sigurimit të përgjegjësisë profesionale ose garanci tjetër të mbulimit të përgjegjësisë pa kundërshtim dhe e pagueshme në thirrjen e parë si sigurim të detyrimeve ndaj ofruesit të shërbimeve të pagesave që mban llogarinë e pagesës ose shfrytëzuesit të shërbimeve të pagesave që dalin nga qasja jo e autorizuar ose e mashtrimeve në llogaritë e pagesës ose përdorimi jo i autorizuar apo mashtrimi i informacioneve për llogaritë e pagesave.

(7) Polica e sigurimit ose garancia për mbulimin e përgjegjësisë pa kundërshtime dhe e pagueshme në thirrjen e parë nga paragrafët (5) dhe (6) të këtij neni nuk duhet të lëshohet nga shoqëria e sigurimit ose banka që i përket të të njëjtit grup, kanë pjesëmarrje të kualifikuar dhe/ose përfaqësojnë persona me marrëdhënie të ngushta me parashtruesin e kërkesës.

(8) Përveç dokumenteve, të dhënave dhe/ose informacioneve nga paragrafët (2), (5) dhe (6) të këtij neni, Banka Popullore mund të kërkojë dokumente, të dhëna shtesë dhe/ ose informacione shtesë nga parashtruesi i kërkesës .

(9) Banka Popullore zhvillon intervistë me udhëheqësin/it e propozuar, anëtarët e këshillit drejtues, anëtarët ekzekutiv të këshillit të drejtorëve të shoqërisë tregtare që ka parashtruar kërkesë.

(10) Nëse operatori i sistemit të pagesave ka për qëllim që të ofrojë një ose më shumë shërbime të pagesave, përkatësisht të emetojë para elektronike, dorëzon kërkesë për marrjen e lejes, përkatësisht për regjistrim në regjistrin të cilit i bashkëngjijt vlerësimin për ndikimin e veprimtarive të reja në gjendjen financiare, strukturën organizative, sistemin e kontrolleve të brendshme dhe stabilitetin, sigurinë dhe efikasitetin në punën e sistemit të pagesave, si dhe dokumente, të dhëna dhe/ose informacione të përcaktuara me akt nënligjor të Bankës Popullore.

(11) Kërkesa sipas paragrafit (1), (6) dhe (10) të këtij neni dhe dëshmitë sipas paragrafit (2) pikat 1 dhe 16, nënpikat a) kryeradha 1,2 dhe 6 b) kryeradha 6, 17 nënparagrafi 3 të këtij neni mund të parashtrohen drejtpërdrejt në arkivin e Bankës Popullore, me postë të rekomanduar ose në formë elektronike duke përdorur mjet identifikimi elektronik nëpërmjet Portalit Nacional të Shërbimeve Elektronike.

(12) Në rast të ndërprerjes teknike të funksionimit të Portalit Nacional të Shërbimeve Elektronike, kërkesat sipas paragrafit (1), (6) dhe (10) të këtij neni dhe dëshmitë sipas paragrafit (2) pikat 1 dhe 16, nënpikat a) kryeradha 1,2 dhe 6 b) kryeradha 6, 17 nënparagrafi 3 të këtij neni dorëzohen në adresë të postës elektronike të vlefshme të Bankës Popullore në formë të dokumentit elektronik nëpërmjet dorëzimit të kualifikuar elektronik të rekomanduar.

(13) Zyrtari i autorizuar nga Banka Popullore i cili vepron ndaj kërkesës sipas paragrafit (1), (6) dhe (10) të këtij neni është i detyruar në afat prej pesë ditëve nga dita e pranimit të kërkesës, dokumentet sipas paragrafit (2) pikat 1 dhe 16, nënpikat a) kryeradha 1,2 dhe 6 b) kryeradha 6, 17 nënparagrafi 3 të këtij neni me detyrë zyrtare t'i kërkojë nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(14) Zyrtari i autorizuar nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut është i detyruar që dokumentet sipas paragrafit (2) pikat 1 dhe 16, nënpikat a) kryeradha 1,2 dhe 6 b) kryeradha 6, 17 nënparagrafi 3 të këtij neni, t'i dorëzojë në Bankën Popullore në afat prej tre ditëve nga dita e pranimit të kërkesës sipas paragrafit (3) të këtij neni.

(15) Kërkesa sipas paragrafit (13) të këtij neni mund të parashtrohet, ndërkaq dokumentet sipas paragrafit (2) pika 1 dhe 16, nënpikat a) kryeradha 1,2 dhe 6 b) kryeradha 6, 17 nënparagrafi 3 të këtij neni, mund të dorëzohen në formë elektronike duke përdorur mjet të identifikimit elektronik nëpërmjet Platformës Nacionale të Ndërveprueshmërisë.

(16) Në rast të ndërprerjes teknike të funksionimit të Portalit Nacional të Ndërveprueshmërisë, kërkesa sipas paragrafit (13) të këtij neni dorëzohet në adresën elektronike të Regjistrimit Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut ndërkaq dokumentet sipas paragrafit (2) pika 1 dhe 16, nënpikat a) kryeradha 1,2 dhe 6 b) kryeradha 6, 17 nënparagrafi 3 të këtij neni, mund të dorëzohen në adresë të vlefshme elektronike të Bankës Popullore në formë të dokumentit elektronik nëpërmjet dorëzimit të kualifikuar elektronik të rekomanduar.

(17) Këshilli i Bankës Popullore, me akt nënligjor, më afër përcakton dokumentet, të dhënat dhe/ose informacionet nga paragrafët (2), (5), (6), (7) dhe (8) të këtij neni si dhe procedurën për vlerësimin e tyre.

(18) Këshilli i Bankës Popullore, me akt nënligjor, përcakton kriteret për përcaktimin e vlerës minimale të policës së sigurimit ose garancisë për mbulimin e detyrimit pa kundërshtim dhe të pagueshme në thirrjen e parë nga paragrafët 5), (6) dhe (7) të këtij neni dhe për kushtet që duhet të plotësojnë institucionet financiare që lëshojnë policat ose garancitë.

Kërkesë për marrjen e lejes për ofrimin e shërbimeve të pagesave me qasje të lehtësuar

Neni 17

(1) Me përjashtim të paragrafit (1) të nenit 16 të këtij ligji, shoqëria tregtare e themeluar në Republikën e Maqedonisë së Veriut që ka për qëllim të ofrojë një ose më shumë shërbime të pagesës nga neni 8 paragrafi (1) pikat 1, 2, 3, 4 dhe 5 të këtij ligji, mund të paraqesin në Bankën Popullore kërkesë për marrjen e lejes për ofrimin e shërbimeve të pagesave me qasje të lehtësuar, nëse vlera e përgjithshme e projektuar e transaksioneve të pagesave në planin afarist, ku përfshihen edhe transaksionet e pagesave që janë planifikuar të realizohen nëpërmjet agjentëve, pas rregullimeve të mundshme me kërkesë të Bankës Popullore, të paraqitura si mesatare mujore për 12 muajt e ardhshëm, nuk i kalon 25.000.000 denarë.

(2) Kërkesës sipas paragrafit (1) të këtij neni, shoqëria i bashkëngjit dokumentet, të dhënat dhe/ose informacionet nga neni 16 paragrafi (2) pika 1, 2, 3, 5, 6, 7, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 20, 21 dhe 22 të këtij ligji dhe dëshmi se ka kapital fillestar në përputhje me nenin 28 paragrafi (3) të këtij ligji dhe dëshminë e burimeve të mjeteve nga të cilat sigurohet kapitali fillestar.

(3) Për kërkesën sipas paragrafit (1) të këtij neni dhe dëshmitë sipas paragrafit (2) të këtij neni në mënyrë përkatëse zbatohen dispozitat nga neni (16) paragrafi (11), (12), (13), (14), (15) dhe (16) të këtij ligji.

(4) Nëse vlera e përgjithshme e transaksioneve të pagesave të realizuara e llogaritur si mesatare mujore nga 12 muajt e kaluar tejkalon vlerën sipas paragrafit (1) të këtij neni, institucioni i pagesave është i detyruar që në afat prej 30 ditësh nga dita e tejkalimit të vlerës në Bankën Popullore të paraqesë kërkesë për marrjen e lejes në pajtim me nenin 16 paragrafi (1) të këtij ligji.

(5) Nëse institucioni i pagesave nuk vepron në pajtim me paragrafin (4) të këtij neni, guvernatori miraton aktvendim për shfuqizimin e aktvendimit për dhënien e lejes lidhur me ofrimin e shërbimeve të pagesave me qasje të lehtësuar.

(6) Institucioni i pagesave që ka marrë leje për ofrim të shërbimeve të pagesave me qasje të lehtësuar nuk duhet të themelojë filiale jashtë Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(7) Institucioni i pagesave që ka marrë leje për ofrim të shërbimeve të pagesave me qasje të lehtësuar mund të ofrojë shërbime dhe të kryejë veprimtari nga neni 11 paragrafi (2) pikat 1 dhe 3 të këtij ligji.

Kërkesë për marrjen e lejes për emetimin e parave elektronike me qasje të lehtësuar

Neni 18

(1) Me përjashtim të paragrafit (1) të nenit 16 të këtij ligji, shoqëria tregtare e themeluar në Republikën e Maqedonisë së Veriut, e cila ka për qëllim emetimin e parave elektronike, në Bankën Popullore mund të parashtrojë kërkesë për marrjen e lejes për emetimin e parave elektronike me qasje të lehtësuar, nëse vlera mesatare e projektuar e parave elektronike të emetuara të pashfrytëzuara të prezantuara në planin afarist, pas rregullimeve eventuale me kërkesë të Bankës Popullore nuk tejkalon 100.000.000 denarë.

(2) Kërkesës për marrjen e lejes për emetimin e parave elektronike me qasje të lehtësuar, shoqëria tregtare i bashkëngjit dokumentet, të dhënat dhe/ose informacionet nga neni 16 paragrafi (2) pika 1, 2, 3, 5, 6, 7, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 20, 21 dhe 22 të këtij ligji dhe dëshmi se disponon kapital fillestar në pajtim me nenin 28 paragrafi (5) të këtij ligji dhe dëshmi të burimeve të mjeteve nga të cilat sigurohet kapitali fillestar.

(3) Për kërkesën sipas paragrafit (1) të këtij neni dhe dëshmitë sipas paragrafit (2) të këtij neni në mënyrë përkatëse zbatohen dispozitat nga neni (16) paragrafi (11), (12), (13), (14), (15) dhe (16) të këtij ligji.

(4) Nëse vlera mesatare parave elektronike të emetuara tejkalon vlerën sipas paragrafit (1) të këtij neni, institucioni i parave elektronike është i detyruar në afat prej 30 ditësh nga dita e tejkalimit të vlerës të paraqesë kërkesë për marrjen e lejes në pajtim me nenin 16 paragrafi (1) të këtij ligji.

(5) Nëse institucioni i parave elektronike nuk vepron në pajtim me paragrafin (4) të këtij neni, guvernatori miraton aktvendim për shfuqizimin e aktvendimit për dhënien e lejes për emetimin e parave elektronike me qasje të lehtësuar.

(6) Institucioni i parave elektronike që ka marrë leje për emetimin e parave elektronike me qasje të lehtësuar nuk guxon të themelojë filiale jashtë Republikës Maqedonisë së Veriut.

(7) Institucioni i parave elektronike që ka marrë leje për emetimin e parave elektronike me qasje të lehtësuar mund të ofrojë shërbime dhe të kryejë veprimtari nga neni 11 paragrafi (3) pikat 1, 2 dhe 4 të këtij ligji.

Vendimmarrje sipas kërkesës për marrjen e lejes dhe kërkesës për regjistrim në regjistër

Neni 19

(1) Guvernatori miraton aktvendim për dhënien e lejes për ofrim të shërbimeve të pagesave ose leje për emetimin e parave elektronike ose për refuzimin e kërkesës në afat prej 90 ditëve nga dita e pranimit të kërkesës së kompletuar nga neni 16 paragrafi (1), neni 17 paragrafi (1) dhe neni 18 paragrafi (1) të këtij ligji.

(2) Guvernatori miraton aktvendim për regjistrimin e ofruesit të shërbimeve të pagesave në regjistrin nga neni 27 i këtij ligji ose për refuzimin e kërkesës për regjistrim në afat prej 90 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës së kompletuar nga neni 16 paragrafi (6) i këtij ligji.

(3) Guvernatori miraton aktvendim për dhënien e lejes për ofrim të shërbimeve të pagesave ose lejes për emetimin e parave elektronike nëse vlerëson se janë plotësuar kushtet e mëposhtme:

1) ndaj kërkesës është dorëzuar dokumentacion i kompletuar nga nenet 16, 17 dhe 18 të këtij ligji;

2) person fizik ose juridik i cili në mënyrë të drejtpërdrejt ose indirekte, nëpërmjet marrëdhënieve të ngushta, posedon pjesëmarrje të kualifikuar në parashtruesin e kërkesës, ka gjendje financiare dhe reputacion;

3) personi i cili është anëtar i organit drejtues të parashtruesit të kërkesës ka reputacion dhe kompetencë profesionale;

4) parashtruesi i kërkesës është i organizuar dhe ka siguruar kushtet për punën e institucionit të pagesave, përkatësisht institucionit të parave elektronike në përputhje me këtë ligj dhe/ose me rregulloret e miratuara në bazë të këtij ligji;

5) parashtruesi i kërkesës ka strukturë të qartë udhëheqëse dhe organizative që përfshin ekzistencën e:

- procedurave të duhura për identifikimin, menaxhimin, monitorimin dhe njoftimin e të gjitha rreziqeve ndaj të cilave është ose mund të ekspozohet institucioni i pagesave ose institucioni i parave elektronike,

- sistemit të duhur të menaxhimit me autorizime dhe përgjegjësi të përcaktuara qartë nëse kërkesa për marrjen e lejes është parashtruar në përputhje me nenin 16 të këtij ligji,

- sistemeve të kontrollit të brendshëm, duke përfshirë procedurat administrative, procedurat e brendshme të menaxhimit të rreziqet dhe procedurat e kontabilitetit, si dhe planin për vazhdimësi të punës, të cilat janë të përshtatshme dhe proporcionale me natyrën, vëllimin dhe ndërlikueshmërinë e shërbimeve të pagesave që do të ofrojë, përkatësisht emetimin e parave elektronike.

(4) Guvernatori miraton aktvendim për regjistrim në regjistër nga neni 27 i këtij ligji nëse vlerëson se janë plotësuar kushtet e mëposhtme:

1) ndaj kërkesës është dorëzuar dokumentacion i kompletuar nga neni 16 paragrafi (6) i këtij ligji;

2) personi fizik ose juridik i cili në mënyrë të drejtpërdrejt ose të tërthortë, nëpërmjet marrëdhënieve të ngushta, posedon pjesëmarrje të kualifikuar në parashtruesin e kërkesës, ka gjendje financiare dhe reputacion;

3) personat që janë anëtarë të organit drejtues së parashtruesit të kërkesës kanë reputacion dhe kompetencë profesionale;

4) parashtruesi i kërkesës është i organizuar dhe i ka siguruar kushtet për punën e institucionit të pagesave, përkatësisht institucionit të parave elektronike në përputhje me këtë ligj dhe/ose me rregulloret e miratuara në bazë të këtij ligji dhe

5) parashtruesi i kërkesës ka strukturë të përshtatshme udhëheqëse dhe organizative.

(5) Personi fizik nuk i plotëson kushtet për reputacion sipas paragrafit (3) pikat 2 dhe 3 dhe paragrafi (4) pika 2) dhe 3) të këtij neni nëse:

1) i është shqiptuar sanksion për kundërvajtje, ndalim për ushtrimin e profesionit, veprimtarisë ose detyrës;

2) me aktgjykim të plotfuqishëm i është shqiptuar ndalimi i ushtrimit të profesionit, të veprimtarisë ose të detyrës për vepra penale;

3) me aktgjykim të plotfuqishëm është dënuar me burgim të pakushtëzuar më shumë se gjashtë muaj për aq kohë sa zgjasin pasojat juridike të aktgjykimit dhe/ose ka bashkëpunëtor i cili është dënuar me aktgjykim të plotfuqishëm me burgim të pakushtëzuar më shumë se gjashtë muaj për aq kohë sa zgjasin pasojat juridike të aktgjykimit;

4) ka kryer funksion në organin drejtues në institucionin e pagesave, përkatësisht institucionin për para elektronike ose personin tjetër juridik mbi të cilin është hapur procedura e likuidimit ose falimentimit, përveç nëse pa mëdyshje, në bazë të dokumenteve dhe të dhënave në dispozicion është përcaktuar se personi nuk ka kontribuar në shfaqjen e procedurës së likuidimit ose falimentimit ose ka kryer funksionin menjëherë para ose pas shfaqjes së shkaqeve që kanë sjellur hapjen e procedurës së likuidimit ose falimentimit dhe

5) nuk i respekton dispozitat e këtij ligji dhe rregulloret e miratuara në bazë të këtij ligji dhe/ose nuk ka zbatuar ose nuk i zbaton dhe/ose ka vepruar ose vepron në kundërshtim me masat ndaj subjekteve të mbikëqyrjes të shqiptuara nga guvernatori, me çka ka qenë ose është rrezikuar siguria dhe stabiliteti i institucionit të pagesave, përkatësisht institucionit të parave elektronike dhe kreditorëve të tij,

(6) Personi juridik nuk i plotëson kushtet për reputacion sipas paragrafit (3) pika 2 dhe paragrafi (4) pika 2 të këtij neni, nëse:

1) nuk respekton dispozitat e këtij ligji dhe rregulloret e miratuara në bazë të këtij ligji dhe/ose nuk i ka zbatuar ose nuk i zbaton dhe/ose ka vepruar ose vepron në kundërshtim me masat ndaj subjekteve të mbikëqyrjes së shqiptuara nga guvernatori, të kanë rrezikuar ose rrezikojnë sigurinë dhe stabilitetin e institucionit të pagesave, përkatësisht institucionit të parave elektronike dhe kreditorëve të tij;

2) me aktgjykim të plotfuqishëm i është shqiptuar dënim dytësor ndalim i përkohshëm për ofrimin e shërbimeve të pagesave, përkatësisht emetimin e parave elektronike, përderisa zgjasin pasojat juridike të aktgjykimit;

3) me aktgjykim të plfuqishëm i është shqiptuar dënimi ndalim i përhershëm për ofrimin e shërbimeve të pagesave, përkatësisht emetimin e parave elektronike, përderisa zgjasin pasojat juridike të aktgjykimit;

4) me aktgjykim të plotfuqishëm i është shqiptuar dënim dytësor ndalesë për marrjen e lejes për ofrimin e shërbimeve të pagesave, përkatësisht emetimin e parave elektronike ose ndalesë për regjistrim në Regjistrin e institucioneve të pagesave, përderisa zgjasin pasojat juridike të aktgjykimit;

5) me aktgjykim të plotfuqishëm i është shqiptuar dënim dytësor heqje të lejes për ofrimin e shërbimeve të pagesave, përkatësisht emetimin e parave elektronike ose fshirje nga Regjistri i institucioneve të pagesave, përderisa zgjasin pasojat juridike të aktgjykimit;

6) me aktgjykim të plotfuqishëm i është shqiptuar dënim dytësor ndalim për themelimin e personave të rinj juridikë, përderisa zgjasin pasojat juridike të aktgjykimit;

7) me aktgjykim të plotfuqishëm i është shqiptuar dënim dytësor ndërprejre të personit juridik, për aq kohë sa zgjasin pasojat juridike të aktgjykimit dhe

8) mbi të cilin është hapur procedurë likuidimi ose falimentimi.

(7) Leja sipas paragrafit (1) të këtij neni nuk mund t'u bartet personave të tjerë në procedurë për ndryshime statusore.

(8) Në lejen veçmas shënohen shërbimet e pagesave nga neni 8 paragrafi (1) i këtij ligji, të cilat mund t'i ofrojë institucioni i pagesës, përkatësisht institucioni i parave elektronike.

(9) Institucioni i pagesave, përkatësisht institucioni i parave elektronike, vazhdimisht duhet t'i plotësojë kushtet nga paragrafët (3) dhe (4) të këtij neni.

(10) Institucioni i pagesave, përkatësisht institucioni i parave elektronike, është i detyruar që menjëherë ta njoftojë Bankën Popullore për çdo ndryshim në dokumentet, të dhënat dhe/ose informacionet në bazë të të cilave është lëshuar leja.

(11) Nëse kërkesa nuk është e kompletuar, Banka Popullore e njofton parashtruesin e kërkesës të dorëzojë dokumentet, të dhënat dhe/ose informacionet më së shumti në afat prej 30 ditësh.

(12) Në afatet nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni nuk llogariten afatin sipas paragrafit (11) të këtij neni afatin.

Refuzimi i kërkesës për marrjen e lejes

Neni 20

(1) Guvernatori me aktvendim e refuzon kërkesën për marrjen e lejes për ofrimin e shërbimeve të pagesave, përkatësisht lejen për emetimin e parave elektronike nga neni 16 paragrafi (1), neni 17 paragrafi (1) dhe neni 18 paragrafi (1) të këtij ligji, nëse:

- 1) nuk është plotësuar njëri nga kushtet sipas nenit 19 paragrafi (3) i këtij ligji;
- 2) kërkesa përmban të dhëna të pasakta ose të pavërteta ose është parashtruar nga personi juridik i cili nuk ka vepruar në përputhje me paragrafin (4) të nenit 17 dhe/ose paragrafin (4) të nenit 18 të këtij ligji;
- 3) vlerëson se për shkak të ekzistimit të marrëdhënieve të afërta të parashtruesit me persona të tjerë juridikë ose fizikë, mbikëqyrja mbi institucionin e pagesës, përkatësisht institucionin për para elektronike në përputhje me këtë ligj, do të pamundësohej ose do të rëndohej dukshëm;
- 4) vlerëson se për shkak të kryerjes së veprimtarive nga neni 11 paragrafët (2) dhe (3) të këtij ligji, do të rrezikohej stabiliteti dhe siguria e punës së institucionit të pagesave përkatësisht institucionit të parave elektronike ose se për shkak të këtyre veprimtarive, mbikëqyrja mbi institucionin e pagesës përkatësisht institucionin për para elektronike në përputhje me këtë ligj, do të pamundësohej ose do të rëndohej dukshëm;
- 5) ka arsye të bazuar për të dyshuar në ligjshmërinë e prejardhjes së parave, reputacionin ose identitetin e vërtetë të personit që ka parashtruar kërkesën, personave që janë anëtarë të organeve të tij drejtuese ose personave të lidhur me ta, si dhe nëse me vendim të formës së prerë të organit kompetent është përcaktuar se personi që ka parashtruar kërkesën, personat që janë anëtarë të organeve drejtuese ose personat e lidhur me të janë përfshirë në pastrim parash ose vepra të tjera penale;

6) vlerëson se për shkak të rregulloreve dhe praktikave të shtetit të tretë që zbatohen për personat me të cilët parashtruesi i kërkesës ka lidhje të afërta, mbikëqyrja mbi institucionin e pagesave, përkatësisht institucionin për para elektronike në përputhje me këtë ligj do të pamundësohej ose do të rëndohej dukshëm.

(2) Guvernatori me aktvendim e refuzon kërkesën për regjistrim në regjistrin nga neni 16 paragrafi (5) i këtij ligji, nëse:

- 1) nuk është plotësuar një nga kushtet sipas nenit 19 paragrafi (4) i këtij ligji;
- 2) kërkesa përmban të dhëna të pasakta ose të pavërteta ose është parashtruar nga personi juridik i cili nuk ka vepruar në përputhje me paragrafin (4) të nenit 17 dhe/ose paragrafin (4) të nenit 18 të këtij ligji;
- 3) vlerëson se për shkak të ekzistimit të marrëdhënieve të afërta, mbikëqyrja mbi institucionin e pagesës, përkatësisht institucionin për para elektronike në përputhje me këtë ligj, do të pamundësohej ose do të rëndohej dukshëm;
- 4) vlerëson se për shkak të kryerjes së veprimtarive nga neni 11 paragrafët (2) dhe (3) të këtij ligji, do të rrezikohej stabiliteti dhe siguria e punës së institucionit të pagesave përkatësisht institucionit të parave elektronike ose se për shkak të këtyre veprimtarive, mbikëqyrja mbi institucionin e pagesës përkatësisht institucionin për para elektronike në përputhje me këtë ligj, do të pamundësohej ose do të rëndohej dukshëm;
- 5) ka arsye të bazuar për të dyshuar në ligjshmërinë e prejardhjes së parave, reputacionin ose identitetin e vërtetë të personit që ka parashtruar kërkesën, personave që janë anëtarë të organeve të tij drejtuese ose personave të lidhur me ta, si dhe nëse me vendim të formës së prerë të organit kompetent është përcaktuar se personi që ka parashtruar kërkesën, personat që janë anëtarë të organeve drejtuese ose personat e lidhur me të janë përfshirë në pastrim parash ose vepra të tjera penale;

6) vlerëson se për shkak të rregulloreve dhe praktikave të shtetit të tretë që zbatohen për personat me të cilët parashtuesi i kërkesës ka lidhje të ngushta, mbikëqyrja mbi institucionin e pagesave përkatësisht institucionin për para elektronike në përputhje me këtë ligj do të pamundësohej ose do të rëndohej dukshëm.

(3) Në rast se kërkesa për marrjen e lejes për ofrimin e shërbimeve të pagesave përkatësisht lejen për emetimin e parave elektronike ose regjistrimin në regjistër refuzohet për arsyet nga paragrafët (1) pika 4 dhe (2) pika 4 të këtij neni, guvernatori në shpjegimin e aktvendimit me të cilin refuzohet kërkesa i sugjeron parashtuesit të kërkesës për mundësinë për të themeluar shoqëri tregtare të veçantë dhe të parashtrojë kërkesë të re për marrjen e lejes për dhënien e shërbimeve të pagesave, përkatësisht lejen për emetimin e parave elektronike për këtë shoqëri tregtare ose për regjistrim në regjistër.

Plotësimi i lejes, heqja e lejes për ofrimin e shërbimeve të pagesave për shkak të emetimit të parave elektronike

Neni 21

(1) Nëse institucioni i pagesave, përkatësisht institucioni i parave elektronike, pas marrjes së lejes për ofrimin e shërbimeve të pagesave, përkatësisht për emetimin e parave elektronike, ka për qëllim të ofrojë edhe shërbime të pagesave që nuk janë të përcaktuara në leje, është i detyruar t'i parashtrojë kërkesë Bankës Popullore për plotësimin e lejes, në përputhje me dispozitat e nenit 16 të këtij ligji.

(2) Nëse institucioni i pagesave ka për qëllim të emetojë para elektronike, është i detyruar që të parashtrojë kërkesë në Bankën Popullore për marrjen e lejes për emetimin e parave elektronike në përputhje me dispozitat e nenit 16 të këtij ligji.

(3) Në rastet sipas paragrafit (2) të këtij neni, Guvernatori miraton aktvendim për lëshimin e lejes për emetimin e parave elektronike dhe shfuqizohet aktvendimi për lëshimin e lejes për dhënien e shërbimeve të pagesave ose aktvendimin për refuzimin e kërkesës.

(4) Në afat prej 15 ditësh nga marrja e lejes sipas paragrafit (3) të këtij neni institucioni i parave elektronike është i detyruar të dorëzojë në Bankën Popullore dëshmi për ndryshimin e kryer në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(5) Banka Popullore, pas marrjes së dëshmisë sipas paragrafit (4) të këtij neni, e fshin institucionin e pagesave nga Regjistri i institucioneve të pagesave.

(6) Në procedurën e vendimmarrjes sipas kërkesës nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni zbatohen në mënyrë të duhur dispozitat e neneve 19 dhe 20 të këtij ligji.

(7) Këshilli i Bankës Popullore i përcakton dokumentet, të dhënat dhe/ose informacionet që dorëzohen ndaj kërkesës nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, mënyrën e paraqitjes së tyre dhe mënyrën dhe procedurën për vlerësimin e tyre.

Leje për ndryshime statusore

Neni 22

(1) Institucioni i pagesave, përkatësisht institucioni i parave elektronike, mund të kryejë ndryshime të statusit me lejen e marrë paraprake nga guvernatori, për çka në Bankën Popullore parashtron kërkesë me dokumente, të dhëna dhe/ose informata të cilat u referohen ndryshimeve të statusit për të cilat parashtrohet kërkesa.

(2) Ndryshimet e statusit mund të kryhen vetëm tek institucionet e pagesave, përkatësisht institucionet për para elektronike të themeluara dhe me seli në Republikën e Maqedonisë së Veriut në përputhje me këtë ligj.

(3) Me kërkesën sipas paragrafit (1) të këtij neni, Guvernatori miraton aktvendim për lëshimin e lejes për ndryshim të statusit ose për refuzimin e kërkesës në afat prej 60 ditësh nga dita e parashtrimit të kërkesës së kompletuar.

(4) Nëse kërkesa nuk është e kompletuar, Banka Popullore e njofton parashtruesin e kërkesës që të dorëzojë dokumentet, të dhënat dhe/ose informacionet lidhur me ndryshimet statusore për të cilat është paraqitur kërkesa në afat prej 30 ditësh.

(5) Në afatin sipas paragrafit (3) të këtij neni nuk llogaritet afati sipas paragrafit (4) të këtij neni.

(6) Këshilli i Bankës Popullore sipas aktit nënligjor të nenit 16 paragrafi (17) i këtij ligji i përcakton më hollësisht dokumentet, të dhënat dhe/ose informacionet dhe procedurën për marrjen e lejes për ndryshime të statusit të institucionit të pagesës përkatësisht institucionin për para elektronike.

Pëlqimi për anëtarët e organit drejtues dhe për fitimin e pjesëmarrjes së kualifikuar

Neni 23

(1) Për emërimin e anëtarëve të organit drejtues, të institucionit të pagesës, përkatësisht institucioni i parave elektronike, parashtron kërkesë në Bankën Popullore për marrjen e pëlqimit paraprak.

(2) Kërkesa për emërimin e anëtarit të organit drejtues parashtrohet në përputhje me dispozitat e nenit 16 të këtij ligji.

(3) Personi fizik ose juridik që synon të fitojë pjesëmarrje të kualifikuar, në mënyrë të drejtpërdrejt ose indirekte nëpërmjet personave që ka marrëdhënie të afërta të rrisë pjesëmarrjen në atë mënyrë që të fitojë së paku 20%, 30% ose 50% nga numri i përgjithshëm i aksioneve ose nga aksionet e lëshuara me të drejtë vote ose nga pjesëmarrja në institucionin e pagesave ose në institucionin e parave elektronike, pavarësisht nëse aksionet ose pjesëmarrjen i fiton gradualisht ose menjëherë, deri te Banka Popullore parashtron kërkesë për marrjen e pëlqimit paraprak për fitimin në përputhje me nenin 16 të këtij ligji.

(4) Personi fizik ose juridik i cili në bazë të vendimit të gjykatës ose organit kompetent në përputhje me ligjin ka fituar pjesëmarrje të kualifikuar, në mënyrë të drejtpërdrejt ose të tërthortë nëpërmjet personave që ka marrëdhënie të afërta e rrit pjesëmarrjen në atë mënyrë që ka fituar së paku 20%, 30% ose 50% nga numri i përgjithshëm i aksioneve ose nga aksionet e lëshuara me të drejtë vote ose nga pjesëmarrja në institucionin e pagesave ose në institucionin e parave elektronike, në afat prej dhjetë ditësh nga hyrja në fuqi dhe/ose plotfuqishmëria e vendimit, deri te Banka Popullore parashtron kërkesë për marrjen e pëlqimit për fitimin në përputhje me dispozitat e nenit 16 të këtij ligji.

(5) Me përjashtim të paragrafit (3) dhe (4) të këtij neni, nëse personi fizik ose juridik synon të fitojë pjesëmarrje të kualifikuar, në mënyrë të drejtpërdrejt ose indirekte nëpërmjet personave që ka marrëdhënie të afërta, ose në bazë të vendimit të gjykatës ose organit kompetent në përputhje me ligjin e rrit pjesëmarrjen në atë mënyrë që do të fitojë së paku 50% nga numri i përgjithshëm i aksioneve ose nga aksionet e lëshuara me të drejtë vote ose nga pjesëmarrja në institucionin e pagesave ose në institucionin e parave elektronike me qasje të lehtësuar, pa marrë parasysh nëse aksionet apo pjesëmarrjen e fiton gradualisht apo menjëherë, deri te Banka Popullore parashtron kërkesë për marrjen e pëlqimit paraprak për fitim në përputhje me dispozitat e nenit 17, përkatësisht nenit 18 të këtij ligji.

(6) Ndaj kërkesës nga paragrafët (3), (4) dhe (5) të këtij neni veçanërisht dorëzohen dokumente, të dhëna dhe informacione nga neni 16 paragrafi (2) pika 16 alinea 1 dhe/ose 2 si dhe të dhëna për numrin e aksioneve ose madhësinë e pjesëmarrjes në institucionin e pagesës ose

institucionin për para elektronike që planifikon t'i fitojë dhe pjesëmarrjen në përqindje në numrin e përgjithshëm të aksioneve ose aksioneve të lëshuara me të drejtë vote ose në pjesëmarrjen, pas fitimit të planifikuar të aksioneve ose pjesëmarrjes në institucionin e pagesave, përkatësisht në institucionin për para elektronike.

(7) Personi fizik ose juridik i cili synon të fitojë së paku 50% të numrit të përgjithshëm të aksioneve ose të aksioneve të lëshuara me të drejtë vote ose nga pjesëmarrja në institucionin e pagesës, përkatësisht në institucionin e parave elektronike, ndaj kërkesës nga paragrafët (3), (4) dhe (5) të këtij neni, përveç dokumenteve, të dhënave dhe/ose informacioneve sipas paragrafit (6) të këtij neni, bashkëngjit edhe plan për tre vitet e para afariste të punës, me projeksion të raporteve financiare, si dhe të dhëna për ndryshimet e planifikuara në aktivitetet afariste, organizimin ose udhëheqjen me institucionin e pagesave, përkatësisht institucionin për para elektronike.

(8) Këshilli i Bankës Popullore me aktin nënligjor nga neni 16 paragrafi (17) i këtij ligji i përcakton më hollësisht dokumentet, të dhënat dhe/ose informacionet nga paragrafët (6) dhe (7) të këtij neni, mënyrën e dorëzimit të tyre, si dhe procedurën e vlerësimit të tyre.

Vendimmarrje sipas kërkesës për pëlqim për anëtarët e organit drejtues dhe për fitimin e pjesëmarrjes së kualifikuar

Neni 24

(1) Guvernatori miraton aktvendim për dhënien e pëlqimit paraprak për anëtarët e organit drejtues ose për fitimin e pjesëmarrjes së kualifikuar ose për refuzimin e kërkesës në afat prej 60 ditësh nga parashtrimi i kërkesës nga neni 23 paragrafi (1), (3), (4), (5) dhe (7) të këtij ligji.

(2) Nëse kërkesa nuk është e kompletuar, Banka Popullore e njofton parashtruesin e kërkesës që të dorëzojë dokumentet, të dhënat dhe/ose informacionet më së shumti në afat prej 30 ditësh.

(3) Në afatin sipas paragrafit (1) të këtij neni nuk llogaritet afati sipas paragrafit (2) të këtij neni.

(4) Guvernatori miraton aktvendim për dhënien e pëlqimit paraprak për anëtarët e organit drejtues nëse:

1) ndaj kërkesës është dorëzuar dokumentacion i kompletuar nga neni 16 paragrafi (2) pika 17 i këtij ligji dhe

2) personi ka reputacion dhe kompetencë profesionale.

(5) Guvernatori miraton aktvendim për dhënien e pëlqimit paraprak për fitimin e pjesëmarrjes së kualifikuar nëse:

1) ndaj kërkesës është dorëzuar dokumentacion i kompletuar nga neni 23 paragrafët (6) ose (7) të këtij ligji;

2) personi ka aftësi financiare dhe reputacion dhe

3) nëse është e zbatueshme, dokumentet dhe të dhënat nga neni 23 paragrafi (7) i këtij ligji tregojnë strukturë të qartë drejtuese dhe strukturë organizative në përputhje me nenin 19 paragrafi (4) pika 5 e këtij ligji.

(6) Personi fizik ose juridik është i detyruar që në afat prej 180 ditësh nga dita e marrjes së pëlqimit t'i fitojë aksionet ose pjesëmarrjen në institucionin e pagesave, përkatësisht në institucionin për para elektronike. Pas skadimit të këtij afati, është e detyrueshme procedura për marrjen e pëlqimit të ri.

(7) Guvernatori me aktvendim e refuzon kërkesën nga neni 23 paragrafët (1), (3), (4), (5) dhe (7) të këtij ligji nëse:

1) kërkesa nuk përmban dokumentacionin e plotë;

2) kërkesa përmban të dhëna të pasakta ose të pavërteta;

3) nuk është plotësuar njëri nga kushtet sipas paragrafit (4) pika 2, përkatësisht paragrafi (5) pikat 2 dhe 3 të këtij neni:

4) vlerëson se gjendja financiare e personit nuk është e përshtatshme për vlerën e aksioneve ose pjesëmarrjeve që ai synon t'i fitojë dhe llojin dhe vëllimin e aktiviteteve që kryen institucioni i pagesës ose institucioni i parave elektronike;

5) ekzistojnë arsye të bazuara për të dyshuar në ligjshmërinë e burimeve të mjeteve për fitimin e pjesëmarrjes së kualifikuar në institucionin e pagesës ose institucionin për para elektronike;

6) ekzistojnë arsye të bazuara për të dyshuar se lidhjet e ngushta dhe/ose struktura organizative dhe pronësore e personit ose grupit që i përket, mund të pengojnë kryerjen e mbikëqyrjes efikase të institucionit të pagesave ose institucionit të parave elektronike dhe

7) ekzistojnë arsye të bazuara për të dyshuar se fitimi i planifikuar i pjesëmarrjes së kualifikuar në institucionin e pagesave ose institucionin për para elektronike ka lidhje me pastrimin e parave dhe/ose financimin e terrorizmit ose fitimi i planifikuar rrit rrezikun e pastrimit të parave dhe/ose financimit të terrorizmit.

(8) Nëse guvernatori e refuzon kërkesën për shkak të ekzistimit të arsyeve sipas paragrafit (7) pika 7) të këtij neni, Banka Popullore menjëherë e njofton Drejtorinë e Zbulimit Financiar.

(9) Vlerësimi i gjendjes së reputacionit nga paragrafët (4) pika 2 dhe (5) pika 2 të këtij neni, bëhet në përputhje me nenin 19 paragrafët (5) dhe (6) të këtij ligji.

Zvogëlimi i pjesëmarrjes së kualifikuar

Neni 25

Personi fizik ose juridik i cili synon, në mënyrë të drejtpërdrejt ose të tërthortë, nëpërmjet personave me të cilët ka lidhje të afërta, të zvogëlojë pjesëmarrjen e tij të kualifikuar në institucionin e pagesave ose institucionin për para elektronike ashtu që pjesëmarrja e tij në numrin e përgjithshëm të aksioneve ose aksioneve të lëshuara me të drejtë vote ose pjesëmarrja do të zvogëlohet nën 20%, 30% ose 50%, pavarësisht nëse aksionet ose pjesëmarrja tjetërsohet gradualisht apo menjëherë, është i detyruar të paktën 30 ditë para realizimit të zvogëlimit të pjesëmarrjes së kualifikuar ta njoftojë Bankën Popullore për pjesëmarrjen e tij të kualifikuar para dhe pas zvogëlimit.

Pëlqimi për themelimin e filialit në shtetin e tretë

Neni 26

(1) Institucioni i pagesave, përkatësisht institucioni i parave elektronike me seli në Republikën e Maqedonisë së Veriut mund të ofrojë shërbime të pagesave dhe/ose të emetojë para elektronike në shtetin e tretë vetëm nëpërmjet filialit.

(2) Për themelimin e filialit në shtetin e tretë, institucioni i pagesës, përkatësisht institucioni i parave elektronike, është i detyruar të marrë aktvendim me të cilin jepet pëlqimi nga guvernatori (në tekstin e mëtejshëm: pëlqim për themelimin e filialit në shtetin e tretë).

(3) Institucioni i pagesave, përkatësisht institucioni i parave elektronike i cili synon të themelojë filial në shtetin e tretë është i detyruar që në përputhje me dispozitat e nenit 16 të këtij ligji të parashtrojë kërkesë për marrjen e pëlqimit për themelimin e filialit në shtetin e tretë ndaj të cilit i bashkëngjit dokumentet, të dhënat dhe/ose informacionet e mëposhtme:

1) shtetin në të cilin synon të themelojë filial.

2) plan afarist për tre vitet e para të punës, i cili duhet të përmbajë listën e shërbimeve të pagesave që synon t'i ofrojë nëpërmjet filialit dhe menaxhimit të filialit;

3) strukturën organizative të institucionit të pagesave, përkatësisht të institucionit të parave elektronike;

4) listën me emrat, mbiemrat dhe adresat e personave që do të jenë përgjegjës për punën e filialit dhe

5) adresën e filialit në shtetin e tretë ku Banka Popullore do të mund të marrë dokumentacionin lidhur me punën e filialit.

(4) Guvernatori vendos në afat prej 90 ditësh nga dita e pranimi të kërkesës së kompletuar sipas paragrafit (3) të këtij neni.

(5) Guvernatori do ta refuzojë kërkesën për themelimin e filialit në shtetin e tretë nëse në bazë të dokumentacionit që disponon konstaton se institucioni i pagesës, përkatësisht institucioni i parave elektronike:

1) nuk ka strukturë të përshtatshme organizative, teknike dhe kadrovike ose gjendje të përshtatshme financiare për sigurimin e vëllimit të planifikuar të shërbimeve të pagesave në shtetin e tretë;

2) nëse në përputhje me rregulloret e atij shteti të tretë dhe/ose mënyrën e zbatimit të rregulloreve, vlerëson se nuk do të ketë bashkëpunim përkatës dhe shkëmbim informacioni ndërmjet Bankës Popullore dhe organit mbikëqyrës së shtetit që kërkohet hapja e filialit dhe se zbatimi i mbikëqyrjes në përputhje me dispozitat e këtij ligji do të pamundësohej ose do të pengohej ndjeshëm ose

3) me themelimin e filialit në shtetin e tretë shman rregulloret dhe rregullat më të rrepta që janë në fuqi në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

(6) Institucioni i pagesës, përkatësisht institucioni i parave elektronike, i cili ka marrë pëlqimin për themelimin e filialit në shtetin e tretë dhe ka për qëllim të bëjë ndryshime në dokumentet, të dhënat dhe/ose informacionet sipas paragrafit (3) të këtij neni, është i detyruar ta njoftojë Bankën Popullore së paku një muaj para se të bëjë ndryshimin.

(7) Guvernatori heq pëlqimin ndaj institucionit të pagesave, përkatësisht institucionit të parave elektronike për themelimin e filialit në shtetin e tretë, nëse:

1) përcaktohet se institucioni i pagesës, përkatësisht institucioni i parave elektronike nuk është më i aftë në mënyrë organizative, teknike dhe kadrovike për të ofruar shërbimet e pagesave për të cilat është dhënë pëlqimi;

2) institucioni i pagesës, përkatësisht institucioni i parave elektronike nëpërmjet filialit nuk i respekton rregulloret të shtetit të tretë;

3) në bazë të shpërndarjes territoriale të ofrimit të shërbimeve të pagesave, rrjedh se në atë mënyrë institucioni i pagesave, përkatësisht institucioni i parave elektronike shman rregulloret dhe rregullat më të rrepta që zbatohen në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

4) organi kompetent i shtetit të tretë i ndalon institucionit të pagesave, përkatësisht institucionit të parave elektronike të ofrojë shërbime të pagesave në territorin e tij;

5) filiali nuk fillon me punë në afat prej 6 muajve nga data e marrjes së pëlqimit për themelimin e filialit në shtetin e tretë;

6) filiali vazhdimisht për më shumë se gjashtë muaj nuk i ka kryer aktivitetet e shënuara në pëlqimin ose

7) përcaktohet se pëlqimi për themelimin e filialit në shtetin e tretë është dhënë në bazë të të dhënave të pasakta ose të pavërteta.

(8) Këshilli i Bankës Popullore sipas aktit nënligjor të nenit 16 paragrafi (17) i këtij ligji do t'i përcaktojë në hollësi dokumentet, të dhënat dhe/ose informacionet sipas paragrafit (3) të këtij neni, mënyrën e dorëzimit të tyre, si dhe kushtet dhe procedurën për dhënien e pëlqimit.

Regjistri i institucioneve të pagesave dhe Regjistri i institucioneve të parave elektronike

Neni 27

(1) Banka Popullore mban Regjistrin e institucioneve të pagesave dhe Regjistrin e institucioneve për para elektronike

(2) Regjistri i institucioneve të pagesave në veçanti përmban:

1) emrin dhe selinë e institucionit të pagesave, llojin e shërbimeve të pagesave për të cilat është lëshuar leja për dhënien e shërbimeve të pagesave, emrin dhe selinë e agjentëve të institucionit të pagesave dhe llojin e shërbimeve të pagesave të dhëna nga agjenti dhe emrin dhe selinë e filialit e hapur në shtetin - anëtar nikoqir dhe/ose në vendin e tretë;

2) emrin dhe selinë e institucionit të pagesave me qasje të lehtësuar, llojin e shërbimeve të pagesave për të cilat është lëshuar leja për dhënien e shërbimeve të pagesave, emrin dhe selinë e agjentëve të institucionit të pagesave dhe llojin e shërbimeve të pagesave të ofruara nga agjenti;

3) emrin dhe selinë e institucionit të pagesave që ofron vetëm shërbime për dhënien e informacioneve për llogaritë e pagesave dhe emrin dhe selinë e agjentëve të institucionit të pagesave;

4) emrin, selinë e emetuesit të instrumenteve të pagesës nga neni 3 paragrafi (1) pika 11 alinea a) dhe b) të këtij ligji dhe përshkrimin e aktivitetit për të cilin është dërguar njoftim në përputhje me nenin 3 paragrafi (3) i këtij ligji dhe

5) emrin dhe selinë e operatorit të rrjeteve të komunikimit elektronik ose dhënësit të shërbimeve të komunikimit elektronik nga neni 3 paragrafi (1) pika 12 të këtij ligji dhe përshkrimi i aktivitetit për të cilin është dërguar njoftim në përputhje me nenin 3 paragrafi (6) i këtij ligji.

(3) Regjistri i institucioneve për para elektronike duhet të përmbajë veçanërisht:

1) emrin dhe selinë e institucionit të parave elektronike;

2) emrin dhe selinë e institucionit të parave elektronike me qasje të lehtësuar;

3) emrin dhe selinë e agjentëve të institucionit të parave elektronike dhe

4) emrin dhe selinë e filialit të hapur në shtetin-anëtar dhe/ose në shtetin e tretë të institucionit të parave elektronike nga pika 1) e këtij paragrafi.

(4) Regjistri sipas paragrafit (2) dhe paragrafi (3) të këtij neni përmban informacione edhe për institucionin e pagesave, përkatësisht institucionin për para elektronike të cilit i është hequr leja për ofrimin e shërbimeve të pagesave ose lëshimin e parasë elektronike, përkatësisht është hequr regjistrimi në regjistrin.

(5) Regjistrat sipas paragrafit (1) të këtij neni udhëhiqen në formë elektronike, janë publike dhe janë të disponueshëm në faqen e internetit të Bankës Popullore. Banka Popullore i përditëson të dhënat nga regjistrat sipas paragrafit (1) të këtij neni në bazë të rregullt.

(6) Banka Popullore menjëherë e njofton Trupin Bankar European për:

1) çdo regjistrim dhe ndryshim të të dhënave në regjistrat sipas paragrafit (1) të këtij neni dhe

2) heqjen e lejes së institucionit të pagesave, përkatësisht institucionit të parave elektronike ose shfuqizimin e aktvendimit për regjistrim në Regjistrin e institucionit të pagesave që ofron vetëm shërbime për dhënien e informacioneve për llogaritë e pagesave, si dhe arsyet e revokimit të lejes ose shfuqizimin e aktvendimit.

(7) Këshilli i Bankës Popullore me aktin nënligjor nga neni 16 paragrafi (17) i këtij ligji do të përcaktojë më hollësisht përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrave dhe mënyrën e fshirjes së të dhënave nga regjistrat sipas paragrafit (1) 1) të këtij neni.

Kapitulli III

Standarde prudente për punën e institucioneve të pagesave dhe të institucioneve të para elektronike

Kapitali fillestar i institucioneve të pagesave dhe I institucioneve të parave elektronike

Neni 28

(1) Institucioni i pagesave themelohet me kapital fillestar prej:

1. së paku 1.300.000 denarë për ofrimin e shërbimeve të pagesave nga neni 8 paragrafi (1) pika 6 i këtij ligji;
2. së paku 3.100.000 denarë për ofrimin e shërbimeve të pagesave nga neni 8 paragrafi (1) pika 7 i këtij ligji, dhe
3. së paku 7.800.000 denarë për ofrimin e shërbimeve të pagesave nga neni 8 paragrafi (1) pikat 1, 2, 3, 4 dhe/ose 5 të këtij ligji.

(2) Nëse institucioni i pagesave ofron disa lloje të shërbimeve të pagesave nga neni 8 i këtij ligji, duhet të sigurojë kapital fillestar në vlerën më të lartë për shërbimin përkatës të përcaktuar në paragrafin (1) të këtij neni.

(3) Me përjashtim të paragrafit (1) të këtij neni, institucioni i pagesave i cili do të japë shërbime të pagesave me qasje të lehtësuar themelohet me kapital fillestar prej së paku 1.300.000 denarë.

(4) Institucioni i parave elektronike themelohet me kapital fillestar së paku 21.700.000 denarë.

(5) Me përjashtim të paragrafit (4) të këtij neni, institucion për para elektronike që do të emetojë para elektronike me qasje të lehtësuar do të themelohet me kapital fillestar prej së paku 3.620.000 denarë.

(6) Kapitali fillestar nga paragrafët (1), (2), (3), (4) dhe (5) të këtij neni dhe të gjitha rritjet e mëtejshme të kapitalit fillestar duhet të jenë vetëm në formë financiare dhe duhet të paguhen në tërësi, ku kapitali fillestar i paguar plotësisht, shënohet si kryegjë themelore në regjistrin tregtar të cilin e mban Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(7) Institucioni i pagesave dhe institucioni i parave elektronike janë të detyruar që vazhdimisht ta ruajnë vlerën e kapitalit fillestar nga paragrafët (1), (2), (3), (4) dhe (5) të këtij neni.

(8) Kapitali fillestar nga paragrafët (1), (2), (3), (4) dhe (5) të këtij neni, si dhe të gjitha rritjet e mëtejshme të kapitalit fillestar, nuk mund të zvogëlohen me kthim të depozitave të paguara për aksionarët ose partnerët.

(9) Këshilli i Bankës Popullore me akt nënligjor i përcakton pozitat nga të cilat përbëhet kapitali fillestar dhe mjetet personale të institucionit të pagesës dhe institucionit të parave elektronike nga ky nen dhe neni 29 i këtij ligji.

Mjetet vetjake të institucionit të pagesave

Neni 29

(1) Institucioni i pagesave i cili ofron shërbime të pagesave nga neni 8 paragrafi (1) pikat 1, 2, 3, 4, 5 dhe/ose 6 të këtij ligji është i detyruar që vazhdimisht të disponojë me vlerë të mjeteve vetjake e cila nuk mund të jetë më e vogël nga vlera më e lartë ndërmjet vlerës së kapitalit fillestar nga neni 28 i këtij ligji dhe vlerës së mjeteve vetjake të përcaktuara në përputhje me paragrafin (2) të këtij neni.

(2) Për nevojat e paragrafit (1) të këtij neni, vlera e mjeteve vetjake fitohet kur shuma e elementeve sipas paragrafit (3) të këtij neni shumëzohet me koeficientin "k" të përcaktuar në paragrafin (6) të këtij neni.

(3) Institucioni i pagesave gjatë përcaktimit të vlerës së mjeteve vetjake që disponon, përdor shumën e këtyre elementeve:

- a) 4,0% të pjesës së vëllimit të pagesave deri në 310.000.000 denarë,
- b) 2,5% të pjesës së vëllimit të pagesave mbi 310.000.000 denarë deri në 620.000.000 denarë,
- c) 1,0% të pjesës së vëllimit të pagesave mbi 620.000.000 deri 6.200.000.000 denarë,
- ç) 0,5% të pjesës së vëllimit të pagesave mbi 6.200.000.000 deri 15.400.000.000 denarë dhe
- d) 0,25% e pjesës së vëllimit të pagesave mbi 15.400.000.000 denarë.

(4) Vëllimi i pagesave sipas paragrafit (3) të këtij neni paraqet një të dymbëdhjetën nga vlera e përgjithshme e transaksioneve të pagesave të kryera nga institucioni i pagesës në 12 muajt paraprak.

(5) Nëse institucioni i pagesave ende nuk ka filluar me kryerjen e veprimtarisë ose kryen veprimtari në periudhë më të shkurtër se 12 muaj, vëllimi i pagesave sipas paragrafit (3) të këtij neni paraqet një të dymbëdhjetën e vlerës së përgjithshme të projektuar të transaksioneve të pagesave që janë planifikuara të kryhen në vitin e parë të punës të shënuara në planin afarist nga neni 16 paragrafi (2) pika 6 të këtij ligji, pas rregullimeve të mundshme me kërkesë të Bankës Popullore.

(6) Koeficienti "k" që përdoret gjatë llogaritjes së vlerës së mjeteve vetjake të institucionit të pagesave sipas paragrafit (2) të këtij neni është:

- a) 0.5, nëse institucioni i pagesave jepë vetëm shërbimet e pagesave nga neni 8 paragrafi (1) pika 6 ose
- b) 1, nëse institucioni i pagesave ofron ndonjë nga shërbimet e pagesave nga neni 8 paragrafi (1) pikat 1, 2, 3, 4 dhe/ose 5.

(7) Detyrimi nga ky nen nuk i referohet institucionit të pagesave, i cili është anëtar i grupit bankar, personi amë i të cilit është me seli në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe është subjekt i supervizionit të konsoliduar në përputhje me ligjin që rregullon punën e bankave ose kur është anëtar i grupi bankar, personi amë i të cilit është me administratë qendrore jashtë vendit, me kusht që organi supervisor në vendin ku është regjistruar selia e personit amë të praktikojë supervizion adekuat të konsoliduar, të paktën identik me mënyrën dhe vëllimin e përcaktuar me ligjin që rregullon funksionimin e bankave.

(8) Banka Popullore, në bazë të vlerësimit të proceseve të menaxhimit të rreziqeve, të dhënave për humbjet e pësuar si pasojë e ngjarjeve të rrezikut dhe sistemeve të kontrollit të brendshëm të institucionit të pagesave, mund të urdhërojë institucionin e pagesës që të disponojë vlerë të mjeteve vetjake e cila është më së shumti 20% më e lartë se vlera e mjeteve vetjake të institucionit të pagesave sipas paragrafit (1) të këtij neni.

(9) Banka Popullore, me kërkesën e institucionit të pagesave, në bazë të vlerësimit të proceseve të menaxhimit të rreziqeve, të dhënave për humbjet e pësuar si pasojë e ngjarjeve të rrezikut dhe sistemeve të kontrollit të brendshëm të institucionit të pagesave, mund të lejojë institucionin e pagesës që të disponojë me vlerë të mjeteve vetjake e cila është më së shumti 20% më e lartë se vlera e mjeteve vetjake të institucionit të pagesave sipas paragrafit (1) të këtij neni.

Mjetet vetjake të institucionit të parave elektronike

Neni 30

(1) Institucioni i parave elektronike është i detyruar që vazhdimisht të disponojë me vlerë të mjeteve personale e cila nuk mund të jetë më e vogël se vlera më e madhe ndërmjet vlerës së kapitalit fillestar nga neni 28 i këtij ligji dhe vlerës së mjeteve fillestare të përcaktuara në përputhje me paragrafët (2), (3) dhe (4) të këtij neni.

(2) Institucioni i parave elektronike për veprimtarinë e emetimit të parave elektronike është i detyruar që vazhdimisht të disponojë me mjetet vetjake në vlerë prej së paku 2% të vlerës mesatare të parave elektronike të pashfrytëzuara.

(3) Institucioni i parave elektronike i cili ofron shërbime të pagesave nga neni 8 i këtij ligji, të cilat nuk janë të lidhur me emetimin e parave elektronike, është i detyruar që vazhdimisht të disponojë me vlerë të mjeteve vetjake të barabartë ose më të madhe se përmbledhja e vlerës së mjeteve vetjake e llogaritur në përputhje me paragrafin (2) të këtij neni dhe vlera e mjeteve vetjake të përcaktuara në përputhje me nenin 29 paragrafi (2) i këtij ligji.

(4) Nëse institucioni i parave elektronike ofron shërbime të pagesave nga neni 8 i këtij ligji të cilat nuk janë të lidhur me emetimin e parave elektronike ose kryen ndonjë nga shërbimet dhe aktivitetet nga neni 11 paragrafi (3) pika 2, 3. dhe/ose 4 të këtij ligji, ndërkaq vlera e parave elektronike të pashfrytëzuara nuk dihet paraprakisht, vlera e mjeteve vetjake sipas paragrafit (2) të këtij neni përcaktohet në bazë të pjesës së mjeteve financiare që supozohet që do të përdoren për emetimin e parave elektronike, me kusht që kjo pjesë të mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme duke përdorur të dhëna historike.

(5) Nëse periudha kohore e punës së institucionit të parave elektronike nuk është mjaftueshëm e gjatë për nevojat e llogaritjes së vlerës mesatare të parave elektronike të pashfrytëzuar të lëshuar, vlera e mjeteve vetjake nga paragrafët (2) dhe (4) të këtij neni do të përcaktohet në bazë të vlerës së projektuar të parasë elektronike të emetuar e cila vërtetohet me planin afarist të institucionit të parave elektronike nga neni 16 paragrafi (2) pika 6 e këtij ligji në të cilin janë zbatuar përshtatjet me kërkesë të Bankës Popullore.

(6) Nëse Banka Popullore vlerëson se llogaritja e mjeteve personale të institucionit të parave elektronike nga paragrafët (4) dhe (5) të këtij neni nuk është e përshtatshme, duke përfshirë edhe kohëzgjatjen e periudhës kohore të cilës i referohen të dhënat e vlerësuara, ose nuk përshtatet me natyrën, llojin dhe vëllimin e veprimtarive të tjera që i kryen nga institucioni i parave elektronike, mund të mos miratojë llogaritjen dhe të kërkojë vlerë më të lartë të mjeteve vetjake.

(7) Detyrimi nga ky nen nuk i referohet institucionit të parave elektronike, i cili është anëtar i grupit bankar, personi amë i të cilit është me seli në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe është subjekt i supervizionit të konsoliduar në përputhje me ligjin me të cilin rregullohet puna e bankave, ose kur është anëtar në grup bankar me seli të regjistruar jashtë vendit, me kusht që organi mbikëqyrës në vendin ku është regjistruar selia e grupit bankar të huaj të praktikojë mbikëqyrje adekuate në baza të konsoliduara, të paktën identike me mënyrën dhe vëllimin e përcaktuar me ligjin që rregullon punën e bankave.

(8) Banka Popullore, në bazë të vlerësimit të proceseve për menaxhim të rreziqeve, të dhënave për humbjet e pësuar si pasojë e ngjarjeve të rrezikut dhe sistemeve të kontrollit të brendshëm të institucionit të parave elektronike, mund të urdhërojë institucionin për para elektronike të disponojë me vlerë të mjeteve personale e cila është më së shumti 20% më e lartë se vlera e llogaritur në përputhje me paragrafët (2), (3) dhe (4) të këtij neni.

(9) Banka Popullore, me kërkesë të institucionit të parave elektronike, në bazë të vlerësimit të proceseve të menaxhimit të rreziqeve, të dhënave për humbjet e pësuar si pasojë e ngjarjeve të rrezikut dhe sistemeve të kontrollit të brendshëm të institucionit të parave elektronike, mund të lejojë që institucioni i parave elektronike të disponojë me vlerë të mjeteve personale e cila është më së shumti 20% më e ulët se vlera e llogaritur në përputhje me paragrafët (2), (3) dhe (4) të këtij neni.

Mbrojtja e mjeteve në para të shfrytëzuesit të shërbimit të pagesave në institucionet e pagesave

Neni 31

(1) Institucioni i pagesës i cili ofron shërbime të pagesave nga neni 8 paragrafi (1) pikat 1, 2, 3, 4, 5 dhe/ose 6 të këtij ligji është i detyruar t'i mbrojë mjetet financiare të pranuara nga ose në dobi të shfrytëzuesit të shërbimit të pagesave për kryerjen e transaksioneve të pagesave ose mjetet e pranuara nga ofruesi tjetër i shërbimeve të pagesave në dobi të shfrytëzuesit të shërbimit të pagesave për kryerjen e transaksioneve të pagesave në përputhje me dispozitat e këtij neni të ligjit.

(2) Institucioni i pagesës është i detyruar që financiare sipas paragrafit (1) të këtij neni t'i ruajë veçmas nga mjetet që i mban në emër të vet dhe llogari të vet, si dhe nga mjetet financiare të pranuara nga persona juridikë ose fizikë që nuk janë shfrytëzues të shërbimeve të pagesave.

(3) Nëse institucioni i pagesave mjetet financiare sipas paragrafit (1) të këtij neni nuk ia bartë pranuesit ose ofruesit tjetër të shërbimeve të pagesave më së voni deri në fund të ditës së ardhshme të punës nga dita e pranimit të tyre, është i detyruar t'i mbrojë këto mjete financiare në mënyrat e mëposhtme:

1) t'i depozitojë në llogari të posaçme të hapur në Bankën Popullore dhe/ose në bankë dhe/ose në kursimore në përputhje me ligjin që rregullon themelimin dhe punën e bankave dhe kursimoreve ku mjetet e depozituara nuk përdoren për qëllime të tjera përveç mbrojtjes së mjeteve financiare të pranuara nga shfrytëzuesi i shërbimeve të pagesave ose ofruesi tjetër i shërbimeve të pagesave dhe/ose

2) t'i investojë në mjete të sigurta, likuide dhe me rrezik të ulët.

(4) Mjetet sipas paragrafit (1) dhe mbrojtja e tyre e përcaktuar me paragrafin (3) të këtij neni:

1) nuk hyjnë në masën e falimentimit ose të likuidimit gjatë zbatimit të procedurës së likuidimit ose falimentimit të institucionit të pagesës;

2) nuk hyjnë në masën e falimentimit ose të likuidimit të bankës dhe/ose të kursimores ku janë depozituar;

3) mbi to nuk mund të vendoset kolateral ose vepër tjetër e ngjashme juridike për sigurimin e kërkesave dhe

4) mbi ta nuk mund të zbatohet ekzekutimi nga ana ose në emër të ofruesve të institucionit të pagesës.

(5) Nëse ndaj institucionit të pagesës hapet procedurë falimentimi, mjetet financiare në llogaritë e veçanta sipas paragrafit (3) pika 1) të këtij neni do të përdoren vetëm për përmbushjen e detyrimeve të institucionit të pagesave ndaj shfrytëzuesve të shërbimeve të pagesave.

(6) Nëse hapet procedurë falimentimi ndaj bankës ose kursimores ku është hapur llogari e veçantë sipas paragrafit (3) pika 1) të këtij neni, mjetet financiare në këtë llogari të veçantë do të transferohen menjëherë dhe pa shtyrje në llogari të veçantë në bankë ose kursimore tjetër, të përcaktuar nga institucioni i pagesave.

(7) Dispozitat e Ligjit për Falimentim që kanë të bëjnë me demantimin e veprimeve juridike nuk zbatohen në mjetet financiare sipas paragrafit (1) të këtij neni dhe për mbrojtjen e tyre të përcaktuar me paragrafin (3) të këtij neni.

(8) Dispozitat nga paragrafët (2) dhe (3) të këtij neni nuk zbatohen nëse mjetet sipas paragrafit (1) të këtij neni mbulohen me policë sigurimi ose me garanci pa kundërshtim dhe të pagueshme në thirrjen e parë, në rast pamundësie institucioni i pagesave për të përmbushur detyrimet e tij financiare, të lëshuara nga shoqëria për sigurim ose banka, të cilat nuk i përkasin të njëjtit grup të cilit i përket institucioni i pagesave, nuk kanë pjesëmarrje të kualifikuar në institucionin e pagesave dhe/ose nuk paraqesin persona me lidhje të ngushta me institucionin e pagesave dhe të

cilët i plotësojnë kushtet që duhet t'i plotësojnë institucionet financiare që lëshojnë policat ose garancitë nga neni 16 paragrafi (18) i këtij ligji. Me policën e sigurimit ose garancinë pa kundërshtim dhe të pagueshme në thirrjen e parë, mjetet financiare duhet të kenë mbulim ose të garantohen, së paku në vlerë të barabartë me atë me të cilin do të mbroreshin nëse do të zbatohesh mënyra e përcaktuar në paragrafin (3) të këtij neni.

(9) Institucioni i pagesave i cili përveç ofrimit të shërbimeve të pagesave sipas paragrafit (1) të këtij neni, kryen edhe shërbimet dhe veprimtaritë nga neni 11 paragrafi (2) të këtij ligji, duke pranuar mjete financiare nga shfrytëzuesi i shërbimeve të pagesave një pjesë e të cilave do të jetë e dedikuar për kryerjen e transaksioneve të ardhshme të pagesave, ndërkaj pjesa tjetër është e dedikuar për kryerjen e shërbimeve dhe veprimtarive të tjera, është i detyruar t'i mbrojë mjetet financiare të pranuar të dedikuara për kryerjen e transaksioneve të ardhshme të pagesave në përputhje me dispozitat e këtij neni. Në rast se vlera e mjeteve financiare për kryerjen e transaksioneve të ardhshme të pagesave është e ndryshueshme ose nuk dihet paraprakisht, institucioni i pagesave do të mbrojë pjesën e mjeteve financiare që supozohet se do të përdoret për kryerjen e transaksioneve të ardhshme të pagesave dhe që mund të jenë vlerësime të besueshme bazuar në të dhënat historike për shfrytëzimin e mjeteve financiare. Nëse Banka Popullore vlerëson se vlerësimi i vlerës së mjeteve financiare të dedikuar për kryerjen e transaksioneve të ardhshme të pagesave nuk është i përshtatshëm, mund të kërkojë ndryshime në llogaritjen dhe mbrojtje më të lartë të mjeteve financiare të pranuar nga shfrytëzuesit e shërbimeve të pagesave.

(10) Nëse institucioni i pagesave planifikon ndryshime në mënyrën e mbrojtjes së mjeteve financiare të shfrytëzuesit të shërbimeve të pagesave, është i detyruar që në afat prej 30 ditësh para ndryshimit ta njoftojë Bankën Popullore dhe të dorëzojë përshkrim të masave të planifikuara mbrojtëse me dëshmi dhe dokumente përkatëse.

Mbrojtja e mjeteve financiare të shfrytëzuesit të shërbimeve të pagesave gjatë emetimit të parave elektronike

Neni 32

(1) Institucioni i parave elektronike është i detyruar t'i mbrojë paratë e gatshme të pranuar me qëllim të emetimit të parave elektronike në përputhje me nenin 31 të këtij ligji.

(2) Dispozitat e nenit 31 të këtij ligji në mënyrë të përshtatshme zbatohen për mjetet financiare të pranuar nga shfrytëzuesi i shërbimeve të pagesave ose nga ofruesi tjetër i shërbimeve të pagesave për kryerjen e transaksioneve të pagesave me institucionet për para elektronike gjatë kryerjes së shërbimeve dhe aktiviteteve nga neni 11 paragrafi (3) të këtij ligji, të cilat nuk kanë të bëjnë me emetimin e parave elektronike.

(3) Nëse mjetet financiare për emetimin e parave elektronike paguhen në dobi të institucionit të parave elektronike me anë të instrumentit të paguar, institucioni i parave elektronike është i detyruar t'i mbrojë ato në përputhje me nenin 31 të këtij ligji pasi mjetet financiare do të miratohen në llogarinë e pagesës ose ndryshe do t'i vihen në dispozicion institucionit të parave elektronike në afatet për kryerjen e transaksioneve të pagesave nga Pjesa e katërt Kapitulli III të këtij ligji nëse është e zbatueshme, por jo më vonë se pesë ditë pune nga dita e lëshimit të parave elektronike.

(4) Këshilli i Bankës Popullore, me akt nënligjor më hollësisht përcakton llojin e mjeteve nga neni 31 paragrafi (3) pika 2 të këtij ligji, të cilat përdoren për mbrojtjen e mjeteve financiare nga institucionet e pagesave dhe institucionet e parave elektronike.

Kapitulli IV

Librat tregtar, llogaria vjetore dhe raportet financiare dhe revizioni i institucioneve të pagesave dhe i institucioneve të parave elektronike

Librat tregtar, llogaritë vjetore dhe raportet financiare

Neni 33

(1) Institucionet e pagesave dhe institucionet për para elektronike janë të detyruara të mbajnë libra tregtar në përputhje me dispozitat e Ligjit të Shoqërive Tregtare.

(2) Institucionet e pagesave dhe institucionet për para elektronike janë të detyruara të përgatisin llogari vjetore dhe raporte financiare vjetore, individualisht dhe në baza të konsoliduara, në përputhje me rregulloret e kontabilitetit.

(3) Institucionet e pagesave dhe institucionet për para elektronike janë të detyruara Bankës Popullore t'i dorëzojnë llogarinë vjetore të reviduar dhe raportet vjetore financiare, individuale dhe në baza të konsoliduara në afat prej dhjetë ditësh nga dita e miratimit të tyre, së bashku me raportin e revizionit.

(4) Institucionet e pagesave dhe institucionet për para elektronike janë të detyruara Bankës Popullore t'i dorëzojnë raporte financiare gjashtëmujore të pakorrigjuara, individuale dhe në baza të konsoliduara, me gjendje në fund të secilit gjashtëmujor, në afat prej 30 ditësh pas mbarimit gjysmëvjetorit.

Revizioni

Neni 34

(1) Llogaria vjetore, raportet financiare vjetore dhe informacionet shtesë financiare dhe të dhënat kontabël nga neni 33 paragrafi (2) i këtij ligji i nënshtrohen revizionit nga Shoqëria e Revizionit.

(2) Revizioni, përveç çështjeve sipas paragrafit (1) të këtij neni, veçanërisht përfshin:

1) sistemet për menaxhim me rreziqet e institucionit të pagesave ose institucionit të parave elektronike;

2) funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm;

3) sigurinë e sistemit të informacionit;

4) saktësinë dhe kompletimin e raporteve që institucioni i pagesave ose institucioni i parave elektronike i dorëzon Bankës Popullore për nevojat e mbikëqyrjes mbi kryerjen e shërbimeve të pagesave dhe/ose mbikëqyrjen e institucioneve të pagesave dhe/ose institucioneve për para elektronike;

5) harmonizimin e punës së institucionit të pagesave ose institucionit të parave elektronike me rregulloret që rregullojnë punën e institucionit të pagesave ose institucionit të parave elektronike dhe

6) sistemin e institucionit të pagesave ose institucionit të parave elektronike për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit.

(3) Revizioni institucionit të pagesave dhe institucionit të parave elektronike nuk mund të kryhet nga:

1) Shoqëria e Revizionit në të cilën ka konflikt interesi dhe kundërvajtje ose cënimin e pavarësisë në lidhje me institucionin e pagesës ose institucionin për para elektronike, në përputhje me dispozitat e Ligjit të Revizionit;

2) Shoqëria e Revizionit e cila në dy vitet e fundit i ka dhënë institucionit të pagesave ose institucionit të parave elektronike:

a) kontabilitetin ose shërbime të tjera që lidhen me evidencën kontabël, llogaritë vjetore ose llogaritë vjetore të konsoliduara të subjektit të cilin kryhet revizioni;

b) ka përrgatitur dhe zbatuar sisteme informacioni financiar;

c) shërbimet e revizionit të brendshëm si person i jashtëm dhe

d) vlerësimin për qëllime të vlerësimit financiar;

3) Shoqëria e Revizionit e cila në tri vitet e fundit është nën masat e vendosura nga Këshilli i Promovimit dhe i Mbikëqyrjes së Kontabilitetit dhe të Revizionit të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Institutit të Revizorëve të Autorizuar të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(4) Shoqëria e Revizionit mund të kryejë revizion të institucionit të pagesave ose institucionit të parave elektronike në periudhë deri në pesë vjet rresht.

Raportimi i shoqërisë së revizionit

Neni 35

(1) Banka Popullore mund të kërkojë nga Shoqëria e Revizionit sqarime dhe të dhëna shtesë lidhur me revizionin e kryer.

(2) Shoqëria e Revizionit është e detyruar që me kërkesë të Bankës Popullore t'i vë në dispozicion materialet punuese nga revizioni i institucionit të pagesave ose institucionit të parave elektronike.

(3) Shoqëria e Revizionit është e detyruar t'i dorëzojë raportim me shkrim Bankës Popullore, nëse gjatë kontrollit konstaton se:

1) ka shkelje të ligjeve, akteve nënligjore dhe akteve të Bankës Popullore me të cilat rregullohet puna e institucionit të pagesave ose institucionit të parave elektronike;

2) raportet financiare vjetore që i nënshtrohen revizionit janë dukshëm të ndryshme nga raportet financiare vjetore të pa reviduara;

3) cenohet parimi i punës së vazhdueshme të institucionit të pagesave ose institucionit të parave elektronike;

4) institucioni i pagesës ose institucioni i parave elektronike është jolikuid ose josolvent;

5) raporti i revizionit do të përmbajë mendim të pafavorshëm, ose përmbajtje nga mendimi nëse revizori i autorizuar nuk është në gjendje të shprehë mendimin e tij të revizionit;

6) ekzistojnë aktivitete me të cilat anëtarët e organeve drejtuese dhe mbikëqyrëse në institucionin e pagesave ose institucionin për para elektronike mund t'i shkaktojnë dëm material institucionit të pagesës ose institucionit të parave elektronike ose klientëve të tij;

7) ekziston mos respektim i rregulloreve për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe

8) ekzistojnë rrethana që paraqesin shkak për heqjen e lejes për ofrimin e shërbimeve të pagesave, përkatësisht emetimin e parave elektronike.

(4) Shoqëria e Revizionit është e detyruar, me kërkesë të Bankës Popullore, të dorëzojë dokumentacionin përkatës për rrethanat sipas paragrafit (3) të këtij neni, si dhe informacione dhe dokumente tjera të marra gjatë revizionit.

(5) Dorëzimi i dokumentacionit nga paragrafët (1), (2) dhe (4) të këtij neni në Bankën Popullore nuk paraqet shkelje të detyrimit të revizorit të autorizuar për ruajtjen e informacioneve konfidenciale të marra gjatë kryerjes së revizionit.

Ruajtja e librave tregtar, e dokumenteve të kontabilitetit, e llogarive vjetore dhe e raporteve financiare

Neni 36

Institucioni i pagesave, përkatësisht institucioni i parave elektronike, është i detyruar që librat tregtar, dokumentet kontabël, llogaritë vjetore dhe raportet financiare t'i ruajë në mënyrën dhe në afatet e përcaktuara në përputhje me Ligjin e Shoqëritëve Tregtare.

Kapitulli V

Përdorimi i agentëve dhe përdorimi i shërbimeve nga persona të jashtëm

Ofrimi i shërbimeve të pagesave nëpërmjet agentëve

Neni 37

(1) Institucionet e pagesave mund të ofrojnë shërbime të pagesave, drejtpërdrejt ose nëpërmjet një ose më shumë agentëve.

(2) Agjentët ofrojnë shërbime të pagesave në emër dhe për llogari të institucionit të pagesave.

(3) Institucioni i pagesave është i detyruar të sigurojë që agjenti t'i informojë përdoruesit e shërbimeve të pagesave se shërbimet i ofron në emër dhe për llogari të institucionit të pagesës.

Distribuími dhe blerja e parave elektronike nëpërmjet agentëve

Neni 38

(1) Institucioni i parave elektronike mund të distribuojë dhe blejë para elektronike dhe/ose të japë shërbime të pagesave nëpërmjet një ose më shumë agentëve që veprojnë në emër dhe për llogari të institucionit të parave elektronike.

(2) Institucioni i parave elektronike është i detyruar të sigurojë që agjenti t'i informojë përdoruesit e parave elektronike se shërbimet i ofron në emër dhe për llogari të institucionit të parave elektronike.

(3) Institucioni i parave elektronike nuk guxon të emetojë para elektronike nëpërmjet agentit.

Regjistrimi i agentëve

Neni 39

(1) Institucioni i pagesave i cili synon të ofrojë shërbime të pagesave nëpërmjet agentit, përkatësisht institucionit të parave elektronike që synon distribuimin dhe blerjen e parave elektronike nëpërmjet agentit dhe/ose të ofrojë shërbime të pagesave nëpërmjet agentit, është i detyruar të dorëzojë kërkesë në Bankën Popullore për regjistrimin e agentit në regjistrin përkatës nga neni 27 i këtij ligji.

(2) Ndaj kërkesës sipas paragrafit (1) të këtij neni, detyrimisht dorëzohen:

1) të dhënat për emrin, selinë dhe numrin amë të agentit;

2) procedurat dhe sistemet e kontrollit të brendshëm në përputhje me Ligjin e Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe të Financimit të Terrorizmit;

3) identiteti i anëtarëve të organit drejtues të agentit dhe nëse agjenti nuk është ofrues i shërbimeve të pagesave ose emetues i parave elektronike, dokumentacioni nga neni 16 paragrafi (2) pika 17 të këtij ligji;

4) shërbimet e pagesave, pra distribuimi dhe/ose blerja e parave elektronike që do të kryhen nga agjenti.

(3) Agjenti mund të fillojë me punë pas regjistrimit të tij në regjistrin përkatës nga neni 27 i këtij ligji.

(4) Banka Popullore në afat prej 60 ditësh nga dita e pranimi të kërkesës sipas paragrafit (1) të këtij neni, agjentin e shënon në regjistrin përkatës nga neni 27 i këtij ligji ose nëse dokumentet, të dhënat dhe/ose informacionet sipas paragrafit (2) të këtij neni vërteton se nuk janë plotësuar kushtet, e njofton institucionin e pagesës, përkatësisht institucionin për para elektronike.

(5) Banka Popullore e fshin agjentin nga regjistri përkatës:

1) me kërkesë të institucionit të pagesës ose institucionit të parave elektronike, përkatësisht me njoftimin e institucionit të pagesës ose institucionit të parave elektronike në përputhje me nenin 171 paragrafi (3) pika 7 të këtij ligji;

2) nëse konstatohet se agjenti në bazë të dokumenteve, të dhënave dhe informatave të pasakta ose të pavërteta është regjistruar në regjistrin nga neni 27 paragrafi (2) i këtij ligji; ose

3) nëse agjenti nuk i plotëson kushtet e këtij neni.

(6) Institucioni i pagesës ose institucioni i parave elektronike është i detyruar të ndërpresë ofrimin e shërbimeve të pagesave nëpërmjet agentit nga dita e fshirjes së agentit në regjistrin përkatës nga neni 27 i këtij ligji.

(7) Për çdo ndryshim të të dhënave sipas paragrafit (2) të këtij neni, institucioni i pagesave, përkatësisht institucioni i parave elektronike, është i detyruar që në afat prej pesë ditësh nga dita e ndryshimit ta njoftojë Bankën Popullore dhe t'ia dorëzojë dokumentet dhe informacionet e nevojshme.

(8) Këshilli i Bankës Popullore me aktin nënligjor nga neni 16 paragrafi (17) i këtij ligji në mënyrë të detajuar e përcakton procedurën për parashtrimin e kërkesës sipas paragrafit (1) të këtij neni, dokumentet, të dhënat dhe/ose informacionet e nevojshme për regjistrimin e agentit në regjistrin përkatës nga neni 27 i këtij ligji dhe procedurën për fshirjen e agentit nga regjistri.

Shërbime nga persona të jashtëm

Neni 40

(1) Institucioni i pagesave, përkatësisht institucioni i parave elektronike, kryerjen e funksioneve operative që kanë të bëjnë me ofrimin e shërbimeve të pagesave, përkatësisht emetimin e parave elektronike, mund t'ua bartë personave të jashtëm ekskluzivisht në bazë të marrëveshjes së lidhur me shkrim. Për qëllimin për bartje njoftohet Banka Popullore jo më herët se 90 ditë para lidhjes së marrëveshjes.

(2) Nëse institucioni i pagesave, përkatësisht institucioni i parave elektronike synon që së bashku me njoftimin sipas paragrafit (1) të këtij neni, të bartë funksione të rëndësishme operative të personat e jashtëm, përfshirë sistemin informativ, është i detyruar të Banka për çdo funksion të rëndësishëm operacional të dorëzojë një propozim marrëveshje e cila detyrimisht duhet të përmbajë dispozita me të cilat personi i jashtëm obligohet se:

1) për qëllimet e mbikëqyrjes së Bankës Popullore do të sigurojë qasje të papenguar në hapësirat e saj dhe në dokumentacionin, të dhënat dhe/ose informacionet me të cilat disponon, të cilat i referohen funksionit operativ që kryen personi i jashtëm për institucionin e pagesave ose institucionin për para elektronike;

2) siguron mbrojtjen e të dhënave personale të përdoruesve të shërbimeve të pagesave në përputhje me nenet 126 dhe 127 të këtij ligji dhe

3) siguron mbrojtjen dhe ruajtjen e dokumenteve, të dhënave dhe/ose informacioneve lidhur me shërbimet e pagesave, në përputhje me nenin 128 të këtij ligji.

(3) Bartja e kryerjes së funksioneve të rëndësishme operative të personat e jashtëm, përfshirë sistemin e informacionit, nuk duhet të kryhet në atë mënyrë që:

1) do të dëmtonte ndjeshëm cilësinë e kontrollit të brendshëm në institucionin e pagesave ose institucionin për para elektronike dhe

2) do të pamundësonte, kufizonte ose komplikonte kapacitetin e Bankës Popullore për të mbikëqyrur dhe ndjekur harmonizimin e punës së institucionit të pagesave ose institucionit të parave elektronike me të gjitha detyrimet e përcaktuara me këtë ligj.

(4) Institucioni i pagesave, përkatësisht institucioni i parave elektronike gjatë bartjes së funksioneve të rëndësishme operative, duke përfshirë edhe personin e jashtëm të sistemit informativ, është i detyruar që gjatë kohëzgjatjes së marrëveshjes për bartje në vazhdimësi të sigurojë që:

1) bartja nuk do të çojë në delegimin e përgjegjësisë të organeve drejtuese të institucionit të pagesave ose institucionit të parave elektronike te personi i jashtëm;

2) me bartjen nuk do të ndryshojnë qëndrimi dhe detyrimet e institucionit të pagesave ose institucionit të parave elektronike ndaj përdoruesve të shërbimeve të pagesave, të përcaktuara me këtë ligj;

3) nuk rrezikohet plotësimi i kushteve që duhet t'i plotësojë institucioni i pagesave ose institucioni i parave elektronike për marrjen dhe mbajtjen e lejes në përputhje me këtë ligj dhe

4) nuk rrezikohet dhe nuk ndryshohet asnjë kërkesë, detyrim për dorëzimin e raporteve dhe informacioneve ose masën ndaj subjektit mbikëqyrës të caktuar nga Banka Popullore që duhet ta përmbushë institucioni i pagesës ose institucioni i parave elektronike në përputhje me këtë ligj.

(5) Institucioni i pagesës, përkatësisht institucioni i parave elektronike, është i detyruar që menjëherë ta njoftojë Bankën Popullore për çdo ndryshim në lidhje me shfrytëzimi e personave të jashtëm që kryejnë funksione operative lidhur me shërbimet e pagesave që mund të kenë ndikim material në integritetin, konfidencialitetin, disponueshmërinë, autenticitetin dhe/ose vazhdimësinë e shërbimeve të lidhura me pagesat.

(6) Institucioni i pagesave, përkatësisht institucioni i parave elektronike, mund të paraqitet në cilësinë e personit të jashtëm që kryen funksione operative në lidhje me shërbimet e pagesave, për të marrë përsipër kryerjen e funksioneve operative nga person tjetër juridik, ekskluzivisht në bazë të marrëveshjes së lidhur me shkrim me atë person juridik, me njoftim paraprak të Bankës Popullore më së voni 90 ditë para lidhjes së marrëveshjes së tillë dhe ekzekutimit të tillë për të mos vënë në dyshim përmbushjen e detyrimeve të institucionit të pagesave, përkatësisht institucionit të parave elektronike të përcaktuara në përputhje me këtë ligj.

(7) Institucioni i pagesave, përkatësisht institucioni i parave elektronike, është i detyruar që të sigurojë plotësimin e kushteve nga paragrafët (3) dhe (4) të këtij neni, nëse kryerjen e funksioneve operative e merr nga ndonjë person tjetër juridik cilësi e një personi të jashtëm që kryen funksione operative në lidhje me shërbimet e pagesave, në mënyrë të vazhdueshme gjatë afatit të marrëveshjes së bartjes.

(8) Nëse Banka Popullore vlerëson se nuk janë plotësuar kushtet nga paragrafët (3) dhe (4) të këtij neni, do ta njoftojë institucionin e pagesave, përkatësisht institucionin për para elektronike, se nuk duhet ta lidhë propozim marrëveshjen sipas paragrafit (2) të këtij neni.

(9) Këshilli i Bankës Popullore, me akt nënligjor, më hollësisht i përcakton mënyrën dhe kushtet për bartjen e kryerjes së funksioneve të rëndësishme operative te personat e jashtëm nga institucioni i pagesës, përkatësisht institucioni i parave elektronike.

Detyrimet e institucionit të pagesës dhe institucionit të parave elektronike

Neni 41

(1) Institucioni i pagesës, përkatësisht institucioni i parave elektronike është plotësisht përgjegjës për veprimet e punonjësve të tij, agjentëve ose personave të jashtëm të cilëve u është bartur kryerja e funksioneve operative lidhur me dhënien e shërbimeve të pagesave.

(2) Institucioni i pagesës, përkatësisht institucioni i parave elektronike nuk guxon të përjashtojë apo kufizojë përgjegjësinë sipas paragrafit (1) të këtij neni.

(3) Institucioni i pagesës, përkatësisht institucioni i parave elektronike që jep shërbime të pagesave nëpërmjet agjentëve, së paku një herë në vit kryen kontroll në terren të punës së tyre.

(4) Me përjashtim të nenit 36 të këtij ligji, institucioni i pagesave, përkatësisht institucioni i parave elektronike, është i detyruar që dokumentet, të dhënat dhe/ose informacionet t'i ruajë në përputhje me këtë pjesë të ligjit më së paku pesë vjet pas përfundimit të vitit kalendarik të cilit i referohen.

(5) Institucioni i pagesave, përkatësisht institucioni i parave elektronike, dokumentet, të dhënat dhe/ose informacionet sipas paragrafit (4) të këtij neni do t'i ruajë në formë origjinale ose në mënyrë tjetër të përshtatshme me të cilën përmbajtja origjinale e dokumenteve, të dhënat dhe/ose informacionet nuk ndryshohet.

Pjesa e tretë **KËRKESA INFORMIMI PËR SHËRBIMET E PAGESAVE**

Kapitulli I **Dispozita të përgjithshme**

Përfshirje

Neni 42

(1) Dispozitat e pjesës së tretë të ligjit zbatohen kur ofruesi i shërbimeve të pagesave të pagesit dhe ofruesi i shërbimeve të pagesave të pranuesit, ose ofruesi i vetëm i shërbimeve të pagesave në transaksionin e pagesës janë themeluar dhe punojnë në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

(2) Dispozitat e kësaj pjese, përveç nenit 49 paragrafi (2) pika 2, 56 paragrafi (1) pika 2 nënpika e) dhe pika 5 nënpika g) dhe 61 paragrafi (1) alinea 1 e këtij ligji, zbatohet edhe për transaksionet e pagesave ndërkufitare, ku të paktën njëri nga ofruesit e shërbimeve të pagesave, pavarësisht nëse është paguesi apo pranuesi, është i themeluar dhe punon në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në lidhje me atë pjesë të transaksionit të pagesës që ekzekutohet në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

(3) Dispozitat e kësaj pjese të ligjit zbatohen detyrimisht nëse përdoruesi i shërbimeve të pagesave është konsumator.

(4) Nenet 53, 58 paragrafët (1), (2) dhe (3), 59 paragrafi (1), 60 dhe 61 të kësaj pjese të ligjit zbatohen detyrimisht ndaj përdoruesve të shërbimeve të pagesave të cilët nuk janë konsumator, kurse ofruesit e shërbimeve të pagesave dhe përdoruesit e shërbimeve të pagesave jo konsumatorë mund të bien dakord për zbatimin e dispozitave tjera të kësaj pjese të ligjit.

(5) Ofruesit e shërbimeve të pagesave mund t'u japin përdoruesve kushte më të favorshme për shfrytëzimin e shërbimeve të pagesave sesa kushtet e përcaktuara në këtë pjesë të ligjit.

(6) Në institucionin e pagesës i cili i ofron vetëm shërbimet e pagesës nga neni 8 paragrafi (1) pika 8 e këtij ligji zbatohen vetëm nenet 46, 48, 54, 55, 56, 64, 65 dhe 66 të kësaj pjese të ligjit.

(7) Kur me Pjesën e tretë dhe Pjesën e katërt të këtij ligji është përcaktuar detyrimi për informim dhe komunikim ndërmjet ofruesve të shërbimeve të pagesave dhe ndërmjet ofruesve dhe përdoruesve të shërbimeve të pagesave, me shprehjen “ofron” përcaktohet detyrimi i ofruesve të shërbimeve të pagesave që t'i japin përdoruesit të shërbimeve të pagesave informacione të caktuara pa kërkesë paraprake të përdoruesit, në mënyrën e përcaktuar me këtë ligj.

(8) Kur pjesa e tretë dhe pjesën e katërt të këtij ligji është përcaktuar detyrim për informim dhe komunikim ndërmjet ofruesve të shërbimeve të pagesave dhe ndërmjet ofruesve dhe përdoruesve të shërbimeve të pagesave, me shprehjen "vë në dispozicion" përcaktohet detyrimi i ofruesve të shërbimeve të pagesave që të vënë në dispozicion informacione të caktuara, me kërkesë të qartë paraprake të përdoruesit të shërbimit të pagesave, nëpërmjet publikimit në faqen e interneti ose njoftim publik në hapësirat e punës së dhënësit të shërbimeve të pagesave ku përdoruesi ka qasje për qëllime të përdorimit të shërbimeve të pagesave.

(9) Këshilli i Bankës Popullore me akt nënligjor për kryerjen e transaksioneve të pagesave i përcakton:

1) kushtet dhe procedurën për hapjen dhe mbylljen e llogarisë së pagesës, duke përfshirë edhe llogarinë e pagesës me funksione bazë;

2) kushtet dhe procedurën për ekzekutimin e transaksioneve të pagesës;

3) elementet e detyrueshme dhe formën e urdhërpagesës, si dhe formën e shprehjes së pëlqimit për ekzekutimin e transaksioneve të pagesave dhe autorizimin për bartjen e llogarisë së pagesës;

4) elementet e detyrueshme të urdhërpagesës për arkëtim të detyruar;

5) kushtet dhe procedurën për korrigjimin e gabimit në transaksionet e pagesave dhe

6) ndarjen e numrit referencues të ofruesve të shërbimeve të pagesave dhe standardet për ndërtimin e llogarive të pagesave që i mbajnë këta ofrues.

Shmangie nga kërkesat e informacioneve për instrumentet e pagesave dhe paratë elektronike me vlerë të ulët

Neni 43

(1) Për instrumentet e pagesave dhe paratë elektronike të cilat në përputhje me marrëveshjen kornizë i referohen vetëm transaksioneve individuale të pagesave që nuk i tejkalojnë 1.200 denarë ose kundërvlerën përkatëse në valuta të tjera, ose kanë kufizim të shpenzimit prej 6.000 denarë ose kundërvlerë në valuta të tjera, ose mbajnë mjete që në asnjë moment nuk tejkalojnë 6.000 denarë ose kundërvlerën përkatëse në valuta të tjera, ose kartelat e pagesës me parapagim që nuk i tejkalojnë 10.000 denarë ose kundërvlerën përkatëse në valuta të tjera, ofruesi i shërbimit të pagesave me përdoruesin e shërbimeve të pagesave mund të bie dakord:

1) ofruesi i shërbimeve të pagesave nuk është i detyruar t'ia japë paguesit informacionet nga nenet 56 dhe 61 të këtij ligji, vetëm informacionet për veçoritë kryesore të shërbimit të pagesave, duke përfshirë edhe mënyrën në të cilën instrumenti i pagesës përdoret, përgjegjësitë, kompensimet dhe informacionet tjera të nevojshme për marrjen e vendimit nga përdoruesi i shërbimeve të pagesave për lidhjen e marrëveshjes, si dhe sugjerim për atë se ku në mënyrë lehtësisht të qasshme janë vënë në dispozicion të gjitha informacionet tjera nga neni 56 i këtij ligji;

2) ofruesi i shërbimeve të pagesave nuk është i detyruar të propozojë ndryshime në kushtet e marrëveshjes kornizë në të njëjtën mënyrë të përcaktuar me nenin 59 të këtij ligji;

3) ofruesi i shërbimeve të pagesave nuk është i detyruar t'ia japë informacionet nga neni 62 i këtij ligji, përkatësisht neni 63 i këtij ligji, përveç që të japë ose t'ia vë në dispozicion informacionet për shenjën referente të transaksionit të pagesës, vlerën e transaksionit të pagesës dhe kompensim për atë transaksion, ndërkaq në rast se disa transaksione të pagesave të të njëjtit lloj të kryera për të njëjtin pranues, informacionet për vlerën e përgjithshme të transaksioneve të pagesës dhe kompensimet e përgjithshme për ato transaksione të pagesës dhe

4) ofruesi i shërbimeve të pagesave nuk ka detyrim t'ia japë ose vë në dispozicion të përdoruesit të shërbimeve të pagesave informacionet nga pika 3) të këtij paragrafi nëse instrumenti i pagesës përdoret në mënyrë anonime ose nëse teknikisht është e pamundur t'u sigurohen këto informacione për përdoruesit, por ofruesi i shërbimeve të pagesave duhet t'i mundësojë paguesit që pas ekzekutimit të transaksionit të pagesës të kontrollojë vlerën e mjeteve financiare që ruhen në instrumentin e pagesës.

Kompensim për dhënien e informacioneve

Neni 44

(1) Ofruesi i shërbimeve të pagesave nuk guxon t'i llogarisë dhe paguajë përdoruesit të shërbimeve të pagesave kompensime për sigurimin e informacioneve që është i detyruar t'i japë ose t'i vë në dispozicion në përputhje me dispozitat e pjesës së tretë të këtij ligji.

(2) Ofruesi i shërbimeve të pagesave dhe përdoruesi i shërbimeve të pagesave mund të dakordohen për llogaritjen dhe pagesën e kompensimeve për informacionet shitesë ose për dhënien e informacioneve më shpesh se dinamika e përcaktuar me dispozitat e pjesës së tretë të këtij ligji, ose për bartjen e informacioneve nëpërmjet mjeteve të ndryshme të komunikimit nga ato që janë të përcaktuara në marrëveshjen kornizë, me kusht që përdoruesi i shërbimeve të pagesave të ketë kërkuar informim të tillë.

3) Në rastet sipas paragrafit (2) të këtij neni, kompensimi duhet të jetë në shumën e shpenzimeve që realisht i ka bërë ofruesi i shërbimeve të pagesave.

Valuta dhe konvertimi valutor

Neni 45

(1) Pagesat bëhen në denarë ose në valutë tjetër me marrëveshje ndërmjet ofruesit të shërbimeve të pagesave dhe përdoruesit të shërbimeve të pagesave.

(2) Pagesat në Republikën e Maqedonisë së Veriut në valutë të ndryshme nga denari, si dhe transaksionet ndërkufitare bëhen në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe Ligjit të Punës Devizore.

(3) Kur ofrohet shërbim i konvertimit të valutës në bankomat, në pikë shitjeje ose nga ana e pranuesit, pala që ofron shërbimin e konvertimit të valutës, përpara inicimit të transaksionit të pagesës, ia shpalosë paguesit të gjitha kompensimet, si dhe kursin e devizor që përdoret gjatë konvertimit të valutës së transaksionit të pagesës.

(4) Ofruesi i shërbimeve të pagesave që kryen transaksione të pagesave ndërkufitare dhe dhënësi i shërbimeve të pagesave që ofron shërbimin e konvertimit të valutës sipas paragrafit (3) të këtij neni, janë të detyruar që publikisht t'i shpallin kurset devizore që zbatohen gjatë konvertimit të valutës në faqen e tyre të internetit, kurse nëse ofruesi i shërbimeve të pagesave nuk ka faqe të internetit, në hapësirat e punës së dhënësit të shërbimeve të pagesave ku përdoruesi ka qasje për qëllime të përdorimit të shërbimeve të pagesave, publikon kursin devizor për periudhë prej 18 muajve përpara çdo datës së shpalljes, me datë dhe orë të përshtatshme të rëndësisë dhe zbatimit për kurse të tilla.

(5) Paguesi duhet të pajtohet për kryerjen e konvertimit të valutës sipas paragrafit (3) të këtij neni.

Informacione për kompensimet për përdorimin e instrumenteve të pagesave

Neni 46

(1) Nëse ofruesi i shërbimeve të pagesave ose pala tjetër e përfshirë në transaksionin e pagesës kërkon kompensim për përdorimin e instrumentit të caktuar të pagesës, është i detyruar që për kompensimin dhe vlerën e të njëjtit ta njoftoj përdoruesin e shërbimeve të pagesave para inicimit të transaksionit të pagesës.

(2) Paguesi është i detyruar të paguajë vetëm kompensimin sipas paragrafit (1) të këtij neni për të cilën është njoftuar para inicimit të transaksionit të pagesës.

Detyrë dëshmie në raport me kërkesat për informim

Neni 47

(1) Në rast të kontestit, ofruesi i shërbimeve të pagesave është i detyruar të dëshmojë se i ka plotësuar ose se është në harmonizim me kërkesat për informimin e përdoruesve të shërbimeve të pagesave në përputhje me dispozitat e pjesës së tretë të këtij ligji.

(2) Ofruesi i shërbimeve të pagesave ka përgjegjësi për dispozita të pasakta, të pavërteta, të pakuptueshme ose të paqarta në marrëveshjen kornizë, me përjashtim të atyre të dhënave dhe informacioneve që i ka dhënë përdoruesi i shërbimeve të pagesave.

Kapitulli II

Transaksione të njëhershme të pagesave

Përfshirja dhe shmangia e dhënies së dyfishtë të informacioneve identike

Neni 48

(1) Dispozitat e pjesës së tretë Kapitullit II të këtij ligji zbatohen për transaksionet e njëhershme të pagesave, për ekzekutimin e të cilave nuk është e nevojshme të lidhet marrëveshje kornizë dhe të hapet ose posedohet llogari për pagesë nga paguesi.

(2) Në rast kur urdhërpagesa për transaksion të njëhershëm të pagesës është iniciuar me instrument të pagesës që përfshihet me marrëveshjen kornizë të lidhur me ofrues tjetër të shërbimeve të pagesave, dhënësi i shërbimeve të pagesave nuk është i detyruar t'ia japë ose t'ia vë në dispozicion informacionet që përdoruesit të shërbimeve të pagesave tashmë i janë dhënë ose do të duhet të 'i jepen në bazë të marrëveshjes kornizë të lidhur me ofruesin e shërbimeve të pagesave që ka lëshuar instrumentin e pagesës.

(3) Vlera më e lartë mujore e transaksioneve të njëhershme të pagesave ndërkufitare të ekzekutuara në bazë të dërgesave financiare të iniciuara nga paguesi në Republikën e Maqedonisë së Veriut për pranues të huaj nëpërmjet ofruesit të vetëm të shërbimeve të pagesave është 2.500 euro ose kundërvlerë përkatëse në valuta të tjera.

(4) Vlera më e lartë ditore e transaksioneve të pagesave të njëhershme ndërkufitare në bazë të dërgesave të iniciuara jashtë vendit për pranues në Republikën e Maqedonisë së Veriut nëpërmjet ofruesit të vetëm të shërbimeve të pagesave është 5.000 euro ose në kundërvlerë përkatëse në valuta të tjera.

(5) Ofruesit e shërbimeve të pagesave janë të detyruar t'i përmbahen kufizimeve të vlerave nga paragrafët (3) dhe (4) të këtij neni.

Informacione paraprake gjatë ekzekutimit të transaksioneve të njëhershme të pagesës

Neni 49

(1) Para ekzekutimit të transaksionit të njëhershëm të pagesës, ofruesi i shërbimeve të pagesave dhe përdoruesi i shërbimeve të pagesave lidhin marrëveshje për shërbimin e njëhershëm të pagesës ose përdoruesi i shërbimeve të pagesave pranon ofertë të përgjithshme për kryerjen e shërbimit të njëhershëm të pagesës.

(2) Para lidhjes së marrëveshjes ose pranimi të ofertës së përgjithshme sipas paragrafit (1) të këtij neni dhe pa marrë parasysh formën dhe mënyrën e lidhjes së marrëveshjes ose pranimi të ofertës, dhënësi i shërbimeve të pagesave është i detyruar t'ia japë ose t'ia vë në dispozicion përdoruesit të shërbimeve të pagesave informacionet dhe kushtet e mëposhtme:

1) specifikimin e informacioneve ose shenjën e vetme identifikuese që duhet të sigurojë përdoruesi i shërbimeve të pagesave me qëllim që urdhërpagesa të iniciohet ose të ekzekutohet siç duhet;

- 2) afatin maksimal për kryerjen e shërbimit të pagesës i cili jepet;
 - 3) llojin dhe vlerën e të gjitha kompensimeve që ofruesi i shërbimeve të pagesave i llogarit dhe paguan nga përdoruesi i shërbimit të pagesave, gjithsej dhe sipas zërave individual;
 - 4) kursi devizor i listuar rrjedhës ose kursi referent devizor, nëse gjatë transaksionit të pagesës do të përdoret shërbimi i konvertimit valutor dhe
 - 5) ku është e zbatueshme ose e nevojshme për ekzekutimin e transaksionit, çdo informacion tjetër për përdorimin e shërbimit të pagesave nga neni 56 i këtij ligji.
- (3) Ofruesi i shërbimeve për iniciimin e pagesave, para inicimit të pagesës, përveç informacioneve sipas paragrafit (2) të këtij neni, është i detyruar që paguesit t'ia japë ose vë në dispozicion, në mënyrë të qartë dhe gjithëpërfshirëse informacionet e mëposhtme:
- 1) emrin e ofruesit të shërbimit të pagesave, adresën e selisë së tij të regjistruar dhe, nëse është e zbatueshme, adresën e vlefshme të agjentit ose filialit të ofruesit të shërbimit të pagesave në vend të tretë ose në shtetin anëtar në të cilin jepet shërbimi;
 - 2) adresën e vlefshme të postës elektronike dhe të dhëna të tjera për kontakt të nevojshme për komunikim me ofruesit e shërbimeve të pagesave dhe
 - 3) të dhëna për kontakt me organin kompetent mbikëqyrës.
- (4) Ofruesi i shërbimeve të pagesave është i detyruar informacionet nga paragrafët (2) dhe (3) të këtij neni:
- 1) t'ia ofrojë ose vë në dispozicion përdoruesit të shërbimeve të pagesave në mënyrë lehtësisht të arritshme;
 - 2) t'i kompozojë në formë të thjeshtë dhe gjithëpërfshirëse, duke përdorur fjalë të kuptueshme dhe
 - 3) me kërkesë të përdoruesit të shërbimeve të pagesave, pa kompensim t'i japë në letër ose medium tjetër të përhershëm.
- (5) Nëse me kërkesë të përdoruesit të shërbimit të pagesave, marrëveshja për shërbimin të njehershëm të pagesës lidhet duke përdorur mjete të komunikimit në distancë që nuk i mundësojnë ofruesit të shërbimeve të pagesave ti plotësojë detyrimet nga paragrafët (2), (3) dhe (4) të këtij neni, dhënësi i shërbimeve të pagesave është i detyruar menjëherë pas ekzekutimit të transaksionit të pagesës t'i përmbush detyrimet nga paragrafët (2), (3) dhe (4) të këtij neni.
- (6) Ofruesi i shërbimeve të pagesave mund t'i përmbushë detyrimet ndaj përdoruesit të shërbimeve të pagesave nga paragrafët (2), (3) dhe (4) të këtij neni edhe me dhënien e ekzemplarit të ofertës së përgjithshme ose të projekt marrëveshjes për shërbimin e njehershëm të pagesës ose ekzemplarit nga urdhërpagesa që i përmban informacionet nga paragrafët (2) dhe (3) të këtij neni.

Informacione për paguesin dhe pranuesin nga ofruesi i shërbimeve për iniciimin e pagesave

Neni 50

- (1) Në rast kur urdhërpagesa është iniciuar nëpërmjet ofruesit të shërbimeve për iniciimin e pagesave, përveç informacioneve dhe kushteve nga neni 49 i këtij ligji, ofruesi i shërbimeve është i detyruar menjëherë pas inicimit të pagesës t'ia ofrojë ose t'i vë në dispozicion paguesit dhe nëse është e zbatueshme edhe pranuesit, informacionet e mëposhtme:
- 1) vërtetim për iniciimin e suksesshëm të urdhërpagesës me ofruesin e shërbimeve të pagesave i cili mban llogarinë e pagesës së paguesit;
 - 2) shenjë e referente të transaksionit të pagesës me qëllim të identifikimit të transaksionit nga paguesi dhe pranuesi dhe nëse është e zbatueshme, shenjat e nevojshme me të cilat pranuesi e identifikon paguesin, si dhe të gjitha informacionet që barten me transaksionin e pagesës;
 - 3) vlerën e transaksionit të pagesës dhe

4) llojin e të gjitha kompensimeve në lidhje me transaksionin që i llogarit dhe paguan ofruesi i shërbimit për iniciimin e pagesave, si dhe vlerën për zërat individuale të kompensimeve dhe vlerën e përgjithshme për të gjitha zërat

(2) Ofruesii i shërbimeve për iniciimin e pagesave sipas paragrafit (1) të këtij neni është i detyruar që ofruesit të shërbimeve të pagesave i cili e mban llogarinë e pagesave paguesit t'ia vë në dispozicion shenjë ose të dhëna me të cilat përdoruesi i shërbimeve të pagesave mund të identifikojë transaksionin e pagesave.

Informacione për paguesin pas pranimit të urdhërpagesës

Neni 51

(1) Ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit është i detyruar që menjëherë pas pranimit të urdhërpagesës t'i japë ose t'i vë në dispozicion paguesit informacionet e mëposhtme:

1) shenjë referente të transaksionit të pagesës me të cilën paguesi mund të identifikojë transaksionin e pagesës dhe, nëse është e zbatueshme, informacione në lidhje me pranuesin e pagesës;

2) vlerën e transaksionit të pagesës në valutën që përdoret në urdhërpagesë;

3) llojin dhe shumën e të gjitha kompensimeve për transaksionin e pagesës që janë në kurriz të paguesit, gjithsej dhe sipas zërave individual;

4) ku është e zbatueshme, kursi devizor i listuar të cilin ofruesi i shërbimeve të pagesave paguesit e ka përdorur në transaksionin e pagesës ose referencë të kursit devizor kur është i ndryshëm nga kursi i zbatuar devizor nga neni 49 paragrafi (2) pika 4 e këtij ligji, si dhe shuma e transaksionit të pagesës pas konvertimit valutor dhe

5) ditën e pranimit të urdhërpagesës.

(2) Ofruesi i shërbimeve të pagesave është i detyruar që informacionet sipas paragrafit (1) të këtij neni t'ia japë ose vë në dispozicion në përputhje me nenin 49 paragrafi (4) të këtij ligji.

Informacione për pranuesin pas ekzekutimit të transaksionit të pagesës

Neni 52

(1) Ofruesi i shërbimeve të pagesave të pranuesit, është i detyruar që menjëherë pas ekzekutimit të transaksionit të pagesës t'ia japë ose t'i vë në dispozicion pranuesit, informacionet e mëposhtme:

1) shenjën referente e transaksionit të pagesës me të cilën pranuesi mund të identifikojë transaksionin dhe nëse është e zbatueshme edhe paguesin, si dhe të gjithë informacionet që barten me transaksionin e pagesës;

2) vlerën e transaksionit të pagesës në valutën në të cilën mjetet financiare janë vënë në dispozicion të pranuesit

3) llojin dhe vlerën e të gjitha kompensimeve që janë në kurriz të pranuesit në transaksionin e pagesës, gjithsej dhe sipas zërave individual;

4) ku është e zbatueshme, kursi devizor i cili ofruesi i shërbimeve të pagesave të pranuesit e ka përdorur në transaksionin e pagesës edhe vlerën e transaksionit të pagesës përpara konvertimit valutor dhe

5) datën e valutës së miratimit.

(2) Ofruesi i shërbimeve të pagesave është i detyruar që informacionet sipas paragrafit (1) të këtij neni ti japë ose vë në dispozicion në përputhje me nenin 49 paragrafi (4) të këtij ligji.

Kapitulli III

Marrëveshja kornizë për shërbimet e pagesave

Dispozita të përgjithshme

Neni 53

(1) Ofruesi i shërbimeve të pagesave dhe përdoruesi i shërbimeve të pagesave lidhin marrëveshje kornizë për shërbimet e pagesave me të cilën rregullohet kryerja e ardhshme e transaksioneve të pagesave individuale dhe të njëpasnjëshme, si dhe të drejtat, detyrimet dhe kushtet për hapjen, mbajtjen dhe mbylljen e llogarisë së pagesës.

(2) Marrëveshja kornizë sipas paragrafit (1) të këtij neni mund të përmbajë edhe dispozita për emetimin dhe blerjen e parave elektronike nëse shërbimet e pagesave i ofron emetuesi i parave elektronike nga neni 9 paragrafi (2) i këtij ligji.

(3) Me lidhjen e marrëveshjes kornizë, ofruesi i shërbimeve të pagesave mund ti hapë një ose më shumë llogari të pagesave përdoruesit të shërbimit të pagesave në valuta të ndryshme, pavarësisht nga veçoritë ose dedikimit të tyre.

(4) Përveç përmbajtjes të detyrueshme të përcaktuar me pjesës së tretë kapitullin III të këtij ligji, marrëveshja kornizë mund të përmbajë edhe dispozita të veçanta kontraktuale për përfshirjen e veçorive specifike të llojeve të caktuara të llogarive të pagesave, kufizimin e përdorimit të tyre për dedikime të veçanta të caktuara ose për përmbushjen e kërkesave të nevojshme ligjore për prodhime ose shërbime konkrete.

Dokument informativ për kompensimet dhe fjalor

Neni 54

(1) Ofruesi i shërbimeve të pagesave është i detyruar që në kohë të mjaftueshme para lidhjes së marrëveshjes kornizë për përdorimin e shërbimeve të pagesave me konsumator, pavarësisht nga mënyra e lidhjes së marrëveshjes, ose para se konsumatori të pranojë ofertë nga marrëveshja kornizë që e obligon ofruesin e shërbimeve të pagesave. T'i japë konsumatorit dokument informativ për kompensimet, në letër ose medium tjetër të përhershëm, i cili i përmban shërbimet sipas termave dhe përcaktimeve të standardizuara nga lista e shërbimeve më përfaqësuese në lidhje me llogarinë e pagesave nga neni 184 paragrafi (4) i këtij ligji dhe kompensimet për shërbimet të cilat dhënësi i shërbimeve të pagesave i jep.

(2) Ofruesi i shërbimeve të pagesave është i detyruar që së bashku me dokumentin informativ sipas paragrafit (1) të këtij neni, t'ia japë konsumatorit të gjitha informacionet e mëparshme nga neni 56 i këtij ligji si dhe të gjitha informacionet e mëparshme para lidhjes së marrëveshjes për kredi konsumatore në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në marrëveshjet e kredisë konsumatore.

(3) Dhënësi i shërbimeve të pagesave është i detyruar që konsumatorit t'i vë në dispozicion fjalor, i cili së paku përmban termat dhe përkufizimet e standardizuara nga lista e shërbimeve më përfaqësuese në lidhje me llogarinë e pagesës nga neni 184 paragrafi (4) i këtij ligji.

(4) Dokumenti informativ për kompensimet sipas paragrafit (1) të këtij neni dhe fjalori sipas paragrafit (3) të këtij neni përditësohen në çdo kohë dhe vihen në dispozicion të konsumatorëve:

1) në formë elektronike në vend të dukshëm në faqen e internetit të ofruesit të shërbimeve të pagesave, nëse dhënësi i shërbimit të pagesave ka faqe të internetit dhe

2) në vend të dukshëm në hapësirat e punës së ofruesit të shërbimeve të pagesave ku konsumatorët kanë qasje për qëllimet e përdorimit të shërbimeve.

(5) Ofruesi i shërbimeve të pagesave është i detyruar që me kërkesë të konsumatorit t'ia dokumentin informativ për kompensimet sipas paragrafit (1) të këtij neni dhe/ose fjalorin sipas paragrafit (3) të këtij neni, në letër ose medium tjetër të përhershëm.

Përmbajtja dhe forma e dokumentit informativ për kompensimet dhe e fjalorit

Neni 55

(1) Dokumenti informativ për kompensimet nga neni 54 paragrafi (1) të këtij ligji, detyrimisht i përmbajë vlerën e kompensimeve përkatëse që ofruesi i shërbimeve të pagesave do t'i llogariste dhe do t'i arkëtonte për shërbimet më përfaqësuese të lidhura me llogarinë e pagesës, duke përfshirë edhe shpalosjen nëse ka një dallim në vlerën e kompensimeve që llogariten dhe arkëtohen sipas mënyrës së inicimit të transaksioneve të pagesave nga konsumatori Nëse ofruesi i shërbimeve të pagesave nuk ofron ndonjë nga shërbimet më përfaqësuese në lidhje me llogarinë e pagesës, duhet qartë të shënoj se një shërbim i tillë nuk ofrohet.

(2) Dokumenti informativ për kompensimet duhet:

1) të jetë dokument i pavarur dhe i shkurtër;

2) të paraqitet dhe strukturohet në mënyrë të thjeshtë dhe të kuptueshme për t'u lexuar, duke përdorur madhësi qartësisht të dukshme dhe lehtësisht të lexueshme të shkronjave, numrave dhe shenjave;

3) në rast se versioni origjinal i dokumentit është me ngjyra, fotokopja e tij ose varianti bardh e zi duhet të jetë i qartë dhe i kuptueshëm;

4) të jetë i saktë, pa mëdyshje dhe i shprehur në valutën në të cilën është shkruar llogaria e pagesës, ose nëse është dakorduar ndërmjet ofruesit të shërbimeve të pagesave dhe konsumatorit, të shprehet në valutë tjetër;

5) të përmbajë titullin "dokument informativ për kompensimet në fillim të faqes së parë, së bashku me simbolin e tij të përbashkët të standardizuar për njohjen dhe dallimin e lehtë nga dokumentet e tjera dhe

6) të përmbajë informacion që përfshin vetëm kompensimet nga lista e shërbimeve më përfaqësuese në lidhje me llogarinë e pagesave nga neni 184 paragrafi (4) i këtij ligji dhe se janë të shënuara informatat e hollësishme parakontraktore dhe kontraktore për të gjitha shërbimet e shënuara në propozim marrëveshjen kornizë.

(3) Nëse një ose më shumë shërbime ofrohen si pjesë e pakos së shërbimeve lidhur me llogarinë e pagesës, në dokumentin informativ për kompensimet duhet të shënohen kompensimet e përgjithshme për pakon në tërësi, lloji dhe numri i shërbimeve të përfshira në pakon dhe kompensimet shtesë që do të llogariteshin dhe arkëtoheshin për çdo shërbim që tejkalon numrin e mbuluar nga kompensimi i përgjithshëm për pakon e shërbimeve.

(4) Fjalori nga neni 54 paragrafi (3) i këtij ligji duhet:

1) të paraqitet dhe strukturohet në mënyrë që është e thjeshtë dhe e kuptueshme për t'u lexuar, duke përdorur madhësi qartësisht të dukshme dhe lehtësisht të lexueshme të shkronjave, numrave dhe shenjave dhe

2) të jetë pa mëdyshje dhe të mos shkaktoj mashtrim të konsumatori.

(5) Këshilli i Bankës Popullore, me akt nënligjor më hollësisht e përcakton përmbajtjen dhe formatin e standardizuar të dokumentit informativ për kompensimet dhe simbolin e përbashkët të standardizuar nga ky nen.

Përmbajtja e marrëveshjes kornizë dhe informacionet e mëparshme për përdorimin e shërbimeve të pagesave

Neni 56

(1) Ofruesi i shërbimeve të pagesave është i detyruar të lidhë marrëveshje kornizë për përdorimin e shërbimeve të pagesave para përdoruesit të shërbimit të pagesave, pavarësisht nga mënyra e lidhjes së marrëveshjes së tillë ose para se përdoruesi i shërbimeve të pagesave të pranojë ofertën e marrëveshjes kornizë që e obligon ofruesin e shërbimeve të pagesave, t'ia japë përdoruesit të shërbimit të pagesave të paktën informacionet e mëposhtëm:

1) për ofruesin e shërbimeve të pagesave:

a) emrin dhe selinë e ofruesit të shërbimeve të pagesave, adresën e agjentit dhe/ose filialin në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe adresën tjetër për komunikim me ofruesin e shërbimeve të pagesave, duke përfshirë adresën e vlefshme të postës elektronike;

b) organi kompetent për mbikëqyrjen e ofruesit të shërbimeve të pagesave, filialit ose agjentit të ofruesit të shërbimeve të pagesave në lidhje me dhënien e shërbimeve të pagesave në Republikën e Maqedonisë së Veriut;

c) të dhënat për regjistrat publik në të cilët është regjistruar ofruesi i shërbimeve të pagesave dhe numri i regjistrimit ose shenjë tjetër identifikuese ekuivalente me të cilën udhëhiqet në regjistrin përkatës dhe

ç) ku është e zbatueshme, çdo sistem pagese në të cilin ofruesi i shërbimeve të pagesave shfaqet si pjesëmarrës, duke përfshirë edhe si pjesëmarrës indirekt në sistemin e pagesave, ose për të cilin është operator i sistemit të pagesave, kurse me kërkesë të përdoruesit të shërbimit të pagesave, është i detyruar t'ia vë në dispozicion informacionet për rregullat e punës sipas të cilave funksionojnë këto sisteme pagesore;

2) për shërbimet e pagesave:

a) përshkrimin e veçorive kryesore të shërbimeve të pagesave që janë lëndë e marrëveshjes kornizë;

b) specifikimin e informacioneve ose shenjës së vetme identifikuese që duhet ti sigurojë përdoruesi i shërbimeve të pagesave me qëllim që urdhërpagesa të iniciohet ose të ekzekutohet siç duhet;

c) formën dhe procedurën e dhënies së pëlqimit për iniciimin e urdhërpagesës ose ekzekutimin e transaksionit të pagesës dhe për heqjen e pëlqimit për ekzekutimin e transaksionit të pagesës ose për revokimin e urdhërpagesës në përputhje me nenet 79 dhe 96 të këtij Ligji;

ç) udhëzimin e kohës së pranimit të urdhërpagesës në përputhje me nenin 94 të këtij ligji dhe afati për pranimin e urdhërpagesës, nëse e përcakton ofruesi i shërbimeve të pagesave;

d) afatin maksimal për kryerjen e shërbimeve të pagesave që janë lëndë e marrëveshjes kornizë;

dh) mundësinë për kufizimin e shpenzimeve gjatë përdorimit të instrumentit të caktuar të pagesës, në përputhje me nenin 83 paragrafi (1) të këtij ligji;

e) të drejtat e përdoruesit të shërbimeve të pagesave në përputhje me nenin 117 paragrafi (2) të këtij ligji dhe informacionet në përputhje me nenin 117 paragrafi (3) të këtij ligji, në rastin e instrumenteve të pagesës të bazuara në kartelë me brendet të përbashkëta të vendosura dhe

ë) të drejtat e paguesit gjatë kryerjes së debitimit direkt në përputhje me nenin 92 paragrafi (2) të këtij ligji, në rast të debitimit direkt;

3) për kompensimet, normat e interesit dhe kurset e devizave:

a) llojin dhe vlerën e të gjitha kompensimeve, në gjithësej dhe sipas zërave individual, të cilat janë ose do të ishin në kurriz të përdoruesit të shërbimeve të pagesave, duke përfshirë edhe kompensimet lidhur me mënyrën dhe frekuentimin e dhënies ose vënies në dispozicion të

informacioneve nga ofruesi i shërbimeve të pagesave dhe arkëtimi i të cilave është i lejuar në përputhje me këtë ligj, si dhe informacione për vlerën e kompensimit për transaksionet e pagesave, nëse ka dallim në vlerën e kompensimeve që llogariten dhe paguhen sipas mënyrës së inicimit të transaksioneve të pagesave nga përdoruesi;

b) nëse është e zbatueshme, norma e interesit dhe/ose kursi devizor që do të zbatohet ose nëse do të zbatohet normë referente interesi dhe/ose kurs devizor referent, një përshkrim i qartë dhe i saktë se si llogariten, duke përfshirë shpeshtësinë për ripërcaktimin e vlerës së normës së interesit që do të zbatohet, si dhe datën përkatëse dhe indeksin ose bazën për përcaktimin e normës së interesit referent dhe/ose kursit devizor referent; dhe

c) nëse janë dakorduar për normë interesi referente ose kurse devizore referente, zbatimi me automatizëm i ndryshimeve në normën e interesit referente ose në kursin devizor referent dhe mënyrën e informimit të përdoruesit të shërbimeve të pagesave për këto ndryshime në përputhje me nenin 59 paragrafët (3) dhe (4) të këtij ligji;

4) për komunikimin ndërmjet palëve të marrëveshjes:

a) nëse është e zbatueshme, mjetet e komunikimit, si dhe kushtet teknike që duhet të plotësojë pajisjet dhe/ose softueri i përdoruesit të shërbimeve të pagesave për shkak të bartjes së informacioneve dhe njoftimeve në përputhje me këtë ligj të rënë dakord ndërmjet palëve;

b) mënyrën dhe frekuencën me të cilën i jepen dhe i vihen në dispozicion informacionet përdoruesit të shërbimeve të pagesave nga ofruesi i shërbimeve të pagesave dhe

c) të drejtën e përdoruesit të shërbimeve të pagesave që në çdo kohë të kërkojë dhe të sigurojë kushtet kontraktuale të marrëveshjes kornizë në përputhje me nenin 58 paragrafi (4) të këtij ligji;

5) për masat mbrojtëse dhe korrigjuese:

a) nëse është e zbatueshme, përshkrim i hapave që duhen ndërmarrë nga përdoruesi i shërbimeve të pagesave për të ruajtur sigurinë e instrumentit të pagesës dhe mënyrën e njoftimit të dhënësit të shërbimeve të pagesave në rast të humbjes, vjedhjes ose mashtrimit të instrumentit të pagesës në përputhje me nenin 85 paragrafi (1) pika 2 të këtij ligji;

b) procedurën për njoftimin e sigurt të përdoruesit të shërbimeve të pagesave nga ofruesi i shërbimeve të pagesave në rast dyshimi, mashtrimi ose rreziqe të sigurie;

c) nëse janë dakorduar, kushtet në të cilat ofruesi i shërbimeve të pagesave rezervon të drejtën për të bllokuar instrumentin e pagesës në përputhje me nenin 83 të këtij ligji;

ç) përgjegjësinë e paguesit për transaksionet e paautorizuara të pagesave dhe informacionet për vlerën për të cilën paguesi është përgjegjës në përputhje me nenin 90 të këtij ligji;

d) mënyrën dhe periudhën kohore në të cilën përdoruesi i shërbimit të pagesave njofton ofruesin e shërbimit të pagesave për çdo transaksion pagesë të paautorizuar ose të iniciuar gabimisht ose të kryer në mënyrë të parregullt, në përputhje me nenin 87 të këtij ligji, si dhe përgjegjësinë e ofruesit të shërbimeve të pagesave për shërbimet e paautorizuara të, transaksionet në përputhje me nenin 89 të këtij ligji;

dh) përgjegjësinë e ofruesit të shërbimeve të pagesave për inicimin ose kryerjen e transaksioneve të pagesave në përputhjen me nenet 102, 103 dhe 104 paragrafi (1) të këtij ligji dhe

e) të drejtat dhe kushtet për kthimin e mjeteve në përputhje me nenin 93 të këtij ligji;

6) për ndryshime dhe përfundimin e marrëveshjes kornizë:

a) nëse është rënë dakord, informacion se do të konsiderohet përdoruesi i shërbimeve të pagesave i ka pranuar ndryshimet në kushtet e marrëveshjes kornizë në përputhje me nenin 59 të këtij ligji, përveç nëse e njofton dhënësin e shërbimeve të pagesave para datës së zbatimit të ndryshimit se i refuzon ndryshimet në kushtet e marrëveshjes kornizë;

b) kohëzgjatjen e marrëveshjes kornizë;

c) nëse është e zbatueshme, të drejtën për përdorimin e shërbimit për bartjen dhe përshkrimin e zbatimit të kësaj procedure, në përputhje me pjesën e katërt, Kapitulli IV të këtij ligji;

ç) udhëzim i së drejtës së përdoruesit të shërbimeve të pagesave për të ndërprerë marrëveshjen kornizë dhe të gjitha marrëveshjet që lidhen me të në përputhje me nenet 59 paragrafët (1) dhe (2) dhe 60 të këtij ligji;

7) për mbrojtjen juridike të përdoruesit të shërbimeve të pagesave:

a) rregulloret që zbatohen për marrëveshjet kornizë të gjykatave kompetente në rast të kontestit;

b) përshkrim i mundësive që i ka në dispozicion përdoruesi i shërbimeve të pagesave në drejtim të mbrojtjes së të drejtave të tij, siç janë:

- të drejtën e parashtrimit të kundërshtimit në përputhje me nenin 129 të këtij ligji;

- të drejtën e parashtrimit të ankesës deri te organi kompetent në përputhje me nenin 130 të këtij ligji;

- procedurën jashtëgjyqësore për zgjidhjen e kontesteve në përputhje me nenin 131 të këtij ligji.

(2) Informacionet sipas paragrafit (1) të këtij neni janë pjesë përbërëse e përmbajtjes së marrëveshjes kornizë të lidhur.

Llogaria e pagesës së konsumatorit në pako me produkte dhe/ose shërbime të tjera

Neni 57

(1) Nëse ofruesi i shërbimeve të pagesave ofron llogari të pagesës në pako me produkte dhe/ose shërbime të tjera që nuk kanë lidhje me llogarinë e pagesës, është i detyruar të informojë konsumatorin nëse mund të hapë dhe përdorë llogarinë e pagesës veçmas nga produktet dhe/ose shërbimet e tjera.

(2) Nëse llogaria e pagesës mund të hapet dhe përdoret veçmas nga produktet dhe/ose shërbimet e tjera, ofruesi i shërbimeve të pagesave është i detyruar t'ia japë konsumatorit informacione për të gjitha kompensimet dhe shpenzimet që lidhen me secilin prej produkteve dhe/ose shërbimeve që ofrohen në pakon sipas paragrafit (1) të këtij neni dhe që mund të përdoren veçmas nga llogaria e pagesës.

Mënyra e informimit

Neni 58

(1) Ofruesi i shërbimeve të pagesave është i detyruar që informacionet për përdorimin e shërbimeve të pagesave nga neni 56 i këtij ligji t'ia japë përdoruesit të shërbimeve të pagesave në letër ose në ndonjë medium tjetër të përhershëm në kohë të mjaftueshme para lidhjes së marrëveshjes kornizë ose para se të pranoj ofertë që e obligon ofruesin e shërbimeve të pagesave me qëllim që përdoruesi të njoftohet me kushtet në lidhje me shërbimet e pagesave të ofruesit të shërbimeve të pagesave para lidhjes së marrëveshjes kornizë, përkatësisht pranimi të ofertës.

(2) Ofruesi i shërbimeve të pagesave i jep informacionet sipas paragrafit (1) të këtij neni në formë të thjeshtë dhe gjithëpërfshirëse, me përdorimin e fjalëve të kuptueshme.

(3) Nëse marrëveshja kornizë është lidhur me kërkesën e përdoruesit të shërbimeve të pagesave duke përdorur mjete të komunikimit në distancë, të cilat nuk i mundësojnë ofruesit të shërbimeve të pagesave t'i përmbushë detyrimet sipas paragrafit (1) të këtij neni, ofruesi i shërbimeve të pagesave është i detyruar t'i përmbushë detyrimet menjëherë pas lidhjes së marrëveshjes kornizë.

(4) Ofruesi i shërbimeve të pagesave mund që informacionet dhe kushtet e përdorimit të shërbimeve të pagesave t'ia japë përdoruesit të shërbimeve të pagesave me dorëzimin e ekzemplarit të propozim marrëveshjes kornizë që e detyron ofruesin e shërbimit të pagesave që përmban informacionet për përdorimin e shërbimeve të pagesave të përmendura në nenin 56 të këtij ligji në mënyrë dhe formë në përputhje me paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni.

(5) Përdoruesi i shërbimeve të pagesave ka të drejtë për kohëzgjatjen e marrëdhënies kontraktuale të kërkojë në letër ose medium tjetër të përhershëm kushtet kontraktuale të marrëveshjes kornizë, si dhe informacionet nga neni 56 i këtij ligji, kurse ofruesi i shërbimeve të pagesave është i detyruar t'i japë të njëjtat.

Ndryshime në marrëveshjen kornizë

Neni 59

(1) Çdo ndryshim në marrëveshjen kornizë, përfshirë ndryshimin e informacioneve për përdorimin e shërbimeve të pagesave nga neni 56 i këtij ligji, ofruesi i shërbimeve të pagesave është i detyruar t'ia propozojë përdoruesit të shërbimeve të pagesave në mënyrën nga neni 58 paragrafët (1) dhe (2) të këtij ligji më së voni dy muaj para datës së zbatimit të ndryshimit.

(2) Përdoruesi i shërbimeve të pagesave i pranon ose nuk i pranon ndryshimet e propozuara sipas paragrafit (1) të këtij neni para datës së zbatimit të ndryshimeve dhe për pranimin ose mospranimin e njofton ofruesin e shërbimeve të pagesave.

(3) Nëse është dakorduar në përputhje me nenin 56 paragrafi (1) pika 6 nënpika a) të këtij ligji, ofruesi i shërbimeve të pagesave është i detyruar ta informojë përdoruesin e shërbimeve të pagesave se do të konsiderohet se përdoruesi i shërbimeve të pagesave i ka pranuar ndryshimet e propozuara në kushtet e marrëveshjes kornizë nëse nuk e njofton dhënësin e shërbimeve të pagesave përpara datës së zbatimit të ndryshimeve se i refuzon të njëjtat.

(4) Ofruesi i shërbimeve të pagesave është i detyruar ta informojë përdoruesin e shërbimeve të pagesave se në rast se përdoruesi i shërbimeve të pagesave nuk i pranon ndryshimet e propozuara, përdoruesi ka të drejtë të ndërpresë marrëveshjen kornizë, në cilëndo datë para datës së zbatimit të ndryshimeve pa paguar shpenzim ose kompensim për ndërprerjen e marrëveshjes kornizë, ku marrëveshja kornizë shfuqizohet në datën e ndërprerjes së marrëveshjes nga përdoruesi i shërbimeve të pagesave.

(5) Ndryshimet në vlerën e normave të interesit dhe të kursit devizor mund të zbatohen menjëherë dhe pa njoftim paraprak sipas paragrafit (1) të këtij neni, me kusht që kjo dispozitë të jetë e përfshirë në marrëveshjen kornizë dhe ndryshimet të bëhen më bazë të ndryshimit të normës referente të interesit dhe/ose kursit devizor referent të dakorduar në përputhje me nenin 56 paragrafi (1) pika 3 nën pikat b) dhe c) të këtij ligji.

(6) Ofruesi i shërbimeve të pagesave është i detyruar që menjëherë ta njoftojë përdoruesin e shërbimeve të pagesave për ndryshimin në vlerën e normës së interesit sipas paragrafit (5) të këtij neni, në mënyrën nga neni 58 paragrafët (1) dhe (2) të këtij ligji, përveç nëse palët nuk kanë rënë dakord për frekuencë ose mënyrë saktë të përcaktuar në të cilën informacionet do të jepeshin ose viheshin në dispozicion.

(7) Ndryshimet në vlerën e normës së interesit ose në kursin devizor që janë më të favorshme për përdoruesit e shërbimit të pagesave mund të zbatohen pa njoftim paraprak.

(8) Ndryshimet në normën e interesit ose në kursin devizor që përdoren në transaksionet e pagesave duhet të zbatohen dhe llogariten në mënyrë që përdoruesit e shërbimeve të pagesave të mos i vendosin në pozitë të pabarabartë.

Zgjidhja e marrëveshjes kornizë

Neni 60

(1) Përdoruesi i shërbimeve të pagesave mund të zgjidhë marrëveshjen kornizë dhe të mbyllë llogarinë e pagesës në çdo kohë, përveç nëse palët kanë rënë dakord për një afat njoftimi, i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 30 ditë.

(2) Zgjidhja e marrëveshjes kornizë dhe mbyllja e llogarisë së pagesës është pa kompensim për përdoruesin e shërbimeve të pagesave, përveç nëse marrëveshja kornizë është në fuqi në periudhë më të shkurtër se gjashtë muaj.

(3) Nëse marrëveshja është në fuqi në periudhë më të shkurtër se gjashtë muaj, kompensimet për zgjidhjen e marrëveshjes kornizë dhe mbylljen e llogarisë së pagesës janë në shumën e shpenzimeve reale të bëra nga ofruesi i shërbimeve të pagesave.

(4) Nëse është dakorduar me marrëveshjen kornizë, ofruesi i shërbimeve të pagesave mund ta zgjidhë marrëveshjen kornizë të lidhur për një kohë të pacaktuar duke njoftuar së paku dy muaj para ditës së zgjidhjes së marrëveshjes kornizë. Njoftimi për zgjidhje i dorëzohet përdoruesit të shërbimeve të pagesave në mënyrën nga neni 58 paragrafët (1), (2) dhe (3) të këtij ligji.

(5) Dispozita sipas paragrafit (4) të këtij neni nuk zbatohet për llogaritë joaktive të pagesave dhe për llogaritë e bllokuara të pagesave.

(6) Në rast të ndërprerjes së marrëveshjes kornizë dhe mbylljes së llogarisë së pagesave sipas së cilës kompensimet për shërbimet e pagesave nga përdoruesi i shërbimeve të pagesave llogariten ose arkëtohen në bazë të rregullt, ofruesi i shërbimeve të pagesave i arkëton kompensimet në vlerë e cila është në përpjesëtim me periudhën deri në ndërprerjen e marrëveshjes.

(7) Nëse përdoruesi i shërbimeve të pagesave paraprakisht i ka paguar kompensimet për shërbimet e pagesave, ofruesi i shërbimeve të pagesave është i detyruar t'i kthejë përdoruesit të shërbimeve të pagesave një pjesë të vlerës së kompensimeve të paguara që është në përpjesëtim me periudhën nga dita e ndërprerjes së marrëveshjes deri në ditën e fundit të periudhës për të cilën është paguar kompensimi.

(8) Ofruesi i shërbimeve të pagesave është i detyruar që menjëherë pas skadimit të afatit sipas paragrafit (4) të këtij neni ta zgjidhë marrëveshjen dhe ta mbyllë llogarinë e pagesës, e nëse në llogarinë e pagesave ka saldo pozitive t'ia bartë mjetet financiare në llogarinë e evidentimit me qëllim të veçantë dhe nuk duhet të llogarisë dhe të arkëtojë asnjë kompensim për mbajtjen e llogarisë së evidentimit.

(9) Me bartjen e mjeteve financiare në llogarinë e evidentimit me qëllim të veçantë nuk ndërpritet e drejta e pronësisë mbi mjetet financiare të përdoruesit të shërbimeve të pagesave, duke përfshirë të dhënat e së drejtës së pronësisë dhe të drejtave të tjera që rrjedhin nga pronësia.

(10) Ofruesi i shërbimeve të pagesave mund t'ia ndërpresë marrëveshjen kornizë përdoruesit të shërbimeve të pagesave i cili është konsumator nëse gjendja e mjeteve financiare në llogarinë e pagesave është zero në periudhë të pandërprerë prej 24 muajsh.

Informacione para ekzekutimit të transaksioneve individuale të pagesave

Neni 61

Në rast të transaksionit individual të pagesës të iniciuar nga paguesit në përputhje me marrëveshjen kornizë të lidhur, dhënësi i shërbimeve të pagesave është i detyruar në kërkesë të paguesit për transaksion konkret të pagesës, t'ia japë informacionet e mëposhtme:

- 1) afatin maksimal për ekzekutimin dhe
- 2) llojin dhe shumën e kompensimeve në barrë të paguesit, gjithsej dhe sipas zërave individual.

Informacione për pagesin për transaksionet individuale të pagesave

Neni 62

(1) Ofruesi i shërbimeve të pagesave të pagesit është i detyruar menjëherë pas debitimit të llogarisë së pagesës së pagesit për vlerën e transaksionit individual të pagesës, ose pas pranimit të urdhërpagesës, nëse pagesi nuk përdor llogarinë e pagesës për ekzekutimin transaksionit individual të pagesës t'ia japë pagesit në letër ose medium tjetër të përhershëm informacionet e mëposhtme:

1) shenjë referente e transaksionit të pagesës me të cilën pagesi mund të identifikojë transaksionin, kurse nëse është e zbatueshme, informacionet në lidhje me pranuesin;

2) vlerën e transaksionit të pagesës në valutën në të cilën debitohet llogaria e pagesës së pagesit ose në valutën e cila përdoret në urdhërpagesën;

3) llojin dhe vlerën e të gjitha kompensimeve që janë në llogari të pagesit, gjithsej dhe sipas zërave individual;

4) kursin devizor të cilin ofruesi i shërbimeve të pagesave e ka përdorur gjatë ekzekutimit të transaksionit të pagesës dhe vlerën e transaksionit të pagesës pas konvertimit valutor, nëse është e zbatueshme dhe

5) datën e valutës së debitimit ose datën e pranimit të urdhërpagesës.

(2) Marrëveshja kornizë duhet të përmbajë dispozitë me të cilën rregullohet që me kërkesë të pagesit ofruesi i shërbimeve të pagesave t'ia japë ose ia vë në dispozicion informacionet për transaksionet individuale të pagesave të ekzekutuara sipas paragrafit (1) të këtij neni, në mënyrë periodike, së paku një herë në muaj, pa kompensim dhe në mënyrën e dakorduar, e cila i mundëson pagesit të ruajë dhe riprodhojë informacionet në formë të pandryshuar.

(3) Ofruesi i shërbimeve të pagesave sipas paragrafit (1) të këtij neni, është i detyruar me kërkesë të pagesit t'ia japë informacionet sipas paragrafit (1) të këtij neni në letër ose medium tjetër të përhershëm, një herë në muaj dhe pa kompensim.

Informacione për pranuesin pas ekzekutimit të transaksioneve individuale të pagesave

Neni 63

(1) Ofruesi i shërbimeve të pagesave të pranuesin është i detyruar që menjëherë pas ekzekutimit të transaksionit individual të pagesës, në përputhje me marrëveshjen kornizë të lidhur, t'ia japë pranuesit në letër ose në një medium tjetër të përhershëm këto të informacione:

1) shenjë referente të transaksionit të pagesës me të cilën pranuesi mund të identifikojë transaksionin dhe pagesin dhe të gjitha informacionet që barten me transaksionin e pagesës;

2) vlerën e transaksionit të pagesës në valutën në të cilën është miratuar llogaria e pagesës së pranuesit;

3) llojin dhe vlerën e të gjitha kompensimeve të që janë në kurriz të pranuesit për transaksionet e pagesave, gjithsej dhe sipas zërave individual;

4) kursin devizor që është përdorur gjatë ekzekutimit të transaksionit të pagesës nga dhënësi i shërbimeve të pagesave të pranuesit, kurse vlerën e transaksionit të pagesës përpara konvertimit valutor, nëse është e zbatueshme dhe

5) datën e valutës për miratimin e llogarisë së pranuesit.

(2) Marrëveshja kornizë mund të përmbajë dispozitë me të cilën rregullohet që dhënësi i shërbimeve të pagesave t'ia japë ose t'ia vë në dispozicion informacionet për transaksionet e ekzekutuara individuale të pagesave sipas paragrafit (1) të këtij neni, në mënyrë periodike, së paku një herë në muaj, në mënyrën e rënë dakord që do të mundësojë ruajtjen dhe riprodhimin e këtyre informacioneve në formë të pandryshuar.

(3) Ofruesi i shërbimeve të pagesave sipas paragrafit (1) të këtij neni është i detyruar, me kërkesë të pranuesit, t'ia japë informacionet sipas paragrafit (1) të këtij neni në letër ose medium tjetër të përhershëm një herë muaj dhe pa kompensim.

Detyrim për dhënien e raportit për kompensimet

Neni 64

(1) Ofruesi i shërbimeve të pagesave është i detyruar që së paku një herë në vit t'i japë raport konsumatorit për të gjitha kompensimet e paguara për shërbimet në lidhje me llogarinë e pagesave dhe nëse është e zbatueshme, informacionet për vlerën e normave të interesit dhe në përputhje me nenin 65 paragrafi (1) pikat 3) dhe 4) të këtij ligji dhe kursi i aplikuar devizor, ndërkaq nëse zbatohet norma referente e interesit dhe/ose kursi devizor referent, detyrimisht përfshihet edhe informacioni për burimin e disponueshëm publikisht nga ku mund të kontrollohet indeksi ose baza për përcaktimin e vlerës dhe lëvizjes së normës së interesit referente të përdorur dhe/ose kursit referent devizor. Nëse është e zbatueshme, në raportin përdoren termet e standardizuara për shërbimet më përfaqësuese lidhur me llogarinë e pagesës në përputhje me listën nga neni 184 paragrafi (4) i këtij ligji.

(2) Ofruesi i shërbimeve të pagesave është i detyruar që ta dorëzojë raportin sipas paragrafit (1) të këtij neni më së voni deri në fund të muajit janar të vitit aktual kalendarik për kompensimet e paguaranë vitin paraprak kalendarik.

(3) Detyrimi për dhënien e raportit për kompensimet sipas paragrafit (1) të këtij neni nuk mund të përjashtohet me përmbushjen e detyrimeve të ofruesit të shërbimeve të pagesave për informimin e konsumatorëve në përputhje me nenet 62 dhe 63 të këtij ligji dhe me përmbushjen e detyrimeve të dhënësit të shërbimeve të pagesave në lidhje me marrëveshjen për tejkalimin e lejuar në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konsumatorëve gjatë marrëveshjeve për kredi konsumatore.

(4) Mënyra e dhënies së raportit për kompensimet sipas paragrafit (1) të këtij neni përcaktohet në marrëveshjen kornizë.

(5) Ofruesi i shërbimeve të pagesave është i detyruar që me kërkesë të konsumatorit t'ia japë raportin për kompensimet sipas paragrafit (1) të këtij neni në letër, pa marrë parasysht mënyrën e kontraktuar për dhënien e raportit në përputhje me paragrafin (4) të këtij neni.

Përmbajtja dhe forma e raportit për kompensimet

Neni 65

(1) Raporti për kompensimet nga neni 64 paragrafi (1) i këtij ligji i përmban së paku këto të informacione:

1) kompensimi i arkëtuar veçmas për çdo shërbim të përdorur dhe informacion për atë se sa herë është përdorur secili prej shërbimeve gjatë periudhës së njoftimit, së bashku me vlerën e përgjithshme të kompensimit të arkëtuar për çdo shërbim të përdorur;

2) kur shërbimet janë të kombinuara në pako, kompensimi i arkëtuar për pakon e shërbimeve, informacion për atë se sa herë është arkëtuar kompensimi për pakon e shërbimeve dhe vlerën e përgjithshme të kompensimit të arkëtuar për pakon e shërbimeve të përdorur gjatë periudhës së njoftimit, si dhe kompensimet shtesë të arkëtuara për çdo shërbim që tejkalon vëllimin e shërbimeve të mbuluara nga kompensimi i pakos së shërbimeve, së bashku me vlerën e përgjithshme të kompensimit të paguar për shërbimet që tejkalojnë vëllimin e mbuluar nga kompensimi për pakon e shërbimeve;

3) nëse është e zbatueshme, norma e interesit zbatohet për tejkalimin e lejuar në llogarinë e pagesave dhe/ose për saldon detyrimore heshturazi të toleruar në llogarinë e pagesave, së bashku me shumën e përgjithshme të interesit të paguar për tejkalimin e lejuar të përdorur dhe/ose saldo detyrimore heshturazi të toleruar për periudhën e raportimit;

4) nëse është e zbatueshme, norma e pasive e interesit që zbatohet në llogarinë e pagesës, së bashku me vlerën e përgjithshme të interesit të paguar për periudhën e raportimit; dhe

5) vlera e përgjithshme e kompensimeve të arkëtuara për të gjitha shërbimet e përdorura gjatë periudhës së raportimit.

(2) Raporti për kompensime nga neni 64 paragrafi (1) i këtij ligji duhet:

1) të jetë i prezantuar dhe strukturuar në mënyrë të thjeshtë dhe të kuptueshme për t'u lexuar, duke përdorur shkronja, numra dhe shenja qartësisht të dukshme dhe lehtësisht të lexueshme;

2) të jetë i saktë, pa mëdyshje dhe i shprehur në valutën përkatëse në të cilën është e hapur dhe lexohet llogaria e pagesës, ndërsa nëse është dakorduar ndërmjet ofruesit dhe përdoruesit të shërbimeve të pagesave në një valutë tjetër dhe

3) të përmbajë titullin "Raport për kompensime" dhe simbol të përbashkët në fillim të faqes së parë, për shkak që të dallohet lehtë nga dokumentet e tjera.

(3) Këshilli i Bankës Popullore, me akt nënligjor më hollësisht i përcakton përmbajtjen dhe formën e standardizuar të raportit për kompensimet dhe simbolin e përbashkët të standardizuar nga ky nen.

Detyrimi për shfrytëzimin e termeve dhe përkufizimeve të standardizuara gjatë informimit të konsumatorëve

Neni 66

(1) Ofruesi i shërbimeve të pagesave në informacionet e tij afariste dhe të marketingut para marrëveshjeve, gjatë marrëveshjeve, të destinuara për konsumatorët, është i detyruar të përdorë termet dhe përkufizimet e standardizuara nga lista e shërbimeve më përfaqësuese nga neni 184 paragrafi (4) i këtij ligji.

(2) Ofruesi i shërbimeve të pagesave në dokumentin informativ për kompensimet nga neni 56 i këtij ligji dhe në raportin për kompensimet nga neni 64 paragrafi (1) i këtij ligji, mund të përdorë emrat e brendeve të pagesave, me kusht që emrat të përdoren së bashku me termet dhe përkufizimet e standardizuara nga lista e shërbimeve më përfaqësuese nga neni 184 paragrafi (4) i këtij ligji.

(3) Ofruesi i shërbimeve të pagesave mund të përdorë brendet e pagesave për të treguar shërbimet e tij të pagesave në informacionet e tij afariste dhe të marketingut, para marrëveshjeve dhe gjatë marrëveshjeve të destinuar për konsumatorët, me kusht që emrat të identifikojnë qartë termet përkatëse nga termet dhe përkufizimet e standardizuara nga lista e shërbimeve më përfaqësuese nga neni 184 paragrafi (4) i këtij ligji.

Kapitulli IV

Kushte për emetim dhe blerje të parave elektronike

Marrëveshje për emetim të parave elektronike

Neni 67

(1) Për emetimin e parave elektronike, emetuesi i parave elektronike është i detyruar të lidhë marrëveshje me shfrytëzuesin e parave elektronike.

(2) Marrëveshja sipas paragrafit (1) të këtij neni, detyrimisht përmban kushte të qarta dhe precize për blerjen e parave elektronike, duke përfshirë të gjitha kompensimet në lidhje me blerjen.

(3) Para lidhjes së marrëveshjes për emetimin e parave elektronike, përkatësisht para pranimit të ofertës për emetimin e parave elektronike, emetues i parave elektronike është i detyruar që shfrytëzuesit të parave elektronike t'i japë kushtet e marrëveshjes, përkatësisht ofertën për emetimin e parave elektronike.

(4) Në marrëveshjen për emetimin e parave elektronike në mënyrë të përshtatshme zbatohen dispozitat e neneve 59 dhe 60 të këtij ligji.

Blerja e parave elektronike

Neni 68

(1) Poseduesi i parave elektronike mund të kërkojë blerjen e parave elektronike në tërësi ose pjesërisht nëse e kërkon blerjen para përfundimit të marrëveshjes për emetimin e parave elektronike.

(2) Nëse poseduesi i parave elektronike kërkon blerjen e parave elektronike në datën e përfundimit të marrëveshjes për emetimin e parave elektronike ose në periudhë deri në një vit pas datës së përfundimit të marrëveshjes, emetuesi i parave elektronike është i detyruar :

1) të kryejë blerjen në vlerën e parave të parave elektronike në tërësi, ose

2) të kryejë blerjen në tërësi të parave elektronike në shumën të cilën poseduesi e ka kërkuar, nëse institucioni i parave elektronike kryen një ose më shumë veprimtari nga neni 11 paragrafi (3) pika 4) të këtij ligji dhe nuk dihet paraprakisht pjesa e parave që do të përdoren si para elektronike.

(3) Emetuesi i parave elektronike mund të llogarisë dhe të paguajë kompensim për blerjen e parave elektronike në shumën e shpenzimeve reale të bëra nga emetuesi në lidhje me kërkesën për blerjen e poseduesit, nëse kompensimi është i përfshirë në marrëveshjen nga neni 67 paragrafi (1) i këtij ligji dhe nëse:

1) blerja kërkohet përpara se marrëveshja të pushojë së vlefshmi;

2) marrëveshja është lidhur për kohë të caktuar dhe poseduesi i parave elektronike e zgjidh atë para skadimit të marrëveshjes ose

3) blerja kërkohet pas kalimit të një viti nga data e përfundimit të marrëveshjes.

(4) Emetuesi i parave elektronike dhe poseduesi i parave elektronike i cili nuk është konsumator dhe i pranon paratë elektronike si mjet pagese, mund që të drejtat për blerjen e parave elektronike me marrëveshje të ndërsjellë t'i rregullojnë në mënyrë të ndryshme nga ajo e rregulluar me paragrafët (1), (2) dhe (3) të këtij neni.

Kapitulli V

Qasja deri te llogaria e pagesës

Zbatimi i dispozitave

Neni 69

Dispozitat e Kapitullit V të këtij ligji zbatohen vetëm për dhënësit e shërbimeve të pagesave nga neni 9 paragrafi (1) pikat 1), 2) dhe 3) të këtij ligji.

Ndalesë për diskriminim

Neni 70

(1) Ofruesi i shërbimeve të pagesave nuk guxon të diskriminojë konsumatorin i cili kërkon hapjen e llogarisë së pagesës dhe/ose përdor llogari të pagesës në bazë të shtetësisë, vendbanimit dhe vendqëndrimit të tij ose për çfarëdo bazë për diskriminim në përputhje me Ligjin e Parandalimit dhe të Mbrojtjes nga Diskriminimi, nëse është konsumator me vendqëndrim të ligjshëm.

(2) Kushtet për hapjen dhe përdorimin e llogarisë së pagesave me funksione bazë nuk duhet të diskriminojnë konsumatorët në asnjë bazë.

Detyrim për ofertën e llogarisë së pagesës me funksione bazë

Neni 71

(1) Ofruesi i shërbimeve të pagesave është i detyruar që në ofertën për shërbime të pagesave për konsumatorët nga neni 72 paragrafi (1) i këtij ligji detyrimisht të përfshijë hapjen e llogarisë së pagesës me funksione bazë.

(2) Ofruesi i shërbimeve të pagesave nuk duhet të kushtëzojë hapjen dhe përdorimin e llogarisë së pagesave me funksionet bazë me përdorimin e shërbimit dhe/ose produkt shtesë, as duke blerë aksione ose letra të tjera me vlerë të lëshuara nga dhënësi i shërbimeve të pagesave ose personat me të cilët ofruesi i ka lidhje të afërta.

(3) Ofruesi i shërbimeve të pagesave është i detyruar që konsumatorit t'i vë në dispozicion të informacionet për veçoritë e llogarisë së pagesave me funksionet bazë, kushtet për hapjen dhe përdorimin dhe vlerën e kompensimeve që llogariten dhe arkëtohen në përputhje me nenin 74 të këtij ligji.

(4) Informacionet sipas paragrafit (3) të këtij neni duhet të tregojnë qartë se përdorimi i produkteve dhe shërbimeve shtesë nuk është i detyrueshëm për hapjen dhe përdorimin e llogarisë së pagesave me funksione bazë.

E drejta e hapjes së llogarisë së pagesës me funksione bazë

Neni 72

(1) Të drejtë për hapjen e llogarisë së pagesave me funksionet bazë ka konsumatori me vendqëndrim të ligjshëm dhe konsumatori të cilit i është refuzuar kërkesa për qëndrim dhe të cilit nuk është i mundësuar largimi nga Republika e Maqedonisë së Veriut për shkaqe juridike ose shkaqe tjera praktike (parimi i moskthimit).

(2) Ofruesi i shërbimeve të pagesave është i detyruar në bazë të kërkesës së konsumatorit t'i hapë llogari të pagesës me funksione bazë menjëherë, por jo më vonë se dhjetë ditë pune nga pranimi i kërkesës me lidhjen e marrëveshjes kornizë në përputhje me nenet 56 dhe 75 të këtij ligji, ose në të njëjtin afat të refuzojë kërkesën në përputhje me paragrafin (4) të këtij neni.

(3) Ndaj kërkesës sipas paragrafit (2) të këtij neni, konsumatori me përgjegjësi të plotë morale dhe materiale dorëzon deklaratë me shkrim se nuk ka hapur llogari për pagesë në denarë tek ofruesi i njëjtë ose ofruesi tjetër i shërbimeve të pagesave në Republikën e Maqedonisë së Veriut nga neni 9 paragrafi (1) pikat 1, 2 dhe 3 të këtij ligji.

(4) Ofruesi i shërbimeve të pagesave e refuzon kërkesën për hapjen e llogarisë së pagesave me funksione bazë, nëse:

1) konsumatori vetëm se ka hapur llogari të pagesës në denarë tek ofruesi i njëjtë ose ofrues tjetër të shërbimeve të pagesave në Republikën e Maqedonisë së Veriut nga neni 9 paragrafi (1) pika 1, 2 dhe 3 të këtij ligji, që i mundëson që ti përdorë shërbimet e pagesës nga neni 73 paragrafi (1) i këtij ligji,

2) krijimi i marrëdhënieve afariste ndërmjet ofruesit të shërbimeve të pagesave dhe konsumatorit që e ka parashtruar kërkesën është në kundërshtim me dispozitat me të cilat rregullohet zbulimi dhe parandalimi i pastrimit të parave dhe financimi i terrorizmit;

3) nuk ka kaluar periudhë prej së paku 12 muaj nga data e përfundimit të njëanshëm të marrëveshjes kornizë për llogarinë e pagesave me funksionet bazë nga neni 75 paragrafi (2) i këtij ligji, ose

4) nëse konsumatori nuk ka dorëzuar deklaratë me shkrim në përputhje me paragrafin (3) të këtij neni.

(5) Nëse kërkesa për hapjen e llogarisë së pagesave me funksione bazë refuzohet për arsye sipas paragrafit (4) pika 2) të këtij neni, dhënësi i shërbimeve të pagesave është i detyruar që menjëherë ta njoftojë organin kompetent për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, në përputhje me ligjin.

(6) Nëse ofruesi i shërbimeve të pagesave e refuzon kërkesën për hapjen e llogarisë së pagesës me funksion bazë në përputhje me paragrafin (4) të këtij neni, është i detyruar që menjëherë ta njoftojë konsumatorin me shkrim ose në mënyrë elektronike pa kompensim për refuzimin me shpjegim të arsyeve të refuzimit, përveç në rast kur zbulimi i arsyeve për refuzimin do të ishte në kundërshtim me qëllimet e sigurisë nacionale, rendin dhe qetësinë publike ose rregulloret me të cilat rregullohet zbulimi dhe parandalimi i pastrimit të parave dhe financimi i terrorizmit.

(7) Raportimi sipas paragrafit (6) të këtij neni përmban edhe këshillë për të drejtat e konsumatorit në pikëpamje të:

1) parashtrimit të kundërshtimit në përputhje me nenin 129 të këtij ligji;

2) ankesë deri te organi kompetent në përputhje me nenin 130 të këtij ligji dhe

3) procedurë jashtëgjyqësore për zgjidhjen e kontesteve në përputhje me nenin 131 të këtij ligji.

(8) Konsumatori mund të kërkojë shndërrimin e llogarisë së pagesës në llogari të pagesës me funksione bazë ose llogarisë së pagesës me funksione bazë në llogari të pagesës, tek i njëjti ofrues i shërbimeve të pagesave.

(9) Gjatë transformimit, dhënësi i shërbimeve të pagesave i zbaton ndryshimet e nevojshme në marrëdhënien e marrëveshjes, duke ruajtur shenjën e vetme ekzistuese identifikuese në llogarinë e pagesës. Për transformimin e llogarisë së pagesës nuk paguhet kompensim.

(10) Për kërkesën sipas paragrafit (8) të këtij neni, dhënësi i shërbimeve të pagesave vendos në afat prej dhjetë ditësh.

(11) Dhënësi i shërbimeve të pagesave nuk guxon të hapë llogari të pagesës në denarë nëse përdoruesi i shërbimeve të pagesave ka hapur llogari të pagesës me funksione bazë tek ofruesi i njëjtë ose ofruesi tjetër i shërbimeve të pagesave.

Përshkrim i llogarisë së pagesës me funksione bazë

Neni 73

(1) Llogaria e pagesave me funksione bazë e përfshin përdorimin e shërbimeve të mëposhtme të pagesave nga neni 8 i këtij ligji:

1) shërbime që i mundësojnë të gjitha veprimet e nevojshme për hapjen, mbajtjen dhe mbylljen e llogarisë së pagesës;

2) shërbimet që mundësojnë pagesën e mjeteve dhe tërheqjen e parave të gatshme nga llogaria e pagesave në Republikën e Maqedonisë së Veriut, pavarësisht nëse ajo është drejtpërdrejt në sportelet në hapësirat e punës së ofruesit ku është hapur llogaria, apo nëpërmjet rrjetit të ATM-ve gjatë ose jashtë orarit të punës së ofruesit të shërbimeve të pagesave dhe

3) kryerja e transaksioneve të mëposhtme të pagesave:

- debitimi direkt;

transaksione të pagesave me kartelë të pagesës, duke përfshirë pagesën online dhe

- transfere kreditore, duke përfshirë urdhëresat e përhershme, nëpërmjet terminaleve bankare, sporteleve në hapësirat e punës së ofruesve dhe përdorimit online, nëse janë lëndë e ofertës nga ofruesi i shërbimeve të pagesave.

(2) Ofruesi i shërbimeve të pagesave i ofron shërbimet sipas paragrafit (1) të këtij neni nëse të njëjtat u ofrohen edhe konsumatorëve të cilët kanë llogari të ndryshme nga llogaria e pagesave me funksione bazë.

(3) Llogaria e pagesave me funksione bazë hapet dhe llogaritet në denarë.

(4) Llogaria e pagesave me funksionet bazë i mundëson konsumatorit të iniciojë dhe të kryejë transaksione të pagesës në hapësirat e punës së dhënësit të shërbimeve të pagesave dhe/ose online nëse është lëndë e ofertës nga dhënësi i shërbimeve të pagesave.

(5) Llogaria e pagesave me funksionet bazë i mundëson konsumatorit të kryejë numër të pakufizuar të veprimeve në lidhje me shërbimet sipas paragrafit (1) të këtij neni.

(6) Ofruesi i shërbimeve të pagesave nuk duhet të bëjë marrëveshje për tejkalimin e lejuar të llogarisë së shërbimeve të pagesave me funksionet bazë.

Kompensime në lidhje me llogarinë e pagesës me funksione bazë

Neni 74

(1) Për shërbimet e pagesave nga neni 73 paragrafi (1), përveç shërbimeve të pagesave nga neni 73 paragrafi (1) pika 2 të iniciuara nëpërmjet ofruesit të shërbimeve të pagesave të cili nuk është hapur llogaria dhe për shërbimet e pagesave nga neni 73 paragrafi (1) pika 3 alinea 2 për kryerjen e transaksioneve të pagesave me kartelë kreditore, ofruesi i shërbimeve të pagesave mund të llogarisë dhe të paguajë kompensim të përgjithshëm mujor në vlerë të arsyeshme.

(2) Vlera e arsyeshme e kompensimit sipas paragrafit (1) të këtij neni nuk mund të jetë më e lartë se 0,1% e mesatares lëvizëse të pagës mesatare mujore neto të paguar në vend për 12 muajt e mëparshëm, në përputhje me publikimet e Entit Shtetëror të Statistikës.

(3) Kompensimi sipas paragrafit (2) të këtij neni përfshin kryerjen e së paku pesë transaksioneve të pagesave nga neni 73 paragrafi (1) pika 3 alinetë 1 dhe 3, në nivel mujor, nëse iniciohen me llogari të pagesë së pranuesi në korniza të të njëjtit ofrues të shërbimeve të pagesave.

(4) Me përjashtimisht të paragrafit (1) të këtij neni, ofruesi i shërbimeve të pagesave nuk do të llogarisë dhe paguajë kompensim nëse konsumatori i përket grupit të përdoruesve të këtyre të drejtave ligjore:

1) mbështetje juridike, kompensim për dëmin e shkaktuar për shkak të dëmtimit të shëndetit ose zvogëlimit, përkatësisht humbjes së aftësisë për punë dhe kompensimit të dëmit për humbjen e mbështetjes për shkak të vdekjes së ofruesit të ndihmës;

2) kompensim për shkak të lëndimit trupor sipas rregulloreve për sigurimin invalidor;

3) ndihmë financiare nga mbrojtja sociale;

4) papunësia e përkohshme;

5) shtesa për fëmijë dhe

6) bursë, kredi dhe ndihmë për nxënësit dhe studentët.

(5) Për përdoruesit sipas paragrafit (4) të këtij neni, dhënësi i shërbimeve të pagesave cakton kryerjen e së paku pesë transaksioneve të pagesës pa pagesë nga neni 73 paragrafi (1) pika 3 alinea 1 dhe 3, në nivel mujor, nëse janë të iniciuara për llogari të pagesës së pranuesit në suaza të të njëjtit ofrues të shërbimeve të pagesave.

(6) Ofruesi i shërbimeve të pagesave mund të llogarisë dhe të paguajë kompensim për transaksionet e pagesave në përputhje me tarifën e vlefshme që zbatohet për shërbimet përkatëse që paguhen nga konsumatorët të cilët nuk përdorin llogari të pagesës me funksione bazë për:

- transaksionet e pagesave që tejkalojnë numrin minimal të transaksioneve të pagesave nga paragrafët (3) dhe (5) të këtij neni;

- transaksionet e pagesave nga neni 73 paragrafi (1) pika 3, alinetë 1 dhe 3 që iniciohen nga llogaria e pagesave të një ofruesi i shërbimeve të pagesave në llogarinë e pagesave të një ofrues tjetër i shërbimeve të pagesave;

- shërbimet e pagesave nga neni 73 paragrafi (1) pika 2, të iniciuara nëpërmjet ofruesit të shërbimeve të pagesave të cilin llogaria nuk është e hapur;

- shërbimet e pagesave nga neni 73 paragrafi (1) pika 3 alinea 2, për kryerjen e transaksioneve të pagesave me kartelë kreditore.

(7) Nëse ofruesi i shërbimeve të pagesave mund të llogarisë dhe të paguajë kompensim për mosrespektimin e detyrimeve të përcaktuara me marrëveshjen kornizë me shumë të arsyeshme, të përcaktuar sipas vlerës dhe lëvizjes së mesatares lëvizëse të pagës mesatare mujore neto të paguar në Republikën e Maqedonisë së Veriut për 12 muajt e mëparshëm, në përputhje me publikimet e Entit Shtetëror të Statistikës, por jo më shumë se gjysma e kompensimeve që në momentin e llogaritjes llogariten dhe paguhet nga konsumatorët që nuk përdorin llogari të pagesës me funksione bazë.

Dispozita të veçanta të marrëveshjes kornizë për llogarinë e pagesave me funksione bazë

Neni 75

(1) Nëse me këtë nen nuk është rregulluar ndryshe, për marrëveshjen kornizë për llogarinë e pagesave me funksione bazë zbatohen dispozitat e Kapitullit III, pjesa e tretë e këtij ligji.

(2) Ofruesi i shërbimeve të pagesave në mënyrë të njëanshme e ndërpret marrëveshjen kornizë për llogarinë e pagesave me funksione bazë nëse:

1) ekziston dyshimi se konsumatori ka përdorur qëllimisht llogarinë e pagesës me funksione bazë për qëllime të paligjshme;

2) nuk është kryer asnjë transaksion pagese me llogarinë e pagesës me funksione bazë në periudhë të pandërprerë prej 24 muajsh;

3) konsumatori ka dorëzuar informacione të pasakta për të hapur llogari të pagesës me funksione bazë, kurse në bazë të informacioneve të sakta nuk do të kishte të drejtë të hapte dhe përdorte llogari të pagesës me funksione bazë;

4) konsumatori nuk ka më vendqëndrim të ligjshëm ose ka humbur bazën e vendqëndrimit të ligjshëm sipas të cilit kishte të drejtë të hapte dhe përdorte llogari të pagesës me funksione bazë, ose

5) konstatohet se konsumatori pas hapjes së llogarisë së pagesës me funksionet bazë ka hapur të një ofrues tjetër i shërbimeve të pagesave nga neni 9 paragrafi (1) pikat 1, 2 dhe 3 llogari të pagesës në denarë e cila i mundëson kryerjen e shërbimeve të pagesave nga neni 73 paragrafi (1) të këtij ligji.

(3) Ndërprerja e njëanshme e marrëveshjes kornizë për llogarinë e pagesave me funksione bazë në përputhje me paragrafin (2) pikat 1 dhe 3 të këtij neni, hyn në fuqi menjëherë.

(4) Nëse ofruesi i shërbimeve të pagesave e ndërpret marrëveshjen kornizë për llogarinë e pagesave me funksione bazë në përputhje me paragrafin (2) pikat 2, 4 dhe 5 të këtij neni, është i detyruar ta njoftojë konsumatorin për ndërprerjen e njëanshme pa kompensim, me shkrim ose në formë elektronike të paktën dy muaj përpara hyrjes në fuqi të ndërprerjes së marrëveshjes kornizë.

(5) Njoftimi sipas paragrafit (4) të këtij neni, detyrimisht përmban shpjegim të arsyeve të ndërprerjes, përveç nëse përmendja e arsyeve është në kundërshtim me qëllimet e sigurisë nacionale ose interesit publik, këshillë për të drejtat e konsumatori në lidhje me:

1) parashtimin e kundërshtimit deri te dhënësi i shërbimeve të pagesave në përputhje me nenin 129 të këtij ligji;

2) ankesën deri te organi kompetent në përputhje me nenin 130 të këtij ligji dhe

3) për procedurën jashtëgjyqësore për zgjidhjen e kontesteve në përputhje me nenin 131 të këtij ligji;

(6) Nëse ofruesi i shërbimeve të pagesave e shfrytëzon të drejtën e tij për ndërprerje të njëanshme të marrëveshjes kornizë për llogarinë e pagesave me funksione bazë në përputhje me paragrafin (2) pikat 2), 4) dhe 5) të këtij neni, në afat prej dy muajve të përcaktuar në paragrafin (4) të këtij neni, mund të dakordohet me konsumatorin që statusi i llogarisë ekzistuese të pagesave me funksionet bazë të shndërrohet në llogari pagese, pa u mbyllur.

(7) Nëse gjatë ndërprerjes së njëanshme të marrëveshjes kornizë në përputhje me paragrafin (2) të këtij neni, në llogarinë e pagesave me funksione bazë ka saldo pozitive të parave, vlera e saldosit pozitive menjëherë do të transferohet në një llogari evidentuese me qëllim të veçantë të ofruesi i shërbimeve të pagesave.

(8) Me transferimin e mjeteve në llogarinë evidentuese me qëllim të veçantë sipas paragrafit (7) të këtij neni nuk e ndërprejnë të drejtën e pronësisë mbi mjetet e konsumatorit, duke përfshirë format e së drejtës së pronësisë dhe të drejtat e tjera që rrjedhin nga pronësia.

Pjesa e katërt

TË DREJTA DHE DETYRIME NË RAPORT ME DHËNIEN DHE PËRDORIMIN E SHËRBIMEVE TË PAGESAVE

Pjesa I

Dispozita të përgjithshme

Përfshirje

Neni 76

(1) Dispozitat e pjesës së katërt të këtij ligji zbatohen kur dhënësi I shërbimeve të pagesave paguesit dhe dhënësit të shërbimeve të pagesave të pranuesit, ose dhënësi I vetëm I shërbimeve të pagesave në transaksionin e pagesës, janë themeluar dhe veprojnë në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

(2) Dispozitat e pjesës së katërt të këtij ligji zbatohen edhe për transaksionet e pagesave ndërkufitare ku së paku njëri nga dhënësit e shërbimeve të pagesave, pavarësisht nëse është paguesi apo pranuesi, është I themeluar dhe punon në Republikën e Maqedonisë së Veriut në lidhje me atë pjesë të transaksionit të pagesës që kryhet në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

(3) Dispozitat e pjesës së katërt të ligjit zbatohen kur shfrytëzuesi I shërbimeve të pagesave është konsumator.

(4) Dispozitat e pjesës së katërt të këtij ligji, përveç dispozitave të nenit 92 dhe dispozitave të Kapitullit IV të pjesës së katërt të këtij ligji, zbatohen edhe kur shfrytëzuesi I shërbimeve të pagesave nuk është konsumator. Kompensimet nga neni 77 paragrafi (1) I këtij ligji, pëlqimi dhe tërheqja e pëlqimit nga neni 79 paragrafët (5) dhe (6) të këtij ligji, afati për njoftimin për transaksionet e pagesave të paautorizuara ose të kryera në mënyrë të padrejtë dhe korigjimi I tyre nga neni 87 I këtij ligji, vërtetimi I autentifikimit dhe ekzekutimit të transaksionit të pagesës nga neni 88 I këtij ligji, përgjegjësia e paguesit për transaksionet e paautorizuara të pagesave të nga neni 90 I këtij ligji, kthimi I mjeteve për transaksionet e pagesave të iniciuara nga ose nëpërmjet pranuesit nga neni 93 I këtij ligji, pa revokueshmërinë e urdhërpagesës nga neni 96 I këtij ligji dhe përgjegjësitë e ofruesit të shërbimeve të pagesave nga nenet 102 dhe 103 të këtij

ligji, mund të rregullohet edhe ndryshe me marrëveshje ndërmjet dhënësit të shërbimit të pagesave dhe përdoruesit të shërbimeve të pagesa I cili nuk është konsumator, por në mënyrë që nuk do t'i shkaktojë dëm financiar dhënësit të shërbimeve të pagesave ose shfrytëzuesit të shërbimeve të pagesave I cili nuk është konsumator.

(5) Në institucionin e pagesës që jep vetëm shërbime të pagesave nga neni 8 paragrafi (1) pika 8 e këtij ligji, zbatohen vetëm dispozitat nga nenet 84, 86 dhe 87 dhe Kapitulli VI të pjesës së katërt të këtij ligji.

(6) Dhënësit e shërbimeve të pagesave mund t'u japin përdoruesve të drejta më të favorshme për shfrytëzimin e shërbimeve të pagesave nga të drejtat e caktuara në pjesën e katërt e këtij ligji.

Kompensime dhe zbritje

Neni 77

(1) Ofruesi i shërbimeve të pagesave përdoruesit të shërbimeve të pagesave do t'ia paguajë vetëm kompensimet nga nenet 95 paragrafi (3), 96 paragrafi (7) dhe 101 paragrafi (7) të këtij ligji, të cilat janë të përmbajtura në marrëveshjen ndërmjet përdoruesit të shërbimeve të pagesave dhe ofruesit të shërbimeve të pagesave dhe janë në vlerën e shpenzimeve reale të bëra nga ofruesi i shërbimeve të pagesave.

(2) Në rast të kryerjes së transaksioneve të pagesave ku edhe ofruesi i shërbimeve të pagesave i pranuesit dhe ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit ose ofruesi i vetëm i shërbimeve të pagesave ndodhen në Republikën e Maqedonisë së Veriut, ofruesit e shërbimeve të pagesave mund të llogarisin dhe paguajnë kompensime për shërbimet e pagesave vetëm nga përdoruesi i tij - paguesi, përkatësisht përdoruesi i tij - pranuesi.

(3) Ofruesi i shërbimeve të pagesave nuk ka të drejtë të pengojë pranuesin që të kërkojë nga paguesi që të paguajë kompensim ose t'i ofrojë zbritje për shkak të përdorimit të instrumentit të caktuar të pagesës ose në mënyrë tjetër ta orientojë atë në shfrytëzimin e një instrumenti të caktuar të pagesës. Në rast se pranuesi i paguan kompensim ose ofron zbritje për përdorimin e instrumentit të caktuar të pagesës, pranuesi duhet të njoftojë paguesin para inicimit të transaksionit të pagesës.

(4) Vlëra e kompensimit për përdorimin e instrumentit të caktuar të pagesës sipas paragrafit (3) të këtij neni duhet të jetë në vlerën e shpenzimeve reale të bëra nga pranuesi për përdorimin e instrumentit të caktuar të pagesës.

(5) Pranuesi nuk ka të drejtë të ofrojë zbritje nëse transaksionet e pagesës kryhen me para të gatshme.

(6) Me përjashtim të paragrafit (3) të këtij neni, pranuesi nuk ka të drejtë të kërkojë nga paguesi kompensim për përdorimin e instrumenteve të pagesës të bazuar në kartelë për të cilat kompensimet e zëvendësimit janë të rregulluara me nenin 115 të këtij ligji, si dhe për transferet kreditore dhe debitimet direkte.

(7) Pranuesi nuk ka të drejtë të llogarisë dhe të arkëtojë kompensime shtesë nga paguesi për shkak të përdorimit të instrumentit të caktuar të pagesës, përveç kompensimit sipas paragrafit (3) të këtij neni.

Dallimet sa i përket instrumenteve të pagesave me vlerë të ulët dhe paratë elektronike

Neni 78

Ofruesit e shërbimeve të pagesave me përdoruesit e shërbimeve të pagesave për instrumentet e pagesave dhe paratë elektronike të cilat në përputhje me dispozitat e marrëveshjes kornizë i referohen vetëm transaksioneve individuale të pagesave që nuk e kalojnë vlerën prej 1.200

denarë ose kundërvlerën përkatëse në valuta të tjera, ose kanë kufizim të shpenzimit deri në vlerën e përgjithshme prej 6.000 denarë ose kundërvlerën përkatës në valuta të tjera, ose paratë e gatshme që nuk tejkalojnë në asnjë moment 6.000 denarë ose kundërvlerën përkatëse në valuta të tjera, ose kartelat e pagesës me parapagim që nuk tejkalojnë vlerën prej 10.000 denarë ose kundërvlerën përkatës në valutat tjera, mund të bien dakord:

1) se dispozitat e nenit 85 paragrafi (1) pika 1, 86 paragrafi (1) pika 3), 4) dhe 6) dhe 90 paragrafët (7) dhe (8) të këtij ligji nuk do të zbatohen nëse instrumenti i pagesës nuk mund të bllokohet ose nuk mund të parandalohet përdorimi i mëtejshëm i tij;

2) se dispozitat e neneve 88, 89 dhe 90 paragrafët (1), (2), (3), (7) dhe (8) të këtij ligji nuk do të zbatohen nëse instrumenti i pagesës përdoret në mënyrë anonime ose nëse ofruesi i shërbimeve të pagesave nuk mund të vërtetojë se transaksioni i pagesës është autorizuar për arsye të tjera karakteristike për atë instrument të pagesës;

3) me përjashtim të dispozitave të nenit 95 paragrafët (1) dhe (2) të këtij ligji, dhënësi i shërbimeve të pagesave nuk është i detyruar ta njoftojë përdoruesin e shërbimeve të pagesave për refuzimin e urdhërpagesës, nëse mosekzekutimi është për arsye të dukshme objektive;

4) me përjashtim të dispozitave nga neni 96 paragrafët (3), (4) dhe (5) të këtij ligji, paguesi nuk ka të drejtë të revokojë urdhërpagesën pas dorëzimit të urdhërpagesës ose pas dhënies së pëlqimit për pranuesin që të kryej transaksionin e pagesës, dhe/ose

5) me përjashtim të dispozitave nga neni 99 paragrafët (1), (2), (3), (4), (5), (6), (7) dhe (8) të këtij ligji, të zbatohen afate të tjera për kryerjen e transaksioneve të pagesave.

Kapitulli II

Autorizim të transaksioneve të pagesave

Pëlqim dhe tërheqje e pëlqimit

Neni 79

(1) Transaksioni i pagesës konsiderohet i autorizuar vetëm nëse paguesi jep pëlqimin për kryerjen e transaksionit të pagesës.

(2) Transaksioni i pagesës mund të autorizohet nga paguesi para ekzekutimit të tij ose, nëse është dakorduar ndërmjet paguesit dhe ofruesit të shërbimit të pagesave, pas ekzekutimit të tij.

3) Pëlqimi për kryerjen e transaksionit të pagesës ose për një sërë transaksionesh të pagesave duhet të jepet në formë të dakorduar ndërmjet paguesit dhe ofruesit të shërbimit të pagesave. Pëlqimi gjithashtu mund të jepet edhe nëpërmjet pranuesit ose ofruesit të shërbimeve për iniciimin e pagesave.

(4) Nëse pëlqimi për kryerjen e transaksionit të pagesës nuk është dhënë në formën e dakorduar ndërmjet paguesit dhe ofruesit të shërbimit të pagesës, transaksioni i pagesës konsiderohet i paautorizuar.

(5) Paguesi mund ta tërheqë pëlqimin për kryerjen e transaksionit të pagesës në çdo kohë, por më së voni deri në momentin e paravokueshmërisë së urdhërpagesës në përputhje me nenin 96 të këtij ligji.

(6) Paguesi mund ta tërheqë pëlqimin për kryerjen e një sërë transaksionesh të pagesave në çdo kohë, pas së cilës çdo transaksion i ardhshëm i pagesës që është pjesë e serisë konsiderohet i paautorizuar.

(7) Mënyra dhe procedura për dhënien e pëlqimit për kryerjen e transaksioneve të pagesave dhe për tërheqjen e pëlqimit të dhënë janë pjesë përbërëse e marrëveshjes ndërmjet paguesit dhe dhënësit, përkatësisht ofruesve të shërbimeve të pagesave.

Konfirmimi i disponueshmërisë së mjeteve financiare

Neni 80

(1) Ofruesi i shërbimeve të pagesave që mban llogarinë e pagesave është i detyruar me kërkesë të ofruesit të shërbimeve të pagesave që ka lëshuar instrumente të pagesave të bazuar në kartelë, që menjëherë të konfirmojë nëse në llogarinë e pagesës së paguesit është e disponueshme vlera e nevojshme për kryerjen e transaksionit të pagesës në kartelë, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

1) llogaria e pagesës së paguesit është e disponueshme online në momentin e kërkesës për konfirmimin e disponueshmërisë së vlerës së mjeteve;

2) paguesi i ka dhënë pëlqimin ofruesit të shërbimeve të pagesave, i cili mban llogarinë e pagesave, që t'i përgjigjet kërkesave të ofruesit konkret të shërbimeve të pagesave për konfirmim se në llogarinë e pagesës së paguesit është e disponueshme svlera që korrespondon me transaksionin e caktuar të pagesës të bazuar në kartelë dhe

3) pëlqimi nga pika 2 e këtij paragrafi është dhënë para se të parashtrohet kërkesa e parë për konfirmimin e disponueshmërisë së vlerës së mjeteve.

(2) Ofruesi i shërbimeve të pagesave i cili ka lëshuar instrumente të pagesave të bazuara në kartelë kërkon konfirmimin e disponueshmërisë së mjeteve sipas paragrafit (1) të këtij neni, nëse plotësohen këto kushte:

1) paguesi i ka dhënë pëlqimin ofruesit të shërbimeve të pagesave i cili ka lëshuar instrumentin e pagesës që të kërkojë konfirmimin e disponueshmërisë së mjeteve sipas paragrafit (1) të këtij neni;

2) paguesi ka iniciuar transaksion të pagesës të bazuar në kartelë në vlerën që duhet të konfirmohet me përdorimin e instrumentit të pagesës së bazuar në kartelë të lëshuar nga ofruesi i shërbimeve të pagesave dhe

3) para çdo kërkesë për konfirmimin e disponueshmërisë së mjeteve sipas paragrafit (1) të këtij neni, ofruesi i shërbimeve të pagesave komunikon në mënyrë të sigurt me ofruesin e shërbimeve të pagesave i cili mban llogarinë e pagesës në përputhje me standardet e komunikimit nga neni 125 të këtij ligji.

(3) Në përputhje me dispozitat për mbrojtjen e të dhënave personale, konfirmimi për disponueshmërinë e mjeteve sipas paragrafit (1) të këtij neni përmban vetëm përgjigjen "po" ose "jo" dhe nuk përmban raport për gjendjen e llogarisë së pagesës.

(4) Ofruesi i shërbimeve të pagesave i cili ka lëshuar instrumente të pagesave të bazuara në kartelë nuk do e mban përgjigjen sipas paragrafit (3) të këtij neni si të dhënë dhe nuk do e përdorë për qëllime të tjera, përveç ekzekutimit transaksionit të pagesës të bazuar në kartelë.

(5) Ofruesi i shërbimeve të pagesave i cili mban llogarinë e pagesave të paguesit nuk ka të drejtë në bazë të konfirmimit për disponueshmërinë e mjeteve sipas paragrafit (1) të këtij neni të bëjë rezervimin e mjeteve në llogarinë e pagesës së paguesit.

(6) Ofruesi i shërbimeve të pagesave i cili mban llogarinë e pagesave të paguesit është i detyruar që me kërkesë të paguesit ta informojë për identitetin e ofruesit të shërbimeve të pagesave sipas paragrafit (2) të këtij neni dhe për përgjigjen sipas paragrafit (3) të këtij neni.

(7) Dispozitat e këtij neni nuk zbatohen për transaksionet e pagesave të iniciuara nëpërmjet instrumenteve të pagesës të bazuara në kartela në të cilat ruhen paratë elektronike.

Rregulla për qasje deri te llogaritë e pagesave gjatë shërbimeve të inicimit të pagesave

Neni 81

(1) Paguesi ka të drejtë ta përdorë shërbimin e ofruesit të shërbimeve për inicimin e pagesave nga neni 8 paragrafi (1) pika 7 të këtij ligji vetëm nëse llogaria e pagesës është e disponueshme online.

(2) Shërbimi për iniciimin e pagesave kryhet pa marrë parasysh ekzistimit të marrëdhënies së kontraktuar për atë qëllim ndërmjet ofruesit të shërbimeve për iniciimin e pagesave dhe ofruesit të shërbimeve të pagesave i cili e mban llogarinë e pagesave.

(3) Ofruesi i shërbimit për iniciimin e pagesave:

1) nuk guxon në asnjë moment përderisa e kryerjen shërbimin për iniciimin e pagesave t'i mbajë mjetet e paguesit;

2) është i detyruar të sigurojë se veçoritë e sigurisë së përdoruesit nuk janë në dispozicion për personat e tjerë, përveç për përdoruesin e shërbimeve të pagesave dhe emetuesin e veçorive të sigurisë së përdoruesit dhe që transmetimi i tyre nga ofruesi i shërbimeve të pagesave për iniciimin e pagesave kryhet nëpërmjet kanaleve të sigurta dhe efikase.

3) është i detyruar të sigurojë që të gjitha informacionet për përdoruesit e shërbimeve të pagesave të marra gjatë kryerjes së shërbimit për iniciimin e pagesës i jepen vetëm pranuesit të mjeteve dhe vetëm me pëlqimin e përdoruesit të shërbimeve të pagesave;

4) është i detyruar sa herë që është e iniciuar pagesa të vërtetojë identitetin e tij të ofruesi i shërbimeve të pagesave që mban llogarinë e pagesave të paguesit dhe me ofruesin e shërbimit të pagesave që mban llogarinë e pagesës, të komunikojë me paguesin dhe pranuesin në mënyrë të sigurt, në përputhje me standardet e komunikimit të përcaktuara nga Këshilli i Bankës Popullore me aktin nënligjor nga neni 125 paragrafi (1) i këtij ligji;

5) nuk duhet të ruajë të dhëna sensitive të pagesave së përdoruesit të shërbimeve të pagesave;

6) nuk duhet të kërkojë nga përdoruesi i shërbimeve të pagesave të dhëna të tjera përveç atyre që janë të nevojshme për kryerjen e shërbimit për iniciimin e pagesave;

7) nuk duhet të përdorë, të ketë qasje ose të ruajë asnjë të dhënë për qëllime të tjera përveç dhënies së shërbimeve për iniciimin e pagesave, siç kërkohet shprehimisht nga paguesi dhe

8) nuk duhet të ndryshojë të dhënat për vlerën, pranuesin e pagesës apo ndonjë karakteristikë tjetër të transaksionit të pagesës.

(4) Në rast kur paguesi ka dhënë pëlqim për kryerjen e transaksioneve të pagesave në përputhje me nenin 79 të këtij ligji, ofruesi i shërbimeve të pagesave që mban llogarinë e pagesave duhet t'i mundësojë paguesit përdorimin e shërbimit për iniciimin e pagesave, me çka është i detyruar:

1) të komunikojë në mënyrë të sigurt me ofruesit e shërbimeve për iniciimin e pagesave, në përputhje me standardet e komunikimit të përcaktuara nga Këshilli i Bankës Popullore me aktin nënligjor nga neni 125 paragrafi (1) i këtij ligji;

2) menjëherë pas pranimit të urdhërpagesës nga ofruesi i shërbimit për iniciimin e pagesave t'i japë ose vë në dispozicion të ofruesit të shërbimit për iniciimin e pagesave të gjitha informacionet për iniciimin e transaksionit të pagesës dhe të gjitha informacionet që janë në dispozicion të tij në lidhje me ekzekutimin e transaksionit të pagesës dhe

3) të veprojë me urdhërpagesat e transferuara nëpërmjet dhënësve të shërbimeve të pagesave, veçanërisht në aspektin e orarit të ekzekutimit, përparësisë së ekzekutimit ose kompensimeve, në të njëjtën mënyrë si me urdhërpagesat që pranohen drejtpërdrejt nga paguesi, vetëm kur nevojitet veprim i ndryshëm për arsye të justifikuara objektivisht.

Rregulla për qasje dhe përdorim të informacioneve për llogaritë e pagesave gjatë shërbimeve për dhënie e informacioneve për llogaritë e pagesave

Neni 82

(1) Përdoruesi i shërbimeve të pagesave mund t'i përdorë shërbimet për dhënie e informacioneve për llogaritë e pagesave vetëm nëse llogaria e pagesës është e disponueshme online.

(2) Shërbimi për dhënien e informacioneve për llogaritë e pagesave kryhet pa marrë parasysh nëse ekziston marrëdhënie të kontraktuar për këtë qëllim ndërmjet dhënësit të shërbimit për dhënien e informacioneve për llogaritë e pagesave dhe ofruesit të shërbimeve të pagesave i cili mban llogarinë e pagesave.

(3) Ofruesi i shërbimeve për dhënien e informacioneve për llogaritë e pagesave:

1) është i detyruar t'i ofrojë vetëm shërbimet për të cilat përdoruesi i shërbimeve të pagesave ka dhënë pëlqimin;

2) është i detyruar të sigurojë që veçoritë e sigurisë së përdoruesit të mos jenë në dispozicion për personat e tjerë, përveç përdoruesit dhe emetuesit të veçorive të sigurisë së përdoruesit dhe që transmetimi i tyre nga dhënësi i shërbimit për dhënien e informacioneve për llogaritë e pagesave të bëhet nëpërmjet kanaleve të sigurta dhe efikase. ;

3) është i detyruar gjatë çdo komunikimi të konfirmojë identitetin e tij te ofruesi i shërbimit të pagesave që mban llogarinë e pagesave të përdoruesit të shërbimit të pagesave dhe me ofruesin e shërbimeve të pagesave që mban llogarinë e pagesave dhe të komunikojë me përdoruesin e shërbimit të pagesave në mënyrë të sigurt në përputhje me standardet e komunikimit të përcaktuara nga Këshilli i Bankës Popullore me aktin nënligjor nga neni 125 paragrafi (1) i këtij ligji;

4) është i detyruar të ketë qasje vetëm re informacionet nga llogaritë e treguara të pagesave dhe transaksionet e pagesave që lidhen me to;

5) nuk duhet të kërkojë të dhëna sensitive të pagesave në lidhje me llogaritë e pagesave dhe

6) nuk duhet të përdorë, të ketë qasje ose të ruajë asnjë të dhënë për qëllime të tjera përveç kryerjes së shërbimit për dhënien e informacioneve për llogaritë e pagesave siç kërkohet shprehimisht nga përdoruesi i shërbimeve të pagesave, në përputhje me rregulloret për mbrojtjen e të dhënave.

(4) Ofruesi i shërbimeve të pagesave i cili mban llogarinë e pagesave në lidhje me llogaritë e pagesave është i detyruar:

1) të komunikojë në mënyrë të sigurt me ofruesit e shërbimeve për dhënien e informacioneve për llogaritë e pagesave, në përputhje me standardet e komunikimit të përcaktuara nga Këshilli i Bankës Popullore me aktin nënligjor nga neni 125 paragrafi (1) i këtij ligji dhe

2) të veprojë me kërkesat për të dhënat e ofruara nga ofruesit e shërbimeve për dhënien e informacioneve për llogaritë e pagesave, përveç kur veprimi i ndryshëm është i nevojshëm për arsye objektivisht të justifikuara.

Kufizime për përdorimin e instrumentit të pagesës

Neni 83

(1) Kur instrumenti i pagesës përdoret për dhënien e pëlqimit për kryerjen e transaksionit të pagesës, pagesi dhe ofruesi i tij i shërbimeve të pagesave mund të bien dakord për përkufizimin e shumës së shpenzuar për transaksionet e pagesave të kryera nëpërmjet atij instrumenti të pagesës.

(2) Nëse është rënë dakord në marrëveshjen kornizë, dhënësi i shërbimeve të pagesave mund të bllokojë instrumentin e pagesës, për arsye të justifikuara objektivisht që lidhen me:

1) sigurinë e instrumentit të pagesës;

2) dyshimin për përdorimin e paautorizuar ose mashtrues të instrumentit të pagesës ose

3) rritjen e ndjeshme të rrezikut që pagesi të mos jetë në gjendje të përmbushë detyrimet e tij monetare në lidhje me linjën kreditore, në rast të përdorimit të instrumenti të paguar me linjë kreditore të miratuar.

(3) Ofruesi i shërbimeve të pagesave është i detyruar para bllokimit të instrumentit të pagesës, e nëse kjo nuk është e mundur, menjëherë pas bllokimit të instrumentit të pagesës, ta informojë paguesin për bllokimin dhe arsyet për këtë, në mënyrë të përcaktuar me marrëveshjen kornizë, vetën në rast kur informimi për bllokimin e instrumentit të pagesës është në kundërshtim me ligjin ose nëse për këtë ekzistojnë arsye sigurie të justifikuara objektive.

(4) Ofruesi i shërbimeve të pagesave është i detyruar që pas përfundimit të arsyeve sipas paragrafit (2) të këtij neni, ta heq bllokimin e instrumentit të pagesës ose ta zëvendësojë instrumentin e bllokuar të pagesës me instrument të ri të pagesës.

Kufizimi i qasjes te llogaritë e pagesave nga ofruesi i shërbimeve të pagesave që mban llogarinë e pagesave

Neni 84

(1) Ofruesi i shërbimeve të pagesave që mban llogarinë e pagesave mund t'ia refuzojë ofruesit të shërbimit të informacioneve të llogarive të pagesave ose ofruesit të shërbimit për iniciimin e pagesave qasjen në llogarinë e pagesës për arsye të justifikuara objektivisht të mbështetura me dëshmi adekuate që i referohen qasjes së paautorizuar ose mashtruese në një llogarinë e pagesës nga ofruesi i shërbimeve për dhënien e informacioneve për llogaritë e pagesave ose ofruesi i shërbimeve për iniciimin e pagesave, duke përfshirë edhe iniciimin e paautorizuar ose mashtrues të transaksionit të pagesës.

(2) Në rastet sipas paragrafit (1) të këtij neni, ofruei i shërbimeve të pagesave i cili e mban llogarinë e pagesave është i detyruar ta informojë paguesin për refuzimin e qasjes në llogarinë e pagesës dhe arsyet për këtë, në mënyrë të përcaktuar me marrëveshjen kornizë. Njoftimi duhet t'i jepet paguesit përpara refuzimit të qasjes, ndërkah nëse kjo nuk është e mundur, menjëherë pas refuzimit, përveç rastit kur dhënia e informacionit të përmendura është në kundërshtim me ligjin ose nëse ka arsye të justifikuara objektivisht të sigurisë.

(3) Ofruesi i shërbimeve të pagesave i cili mban llogarinë e pagesave duhet të mundësojë qasjen në llogarinë e pagesës sapo të pushojnë të ekzistojnë arsyet sipas paragrafit (1) të këtij neni për të cilat i është refuzuar qasja.

(4) Ofruesi i shërbimeve të pagesave i cili mban llogarinë e pagesave është i detyruar që menjëherë ta njoftojë Bankën Popullore për çdo refuzim në përputhje me paragrafin (1) të këtij neni. Njoftimi duhet të përmbajë përshkrim të detajuar dhe arsyet e refuzimit të qasjes në llogaritë e pagesave.

(5) Banka Popullore e shqyrton njoftimin sipas paragrafit (4) të këtij neni dhe nëse është e nevojshme, ndaj ofruesve të shërbimeve të pagesave guvernatori do të marrë masa ndaj subjektit të mbikëqyrjes në përputhje me nenin 163 të këtij ligji.

Detyrimet e përdoruesit të shërbimeve të pagesave në lidhje me instrumentet e pagesës dhe veçoritë e sigurisë së përdoruesit

Neni 85

Përdoruesi i shërbimit të pagesave i cili është i autorizuar të përdorë instrumentin e pagesës është i detyruar:

1) menjëherë pasi të marrë instrumentin e pagesës, të marrë të gjitha masat e arsyeshme për mbrojtjen e veçorive të sigurisë së përdoruesit të instrumentit të pagesës,

2) të përdor instrumentin e pagesës në përputhje me kushtet e marrëveshjes për lëshimin dhe përdorimin e instrumentit të pagesës dhe

3) të njoftojë ofruesin e shërbimeve të pagesave ose personin e caktuar nga ofruesi i shërbimeve të pagesave, menjëherë pas marrjes së informacionit për humbje, vjedhje, keqpërdorim ose përdorim të paautorizuar të instrumentit të pagesës.

Detyrimet e ofruesit të shërbimeve të pagesave në lidhje me instrumentet e pagesave

Neni 86

(1) Ofruesi i shërbimeve të pagesave që lëshon instrumentin e pagesës ka këto detyrime:

1) të sigurojë që veçoritë e sigurisë së përdoruesit në lidhje me instrumentin e pagesës janë të disponueshme vetëm për përdoruesin e shërbimit të pagesave të autorizuar për të përdorur instrumentin e pagesës dhe se të njëjtat nuk janë të disponueshme për personat e tjerë, pa rrezikuar detyrimet e përdoruesit të shërbimeve të pagesave nga neni 85 të këtij ligji;

2) të mos dërgojë instrument të pagesës te përdoruesi i shërbimeve të pagesave, përveç në rastin kur instrumenti i dhënë i pagesës së përdoruesit duhet të zëvendësohet;

3) të sigurojë që përdoruesi i shërbimeve të pagesave në çdo kohë të mund të dorëzojë njoftim në përputhje me nenin 85 pika 3 të këtij ligji ose të kërkojë heqjen e bllokadës së instrumentit të pagesës në përputhje me nenin 83 paragrafi (4) të këtij ligji;

4) me kërkesë të përdoruesit të shërbimeve të pagesave të parashtruar në afat prej 18 muajsh pas njoftimit të dorëzuar nga pika 3 e këtij paragrafi, të dorëzojë dëshmi që vërteton se njoftimi është dorëzuar;

5) të ndalojë përdorimin e instrumentit të pagesës menjëherë pas marrjes së njoftimit nga neni 85 pika 3 të këtij ligji;

6) t'i mundësojë përdoruesit të shërbimeve të pagesave pa kompensim dorëzimin e njoftimit nga neni 85 pika 3 e këtij ligji dhe të llogarisë dhe paguajë vetëm shpenzimet e zëvendësimit që lidhen drejtpërdrejt me instrumentin përkatës të pagesës, nëse këto shpenzime ekzistojnë dhe

7) të mundësojë kushte objektive, jodiskriminuese dhe proporcionale për lëshimin, zëvendësimin dhe përdorimin e instrumentit të pagesës.

(2) Ofruesi i shërbimeve të pagesave e bartë rrezikun gjatë dorëzimit të instrumentit të pagesës ose ndonjë karakteristike të sigurisë së përdoruesit lidhur me instrumentin e pagesës deri te përdoruesi i shërbimeve të pagesave.

Raportim për transaksionet e pagesave të paautorizuara ose të realizuara në mënyrë të parregullt dhe korrigjimi i tyre

Neni 87

(1) Nëse ofruesi i shërbimit të pagesave kryen transaksion të pagesës të paautorizuar ose në mënyrë të parregullt, përdoruesi i shërbimeve të pagesave ka të drejtën e korrigjimit duke parashtruar njoftim deri te ofruesi i shërbimeve të pagesave më së voni në afat prej 13 muajve nga data e debitimit.

(2) Me përjashtim të paragrafit (1) të këtij neni, nëse ofruesi i shërbimeve të pagesave nuk i ka dhënë ose nuk i ka vënë në dispozicion përdoruesit të shërbimeve të pagesave informacionet për kryerjen e transaksionit të pagesës të paautorizuar të kryer në mënyrë të parregullt në përputhje me Pjesën e tretë të këtij ligj, përdoruesi mund të parashtrojë njoftimin në çdo kohë.

(3) Nëse në kryerjen e transaksionit të pagesës është i përfshirë ofruesi i shërbimeve për iniciimin e pagesave, përdoruesi i shërbimeve të pagesave e dorëzon raportimin sipas paragrafit (1) të këtij neni deri te ofruesi i shërbimeve të pagesave i cili mban llogarinë e pagesave.

Argumentimi i autentifikimit dhe i ekzekutimit të transaksionit të pagesës

Neni 88

(1) Nëse përdoruesi i shërbimit të pagesave konteston se e ka autorizuar transaksionin e kryer të pagesës ose pretendon se transaksioni i pagesës nuk është kryer në mënyrë të rregullt, ofruesi i shërbimeve të pagesave është i detyruar të argumentojë që:

- është bërë autentifikimi i transaksionit të pagesës dhe
- transaksioni i pagesës është evidentuar me të drejtë dhe regjistruar siç duhet dhe mbi ekzekutimin e transaksionit të pagesës nuk ka ndikuar ndonjë parregullsi teknike ose lëshim tjetër i ofruesit të shërbimit të pagesave.

(2) Nëse transaksioni i pagesës është inicuar nëpërmjet ofruesit të shërbimeve për inicimin e pagesave, dhënësi i shërbimit për inicimin e pagesave është i detyruar në kuadër të shërbimit që e jep të argumentojë që :

- është bërë autentifikimi i transaksionit të pagesës dhe
- transaksioni i pagesës është regjistruar siç duhet dhe mbi ekzekutimin e transaksionit të pagesës nuk ka ndikuar ndonjë parregullsi teknike ose lëshim tjetër në lidhje me shërbimin e kryer të pagesës.

(3) Në rast se përdoruesi i shërbimit të pagesave konteston se ka autorizuar transaksionin e kryer të pagesës, regjistrimi i përdorimit të instrumentit të pagesës nga ofruesi i shërbimeve të pagesave, përfshirë aty ku është e përshtatshme edhe nga ofruesi i shërbimeve të pagesave, nuk është argument i mjaftueshëm që:

- transaksioni i pagesës ishte autorizuar nga paguesi,
- paguesi ka vepruar me qëllimin për të kryer mashtrim dhe/ose
- paguesi me qëllim ose nga pakujdesia e skajshme nuk ka përmbushur një ose më shumë nga detyrimet nga neni 85 i këtij ligji.

(4) Ofruesi i shërbimeve të pagesave, duke përfshirë ku është e përshtatshme edhe ofruesin e shërbimeve për inicimin e pagesave, janë të detyruar të sigurojnë dëshmi shtesë që e argumentojnë ekzistimin e mashtrimit ose të pakujdesisë së skajshme nga ana e përdoruesit të shërbimeve të pagesave sipas paragrafit (3) të këtij neni.

Përgjegjësia e ofruesit të shërbimit të pagesave për transaksione të pagesave të paautorizuara

Neni 89

(1) Në rast të transaksionit të paautorizuar të pagesës, ofruesi i shërbimeve të pagesave është i detyruar që vlerën e transaksionit të paautorizuar të pagesës t'ia kthejë paguesit, menjëherë pasi të mësojë për transaksionin ose pasi të ketë marrë njoftimin nga neni 87 paragrafi (1) të këtij ligji, kurse më së voni deri në fund të ditës së ardhshme të punës, përveç nëse ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit ka bazë të arsyeshme për të dyshuar për mashtrim dhe këtë bazë ta paraqes me shkrim deri te organet kompetente përkatëse.

(2) Ofruesi i shërbimeve të pagesave paguesit është i detyruar që në afatin sipas paragrafit (1) të këtij neni t'ia kthejë paguesit gjendjen e llogarisë së debitorit në të njëjtën gjendje që do të ishte sikur të mos ishte kryer transaksioni i paautorizuar i pagesës dhe pastaj data e miratimit të llogarisë së paguesit nuk mund të jetë më vonë se data në të cilën llogaria e paguesit është debituar për shumën e transaksionit.

(3) Ofruesi i shërbimeve të pagesave përgjegjës për transaksionin e paautorizuar të pagesës është i detyruar t'i kthejë vlerat e të gjitha kompensimeve të arkëtuara nga paguesi në lidhje me atë transaksion, përkatësisht të llogarisë dhe paguajë të gjithë interesin në të cilin paguesi do të kishte të drejtë nëse nuk ishte realizuar i transaksioni i paautorizuar i pagesës.

(4) Nëse transaksioni i pagesës është iniciuar nëpërmjet ofruesit të shërbimeve të pagesave për iniciimin e pagesave, ofruesi i shërbimeve të pagesave i cili e mban llogarinë e pagesës dhe e ka pranuar raportimin në përputhje me nenin 87 pika 3 të këtij neni, është i detyruar menjëherë, kurse më së voni deri në fundin e ditës tjetër të punës:

- ta kthejë vlerën e transaksionit të pagesës së paautorizuar dhe
- t'i kthejë gjendjen e debituar të llogarisë së pagesës paguesit në të njëjtën gjendje si do të ishte nëse nuk do të kryhej transaksioni i paautorizuar i pagesës.

(5) Dhënësi i shërbimeve për iniciimin e pagesave me kërkesë të ofruesit të shërbimeve të pagesave i cili mban llogarinë e pagesave është i detyruar:

- të kompensojë menjëherë humbjet e shkaktuara ose vlerat e paguara si rezultat i kthimit të mjeteve të paguesit, duke përfshirë edhe vlerën e transaksionit të pagesës së paautorizuar, nëse është përgjegjës për transaksionin e paautorizuar të pagesës, ose

- të dëshmojë në përputhje me nenin 88 paragrafi (2) të këtij ligji se në kuadër të shërbimit që ofron, është bërë autentifikimi i transaksionit të pagesës, transaksioni i pagesës është regjistruar saktë dhe ekzekutimi i transaksionit të pagesës nuk është ndikuar nga parregullsi teknike ose lëshim tjetër në lidhje me shërbimin e pagesës që ka kryer.

(6) Në rast të kryerjes së transaksionit të paautorizuar të pagesës, paguesi ka të drejtë në kompensim për dëmin e pësuar nga ofruesi përgjegjës i shërbimeve të pagesave në përputhje me Ligjin për Marrëdhëniet Obligative.

(7) Dispozitat e këtij neni i referohen edhe parave elektronike, përveç nëse ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit nuk ka mundësi ta fiksojë llogarinë e pagesës në të cilën mbahen paratë elektronike ose ta bllokojë instrumentin e pagesës.

Përgjegjësia e paguesit për transaksionet e pagesave të paautorizuara

Neni 90

(1) Me përjashtim të dispozitave të nenit 89 të këtij ligji, paguesi mund të jetë përgjegjës për kompensimin e humbjeve që rezultojnë nga transaksionet e kryera të paautorizuara të pagesës për shkak të humbjes ose vjedhjes së instrumentit të pagesës ose keqpërdorimit të instrumentit të pagesës deri në shumën maksimale prej 1.200 denarëve ose kundërvlerë përkatëse në valuta të tjera.

(2) Dispozitat sipas paragrafit (1) të këtij neni nuk zbatohen, nëse:

1) humbja, vjedhja ose keqpërdorimi i instrumentit të pagesës mund të mos jetë zbuluar nga paguesi përpara pagesës, përveç nëse vetë paguesi ka vepruar me qëllim për të mashtruar ose

2) humbja ka ndodhur për shkak të veprimeve ose mosveprimit të të punësuarit, agentit ose filialës së dhënësit të shërbimeve të pagesave ose personave të jashtëm të cilëve u është transferuar kryerja e funksioneve operative në lidhje me dhënien e shërbimeve të pagesave.

(3) Paguesi i bartë plotësisht humbjet nga transaksionet e pagesave të paautorizuara të kryera nëse transaksionet e pagesës kanë ndodhur për shkak të veprimit me qëllim të mashtrimit nga paguesi ose për shkak të mospërmbylljes, të qëllimshme ose të pakujdesisë së plotë të një ose më shumë detyrimeve të paguesit nga neni 85 i këtij ligji.

(4) Vlera maksimale sipas paragrafit (1) të këtij neni nuk zbatohet në rastet sipas paragrafit (3) të këtij neni.

(5) Nëse dhënësi i shërbimeve të pagesave të paguesit nuk bën autentifikim të përforcuar të klientit, paguesi nuk do të ketë humbje financiare, përfshirë vlerën sipas paragrafit (1) të këtij neni, përveç nëse paguesi ka vepruar me qëllim të mashtrimit.

(6) Nëse pranuesi ose ofruesi i tij i shërbimeve të pagesave nuk pranon autentifikim të përforcuar të klientit, ai është i detyruar të kompensojë dëmin financiar që i është shkaktuar dhënësit të shërbimit të pagesave paguesit.

(7) Paguesi nuk është përgjegjës për pasojat financiare që rrjedhin nga përdorimi i instrumentit të pagesës të humbur, të vjedhur ose të keqpërdorur pas dorëzimit të njoftimit në përputhje me nenin 85 paragrafi (1) pika 2 të këtij ligji, përveç nëse paguesi ka vepruar me qëllim për të mashtruar.

(8) Nëse ofruesi i shërbimeve të pagesave nuk ofron mjete adekuate për njoftim në çdo kohë për instrumentin e pagesës të humbur, të vjedhur ose të keqpërdorur në përputhje me nenin 86 paragrafi (1) pikat 3 dhe 4 të këtij ligji, paguesi nuk është përgjegjës për pasojat financiare të përdorimit të instrumentit të pagesës, përveç rasteve kur paguesi ka vepruar me qëllim për të mashtruar.

(9) Dispozitat e këtij neni i referohen edhe parave elektronike, përveç nëse ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit nuk ka mundësi ta ngrijë llogarinë e pagesës në të cilën mbahen paratë elektronike ose ta bllokojë instrumentin e pagesës.

Transaksionet e pagesave në të cilat vlera e transaksionit nuk dihet paraprakisht

Neni 91

(1) Në rast të transaksionit të pagesës të bazuar në kartelë të iniciuar nga ose nëpërmjet pranuesit, që në momentin kur paguesi jep pëlqimin për kryerjen e transaksionit të pagesës nuk dihet vlera e saktë e transaksionit, ofruesi i shërbimeve të pagesave mund të rezervojë mjete të parave në llogarinë e pagesës së paguesit vetëm nëse paguesi ka dhënë pëlqim për vlerën e saktë të mjeteve që duhet të rezervohen.

(2) Ofruesi i shërbimeve të pagesave paguesit është i detyruar t'ia lirojë mjetet financiare të rezervuara në llogarinë e pagesave të paguesit sipas paragrafit (1) të këtij neni pa shtyerje të panevojshme pas pranimit të informacionit për vlerën e saktë të transaksionit të pagesës ose menjëherë pas pranimit të urdhërpagesës.

Të drejtat specifike të paguesit gjatë debitimeve të drejtpërdrejta në të cilat konsumatori paraqitet si përdorues

Neni 92

(1) Gjatë kryerjes së debitimeve të drejtpërdrejta në të cilat së paku njëri nga përdoruesit e shërbimeve të pagesave është konsumator, pavarësisht nëse është pagues apo pranues, paguesi ka të drejtë t'i ofrojë ofruesit të tij të shërbimeve të pagesave këto udhëzime:

1) të kufizojë pagesën gjatë debitimeve të drejtpërdrejta në vlerë dhe / ose periudhë të caktuar kohore;

2) para se të debitojë llogarinë e pagesës së paguesit, të kryejë verifikimin e çdo debitimi direkt sipas informacioneve që përmban në mandat, të kontrollojë nëse vlera dhe periudha kohore e transaksionit të pagesës së debitimit direkt është në përputhje me mandatin, nëse mandati sipas skemës së pagesës për debitimin direkt nuk lejon të drejtën e kthimit të pakushtëzuar të mjeteve, ose

3) të bllokojë çdo debitim direkt nga llogaria e pagesave të paguesit ose të iniciuar nga një ose më shumë pranues të listuar saktë, ose të lejojë çdo debitim direkt e iniciuar nga një ose më shumë pranues të listuar saktë.

(2) Nëse marrëveshja kornizë për shërbimet e pagesave ka të bëjë me përdorimin e debitimit direkt, e njëjta duhet të përmbajë edhe të dhëna për të drejtat e paguesit sipas paragrafit (1) të këtij neni.

(3) Gjatë kryerjes së secilit transaksion të veçantë të pagesës së debitimit direkt, pranuesi është i detyruar që informacionet që përmban mandati t'ia dërgojë ofruesit të tij të shërbimeve të pagesave dhe ofruesi i shërbimit të pagesave të pranuesit është i detyruar t'ia përcjellë ofruesit të shërbimeve të pagesave të paguesit.

Kthimi i transaksioneve të pagesave të iniciuara nga ose nëpërmjet pranuesit

Neni 93

(1) Ofruesi i shërbimeve të pagesave të pagesit është i detyruar që me kërkesën e parashtruar të pagesit t'i kthejë mjetet e pagesit për transaksionin e kryer dhe të autorizuar të pagesës të iniciuar nga pranuesi ose nëpërmjet tij, por nëse plotësohen këto kushte:

1) gjatë autorizimit të transaksionit të pagesës nuk është shënuar vlera e saktë e transaksionit të pagesës dhe

2) vlera e transaksionit të pagesës e tejkalon vlerën që paguesi zakonisht e pret duke marrë parasysh vlerat e transaksioneve të mëparshme të pagesave, kushtet e marrëveshjes kornizë dhe rrethanat përkatëse në rastin konkret, përveç rasteve kur vlera e transaksionit të pagesës është tejkaluar për shkak të konvertimit të valutës me zbatimin e kursit devizor referent të dakorduar ndërmjet paguesit dhe ofruesit të shërbimeve të pagesave në përputhje me nenet 49 paragrafi (2) pika 4 dhe 56 paragrafi (1) pika 3) nënpika b) të këtij ligji.

(2) Paguesi është i detyruar që me kërkesë të dhënësit të shërbimeve të pagesave të vërtetojë përmbushjen e kushteve sipas paragrafit (1) të këtij neni.

(3) Vlera e mjeteve të kthyera sipas paragrafit (1) të këtij neni është e barabartë me vlerën e përgjithshme të transaksionit të pagesës së kryer, me ç'rast data e miratimit të llogarisë së pagesës së paguesit nuk duhet të jetë më vonë se data në të cilën është debituar vlera.

(4) Me përjashtim të paragrafit (1) të këtij neni, për debitimet direkte, paguesi i cili është konsumator ka të drejtë të kthimit të pakushtëzuar të mjeteve nga ofruesi i tij i shërbimeve të pagesave, nëse në afatin e caktuar parashtron kërkesë për kthimin në afatin sipas paragrafit (7) të këtij neni.

(5) Nëse në marrëveshjen kornizë ndërmjet paguesit jo konsumator dhe ofruesit të shërbimeve të pagesave të pagesit, e drejta e pakushtëzuar e paguesit për kthimin e mjeteve për debitime direkte nuk është e rregulluar pa kusht, ofruesi i shërbimit të pagesës të paguesit, para se të debitojë llogarinë e pagesës së paguesit është i detyruar të kryejë verifikimin e çdo debiti direkt sipas informacioneve që përmban mandati, për të kontrolluar harmonizimin e transaksionit të pagesës së debitimit direkt me vlerën dhe periudhën kohore të përcaktuar me mandatin.

(6) Paguesi dhe ofruesi i shërbimeve të pagesave mund të rregullojnë me marrëveshje kornizë se paguesi nuk ka të drejtë në kthimin të mjeteve në përputhje me paragrafin (1) të këtij neni, nëse:

1) paguesi i ka dhënë drejtpërdrejt pëlqimin për kryerjen e transaksionit të pagesës ofruesit të shërbimeve të pagesave dhe

2) ofruesi i shërbimit të pagesave ose pranuesi i ka dhënë ose ka vënë në dispozicion informacionet për transaksionin e ardhshëm të pagesës të paguesit në mënyrën e rënë dakord, të paktën 28 ditë përpara datës së fundit të dorëzimit.

(7) Paguesi e parashtron kërkesën për kthimin e mjeteve nga paragrafët (1) dhe (4) të këtij neni, në afat prej 56 ditësh nga data e debitimit të vlerës së mjeteve financiare.

(8) Ofruesi i shërbimeve të pagesave është i detyruar në afat prej dhjetë ditë pune nga pranimi i kërkesës për kthimin e mjeteve, ta kthejë të gjithë vlerën e transaksionit të pagesës ose ta refuzojë kërkesën me shpjegimin e arsyeve të refuzimit dhe sugjerim të mundësive për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe organeve të cilave paguesi mund t'u drejtohet në përputhje me nenet 129, 130 dhe 131 të këtij ligji nëse nuk është i kënaqur me arsyet e refuzimit.

(9) Me përjashtim të paragrafit (8) të këtij neni, kur kërkesa për kthimin e mjeteve është parashtruar në përputhje me paragrafin (4) të këtij neni, ofruesi i shërbimeve të pagesave nuk ka të drejtë ta refuzojë kërkesën dhe është detyruar në afat prej dhjetë ditë të punës nga marrja e kërkesës për kthim ta kthejë të gjithë vlerën e transaksionit të pagesës.

Kapitulli III

Ekzekutimi i transaksioneve të pagesës

Pranimi i urdhërpaguesës

Neni 94

(1) Koha e pranimi të urdhërpaguesës është momenti kur dhënësi i shërbimeve të pagesave të paguesit e ka pranuar urdhërpaguesën.

(2) Ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit e debiton llogarinë e pagesës së paguesit pas pranimi të urdhërpaguesës.

(3) Nëse koha e pranimi të urdhërpaguesës është në ditë jopune për ofruesin e shërbimeve të pagesave të paguesit, do të konsiderohet se urdhërpaguesa është pranuar në ditën e ardhshme të punës.

(4) Ofruesi i shërbimeve të pagesave mund të caktojë një moment nga fundi i ditës së punës si kohë përfundimtare pas të cilit urdhërpaguesat e pranuar konsiderohen se janë pranuar ditën e ardhshme të punës nga ofruesi i shërbimeve të pagesave.

(5) Përdoruesi i shërbimit të pagesave i cili inicion urdhërpaguesën dhe dhënësi i shërbimit të pagesave mund të bien dakord për ekzekutimin e urdhërpaguesës në një ditë të caktuar ose në fund të një periudhe të caktuar ose në ditën kur paguesi i vë në dispozicion ofruesit të shërbimeve të pagesave mjetet e nevojshme për ekzekutimin e urdhërpaguesës, me çka koha e pranimi të urdhërpaguesës konsiderohet si dita e dakorduar për ekzekutimin e urdhërpaguesës.

(6) Nëse dita e kontraktuar sipas paragrafit (5) të këtij neni është ditë jopune për ofruesin e shërbimeve të pagesave, konsiderohet se urdhërpaguesa është pranuar në ditën e ardhshme të punës.

Refuzimi i urdhërpaguesës

Neni 95

(1) Nëse ofruesi i shërbimeve të pagesave refuzon të ekzekutojë urdhërpaguesën ose të iniciojë transaksionin e pagesës, është i detyruar që ta njoftojë përdoruesin e shërbimeve të pagesave për refuzimin, arsyet e refuzimit dhe procedurën për korrigjimin e gabimeve që kanë rezultuar në refuzimin e urdhërpaguesës, përveç nëse dhënia e informacioneve është e ndaluar me ligj.

(2) Ofruesi i shërbimeve të pagesave është i detyruar që ta japë ose ta vë në dispozicion njoftimin sipas paragrafit (1) të këtij neni, në mënyrën e dakorduar me përdoruesin e shërbimeve të pagesave, menjëherë, ndërkaq më së voni në afatet e përcaktuara në nenin 99 të këtij ligji.

(3) Marrëveshja kornizë mund të përmbajë dispozitë me të cilën për refuzimin e urdhërpaguesës sipas paragrafit (1) të këtij neni, ofruesi i shërbimeve të pagesave mund të llogarisë dhe ta arkëtojë kompensimin në vlerë të arsyeshme nëse për refuzimin ekzistojnë arsye objektivist të justifikuar.

(4) Nëse janë plotësuar të gjitha kushtet e marrëveshjes kornizë të lidhur ndërmjet paguesit dhe ofruesit të shërbimeve të pagesave i cili mban llogarinë e pagesës së paguesit, i njëjti dhënësi i shërbimeve të pagesave është i detyruar që ta ekzekutojë urdhërpaguesën e autorizuar pa marrë parasysh nëse urdhërpaguesa është iniciuar nga paguesi, duke përfshirë nëpërmjet edhe dhënësit tjetër të shërbimit për iniciimin e pagesave ose është iniciuar nga ose nëpërmjet pranuesit, përveç në rast kur ekzekutimi i urdhërpaguesës është i ndaluar me ligj.

(5) Urdhërpaguesa ekzekutimi i të cilës është refuzuar konsiderohet se nuk është pranuar dhe në atë rast nuk zbatohen dispozitat e nenit 99 paragrafët (1), (2), (3), (4), (5), (6), (7), (8) dhe (9), 102 dhe 103 të këtij ligji.

Parevokueshmëria e urdhërpagesës

Neni 96

(1) Përdoruesi i shërbimeve të pagesave nuk mund ta revokojë urdhërpagesën pas pranimi të urdhëresës nga dhënësi i shërbimeve të pagesave të paguesit, përveç në rastet nga paragrafët (3), (4) dhe (5) të këtij neni.

(2) Nëse transaksioni i pagesës është iniciuar nga dhënësi i shërbimeve për iniciimin e pagesave ose nga ose nëpërmjet pranuesit, paguesi nuk mund ta revokojë urdhërpagesën pasi t'ia japë pëlqimin për iniciimin e transaksionit të pagesës dhënësit të shërbimeve për iniciimin e pagesave ose pasi të ketë dhënë pëlqimin për ekzekutimin e transaksionit të pagesës së pranuesit.

(3) Me përjashtim të dispozitave nga paragrafëve (1) dhe (2) të këtij neni, në rast të debitimit direkt dhe pa vënë në dyshim të drejtën e kthimit të mjeteve, paguesi mund ta revokojë urdhërpagesën më së voni deri në fund të ditës së punës që i paraprin ditës së kontraktuar për debitimin e mjeteve në para.

(4) Në rastin nga neni 94 paragrafët (5) dhe (6) të këtij ligji, përdoruesi i shërbimeve të pagesave mund ta revokojë urdhërpagesën më së voni deri në fundin e ditës së punës që i paraprin ditës së kontraktuar për ekzekutimin e urdhërpagesës.

(5) Pas skadimit të afateve nga paragrafët (1), (2), (3) dhe (4) të këtij neni, urdhërpagesa mund të revokohet vetëm nëse është rënë dakord ndërmjet përdoruesit të shërbimeve të pagesave dhe ofruesit e shërbimeve të pagesave.

(6) Në rastet nga paragrafët (2) dhe (3) të këtij neni, për revokimin e urdhërpagesës në përputhje me paragrafin (5) të këtij neni kërkohet pëlqimi nga pranuesi.

(7) Ofruesi i shërbimeve të pagesave mund të llogarisë dhe të paguajë kompensim për revokimin e urdhërpagesës, nëse llogaritja dhe pagimi i kompensimit është dakorduar dhe përcaktuar në marrëveshjen kornizë.

Vlera e transferuar dhe e pranuar

Neni 97

(1) Ofruesit e shërbimeve të pagesave të paguesit, ofruesit e shërbimeve të pagesave të pranuesit dhe të gjithë ofruesit ndërmjetësues të shërbimeve të pagesave, janë të detyruar që të gjithë vlerën e transaksionit të pagesës ta transferojnë, përkatësisht nuk guxojnë ta zvogëlojnë atë për kompensimet për shërbimet e tyre.

(2) Vlera e transferuar e transaksionit të pagesës duhet të jetë në lartësinë e vlerës së urdhërpagesës individuale.

(3) Me përjashtim të paragrafit (1) të këtij neni, pranuesi dhe ofruesi i shërbimeve të pagesave mund të dakordohen që ofruesi i shërbimeve të pagesave t'i paguajë kompensimet për shërbimet e tij nga shuma e transferuar e transaksionit të pagesës para se t'i miratojë mjetet e pranuesit.

(4) Në rastin sipas paragrafit (3) të këtij neni, ofruesi i shërbimeve të pagesave është i detyruar që në informacionet e dhëna të pranuesit për transaksionin e kryer të pagesës veçmas të paraqesë tërë vlerën e transaksionit të pagesës dhe vlerën e të gjitha kompensimeve të llogaritura dhe të arkëtuara.

(5) Nëse nga vlera e transferuar e transaksionit të pagesës arkëtohen edhe kompensime tjera përveç kompensimeve sipas paragrafit (3) të këtij neni, ofruesi i shërbimeve të pagesave është i detyruar të sigurojë që pranuesi ta marrë vlerën e plotë të transaksionit të pagesës së iniciuar nga paguesi, të zvogëluar për kompensimet e kontraktuara në përputhje me paragrafin (3) të këtij neni.

(6) Në rast se transaksioni i pagesës është iniciuar nga ose nëpërmjet pranuesit dhe nga vlera e transferuar e transaksionit të pagesës arkëtohen edhe kompensime tjera përveç kompensimeve sipas paragrafit (3) të këtij neni, ofruesi i shërbimeve të pagesave të pranuesit është i detyruar që të sigurojë që pranuesi të marrë vlerën e plotë të transaksionit të pagesës të iniciuar nga ose nëpërmjet pranuesit të zvogëluar për kompensimet e dakorduara në përputhje me paragrafin (3) të këtij neni.

Kompensim shumëpalësh i zëvendësimit ndërmjet ofruesve të shërbimeve të pagesave në transaksionet e pagesave për debitim direkt në denarë

Neni 98

(1) Ofruesit e shërbimeve të pagesave nuk mund të llogarisin dhe arkëtojnë kompensim shumëpalësh të zëvendësimit për disa transaksione të pagesave nga ofruesit e tjerë të shërbimeve të pagesave që marrin pjesë në skemën e pagesave për debitimet direkte në denarë, as kompensime të ngjashme që kanë të njëjtin qëllim ose efekt si kompensimi shumëpalësh i zëvendësimit, përveç transaksioneve-R në kushtet e përcaktuara në paragrafin (2) të këtij neni.

(2) Për Transaksionet-R të debitimit direkt në denarë mund të llogaritet dhe të paguhet kompensim shumëpalësh i zëvendësimit në bazë të marrëveshjes së lidhur ndërmjet ofruesve të shërbimeve të pagesave për vendosjen e skemës së pagesës për debitimet direkte, nëse plotësohen këto kushte:

1) marrëveshja siguron:

- shpërndarje efikase e shpenzimeve ndërmjet ofruesve të shërbimeve të pagesave ose përdoruesve të shërbimeve të pagesave, në varësi të asaj se cili prej tyre shkaktoi transaksionin-R dhe duke marrë parasysh ekzistencën e shpenzimet e transaksionit,

- kompensimi nuk arkëtohet automatikisht dhe

- ndalesë për ofruesit të shërbimeve të pagesave për të arkëtuar kompensime nga përdoruesit e shërbimeve të pagesave për transaksionin-R që janë më të larta se shpenzimet që i heq ofruesi i shërbimeve të pagesave për transaksionin-R përkatës;

2) kompensimi shumëpalësh i zëvendësimit të bazohet vetëm në shpenzimet e bëra nga ofruesi i shërbimeve të pagesave;

3) vlera e kompensimit nuk i tejkalon shpenzimet reale të bëra për veprim ndaj transaksioneve-R nga ofruesi më efikas i shërbimeve të pagesave, i cili sipas numrit të transaksioneve të pagesave dhe natyrës së shërbimeve është më përfaqësuesi në skemën e pagesave për debitime direkte;

4) zbatimi i kompensimit shumëpalësh i zëvendësimit nuk i jep të drejtë ofruesit të shërbimeve të pagesave të llogarisë dhe të arkëtojë nga përdoruesit e tij të shërbimeve të pagesave kompensime shtesë për shpenzimet e mbuluara nga kompensimi shumëpalësh i zëvendësimit dhe

5) nuk ka alternativë të zbatueshme dhe ekonomikisht të qëndrueshme ndaj skemës së pagesës së debitimeve të drejtpërdrejta e cila do të mundësonte veprimin ndaj transaksioneve-R me efikasitet të njëjtë ose më të lartë, me shpenzime të njëjta ose më të ulëta për përdoruesit e shërbimeve të pagesave.

(3) Në përlllogaritjen e vlerës së kompensimit shumëpalësh të zëvendësimit për Transaksionet-R në përputhje me nenin (2) të këtij neni, ofruesit e shërbimeve të pagesave duhet të marrin parasysh vetëm ato lloje të shpenzimeve që lidhen drejtpërdrejt dhe pamëdyshje me veprimin ndaj transaksioneve-R dhe të cilat mund të përcaktohen me saktësi. Për kontroll dhe monitorim më të lehtë, vlera e shpenzimeve, në përgjithësi dhe sipas zërave individualë, duhet të rregullohen në marrëveshjen sipas paragrafit (2) të këtij neni.

(4) Dispozitat e këtij neni zbatohen në mënyrë të përshtatshme edhe në marrëveshjet bilaterale ndërmjet ofruesve të shërbimeve të pagesave, si dhe për rregullat e përcaktuara në mënyrë të njëanshme për debitime direkte në denarë të ofruesit të shërbimeve të pagesave, të cilat kanë të njëjtin qëllim ose efekt si ato të marrëveshjes shumëpalëshe.

Afati i ekzekutimit të transaksioneve të pagesave

Neni 99

(1) Gjatë ekzekutimit të transaksioneve të pagesave në denarë dhe euro në Republikën e Maqedonisë së Veriut, ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit është i detyruar të sigurojë që vlera e transaksionit të pagesës të miratohet në llogarinë e ofruesit të shërbimeve të pagesave të pranuesit në të njëjtën ditë pune kur është pranuar urdhërpagesa në përputhje me nenin 94 të këtij ligji.

(2) Gjatë ekzekutimit të transaksioneve të pagesave në valutë të ndryshme nga denarë dhe euro në Republikën e Maqedonisë së Veriut, ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit është i detyruar të sigurojë që vlera e transaksionit të pagesës të aprovohet në llogarinë e ofruesit të shërbimeve të pagesave të pranuesit më së voni deri në fundin e ditës së dytë të punës pas ditës kur është pranuar urdhërpagesa në përputhje me nenin 94 të këtij ligji.

(3) Gjatë ekzekutimit të transaksioneve të pagesave ndërkufitare, ofruesi i shërbimeve të pagesave është i detyruar që urdhërpagesën e iniciuar nga paguesi t'ia dorëzojë ofruesit të shërbimeve të pagesave jashtë vendit me datën e valutës më së voni në ditën e tretë të punës pas ditës së pranimi të urdhërpagesës në përputhje me nenin 94 të këtij ligji, përveç nëse është marrë vesh ndryshe me paguesin.

(4) Për transaksionet e pagesave ndërkufitare në euro në Zonën Ekonomike Europiane, ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit është i detyruar të sigurojë që vlera e transaksionit të pagesës të aprovohet në llogarinë e ofruesit të shërbimeve të pagesave të pranuesit më së voni deri në fundin e ditës së ardhshme të punës pas pranimi të urdhërpagesës në përputhje me nenin 94 të këtij ligji.

(5) Afati sipas paragrafit (4) të këtij neni mund të vazhdohet për edhe një ditë tjetër pune për transaksionet e pagesave ndërkufitare në euro në Zonën Ekonomike Europiane të cilat iniciohen në letër.

(6) Afatet për ekzekutimin e transaksioneve të pagesave ndërkufitare të përcaktuara në paragrafin (4) dhe paragrafin (5) të këtij neni zbatohen në mënyrë të përshtatshme edhe në transaksionet e tjera të pagesave ndërkufitare, përveç nëse përdoruesi i shërbimeve të pagesave dhe ofruesi i shërbimeve të pagesave dakordohen për zbatimin e afatit më të gjatë për ekzekutimin e transaksioneve të pagesave.

(7) Nëse për ekzekutimin e transaksioneve të pagesave ndërkufitare në Zonën Ekonomike Europiane në valuta të tjera të vendeve të Zonës Ekonomike Europiane të ndryshme nga euro, është dakorduar afat më i gjatë se afati i përcaktuar në paragrafin (6) të këtij neni,

i njëjti nuk mund të kalojë katër ditë pune nga koha e pranimi të urdhërpagesës në përputhje me nenin 94 të këtij ligji.

(8) Ofruesi i shërbimeve të pagesave të pranuesit, pas pranimi të mjeteve është i detyruar që vlerën e transaksionit të pagesës ta vë në dispozicion në llogarinë e pagesës së pranuesit, në datën e valutës së përcaktuar në përputhje me nenin 100 të këtij ligji.

(9) Ofruesi i shërbimeve të pagesave të pranuesit është i detyruar që urdhërpagesën e iniciuar nga pranuesi ose nëpërmjet pranuesit t'ia transferojë ofruesit të shërbimeve të pagesave të paguesit, në afatin e dakorduar ndërmjet pranuesit dhe ofruesit të tij të shërbimeve të pagesave, dhe në rast të debitimit direkt në afatin që lejon shlyerjen e detyrimeve të paguesit në datën e dakorduar të dorëzimit.

(10) Në rast kur konsumatori në llogarinë e pagesave me ofruesin e shërbimeve të pagesave fut para të gatshme në valutën e llogarisë së pagesës, ofruesi i shërbimit të pagesave është i detyruar që vlerën e mjeteve financiare ta vë në dispozicion në të njëjtën ditë dhe me të njëjtën datë të valutës, menjëherë pas pranimit të parave të gatshme.

(11) Kur përdoruesi i shërbimeve të pagesave i cili nuk është konsumator, në llogarinë e pagesave të ofruesit i shërbimeve të pagesave fut para në valutë të llogarisë së pagesës, ofruesi i shërbimit të pagesave është i detyruar që vlerën e mjeteve ta vë në dispozicion dhe me datën valutës, më së voni në ditën tjetër të punës pas ditës së pranimit të parave të gatshme.

(12) Kur transaksioni i pagesës nuk përfshin përdorimin e llogarisë së pagesës nga pranuesi, ofruesi i shërbimeve të pagesave që merr mjetet në emër të pranuesit është i detyruar t'ia vë në dispozicion mjetet pranuesit, në afatin e përcaktuar në përputhje me nenin 100 paragrafi (2) të këtij ligji.

(13) Afatet nga ky nen nuk zbatohen nëse veprohet në përputhje me rregullat për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Data e valutës dhe disponueshmëria e mjeteve financiare

Neni 100

(1) Data e valutës së llogarisë së pagesave të pranuesit nuk duhet të jetë më vonë se dita e punës në të cilën është aprovuar vlera e transaksionit të pagesës në llogarinë e ofruesit të shërbimeve të pagesave të pranuesit.

(2) Ofruesi i shërbimeve të pagesave të pranuesit është i detyruar që vlerën e transaksionit të pagesës t'ia vërë në dispozicion pranuesit menjëherë pasi të jetë aprovuar vlera në llogarinë e ofruesit të shërbimeve të pagesave të pranuesit, në rastet kur ofruesi i shërbimeve të pagesave të pranuesit:

1) nuk kryen konvertim të valutës, ose

2) kryen konvertimin e valutës së vlerës financiare në euro ose në valuta të tjera të vendeve të Zonës Ekonomike Europiane, në kundërvlerë përkatëse me denarë.

(3) Dispozita sipas paragrafit (2) të këtij neni zbatohen edhe në rastin e transaksioneve të pagesave që ekzekutohen nga ofruesi i shërbimeve të pagesave.

(4) Data e valutës së debitimit në llogarinë e pagesës së paguesit nuk duhet të jetë para datës kur llogaria e pagesës së paguesit është debituar për vlerën e transaksionit të pagesës.

(5) Këshilli i Bankës Popullore me aktin nënligjor nga neni 42 paragrafi (9) i këtij ligji më hollësisht i përcakton kushtet për vënien në dispozicion të mjeteve financiare për pranuesin.

Shenja e vetme identifikuese e gabuar

Neni 101

(1) Nëse urdhërpagesa ekzekutohet me shenjë të vetme identifikuese, konsiderohet se urdhërpagesa është ekzekutuar në mënyrë korrekte në raport me pranuesin e përcaktuar me shenjën e vetme identifikuese.

(2) Nëse përdoruesi i shërbimit të pagesës ka dorëzuar shenjën të vetme identifikuese të ofruesit i shërbimeve të pagesave, ofruesi i shërbimeve të pagesave nuk ka përgjegjësi për mosekzekutimin ose ekzekutimin jo të drejtë të transaksionit të pagesës në përputhje me nenin 102 të këtij ligji.

(3) Nëse përdoruesi i shërbimeve të pagesave, përveç informacioneve nga neni 49 paragrafi (2) pika 1 ose neni 56 paragrafi (1) pika 2 nënpika b) të këtij ligji, i dorëzon ofruesit të shërbimeve të pagesave edhe informacione tjera, ofruesi i shërbimeve të pagesave është përgjegjës vetëm për ekzekutimin e transaksioneve të pagesave sipas shenjës së vetme identifikuese të cilën e ka dhënë përdoruesi i shërbimeve të pagesave.

(4) Ofruesi i shërbimeve të pagesave bën përpjekje të arsyeshme për t'i kthyer mjetet financiare nga transaksioni i pagesës me shenjën e vetme identifikuese të vendosur gabimisht.

(5) Ofruesi i shërbimeve të pagesave të pranuesit është i detyruar që të bashkëpunojë me ofruesin e shërbimeve të pagesave të paguesit sipas paragrafit (4) të këtij neni dhe t'i transmetojë të gjitha informatat relevante për nevojat e kthimit të mjeteve financiare.

(6) Ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit është i detyruar, në rast se kthimi i mjeteve financiare në transaksionin e pagesës me shenjën e vetme identifikuese të vendosur gabimisht, nuk është i mundur, me kërkesë me shkrim të paguesit, t'i dorëzojë me shkrim të gjitha informacionet të cilat i disponon dhe të cilat janë relevante për ngritjen e procedurës para gjykatës kompetente.

(7) Ofruesi i shërbimeve të pagesave mund të llogarisë dhe të arkëtojë kompensim për kthimin e mjeteve financiare në transaksionin e pagesës me shenjën e vetme identifikuese të vendosur gabimisht, nëse kompensimi i tillë është dakorduar me marrëveshjen kornizë.

Përgjegjësia e ofruesit të shërbimit të pagesave për mosekzekutim, ekzekutim të parregullt ose ekzekutim me vonesë të transaksioneve të pagesave të iniciuara nga paguesi

Neni 102

(1) Në rast kur urdhërpagesa është iniciuar drejtpërdrejt nga paguesi, ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit, pa qenë në kundërshtim me nenet 87, 101 paragrafët (2), (4), (5) dhe (6) dhe 107 të këtij ligji, është përgjegjës ndaj paguesit për ekzekutimin e drejtë të transaksionit të pagesës.

(2) Me përjashtim të paragrafit (1) të këtij neni, ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit nuk është përgjegjës nëse i vërteton paguesit, ndërkaq sipas nevojës edhe ofruesit të shërbimeve të pagesave të pranuesit, se vlera e transaksionit të pagesës është pranuar nga ofruesi i shërbimeve të pagesave të pranuesit në përputhje me nenin 99 paragrafët (1), (2), (4), (5), (6) dhe (7) të këtij ligji.

(3) Në rastin sipas paragrafit (2) të këtij neni, ofruesi i shërbimeve të pagesave të pranuesit është përgjegjës ndaj pranuesit për kryerjen e duhur të transaksionit të pagesës.

(4) Në rast kur ofruesi i shërbimeve të pagesave të pranuesit është përgjegjës në përputhje me paragrafin (1) të këtij neni është i detyruar që menjëherë t'ia kthejë vlerën e transaksionit të pagesës të pa ekzekutuar ose të ekzekutuar në mënyrë të parregullt.

(5) Nëse në rastin sipas paragrafit (4) të këtij neni, llogaria e paguesit debitohet, ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit është i detyruar që llogarinë e debituar të pagesës ta kthejë në gjendjen në të cilën do të ishte llogaria nëse transaksioni i pagesës i parregullt nuk ishte ekzekutuar dhe me datën e valutës në të cilën është debituar vlera nga llogaria e pagesës.

(6) Kur ofruesi i shërbimeve të pagesave të pranuesit është përgjegjës për ekzekutimin e duhur të transaksionit të pagesës në përputhje me paragrafin (3) të këtij neni, është i detyruar që vlerën e transaksionit të pagesës t'ia vë në dispozicion menjëherë pranuesit dhe, nëse është e zbatueshme, ta aprovojë vlerën e transaksionit në llogarinë e pagesave të pranuesit me datën e valutës në të cilën vlera do të aprovohej në përputhje me nenin 100 të këtij ligji.

(7) Nëse transaksioni i pagesës ekzekutohet me vonesë, ofruesi i shërbimeve të pagesave të pranuesit, me kërkesë të ofruesit të shërbimeve të pagesave të paguesit i cili vepron në emër të paguesit, është i detyruar të sigurojë që data e valutës të jetë data në të cilën do të ekzekutohej transaksioni i pagesës.

(8) Në rast të mosekzekutimit ose ekzekutimit jo të drejtë të transaksionit të pagesës në të cilin urdhërpagesa është iniciuar nga paguesi, ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit, pavarësisht nga përgjegjësia e tij në përputhje me këtë nen, është i detyruar që me kërkesë të

paguesit, menjëherë të ndërmarrë masat për ndjekjen e rrjedhës së transaksionit të pagesës dhe për rezultatin ta njoftojë paguesin, pa llogaritur dhe arkëtuar kompensime për masat e ndërmarra dhe për njoftimin.

(9) Ofruesi i shërbimeve të pagesave i cili është përgjegjës për transaksionin e pagesës të pa ekzekutuar ose të ekzekutuar në mënyrë jo të drejtë ose për ekzekutimin e vonuar të transaksionit të pagesës të iniciuar nga paguesi, është i detyruar t'ia kthejë përdoruesit të shërbimeve të tij të pagesave vlerën e të gjitha kompensimeve të llogaritura dhe/ose të arkëtuara, si dhe të bëjë kthimin, përkatësisht të paguajë të gjithë interesin që i takon përdoruesit në lidhje me transaksionin e pagesës të pa ekzekutuar ose të ekzekutuar në mënyrë jo të drejtë ose për shkak të ekzekutimit me vonesë të transaksionit të pagesës.

Përgjegjësia e ofruesit të shërbimit të pagesave për mosekzekutim, ekzekutim të parregullt ose ekzekutim të vonuar të transaksioneve të pagesave të iniciuara nga ose nëpërmjet pranuesit

Neni 103

(1) Në rast kur urdhërpagesa është iniciuar nga pranuesi ose nëpërmjet tij, ofruesi i shërbimeve të pagesave të pranuesit, pa qenë në kundërshtim me nenet 87, 101 paragrafët (2), (4), (5) dhe (6) dhe 107 të këtij ligji, është përgjegjës ndaj pranuesit për bartjen e duhur të urdhërpagesës të ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit në përputhje me nenin 99 paragrafi (9) të këtij ligji. Nëse urdhërpagesa nuk është bartur siç duhet, ofruesi i shërbimeve të pagesave të pranuesit është i detyruar ta bartë atë menjëherë të ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit.

(2) Në rast të bartjes së vonuar të urdhërpagesës, ofruesi i shërbimeve të pagesave të pranuesit është i detyruar të miratojë llogarinë e pagesës së pranuesit në datën e valutës në të cilën është dashur të aprovohet vlera nëse është ekzekutuar transaksioni në kohë.

(3) Ofruesi i shërbimeve të pagesave të pranuesit, pa qenë në kundërshtim me nenet 87, 101 paragrafët (2), (4), (5) dhe (6) dhe 107 të këtij ligji, është përgjegjës ndaj pranuesit për ekzekutimin e transaksionit të pagesës në përputhje me nenin 100 të këtij ligji dhe është i detyruar t'ia vë në dispozicion pranuesit vlerën e transaksionit të pagesës menjëherë pasi të jetë aprovuar në llogarinë e ofruesit të shërbimeve të pagesave të pranuesit me datën e valutës në të cilën do të aprovohej vlera nëse transaksioni do të ishte ekzekutuar siç duhet.

(4) Në rast të transaksioni të pagesës së pa ekzekutuar ose të ekzekutuar në mënyrë të parregullt për të cilin ofruesi i shërbimeve të pagesave të pranuesit nuk është përgjegjës në përputhje me paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit është përgjegjës ndaj paguesit dhe, aty ku është e zbatueshme, është i detyruar që menjëherë dhe pa vonesë t'i kthejë paguesit vlerën e transaksionit të pagesës të pa ekzekutuar ose të ekzekutuar në mënyrë të parregullt. Nëse llogaria e pagesës së paguesit debitohet, ofruesi i shërbimit të pagesave të paguesit është i detyruar të kthejë gjendjen e llogarisë së debituar të pagesës në gjendjen në të cilën do të ishte llogaria nëse transaksioni i pagesës së parregullt nuk do të ishte kryer dhe me datën e valutës në të cilën është debituar vlera nga llogaria e pagesës.

(5) Ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit nuk është përgjegjës në përputhje me paragrafin (4) të këtij neni nëse vërteton se ofruesi i shërbimeve të pagesave të pranuesit e ka pranuar vlerën e transaksionit të pagesës edhe në rast se ka vonesë në ekzekutimin e transaksionit të pagesës, ndërkaq ofruesi i shërbimeve të pagesave të pranuesit është i detyruar ta miratojë vlerën në llogarinë e pagesës së pranuesit me datën e valutës në të cilën vlera duhet të ishte aprovuar nëse transaksioni është kryer në mënyrë të rregullt.

(6) Në rast të transaksionit të pagesës së pa ekzekutuar ose të ekzekutuar në mënyrë të parregullt, në të cilin urdhërpagesa është iniciuar nga ose nëpërmjet pranuesit, ofruesi i shërbimeve të pagesave të pranuesit, pavarësisht nga përgjegjësia e tij në përputhje me këtë nen, është i detyruar që me kërkesë të dorëzuar të pranuesit menjëherë të ndërmarrë masa për ndjekjen e rrjedhës së transaksionit të pagesës dhe ta njoftojë pranuesin për rezultatin pa llogaritur dhe arkëtuar kompensimet për masat e ndërmarra dhe për njoftimin.

(7) Ofruesi i shërbimit të pagesave i cili është përgjegjës për transaksionin e pagesës së pa ekzekutuar ose të ekzekutuar në mënyrë të parregullt ose për ekzekutimin e vonuar të transaksionit të pagesës së iniciuar nga ose nëpërmjet pranuesit, është i detyruar t'i kthejë përdoruesit të tij të shërbimeve të pagesave vlerën e të gjitha kompensimeve të llogaritura dhe/ose arkëtuara, si dhe t'ia kthejë, përkatësisht t'ia paguajë të gjithë interesin për të cilin përdoruesi ka të drejtë në lidhje me transaksionin e pagesës së pa ekzekutuar ose të ekzekutuar në mënyrë parregullt ose për shkak të ekzekutimit me vonesë të transaksionit të pagesës.

Përgjegjësia gjatë kryerjes së shërbimeve për iniciimin e pagesave për mosekzekutim, ekzekutim të parregullt ose ekzekutim të vonuar të transaksioneve të pagesave

Neni 104

(1) Nëse paguesi e ka iniciuar urdhërpagesën nëpërmjet ofruesit të shërbimeve për iniciimin e pagesave, ofruesi i shërbimeve të pagesave i cili mban llogarinë e pagesës, pa qenë në kundërshtim me dispozitat e nenëve 87 dhe 101 paragrafët (2), (4), (5) dhe (6) të këtij ligji, është i detyruar t'i kthejë paguesit vlerën e transaksionit të pagesës të pa ekzekutuar ose të ekzekutuar në mënyrë të parregullt dhe, nëse llogaria e pagesës është e debituar, ta kthejë atë në gjendjen në të cilën do të ishte llogaria e pagesës nëse nuk ishte ekzekutuar transaksioni i parregullt i pagesës.

(2) Ofruesi i shërbimeve të pagesave është i detyruar të dëshmojë se urdhërpagesa është pranuar nga ofruesi i shërbimeve të pagesave i cili mban llogarinë e pagesave në përputhje me nenin 94 të këtij ligji dhe se në kuadër të kompetencave të tij lidhur me transaksionin e pagesës, është bërë autentifikimi i transaksionit të pagesës, transaksioni i pagesës është regjistruar me saktësi dhe ekzekutimi i transaksionit të pagesës nuk është ndikuar nga ndonjë parregullsi teknike ose lëshim tjetër që ka shkaktuar mosekzekutim, ekzekutim të parregullt ose vonesë në ekzekutimin e transaksionit të pagesës.

(3) Nëse ofruesi i shërbimeve për iniciimin e pagesave është përgjegjës për mosekzekutimin, ekzekutimin e parregullt ose ekzekutimin e vonuar të transaksionit të pagesës, me kërkesë të ofruesit të shërbimeve të pagesave që mban llogarinë e pagesës, është i detyruar t'i kompensojë ato menjëherë dhe pa vonesë të panevojshme humbjet e shkaktuara ose vlerat e paguara që rrjedhin nga kthimi i realizuar i mjeteve të paguesit.

E drejta e kërkesës shtesë për kompensim të demit

Neni 105

Përdoruesi i shërbimeve të pagesave, përveç të drejtave nga nenet 101, 102, 103, 104 dhe 106 të këtij ligji, ka të drejtë të kërkojë kompensim nga ofruesi përgjegjës i shërbimeve të pagesave në përputhje me Ligjin e Marrëdhënieve Detyrimore.

E drejta e regresit

Neni 106

(1) Ofruesi i shërbimeve të pagesave ka përgjegjësi ndaj përdoruesit të tij të shërbimeve të pagesave për ekzekutimin e transaksionit të pagesës në përputhje me nenet 89, 102 dhe 103 të këtij ligji dhe në rast kur përgjegjësia është mbi një ofrues ose ndërmjetësues tjetër të shërbimeve të pagesave.

(2) Në rastin sipas paragrafit (1) të këtij neni, ofruesi i shërbimeve të pagesave ka të drejtë të kërkojë nga ofruesi përgjegjës i shërbimeve të pagesave ose ndërmjetësuesi që t'i kompensojë të gjitha shpenzimet, duke përfshirë vlerat e paguara të përdoruesit të tij të shërbimeve të pagesave në përputhje me nenet. 89, 102 dhe 103 të këtij ligji, duke përfshirë shpenzimet dhe vlerat e paguara që kanë ndodhur për shkak se ofruesi përgjegjës i shërbimit të pagesave nuk ka përdorur autentifikim të përforcuar të klientit.

(3) Në marrëveshjet e lidhura ndërmjet ofruesve të shërbimeve të pagesave ose ndërmjet ofruesit të shërbimeve të pagesave dhe ndërmjetësuesit, mund të dakordohet e drejta për kompensim për dëmin e pësuar në përputhje me ligj.

Rrethana të jashtëzakonshme dhe të paparashikuara

Neni 107

Përgjegjësia në lidhje me autorizimin dhe ekzekutimin e transaksioneve të pagesave të përcaktuara në dispozitat e kapitujve II dhe III Pjesa e katërt e këtij ligji përjashtohet në rast:

1) të rrethanave të jashtëzakonshme dhe të paparashikuara, në të cilat pala që thirret në rrethanat nuk mund të ndikojë në to dhe janë jashtë kontrollit të saj dhe pasojat e rrethanave janë të pashmangshme pavarësisht nga përpjekjet e bëra për t'i shmangur ose

2) kur ofruesi i shërbimeve të pagesave është i detyruar të veprojë në përputhje me detyrimet e tjera ligjore që dalin nga ligji.

Kapitulli IV

Zbatimi i shërbimit të bartjes

Zbatimi i dispozitave

Neni 108

(1) Dispozitat nga Pjesa e katërt Kapitulli IV i këtij ligji zbatohen për ofruesit e shërbimeve të pagesave nga neni 9 paragrafi (1) pikat 1, 2, 3, 4 dhe 5 të këtij ligji.

(2) Ofruesi i shërbimeve të pagesave është i detyruar që konsumatorit me të cilin ka lidhur marrëveshje kornizë dhe ka hapur llogari pagese, t'i mundësojë përdorimin e shërbimit për bartje të llogarive të pagesave në të njëjtën valutë në të cilën janë, te ofruesi tjetër i shërbimeve të pagesave i cili ka leje për ofrimin e shërbimeve të pagesave të lëshuar nga guvernatori.

(3) Shërbimi i bartjes nuk i referohet:

1) llogarive joaktive të pagesave për derisa nuk iu ndërpritet statusi i llogarisë joaktive në përputhje me nenin 188 paragrafi (3) të këtij ligji;

2) llogarive të bllokuara të pagesave deri në heqjen e bllokadës në përputhje me ligjin;

3) llogarive të pagesave të hapura me përdorim të kufizuar të mjeteve financiare për qëllime të veçanta të përcaktuara për sa kohë që ekziston një kufizim i tillë;

4) llogarive të pagesave në të cilat mbahen paratë elektronike;

5) llogarive të lidhura me kartela kreditore të lëshuara në të cilat pagesa e mjeteve financiare bëhet vetëm për shlyerjen e borxhit në bazë të kartelës së lëshuar kreditore;

6) llogarive të pagesave për të cilat është përcaktuar detyrimi i ofruesit të shërbimeve të pagesave t'i hapë dhe t'i mbajë me aktgjykim të plotfuqishëm.

(4) Ofruesit të shërbimeve të pagesave që nuk guxon të kushtëzojë zbatimin e shërbimit të bartjes me përdorimin e produkteve dhe/ose shërbimeve tjera të konsumatorit.

Informacione për konsumatorët në lidhje me shërbimin e bartjes

Neni 109

(1) Ofruesi i shërbimeve të pagesave është i detyruar t'ia vë në dispozicion konsumatorit, në letër ose në një mjet tjetër të përhershëm, informacionet për:

1) detyrimet e ofruesit të shërbimeve të pagesave që pranon bartjen e llogarisë së pagesës dhe detyrimet e ofruesit të shërbimeve të pagesave që kryen bartjen e llogarisë së pagesës në secilën fazë individuale të procedurës së bartjes së pagesës në përputhje me nenin 111 të këtij ligji;

2) afatin kohor për përfundimin e secilës fazë individuale në procedurën e bartjes së llogarisë së pagesës;

3) llojin dhe vlerën e kompensimeve nëse llogariten dhe arkëtohen në lidhje me shërbimin e bartjes;

4) informacionet që është e nevojshme t'i dorëzojë konsumatori për shkak të zbatimit të shërbimit të bartjes;

5) të drejtat e konsumatorit në pikëpamje të:

a) parashtrimit të kundërshtimit deri te ofruesi i shërbimeve të pagesave në përputhje me nenin 129 të këtij ligji,

b) parashtrimit të ankesës deri te organi kompetent në përputhje me nenin 130 të këtij ligji dhe

c) procedurës jashtëgjyqësore për zgjidhjen e kontesteve në përputhje me nenin 131 të këtij ligji dhe

6) informacionet për pjesëmarrjen e ofruesit të shërbimeve të pagesave në sistemin e sigurimit të detyrueshëm të depozitave ose për anëtarësim në sistem të sigurimit vullnetar, duke përfshirë mbulimin që sigurohet nga këto sisteme.

(2) Informacionet sipas paragrafit (1) të këtij neni duhet të jenë të disponueshme dhe të përditësuara nga ofruesi i shërbimeve të pagesave:

1) në formë elektronike, në çdo kohë, në faqet e tij të internetit, nëse ofruesi i shërbimit të pagesave ka faqen e tij të internetit dhe

2) në hapësirat e tij të punës ku konsumatorët kanë qasje për qëllimet e përdorimit të shërbimeve të pagesave.

(3) Ofruesi i shërbimeve të pagesave është i detyruar që me kërkesë të konsumatorit pa kompensim t'ia japë informacionet sipas paragrafit (1) të këtij neni, në letër ose në medium tjetër të përhershëm.

Autorizim për bartjen e llogarisë së pagesës

Neni 110

(1) Ofruesi i shërbimeve të pagesave i cili pranon bartjen e llogarisë së pagesës e fillon me zbatimin e shërbimit të bartjes, vetëm nëse konsumatori në emër të të cilit mbahet llogaria e pagesës ka dhënë autorizim të qartë për bartjen e llogarisë së pagesës.

(2) Ofruesi i shërbimeve të pagesave i cili pranon bartjen e llogarisë së pagesës është i detyruar që një kopje të autorizimit të dhënë për bartjen e llogarisë së pagesës sipas paragrafit (1) të këtij neni t'ia japë konsumatorit në emër të të cilit mbahet llogaria e pagesës.

3) Autorizimi për bartjen e llogarisë së pagesës sipas paragrafit (1) të këtij neni përmban pëlqimin e konsumatorit ndaj ofruesit të shërbimeve të pagesave që e pranon bartjen e llogarisë së pagesës për zbatimin e secilit nga aktivitetet nga neni 111 paragrafët (4) dhe/ose (5) të këtij ligji të cilat i ka zgjedhur konsumatori dhe pëlqimi i konsumatorit ndaj ofruesit të shërbimeve të pagesave që e kryen bartjen e llogarisë së pagesës t'i zbatojë aktivitetet nga neni 111 paragrafi (1) të këtij ligji të cilat i ka zgjedhur konsumatori.

(4) Konsumatori në autorizimin për bartjen e llogarisë së pagesës sipas paragrafit (1) të këtij neni duhet:

1) të identifikojë veçmas transferet hyrëse të kredisë, urdhëresat e transferimit të përhershëm të kredisë dhe mandatet e debitimeve të drejtpërdrejta që duhet të barten,

2) të përcaktojë veçmas datën nga e cila duhet të fillojnë të ekzekutohen urdhëresat e përhershëm për transferet e kredisë dhe mandatet e dhëna për debitimet direkte nga llogaria e pagesave që hapet ose është hapur te ofruesi i shërbimeve të pagesave që e pranon bartjen e llogarisë së pagesës dhe

3) të përcaktojë datën e mbylljes së llogarisë së pagesës, nëse dëshiron të mbyllë llogarinë e pagesave të hapur te ofruesi i shërbimeve të pagesave që e kryen bartjen e llogarisë së pagesës.

(5) Data sipas paragrafit (4) pika 2 të këtij neni mund të jetë më herët i gjashtë ditë pune pas datës në të cilën ofruesi i shërbimeve të pagesave që e pranon bartjen e llogarisë së pagesës ka pranuar informacionet dhe dokumentacionin nga ofruesi i shërbimeve të pagesave që e kryen bartjen e llogarisë së pagesës, në përputhje me nenin 111 paragrafët (2) dhe (3) të këtij ligji.

Procedura për zbatimin e shërbimit të bartjes dhe detyrimet e ofruesve të shërbimeve të pagesave në lidhje me bartjen e llogarisë së pagesës

Neni 111

(1) Ofruesi i shërbimeve të pagesave i cili e pranon bartjen e llogarisë së pagesës, në afat prej dy ditësh pune nga dita e pranimin të autorizimit për bartjen e llogarisë së pagesës nga neni 110 i këtij ligji, është i detyruar deri te ofruesi i shërbimeve të pagesave që e kryen bartjen e llogarisë së pagesës të dorëzojë kërkesë për sigurimin e informacioneve dhe për zbatimin e aktiviteteve, nëse janë të shënuara në autorizimin për bartjen e llogarisë së pagesës, edhe atë:

1) t'i dorëzojë ofruesit të shërbimeve të pagesave që e pranon bartjen e llogarisë së pagesës listë të urdhëresave ekzistuese të transfereve të përhershme të kredisë dhe informacionet në dispozicion për mandatet e debitimeve të drejtpërdrejta që barten, kurse nëse ka kërkuar shprehimisht në autorizimin për bartjen e llogarisë së pagesës, listën t'ia dorëzojë edhe konsumatorit;

2) t'i dorëzojë ofruesit të shërbimeve të pagesave që e pranon bartjen e llogarisë së pagesës, informacionet e disponueshëm për transferet e përsëritura të kredisë hyrëse dhe mandatet e debitimeve të drejtpërdrejta, të cilat janë ekzekutuar në favor ose në kurriz të llogarisë së pagesave të konsumatorit në 13 muajt e mëparshëm, kurse nëse kërkohet shprehimisht në autorizimin për bartjen e llogarisë së pagesës, informacionet i dorëzohen edhe konsumatorit;

3) të ndërpresë pranimin e debitimeve të drejtpërdrejta dhe transfereve të kredisë hyrëse nga data e përcaktuar në autorizimin për bartjen e llogarisë së pagesës nëse ofruesi i shërbimeve të pagesave që kryen bartjen e llogarisë së pagesës nuk ka sistem të krijuar për ridrejtim automatik të transfereve të kredisë hyrëse dhe debitimeve të drejtpërdrejta në llogarinë e pagesës së konsumatorit që hapet ose është hapur te ofruesi i shërbimit të pagesave që e pranon bartjen e llogarisë së pagesës;

4) të tërheqë urdhëresat e përhershme nga data e përcaktuar në autorizimin për bartjen e llogarisë së pagesës;

5) të bartë pjesën e mbetur të saldosit pozitive të mjeteve financiare në llogarinë e pagesës së konsumatorit që hapet ose është hapur te ofruesi i shërbimit të pagesave që e pranon bartjen e llogarisë së pagesës në datën e përcaktuar në autorizimin për bartjen e llogarisë së pagesës dhe

6) të mbyllë llogarinë e pagesës në datën e përcaktuar në autorizimin për bartjen e llogarisë së pagesës.

(2) Pas pranimiit të kërkesës sipas paragrafit (1) të këtij neni, ofruesi i shërbimeve të pagesave i cili kryen bartjen e llogarisë së pagesës është i detyruar që t'i dorëzojë informacionet dhe t'i zbatojë aktivitetet, nëse janë të shënuara në autorizimin për bartjen e llogarisë së pagesës edhe atë:

1) t'i dorëzojë deri te ofruesi i shërbimeve të pagesave që e pranon bartjen e llogarisë së pagesës, në afat prej pesë ditësh pune, informacionet sipas paragrafit (1) pikat 1 dhe 2 të këtij neni;

2) të ndërpresë pranimin e transfereve të kredisë hyrëse dhe debitimeve të drejtpërdrejta nga data e përcaktuar në autorizimin për bartjen e llogarisë së pagesës dhe të informojë paguesin e transfereve të kredisë hyrëse dhe/ose pranuesin të mandatet për debitimet direkte për arsyet e mospranimiit të transaksioneve të pagesave nëse ofruesi i shërbimeve të pagesave që e kryen bartjen e llogarisë së pagesës nuk ka sistem të krijuar për ridrejtimin automatik të transfereve të kredisë hyrëse dhe debitimeve të drejtpërdrejta në llogarinë e pagesës së konsumatorit që hapet ose është hapur te ofruesi i shërbimeve të pagesave që e pranon bartjen e llogarisë së pagesës;

3) të revokojë urdhëresat e përhershme nga data e përcaktuar në autorizimin për bartjen e llogarisë së pagesës;

4) të bartë pjesën e mbetur të saldosit pozitive të mjeteve financiare në llogarinë e pagesës së konsumatorit që e hapë ose është hapur te dhënësi i shërbimeve të pagesave që e pranon bartjen e llogarisë së pagesës në datën e përcaktuar në autorizimin për bartjen e llogarisë së pagesës dhe

5) pa e vënë në dyshim të drejtën për ndërprerjen e marrëveshjes kornizë dhe zbatimin e mundshëm të afatit të dorëheqjes në përputhje me nenin 60 paragrafi (1) të këtij ligji, ta mbyll llogarinë e pagesës në datën e caktuar në autorizimin për bartjen e llogarisë së pagesës, nëse:

a) konsumatori nuk ka detyrime të papaguara për llogarinë e pagesës që mbyllet ndaj ofruesit të shërbimeve të pagesave që e kryen bartjen e llogarisë së pagesës dhe

b) ka zbatuar plotësisht aktivitetet e përmendura në pikat 1, 2 dhe 4 të këtij paragrafi.

(3) Ofruesi i shërbimeve të pagesave që e kryen bartjen e llogarisë së pagesës është i detyruar që menjëherë ta njoftojë konsumatorin nëse ka detyrime të papaguara sipas paragrafit (2) pika 5 alinea 1 të këtij neni që e pengojnë mbylljen e llogarisë së pagesës.

(4) Ofruesi i shërbimeve të pagesave i cili e pranon bartjen e llogarisë së pagesës, në përputhje me autorizimin për bartjen e llogarisë së pagesës nga neni 110 i këtij ligji, është i detyruar që në afat prej pesë ditësh pune pas pranimiit të informacioneve të kërkuara sipas paragrafit (1) të këtij neni, t'i zbatojë aktivitetet në vijim:

1) të fillojë me ekzekutimin e urdhëresave të përhershme për transfere kreditore që i ka kërkuar konsumatori nga data e përcaktuar në autorizimin për bartjen e llogarisë së pagesës;

2) t'i informojë paguesit që kryejnë transfere kreditore hyrëse të përsëritura në favor të llogarisë së pagesës së konsumatorit të përcaktuar në autorizimin për bartjen e llogarisë së pagesës për të dhënat e llogarisë së pagesave të hapur te ofruesi i shërbimeve të pagesave që e pranon bartjen e llogarisë së pagesës dhe tu dorëzojë një kopje nga autorizimi për bartjen e llogarisë së pagesës. Nëse ofruesi i shërbimeve të pagesave që e pranon bartjen e llogarisë së pagesës nuk i ka të gjitha informacionet e nevojshme për të informuar paguesit, është i detyruar nga konsumatori ose dhënësi i shërbimeve të pagesave që kryen bartjen e llogarisë së pagesës të kërkojë informacionet që mungojnë.

3) ta njoftojë konsumatorin për të drejtat e tij në përputhje me nenin 92 paragrafi (1) të këtij ligji, nëse përdoret debitimi direkt;

4) të bëjë të gjitha përgatitjet e nevojshme për pranimin e debitimeve të drejtpërdrejta dhe të fillojë t'i pranojë nga data e përcaktuar në autorizimin për bartjen e llogarisë së pagesës dhe

5) t'i informojë pranuesit që përdorin debitim direkt për arkëtimin e mjeteve nga llogaria e pagesës së konsumatorit të shënuara në autorizimin për bartjen e llogarisë së pagesës për të dhënat e llogarisë së pagesave të hapur te ofruesi i shërbimeve të pagesave që e pranon bartjen e

llogarisë së pagesës dhe për datën në të cilën debitimet direkte mund të paguhen nga llogaria e pagesës së konsumatorit dhe t'u dorëzojë kopje të autorizimit për bartjen e llogarisë së pagesës. Nëse ofruesi i shërbimeve të pagesave që e pranon bartjen e llogarisë së pagesës nuk i ka të gjithë informacionet e nevojshme për informimin e pranuesve, është i detyruar nga konsumatori ose ofruesi i shërbimeve të pagesave që kryen bartjen e llogarisë së pagesës të kërkojë informacionet që mungojnë.

(5) Konsumatori personalisht i dorëzon informacionet sipas paragrafit (4) pika 2 dhe 5 të këtij neni, paguesve dhe/ose pranuesve nëse në autorizimin nga neni 110 paragrafi (1) nuk ka dhënë pëlqimin që informacionet t'i dorëzojë ofruesit të shërbimeve të pagesave që e pranon bartjen e llogarisë së pagesës. Në këtë rast, ofruesi që pranon bartjen e llogarisë së pagesës është i detyruar që në afat prej pesë ditë pune pas pranimit të informacioneve të kërkuara sipas paragrafit (1) të këtij neni, të dërgojë njoftim me shkrim konsumatorit, ose në një medium tjetër të përhershëm, me të dhëna për llogarinë e pagesës dhe për datën e përcaktuar në autorizimin nga kur fillon realizimi i transaksioneve të pagesës.

(6) Pa vënë në pikëpyetje zbatimin e nenit 83 të këtij ligji, ofruesi i shërbimeve të pagesave që kryen bartjen e llogarisë së pagesës nuk guxon ta bllokojë instrumentin e pagesës para datës së caktuar në autorizimin për bartje për të mos ndërprerë ofrimin e shërbimeve të pagesave për konsumatorin gjatë zbatimit të shërbimit të bartjes.

Kompensimet lidhur me shërbimin e bartjes

Neni 112

(1) Ofruesi i shërbimeve të pagesave i cili kryen bartjen e llogarisë së pagesës dhe/ose ofruesi i shërbimeve të pagesave që pranon bartjen e llogarisë së pagesës është i detyruar t'i sigurojë konsumatorit qasje pa pagesë në të gjitha të dhënat në dispozicion për urdhëresa të përhershme dhe debitime direkte.

(2) Ofruesi i shërbimeve të pagesave që kryen bartjen e llogarisë së pagesës është i detyruar që ofruesit të shërbimeve të pagesave që pranon bartjen e llogarisë t'i japë informacionet e kërkuara në përputhje me nenin 111 paragrafi (2) pika 1 të këtij ligji pa i arkëtuar kompensim konsumatorit ose ofruesit të shërbimeve të pagesave që pranon bartjen e llogarisë së pagesës.

(3) Nëse ofruesi i shërbimeve të pagesave i cili kryen bartjen e llogarisë së pagesës arkëton kompensim për mbylljen e llogarisë së pagesës, është i detyruar të caktojë vlerën e kompensimit në pajtim me nenin 60 paragrafët (2), (3) dhe (6) të këtij ligji.

(4) Nëse ofruesi i shërbimeve të pagesave që kryen bartjen e llogarisë së pagesës dhe/ose ofruesi i shërbimeve të pagesave që pranon bartjen e llogarisë së pagesës llogarisin edhe arkëtojnë kompensim nga konsumatori për aktivitetet nga neni 111 i këtij ligji, përveç për aktivitetet nga paragrafët (1), (2) dhe (3) të këtij neni, duhet t'i përcaktojnë në vlerën e shpenzimeve të kryera në të vërtetë.

Përgjegjësia e ofruesve të shërbimeve të pagesave gjatë zbatimit të shërbimit të bartjes

Neni 113

(1) Ofruesit e shërbimeve të pagesave të përfshira në zbatimin e shërbimit për bartje janë përgjegjës për çfarëdo lloj humbje financiare që do të pësojë konsumatori, duke përfshirë edhe për interesat e llogaritura dhe të arkëtuar dhe/ose kompensime, për shkak mosveprimit ose veprimit në kundërshtim me nenin 111 të këtij ligji nga ofruesit të përfshirë në shërbimin e bartjes, dhe janë të detyruar të dëmin ta kompensojnë pa vonesë.

(2) Me përjashtim të paragrafit (1) të këtij neni, ofruesi i shërbimeve të pagesave i përfshirë në zbatimin e shërbimit të bartjes nuk është përgjegjës në rast të rrethanave të jashtëzakonshme dhe të paparashikueshme, në të cilat thirret dhe të cilat nuk mund të ndikohen dhe janë jashtë kontrollit të tij dhe pasojat e rrethanave nuk mund të shmangeshin pavarësisht përpjekjeve për shmangien e tyre, ose kur ofruesi i shërbimeve të pagesave është i detyruar të zbatojë ligje të tjera.

(3) Përgjegjësia dhe kompensimi i dëmit nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni përcaktohen në pajtim me ligjin.

Kapitulli V

Rregullat e punës së skemave të kartelave të pagesave gjatë realizimit të transaksioneve të pagesave të bazuara në kartela

Përfshirja

Neni 114

Kapitulli V Pjesa e katërt i këtij ligji përcakton kushtet teknike dhe afariste për realizimin e transaksioneve të pagesave në bazë të kartelave të lëshuara në Republikën e Maqedonisë së Veriut, nëse ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit dhe ofruesi i shërbimeve të pagesave të pranuesit janë të themeluar dhe punojnë në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Kufizimi i vlerës së kompensimit të zëvendësimit

Neni 115

(1) Nëse transaksioni i pagesës kryhet me instrument pagese të bazuar me kartelë, kompensimet e zëvendësimit që llogariten dhe paguhen ndërmjet ofruesve të shërbimeve të pagesave në Republikën e Maqedonisë së Veriut nuk mund të jenë më të larta se:

1) 0,2% e vlerës së transaksionit të realizuar në rastin e transaksioneve të pagesave të bazuara në kartela debiti dhe

2) 0.3% e vlerës së transaksionit të realizuar në rastin e transaksioneve të pagesave të bazuara në kartela krediti.

(2) Çdo kompensim i dakorduar, përfshirë edhe kompensimet neto, të cilat kanë lëndë ose efekt si edhe kompensimi i zëvendësimit dhe që ofruesi i shërbimeve të pagesave që lëshon instrument të pagesës të bazuar në kartelë merr nga skema e kartelave të pagesave, nga ofruesi i shërbimeve të pagesave që kryen pranimin e transaksioneve të pagesave të bazuara me kartelë ose nga ndonjë ndërmjetësues në realizimin e transaksioneve të pagesave me kartelë ose aktiviteteve të lidhura me transaksionet janë pjesë e kompensimit të zëvendësimit sipas paragrafit (1) të këtij neni.

(3) Ofruesi i shërbimeve të pagesave që lëshojnë instrumente të pagesave në bazë të kartelës dhe/ose skemave të kartelave të pagesave, janë të detyruar që me kërkesë të Bankës Popullore t'i dorëzojnë të dhënat dhe informacione të nevojshme për verifikimin e zbatimit të paragrafëve (1) dhe (2) të këtij neni.

(4) Banka Popullore mund të kërkojë nga ofruesi i shërbimeve të pagesave të dhënat dhe/ose informacionet sipas paragrafit (3) të këtij neni t'i konfirmojë Shoqëria e Revizionit.

(5) Dispozitat e këtij neni nuk zbatohen në:

1) transaksionet e pagesave me kartela të pagesave afariste;

2) tërheqja e parave të gatshme nëpërmjet bankomatit ose në mënyrë të drejtpërdrejtë në sportelet në hapësirat e ofruesve të shërbimeve të pagesave dhe

3) transaksionet e pagesave të bazuara në kartela të lëshuara nga skema e treanshme e kartelës së pagesave.

Ndarja e skemës së kartelës së pagesës dhe subjekti që kryen procesim

Neni 116

(1) Skema e kartelës së pagesës e cila është krijuar dhe punon në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe subjekti që kryen procesim nuk mund:

1) të jenë të varur nga kontabiliteti, organizimi i brendshëm dhe proceset e brendshme të vendimmarrjes;

2) të prezantojnë kolektivisht çmimet për skemën e kartelës së pagesës dhe për aktivitetet për procesim dhe nuk duhet të bëjnë subvencionimin e ndërsjellë;

3) të bëjnë diskriminim për çfarëdo baze midis filialeve, shoqërive përcejlëse dhe aksionarëve të tyre nga njëra anë dhe përdoruesve të skemës së tyre të kartelave të pagesave dhe partnerëve të tjerë kontraktues nga ana tjetër; dhe

4) në çdo mënyrë t'i kushtëzojnë partnerët kontraktues që përdorin shërbimet e tyre duke përdorur çdo shërbim tjetër që ofrojnë.

(2) Banka Popullore, nëse vlerëson se është e nevojshme, mund të kërkojë që skema e kartelës së pagesës të dorëzojë raport nga Shoqëria e Revizionit ose persona tjera të pavarur për vlerësimin e përputhshmërisë së skemës së kartelës së pagesës me kushtet sipas paragrafit (1) të këtij neni.

(3) Këshilli i Bankës Popullore me akt nënligjor i përcakton kërkesat për plotësimin e kushteve sipas paragrafit (1) pika 1 të këtij neni.

(4) Skemat e kartelës së pagesës detyrohen që të sigurojnë ndarje të mesazheve për autorizim dhe mesazheve kliringe të transaksioneve individuale të pagesave me kartelë dhe të mundësojnë aktivitete për procesim që të mund të realizohen nga subjekte të ndryshme që kryejnë procesim.

(5) Subjektet që kryejnë procesim janë të detyruara të sigurojnë ndërveprueshmëri teknike të sistemeve të tyre me sistemet përkatëse të subjekteve të tjera që bëjnë përpunimin duke i zbatuar standardet e miratuara të trupave ndërkombëtarë ose europian për standardizim. Skemat e kartelave të pagesave nuk duhet të vendosin ose zbatojnë asnjë rregulla afariste që kufizojnë mundësinë e arritjes së ndërveprueshmërisë teknike të sistemeve të subjekteve që bëjnë përpunimin.

(6) Dispozitat e këtij neni nuk zbatohen për skemat e treanshme të kartelave të pagesave.

Vendosja e përbashkët e brendeve të pagesave në instrumentet e pagesave të bazuara në kartelë dhe përzgjedhja e brendit të pagesës ose aplikacionit të pagesës

Neni 117

(1) Ndalohet çdo dispozitë në rregullat e skemave të kartelave të pagesave ose në marrëveshjet e autorizimit ndërmjet skemës së kartelës së pagesës dhe ofruesve të shërbimeve të pagesave që lëshojnë instrumente pagesore të bazuara në kartelë dhe që kufizon ose pengon ofruesin nga veprimi i përbashkët i dy ose më shumë brendeve të pagesave të ndryshme ose aplikacione të pagesave të instrumentit pagesor të bazuara në kartelë.

(2) Me rastin e lidhjes së marrëveshjes kornizë me ofrues të shërbimeve të pagesave, në bazë të së cilës lëshohet instrumenti i pagesës me kartelë, konsumatori mund të kërkojë dy ose më shumë brende të ndryshme të instrumenteve të pagesave të bazuara në kartelë, me kusht që shërbimi i tillë të ofrohet nga ofruesi i shërbimit të pagesave.

(3) Ofruesi i shërbimeve të pagesave që lëshon instrument të pagesës të bazuar në kartelë është i detyruar që përpara lidhjes së marrëveshjes kornizë t'i mundësojë konsumatorit të marrë informacione të qarta dhe objektive për të gjitha markat e disponueshme të pagesave dhe veçoritë e tyre, duke përfshirë funksionalitetin e tyre, veçoritë e sigursisë dhe shpenzimet lidhur me ta.

(4) Në rregullat e skemave të kartelave të pagesave ose në marrëveshjet e autorizimit ndërmjet skemës së kartelës së pagesave dhe ofruesve të shërbimeve të pagesave që lëshojnë instrumente pagesore të bazuara në kartela të pagesave, që i referohen veprimit të përbashkët të brendeve të ndryshme të pagesave ose aplikacioneve të instrumentit pagesor të bazuar në kartelë, dallimi në trajtimin e ofruesve të shërbimeve të pagesave që lëshojnë instrumente pagesore të bazuar në kartelë ose ofruesit e shërbimeve të pagesave që pranojnë transaksione të pagesave të bazuara në kartela duhet të bazohen në arsye objektive dhe në mënyrë jodiskriminuese.

(5) Skemat e kartelave të pagesave nuk guxojnë që ofruesve të shërbimeve të pagesave që lëshojnë instrumenete pagesore të bazuara në kartelë ose që ofruesve të shërbimeve të pagesave që pranojnë transaksione të pagesave të bazuara në kartelë t'i imponojnë detyrime raportuese, detyrime të pagesës së kompensimeve ose çfarë do lloj detyrimi tjetër të ngjashëm për transaksionet e pagesave për të cilat nuk përdoret skema e kartelës së tyre të pagesave dhe janë të realizuar me çdo pajisje në të cilën ekziston brendi i tyre i pagesës.

(6) Rregullat udhëzuese ose çdo masë që ka për qëllim transaksionet të drejtohen në një kanal konkret ose proces ose standarde dhe norma të tjera teknike ose të sigurisë në lidhje me veprimin e dy ose më shumë brendeve të pagesave ose aplikacioneve të pagesave në instrumente pagese të bazuar në kartelë, nuk duhet të diskriminojnë dhe duhet të zbatohen në mënyrë jodiskriminuese.

(7) Skemat e kartelave të pagesave, ofruesit e shërbimeve të pagesave që lëshojnë instrumente pagese të bazuara në kartelë, ofruesit e shërbimeve të pagesave që bëjnë pranimin transaksionave të pagesave bazuar në kartelë, subjektet që kryejnë procesim ose persona të tjerë që kryejnë shërbime teknike, nuk mund të vendosin në instrumentin e pagesës ose pajisjen që përdoren në vendet e shitjes çdo mekanizëm të automatizuar, softuer ose pajisje tjetër që kufizon zgjedhjen e brendit të pagesës dhe/ose aplikacionit të pagesës nga pagesi ose panuesi në përdorimin e instrumentit pagesor të bazuar në kartelë, në të cilin së bashku janë vendosur dy ose më shumë brende të pagesës ose aplikacione të pagesës.

(8) Pranuesit kanë të drejtë të instalojnë një mekanizëm ose pajisje në vendin e shitjes që mundëson zgjedhjen e brendit pritar të pagesës ose aplikacionit të pagesës, por nuk guxojnë të kufizojnë pagesin që të zgjedhë një brend tjetër të pagesës ose aplikacion të pagesës që merret nga pranuesi.

Llogaritja dhe prezantimi i kompensimeve të ndara

Neni 118

(1) Ofruesi i shërbimeve të pagesave që pranon transaksionet e pagesave bazuar në kartelë është i detyruar që shitësit që është pranues i pagesës t'ia llogarisë veçmas dhe t'ia paraqesë kompensimin për kategoritë e ndryshme dhe brendet e ndryshme të kartelave të pagesave, me nivele përkatëse të kompensimeve të zëvendësimit ndërmjet ofruesve të shërbimeve të pagesave në transaksionet e pagesave të bazuara në kartelë, përveç nëse vetë pranuesi ka kërkuar, me kërkesë të shprehur me shkrim, llogaritje dhe paraqitje të kompensimit përmbljedhës nga pranuesi i pagesës.

(2) Ofruesi i shërbimeve të pagesave i cili kryen pranimin e transaksioneve të pagesave bazuar me kartelë në marrëveshje me shitësin që është pranues i pagesës, është i detyruar të paraqesë vlerën e kompensimit të shërbimit të shitësit, kompensimin e zëvendësimit dhe kompensimin për skemën e pagesës me kartelë, veçmas për çdo kategori dhe brend të pagesës të kartelave të pagesave, përveç nëse shitësi me kërkesë me shkrim kërkon paraqitje të ndryshme.

Rregulla për pranimin e të gjitha kartelave

Neni 119

(1) Skemat e kartelave të pagesave dhe ofruesit e shërbimeve të pagesave nuk duhet të detyrojnë pranuesit që pranojnë instrumente pagesash me kartelë të lëshuara nga një ofrues i shërbimeve të pagesave që lëshojnë instrumente pagesore të bazuara në kartelë duke pranuar instrumente të tjera pagese të bazuara në kartelë të lëshuara në kuadër skemës së njëjtë të pagesave me kartelë..

(2) Dispozita sipas paragrafit (1) të këtij neni nuk zbatohet për instrumentet e pagesave të bazuara në kartela të brendit të njëjtë të pagesës dhe kategorisë së njëjtë të kartelave të pagesave me parapagim edhe të kartelave të pagesës debitore ose kreditore të cilat janë lëndë e kufizimit të vlerës së kompensimit të zëvendësimit që llogaritet dhe arkëtohet ndërmjet ofruesve të shërbimeve të pagesave në pajtim me nenin 115 të këtij ligji.

(3) Dispozita sipas paragrafit (1) të këtij neni nuk e vë në dyshim të drejtën e skemave të kartelave të pagesave dhe të ofruesve të shërbimeve të pagesave që të përcaktojnë se kartelat e pagesës nuk mund të refuzohen në bazë të identitetit të ofruesit të shërbimeve të pagesave që lëshon instrumente pagesore bazuar në kartela ose pranuesit të kartelës së pagesës.

(4) Pranuesi është i detyruar t'i informojë konsumatorët në mënyrë të qartë dhe pamëdyshje për kartelat e pagesave ose instrumentet e tjera të pagesës së bazuara në kartelat e skemës së caktuar të kartelës së pagesës që pranon dhe për kartelat e pagesës ose instrumentet e tjera të pagesës të bazuara në kartelat e skemës së caktuar të pagesës që nuk i pranon.

(5) Informacionet sipas paragrafit (4) të këtij neni duhet të vendosen në vend të dukshëm në hyrje të shitores dhe në arkën e shitësit, ndërkaq në rast të shitjes në distancë, informacionet publikohet në faqen e internetit të marrësit ose një medium tjetër të përshtatshëm elektronik ose celular, kohë të mjaftueshme përpara se paguesi të lidhë kontratë për shitje me pranuesin, në mënyrë që paguesi të mund të njihet dhe të vendosë.

(6) Ofruesit e shërbimeve të pagesave që lëshojnë instrumente pagesore të bazuara në kartela duhet të mundësojnë që instrumentet e tyre të pagesave të jenë të njohura në mënyrë elektronike, dhe në rast të instrumenteve të pagesave të sapo lëshuara të bazuara në kartelë, të jenë në gjendje të identifikojnë në mënyrë të dukshme me të cilat paguesit dhe marrësit pa mëdyshje do të mund të identifikojë brendet e pagesave dhe kategoritë e kartelave të pagesave me parapagim, kartela të pagesave të debitit, të kreditit ose afariste që janë të zgjedhura nga paguesi.

Rregullat udhëzuese

Neni 120

Janë të ndaluara dispozitat në marrëveshjet e autorizimit ndërmjet skemës së kartelës së pagesës dhe ofruesve të shërbimeve të pagesave që lëshojnë instrumente pagesore të bazuara në kartelë, në rregullat e zbatuara nga skema e kartelës së pagesës dhe në marrëveshjet e lidhura ndërmjet ofruesve të shërbimeve të pagesave që pranojnë transaksione të pagesave të bazuara me kartelë, që pengojnë pranuesin e pagesës:

- 1) t'i udhëzojë përdoruesit në përdorimin e instrumentit të caktuar të pagesës;
- 2) të ofrojë trajtim më të favorshëm të instrumenteve pagesore të bazuara në kartela në skemë të caktuar të kartelës së pagesës;
- 3) të japë informacione paguesve për kompensimin e zëvendësimit ndërmjet ofruesve të shërbimeve të pagesave në transaksionet e pagesave bazuar në kartelë dhe për kompensimin e shërbimit të shitësit.

Informacioni i pranuesit në lidhje me transaksionet individuale të pagesave bazuar në kartela

Neni 121

(1) Pas realizimit të transaksionit individual të pagesës në bazë të kartelës, ofruesi i shërbimeve të pagesave është i detyruar që pranuesit, në letër ose në një medium tjetër të përhershëm, t'i japë këto të dhëna:

1) shenjë referente nga e cila pranuesi mund të identifikojë transaksionin e pagesës bazuar në kartelë;

2) vlera e transaksionit të pagesës e bazuar në kartelë në valutën në të cilën është aprovuar llogaria e pagesës e pranuesit; dhe

3) vlera e të gjitha kompensimeve që janë në kurriz të pranuesit të transaksionit të pagesës bazuar me kartelë, gjithsej dhe veçmas për kompensimin e shërbimit të shitësit dhe të kompensimit të zëvendësimit.

(2) Në bazë të pëlqimit me shkrim të marrë paraprakisht nga pranuesi, informacionet sipas paragrafit (1) të këtij neni, ofruesi i shërbimeve të pagesave mund t'i paraqesë së bashku, sipas brendit të pagesës, aplikacionit për pagesë, llojeve të instrumenteve të pagesave dhe normave të kompensimit të zëvendësimit që zbatohen për transaksionet e pagesave të bazuar me kartelë.

(3) Pranuesi i pagesës dhe ofruesi i shërbimeve të pagesave që pranon transaksionet e pagesave të bazuara në kartela me marrëveshjen kornizë mund të bien dakord që informacionet nga paragrafët (1) ose (2) të këtij neni të sigurohen ose të vihen në dispozicion nga ofruesi në periudha të caktuara, por të paktën një herë në muaj.

Kapitulli VI

Rreziqet operative dhe të sigurtisë dhe autentikimi

Menaxhimi i rrezikut operativ dhe të sigurtisë

Neni 122

(1) Ofruesi i shërbimeve të pagesave është i detyruar të krijojë kornizë për menaxhimin e rreziqeve operative dhe të sigurtisë lidhur me shërbimet e pagesave që i ofron, e cila përfshin masat përkatëse për zvogëlimin dhe mekanizmat e kontrollit të tyre.

(2) Ofruesi i shërbimeve të pagesave si pjesë e kornizës sipas paragrafit (1) të këtij neni është i detyruar që të krijojë dhe mbajë procedura efektive për menaxhimin e incidenteve, përfshirë identifikimin e tyre dhe klasifikimin e incidenteve të rëndësishme operative dhe të sigurtisë.

(3) Ofruesi i shërbimeve të pagesave është i detyruar t'i paraqesë Bankës Popullore, së paku një herë në vit, dhe me kërkesë të Bankës Popullore dhe në intervale më të shkurtra kohore, një vlerësim të përditësuar dhe gjithëpërfshirës të ekspozimit ndaj rreziqeve operationale dhe të sigurtisë në lidhje me shërbimet e pagesave dhe përshtatshmërinë e masave të zbatuara dhe mekanizmave të kontrollit për menaxhimin e rrezikut operacional dhe të sigurtisë.

Njoftim për incidente dhe mashtrime

Neni 123

(1) Në rast të ndonjë incidenti të rëndësishëm operativ dhe të sigurtisë, ofruesi i shërbimeve të pagesave i themeluar dhe që vepron në Republikën e Maqedonisë së Veriut është i detyruar ta njoftojë Bankën Popullore menjëherë dhe pa vonesë të panevojshme dhe në afat prej tri ditësh.

(2) Në rast se incidenti sipas paragrafit (1) të këtij neni ka ose mund të ketë ndikim në interesat financiare të përdoruesve të shërbimeve të pagesave, ofruesi i shërbimeve të pagesave është i detyruar që menjëherë dhe pa vonesë të paarsyeshme të informojë përdoruesit e tij të shërbimeve të pagesës për incidentin dhe për të gjithë masat që përdoruesit e shërbimeve të pagesave mund të ndërmarrin për të zvogëluar efektet negative të incidentit.

(3) Banka Popullore menjëherë pas pranimit të njoftimit sipas paragrafit (1) të këtij neni, njofton Trupin Bankar European dhe Bankën Qendrore Europiane për të gjitha detajet e incidentit.

(4) Banka Popullore në bazë të vlerësimit të saj për rëndësinë e incidentit sipas paragrafit (1) të këtij neni, njoftonë institucionet kompetente në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

(5) Banka Popullore bashkëpunon me Trupin Bankar European dhe Bankën Qendrore Europiane në vlerësimin e rëndësisë së incidentit për trupat e tjerë të involvuar të Bashkimit dhe trupat kompetente të shteteve të tjera anëtare.

(6) Në bazë të njoftimit për incidentet në shtetin tjetër anëtar të Trupit Bankar European dhe Bankës Qendrore Europiane, Banka Popullore ndërmerrë të gjitha masat e nevojshme për mbrojtjen e sigurisë së sistemit financiar.

(7) Ofruesi i shërbimeve të pagesave sipas paragrafit (1) të këtij neni është i detyruar që së paku një herë në vit t'i dorëzojë Bankës Popullore të dhëna statistikore për mashtrimet e bëra në lidhje me mjetet e ndryshme të pagesës.

(8) Banka Popullore i dorëzon në formë të përmbledhur të dhënat statistikore sipas paragrafit (7) Trupit Bankar European dhe Bankës Qendrore Europiane.

(9) Këshilli i Bankës Popullore, me akt nënligjor në mënyrë të hollësishme i përcakton masat e sigurisë për rreziqet operative dhe të sigurisë në lidhje me shërbimet e pagesave dhe udhëzimet për klasifikimin e incidenteve operative dhe të sigurisë nga neni 122 paragrafi (1) dhe (2) të këtij ligji, si dhe mënyrën dhe procedurën për njoftimin e incidenteve dhe mashtrimeve të ndodhura nga paragrafët (1), (2) dhe (7) të këtij neni.

Autentifikimi i përforcuar

Neni 124

(1) Ofruesi i shërbimeve të pagesave është i detyruar të përdorë autentifikim të përforcuar të klientit, kur paguesi:

1) hyn në llogarinë e pagesës, në mënyrë të drejtpërdrejtë online,

2) iniciacion transaksionit pagese elektronike dhe/ose

3) kryen çdo veprim nëpërmjet komunikimit në distancë që mund të shkaktojë rrezikun e shfaqjes së mashtrimit lidhur me pagesat ose keqpërdorimet e tjera.

(2) Gjatë inicimit të transaksionit të pagesës elektronike nëpërmjet mjeteve të komunikimit në distancë sipas paragrafit (1) pika 2) të këtij ligji, ofruesi i shërbimeve të pagesave është i detyruar që të zbatojë autentifikimin e përforcuar të klientit, që përmban elemente që në mënyrë dinamike e lidhin transaksionin me vlerë të caktuar dhe me pranues të caktuar të transaksionit.

(3) Ofruesi i shërbimeve të pagesave është i detyruar në rastet sipas paragrafit (1) të këtij neni të vendosë masa përkatëse të sigurisë për mbrojtjen e konfidencialitetit dhe integritetit të veçorive të sigurisë së përdoruesve të përdoruesve të shërbimeve të pagesave.

(4) Dispozitat nga paragrafët (2) dhe (3) të këtij neni zbatohen edhe kur pagesa bëhet nëpërmjet ofruesit të shërbimeve për iniciimin e pagesave.

(5) Dispozitat nga paragrafët (1) dhe (3) të këtij neni do të zbatohen edhe kur nëpërmjet ofruesve të shërbimeve kërkohen informacione për dhënien e informacioneve për llogaritë e pagesave.

(6) Banka Popullore i përcakton përjashtimet nga zbatimi i paragrafëve (1), (2) dhe (3) të këtij neni, në bazë të këtyre kriterëve:

- 1) nivelit të rrezikut në lidhje me shërbimet e pagesave të ofruara,
- 2) shumës, përsëritjes së transaksioneve ose kombinim të të dyjave dhe
- 3) kanalet e pagesave që përdoren për të kryer transaksione.

(7) Këshilli i Bankës Popullore, me akt nënligjor në hollësi i përcakton kërkesat për autentifikim të përforcuar ndërmjet ofruesve të shërbimeve të pagesave që mbajnë llogari të pagesave, ofruesve të shërbimeve të pagesave për iniciimin e pagesës, ofruesve të shërbimeve për dhënie të informacioneve për llogaritë të pagesave, pagesve, pranuesve dhe ofruesve të tjerë të shërbimeve të pagesave për qëllimet e identifikimit, autentifikimit, njoftimit dhe informimit, mbrojtjes së konfidencialitetit dhe integritetit të veçorive të sigurisë së përdoruesve, si dhe përjashtimet sipas paragrafit (6) të këtij neni.

Standarde të përgjithshme, të sigurta dhe të hapura të komunikimit

Neni 125

(1) Ofruesit e shërbimeve të pagesave që mbajnë llogari të pagesës dhe mundësojnë qasje në llogarinë e pagesave, në mënyrë të drejtpërdrejtë online, janë të detyruar të kenë të paktën një kanal komunikimi që mundëson lidhjen dhe komunikimin e sigurt me oruesit e shërbimeve për dhënie të informacioneve të llogarive të pagesave, ofruesit e shërbimeve të iniciimit të pagesave dhe ofruesit të shërbimeve të pagesave në transaksionet e pagesave të bazuara në kartela.

(2) Ofruesi i shërbimeve të pagesave i cili mban llogarinë e pagesave është i detyruar që ofruesit të shërbimeve të pagesave t'i mundësojë iniciimin e pagesave dhe ofruesit të shërbimeve për dhënie të informacioneve për llogari të pagesave të mbështeten në procedurat e autentifikimit nëpërmjet standardeve të përgjithshme, të sigurta dhe të hapura. për komunikim sipas paragrafit (1) të këtij neni, në atë mënyrë që vetë ofruesi i shërbimeve të pagesave mban llogarinë e pagesave siguron qasje për përdoruesin e shërbimeve të pagesave në përputhje me nenin 124 paragrafët (1) dhe (3) të këtij ligji, si dhe për ofruesit e shërbimit për iniciimin e pagesave dhe në përputhje me nenin 124 paragrafi (2) të këtij ligji.

(3) Këshilli i Bankës Popullore sipas aktit nënligjor të nenit 124 paragrafi (7) i këtij ligji hollësisht i përcakton standardet për lidhje dhe komunikim sipas paragrafit (1) të këtij neni dhe kushtet në të cilat Banka Popullore mund të mundësojë zbatim të lehtësuar të standardeve për vazhdimësi.

Kapitulli VII

Mbrojtja e të dhënave personale dhe sekretit afarist

Mbrojtja e të dhënave personale

Neni 126

(1) Ofruesi i shërbimeve të pagesave për qëllime të zbatimit të dispozitave të këtij ligji do t'i përpunojë të dhënat personale të përdoruesit të shërbimeve të pagesave dhe në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale do të sigurojë informacione nga përpunimi i të dhënave personale, ku të dhënat personale konsiderohen: numri amë i qytetarit, emri dhe mbiemri, adresa, numri i telefonit, si dhe të dhëna ose regjistrime të tjera nëpërmjet të cilave personi mund të identifikohet në mënyrë të drejtpërdrejtë ose indirekte (në tekstin në vijim të Kapitullit VII i këtij ligji: të dhënat personale).

(2) Ofruesi i shërbimeve të pagesave duhet t'i qaset të dhënave personale, t'i përpunojë dhe/ose t'i ruajë me pëlqimin e marrë paraprakisht nga përdoruesi i shërbimit të pagesave dhjetë vjet pas skadimit të vitit kalendarik në të cilin ka pasur qasje në të dhënat personale.

(3) Ofruesi i shërbimeve të pagesave i përpunon të dhënat personale me qëllim të veprimit në parandalimin, hetimin dhe zbulimin e mashtrimeve në lidhje me shërbimet e pagesave.

(4) Me përjashtim të paragrafit (2) të këtij neni, ofruesi i shërbimeve të pagesave ka qasje në të dhënat personale, i përpunon dhe/ose i ruan të dhënat personale në procedurën sipas paragrafit (3) të këtij neni pa pëlqimin e personit që është lëndë e procedurës.

Ruajtja e të dhënave për shërbimet e pagesave dhe përdoruesit e tyre

Neni 127

(1) Ofruesit e shërbimeve të pagesave janë të detyruar të ruajnë dokumentacionin në bazë të të cilit hapen dhe mbyllen llogaritë e pagesave, të dhënat që mundësojnë monitorimin e transaksioneve të realizuara të pagesave dhe përdorimin e instrumenteve të pagesës, si dhe dokumentacionin në bazë të të cilit regjistrohen ndryshimet e llogarisë së pagesës dhjetë vjet pas përfundimit të vitit kalendarik në të cilin është mbyllur llogaria e pagesës, kryhen transaksionet ose regjistrohen ndryshimet e llogarive të pagesave.

(2) Me përjashtim të paragrafit (1) të këtij neni, ofruesi i shërbimeve të pagesave është i detyruar të mbajë dokumentacionin lidhur me llogaritë e pagesave, gjendja pozitive e të cilave është bartur në llogaritë e regjistrimit me dedikim të veçantë në pajtim me nenin 60 paragrafi (8) dhe nenin 75 paragrafi (7) i këtij ligji dhjetë vjet pas skadimit të vitit kalendarik në të cilin është kryer bartja e mjeteve financiare nga llogaria e regjistrimit me dedikim të veçantë personave për të cilët ka dalë e drejta e pronësisë dhe forma të tjera të së drejtës së pronësisë.

Sekreti afarsit

Neni 128

(1) Dokumentet, të dhënat dhe/ose informacionet e marra nga institucionet e pagesave dhe institucionet e parasë elektronike gjatë kryerjes së shërbimeve të pagesave në lidhje me llogaritë e pagesave dhe/ose transaksionet e pagesave, paraqesin sekret afarist dhe mund të përdoren vetëm për qëllimet për të cilat janë fituar.

(2) Institucionet e pagesave dhe institucionet e parasë elektronike, personat që janë anëtarë të organeve për menaxhim dhe mbikëqyrje të institucioneve të pagesave dhe institucioneve të parasë elektronike, punonjësit e tyre, personat e jashtëm që kryejnë funksione operative lidhur me ofrimin e shërbimeve të pagesave dhe agjentët janë të detyruar të mbrojnë dhe të ruajnë sekretin e tyre dhe nuk mund t'u zbulojnë ose dorëzojnë personave të tretë, as t'u mundësojnë qasje në dokumente, të dhëna dhe informacione të tilla, përveç në rastet dhe në procedurë të përcaktuar me ligj ose me pëlqimin e marrë nga përdoruesi i shërbimeve të pagesave.

(3) Detyrimet për ruajtjen e sekretit afarist dhe konfidencialitetin e të dhënave nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni vazhdojnë edhe pas përfundimit të marrëdhënies së punës, përkatësisht pas përfundimit të bazës dhe statusit në bazë të të cilit realizohet qasja në dokumente, të dhëna dhe/ose informacione që konsiderohen sekret afarist gjatë kryerjes së shërbimeve të pagesave.

(4) Për institucionet e pagesave dhe institucionet e parasë elektronike, personat që janë anëtarë të organeve drejtuese dhe mbikëqyrëse të ofruesit të shërbimeve të pagesave dhe punonjësit e tij, detyrimi për ruajtjen e sekretit afarist dhe konfidencialitetin e të dhënave nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni nuk i referohet dhe nëse dokumentet, të dhënat dhe/ose informacionet jepen:

- 1) me kërkesë me shkrim të Prokurorisë Publike ose të gjykatës kompetente për zhvillimin e procedurave që janë në kuadër të kompetencave të saj;
- 2) për nevojat e Bankës Popullore ose organit tjetër mbikëqyrës i cili është i autorizuar me ligj për pranimin e të dhënave;
- 3) nëse të dhënat për hyrjet e mjeteve në llogaritë e personave fizikë kumtohen në Drejtorinë e të Hyrave Publike, në përputhje me ligjin;
- 4) me kërkesë me shkrim të Drejtorisë së të Hyrave Publike për zhvillimin e procedurave që janë në kompetencat e saj, në përputhje me ligjin;
- 5) nëse të dhënat i komunikohen Drejtorisë së Zbulimit Financiar, në përputhje me ligjin;
- 6) me kërkesë me shkrim të Komisionit Shtetëror të Parandalimit të Korrupsionit, në kuadër të realizimit të kompetencave të tij, në përputhje me ligjin;
- 7) nëse të dhënat i komunikohen Drejtorisë së Policisë Financiare, në përputhje me ligjin;
- 8) me kërkesë me shkrim të Inspektoratit Shtetëror të Devizave për kontrollin e punës devizore;
- 9) me kërkesë me shkrim të Drejtorisë së Doganave për zhvillimin e procedurave që janë në kuadër të kompetencave të saj, në përputhje me ligjin;
- 10) me kërkesë me shkrim të Agjencisë së Administrimit të Pasurisë së Konfiskuar, në përputhje me ligjin;
- 11) me kërkesë me shkrim të noterit në kuadër të zhvillimit të procedurës së trashëgimisë, në përputhje me ligjin;
- 12) nëse të dhënat komunikohen për nevojat e funksionimit të KEP, në përputhje me këtë ligj;
- 13) nëse të dhënat komunikohen për nevojat e funksionimit të byrosë kreditore, në përputhje me këtë ligj dhe
- 14) me kërkesën me shkrim të personave të autorizuar për përmbarim në përputhje me ligjin.

Kapitulli VIII

Mundësitë për zgjidhjen e kontesteve

Procedurat tek ofruesit e shërbimeve të pagesave

Neni 129

- (1) Përdoruesi i shërbimeve të pagesave mund të paraqesë kundërshtim të ofruesit të shërbimeve të pagesave kur konsideron se ofruesi nuk i përmbahet dispozitave të pjesëve tre dhe katër të këtij ligji.
- (2) Ofruesi i shërbimeve të pagesave është i detyruar të vendosë dhe të zbatojë procedura të përshtatshme dhe efektive për zgjidhjen e kundërshtimeve nga përdoruesit e shërbimeve të pagesave lidhur me të drejtat dhe detyrimet që dalin nga Pjesa e tretë dhe Pjesa e katërt e këtij ligji.
- (3) Ofruesi i shërbimeve të pagesave është i detyruar t'i zbatojë procedurat sipas paragrafit (2) të këtij neni në të gjitha shtetet anëtare në të cilat i ofron shërbimet e pagesave.
- (4) Ofruesi i shërbimeve të pagesave është i detyruar që përdoruesit të shërbimeve të pagesave t'i parashtrojë përgjigje për të gjitha pretendimet në kundërshtimin sipas paragrafit (1) të këtij neni me shkrim ose në ndonjë medium tjetër të përhershëm, nëse ky lloj i njoftimit është dakorduar ndërmjet ofruesit të shërbimeve të pagesave dhe përdoruesit të shërbimeve të pagesave, në afat prej 15 ditë pune nga dita e pranimit të kundërshtimit.
- (5) Nëse ofruesi i shërbimeve të pagesave nuk mund të përgjigjet në afatin sipas paragrafit (4) të këtij neni për arsye që janë jashtë kontrollit të dhënësit të shërbimeve të pagesave, është i detyruar që ta njoftojë përdoruesin e shërbimeve të pagesave për vonesën e përgjigje me arsyet e

theksuara qartë dhe për afatin deri në të cilin përdoruesi i shërbimeve të pagesave do të marrë përgjigjen dhe i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 35 ditë pune nga dita e pranimi të kundërshtimit.

(6) Ofruesi i shërbimeve të pagesave është i detyruar në përgjigjen e kundërshtimit të njoftojë përdoruesin e shërbimeve të pagesave për së paku një person ose organ të autorizuar kompetent për procedurën jashtëgjyqësore për zgjidhjen e kontesteve lidhur me të drejtat dhe detyrimet që dalin nga Pjesa e tretë dhe Pjesa e katërt e këtij ligji.

(7) Dispozitat e këtij neni zbatohen edhe për poseduesit e parasë elektronike dhe emetuesit e parasë elektronike.

Ankesë në Bankën Popullore

Neni 130

(1) Përdoruesit e shërbimeve të pagesave, të cilët paraprakisht kanë parashtruar kundërshtim të ofruesit e shërbimeve të pagesave në pajtim me nenin 129 të këtij ligji, si dhe palët e tjera të interesuara, duke përfshirë organizatat e konsumatorëve, mund të parashtrojnë ankesa në Bankën Popullore për shkelje të mundshme të dispozitat e këtij ligji nga ofruesit e shërbimeve të pagesave (në tekstin e mëtejme të këtij neni: parashtruesi i ankesës).

(2) Përgjigja në ankesën e dorëzuar nga Banka Popullore nuk është e detyrueshme për ofruesin e shërbimeve të pagesave, as nuk ka veprim juridik në lidhje me marrëdhëniet juridike ndërmjet parashtruesit të ankesës dhe ofruesit të shërbimeve të pagesave.

(3) Ankesa në Bankën Popullore sipas paragrafit (1) të këtij neni mund të parashtrohet drejtpërdrejt në arkivin e Bankës Popullore, me postë me dërgesë të rekomanduar ose në formë elektronike duke përdorur mjete për identifikim elektronik nëpërmjet Portalit Nacional të Shërbimeve Elektronike.

(4) Në rast të ndërprerjes teknike të funksionimit të Portalit Nacional të Shërbimeve Elektronike, ankesa sipas paragrafit (3) të këtij neni dorëzohet në adresën elektronike të vlefshme të Bankës Popullore në formë të dokumentit elektronik nëpërmjet dorëzimit të kualifikuar elektronik të rekomanduar.

(5) Përgjigja në ankesën e dorëzuar nga Banka Popullore sipas paragrafit (2) të këtij neni mund të dorëzohet deri te parashtruesi i ankesës me dërgesë të rekomanduar ose në formë elektronike duke përdorur mjete për identifikim elektronik nëpërmjet Portalit Nacional të Shërbimeve Elektronike.

(6) Në rast të ndërprerjes teknike të funksionimit të Portalit Nacional të Shërbimeve Elektronike, përgjigja e ankesës sipas paragrafit (5) të këtij neni dorëzohet në adresën elektronike të vlefshme të postës elektronike të parashtruesit të ankesës në formë të dokumentit elektronik nëpërmjet dorëzimit të kualifikuar elektronik të rekomanduar.

(7) Veprimi i Bankës Popullore në lidhje me ankesat e parashtruara nga përdoruesit e shërbimeve të pagesave në asnjë mënyrë nuk e përjashton ose kufizon mundësinë e ndërmarrjes së një ose më shumë masave ndaj subjekteve të mbikëqyrjes në përputhje me këtë ligj.

(8) Në rastet kur është e përshtatshme dhe pa e vënë në dyshim të drejtën e ngritjes së procedurës gjyqësore nga parashtruesi i ankesës, Banka Popullore si përgjigje do ta njoftojë parashtruesin e ankesës për ekzistimin e mundësisë së zgjidhjes së kontesteve në procedurë jashtëgjyqësore.

(9) Banka Popullore, guvernatori, zëvendës-guvernatorët, anëtarët joekzekutivë të Këshillit të Bankës Popullore, të punësuarit gjatë dhe pas përfundimit të angazhimit në Bankën Popullore, përkatësisht marrëdhënies së punës, nuk janë përgjegjës ndaj parashtruesit të ankesës, ofruesit të shërbimeve të pagesave dhe/ose personave të tretë, për dëmet që mund të ndodhin për shkak të veprimit në lidhje me përgjigjet e dhëna ndaj ankesave të parashtruara, përveç kur janë përjashtuar autorizimet e tyre të përcaktuara me ligj dhe janë dënuar për vepër penale për të njëjtën.

(10) Parashtrimi i ankesës në Bankën Popullore nuk e përjashton apo kufizon të drejtën e përdoruesve të shërbimeve të pagesave apo palëve të tjera të interesuara që të fillojnë kontest gjyqësor me ofruesin e shërbimeve të pagesave, me qëllim të mbrojtjes së interesave të tyre.

(11) Dispozitat nga paragrafët (1), (2), (7), (8), (9) dhe (10) të këtij neni zbatohen edhe për ankesat kundër filialeve dhe agentëve të ofruesve të shërbimeve të pagesave të themeluara në një vend tjetër anëtar që ofron shërbime të pagesave në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(12) Dispozitat nga paragrafët (1), (2), (7), (8), (9) dhe (10) të këtij neni nuk zbatohen për Bankën Popullore, Thesarin dhe Thesarin e Fondit, gjatë kryerjes së shërbimeve të pagesave në kuadër të autorizimeve të tyre.

(13) Në rast se Banka Popullore pranon ankesë kundër ofruesit të shërbimeve të pagesave të krijuar në vendin tjetër anëtar që ofron shërbime të pagesave në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në mënyrë të drejtpërdrejtë ose nëpërmjet agentit, ankesën do ta dorëzojë tek organi mbikëqyrës të vendit amë anëtar.

(14) Dispozitat e këtij neni zbatohen edhe për poseduesit e parasë elektronike.

Procedura jashtëgjyqësore për zgjidhjen e kontesteve

Neni 131

(1) Në rast të procedurës jashtëgjyqësore për zgjidhjen e kontesteve lidhur me të drejtat dhe detyrimet që dalin nga Pjesa e tretë dhe Pjesa e katërt e këtij ligji, ofruesi i shërbimeve të pagesave është i detyruar t'i sigurojë përdoruesit të shërbimeve të pagesave këto informacione:

1) emrin, formën dhe statutin juridik për së paku një person ose organ të autorizuar, kompetent për procedurën jashtëgjyqësore për zgjidhjen e kontesteve;

2) përshkrimin e procedurës për paraqitjen e kërkesës për procedurën jashtëgjyqësore për zgjidhjen e kontesteve, duke përfshirë adresën dhe nëse ekziston adresë e vlefshme e postës elektronike, të cilës përdoruesi i shërbimeve të pagesave mund ta referojë kërkesën, si dhe formular për kërkesë të tillë;

3) afatin në të cilin personi ose organi kompetent për procedurën jashtëgjyqësore për zgjidhjen e kontesteve duhet të veprojë me kërkesë për zgjidhje jashtëgjyqësore të kontesteve; dhe

4) se parashtrimi i kërkesës për procedurë jashtëgjyqësore për zgjidhjen e kontesteve në përputhje me këtë nen dhe rezultatin e procedurës së tillë, nuk cenon të drejtën e përdoruesit të shërbimeve të pagesave për të ngritur procedurë gjyqësore në gjykatën kompetente.

(2) Ofruesi i shërbimeve të pagesave është i detyruar që informacionet sipas paragrafit (1) të këtij neni të përditësuara t'i sigurojë në mënyrë të qartë, gjithëpërfshirëse dhe lehtë të qasshme si më poshtë:

1) në faqen e tij të internetit, nëse ofruesi i shërbimit të pagesave ka faqe interneti,

2) në hapësirat e punës në të cilat i ofron shërbimet e pagesave për konsumatorët dhe

3) në marrëveshjen kornizë në përputhje me nenin 56 paragrafi (1) pika 7 nënpika b të këtij ligji.

(3) Ofruesi i shërbimeve të pagesave është i detyruar të marrë pjesë në procedurën jashtëgjyqësore për zgjidhjen e kontesteve të filluara nga konsumatori.

(4) Ofruesi i shërbimeve të pagesave nuk i paguan konsumatorit kompensim në lidhje me procedurën jashtëgjyqësore për zgjidhjen e kontesteve.

(5) Dispozitat nga paragrafët (1), (2), (3) dhe (4) të këtij neni zbatohen edhe për emetuesit e parasë elektronike lidhur me detyrimet për emetimin dhe blerjen e parasë elektronike.

(6) Dispozitat nga paragrafët (1), (2), (3) dhe (4) të këtij neni nuk zbatohen për Bankën Popullore, Thesarin dhe Thesarin e Fondit gjatë kryerjes së shërbimeve të pagesave në kuadër të kompetencave të tyre.

(7) Personi ose organi i autorizuar kompetent për procedurën jashtëgjyqësore për zgjidhjen e kontesteve është i detyruar të bashkëpunojë me trupat kompetente për procedurën jashtëgjyqësore për zgjidhjen e kontesteve të vendeve të tjera anëtare në lidhje me të drejtat dhe detyrimet që dalin nga dispozitat Pjesa tretë dhe Pjesa e katërt e këtij ligji.

Pjesa e pestë

SISTEMET E PAGESAVE

Kapitulli I

Kushtet e punës së sistemeve të pagesave

Dispozita të përgjithshme

Neni 132

(1) Sistemi i pagesave krijohet me marrëveshje me shkrim për pjesëmarrje në sistemin e pagesave lidhur ndërmjet të gjithë pjesëmarrësve (marrëveshje shumëpalëshe) prej të cilave njëri përcaktohet si operator i sistemit të pagesave ose me marrëveshje të veçanta me shkrim të lidhura ndërmjet operatorit të sistemit të pagesave dhe secilit pjesëmarrës individual (marrëveshje dypalëshe).

(2) Operatori i sistemit të pagesave mund të ofrojë shërbime të pagesave dhe/ose të emetojë para elektronike me leje të marrë paraprakisht në përputhje me dispozitat e Pjesës së dytë të këtij ligji dhe/ose të kryejë shërbime dhe/ose veprimtari të tjera që nuk përbëjnë ofrimin e shërbimeve të pagesave, përkatësisht emetimin e parave elektronike.

(3) Operatori i sistemit të pagesave është i detyruar që ta njoftojë Bankën Popullore së paku 30 ditë para fillimit të realizimit të shërbimeve dhe/ose veprimtarive të tjera që nuk paraqesin dhënien e shërbimeve të pagesave, përkatësisht lemetimin e parave elektronike, për ndikimin e veprimtarive të reja mbi gjendjen financiare, strukturën organizative, sistemin e kontrollit të brendshëm dhe stabilitetin, sigurinë dhe efikasitetin në punën e sistemit të pagesave.

(4) Në rastin sipas paragrafit (3) të këtij neni, Banka Popullore vlerëson nëse shërbimet dhe/ose veprimtarit e tjera që nuk paraqesin ofrimin e shërbimeve të pagesave, përkatësisht emetimin e parave elektronike cenojnë ose mund të cenojnë stabilitetin, sigurinë dhe efikasitetin e punën e sistemit të pagesave ose të rëndojnë mundësinë që Banka Popullore të monitorojë punën dhe harmonizimin e operatorit të sistemit të pagesave me kushtet e përcaktuara me këtë ligj dhe nëse vlerëson se është e nevojshme, ta detyrojë që të ndërmarrë aktivitetet dhe masat konkrete.

(5) Operatori i sistemit të pagesave është i detyruar të njoftojë Bankën Popullore së paku 30 ditë para qëllimit për ndërprerjen e kryerjes së shërbimeve dhe/ose veprimtarive të tjera që nuk paraqesin ofrimin e shërbimeve të pagesave, përkatësisht emetimin e parave elektronike.

Pjesëmarrësit në sistemin e pagesave

Neni 133

(1) Pjesëmarrësi në sistemin e pagesave mund të jenë:

1. ofruesi i shërbimeve të pagesave nga neni 9 paragrafi (1) i këtij ligji;
2. shoqëri investimi, e krijuar në përputhje me ligjin që rregullon tregun e kapitalit,
3. shtëpi kleringu,

4. agjent për shlyerje,
5. pala kontraktuese qendrore,
6. operatori i sistemit të shlyerjes së letrave me vlerë,
7. operatori i sistemit të pagesave dhe
8. operatori i sistemit të pagesave nga vendi anëtar ose vend i tretë përgjegjës për funksionimin e skemës pagesës me kartelë.

(2) Pjesëmarrës në sistemin e pagesave mund të jetë në të njëjtën kohë palë kontraktuese qendrore, agjent shlyerjeje dhe/ose shtëpi kliringu.

(3) Pjesëmarrësi në sistemin e pagesave mund të marrë pjesë në disa sisteme të pagesave.

(4) Pjesëmarrësit në sistemin e pagesave sipas paragrafit (1) pikat 2, 3, 4, 5, 6, 7 dhe 8 të këtij neni marrin pjesë në sistemin e pagesave për nevojat e kliringut dhe/ose shlyerjes së transaksioneve të pagesës dhe/ose transaksioneve të letrave me vlerë.

(5) Pjesëmarrësit në sistemin e pagesave sipas paragrafit (1) pika 1 të këtij neni, të cilët nuk hapin dhe mbajnë llogari të pagesave të përdoruesve të shërbimeve të pagesave, mund të jenë vetëm pjesëmarrës indirekt në sistemin e pagesave nëpërmjet bankës ose kursimores që është pjesëmarrëse në sistemin e pagesave.

(6) Pjesëmarrësi në sistemin e pagesave është i detyruar me kërkesën e secilit shfrytëzues apo shfrytëzues potencial të shërbimeve të pagesave, ta informojë për secilin sistem të pagesave në të cilin pjesëmarrësi merr pjesë dhe t'i japë informacion për rregullat sa i përket funksionimit të sistemit të pagesave.

(7) Agjent për shlyerje në sistemin e pagesave mund të jetë ofrues i shërbimeve të pagesave nga neni 9 paragrafi (1) pikat 1, 2, 3, 4 dhe 9 të këtij ligji, që është pjesëmarrës në sistemin e pagesave.

(8) Agjenti për shlyerje siguron procedura administrative të sigurta dhe efektive dhe procedura për komunikim me pjesëmarrësit në sistemin e pagesave, të cilat janë të përshtatshme për veçoritë e sistemit të pagesave dhe vëllimit të transaksioneve të realizuara në sistem.

Rregullat për punën e sistemit të pagesave

Neni 134

(1) Sistemi i pagesave duhet të ketë dhe të punojë sipas rregullave të përcaktuara nga operatori i sistemit të pagesave.

(2) Rregullat për punën e sistemit të pagesave sipas paragrafit (1) të këtij neni në veçanti përmbajnë:

1) kushtet për pjesëmarrje në sistemin e pagesave, mënyra dhe kushtet për përfshirjen e pjesëmarrësve të rinj dhe për përjashtimin e përkohshëm ose të përhershëm të pjesëmarrësve nga sistemi i pagesave;

2) të drejtat dhe detyrimet e operatorit të sistemit të pagesave dhe pjesëmarrësve në sistemin e pagesave;

3) mënyra e bartjes së urdhëresave për bartje, mënyra e verifikimit të korrektësisë së urdhëresave për bartje dhe afati kohor për njoftim në rast të refuzimit të urdhëresës për bartje;

4) momentin e vendosjes dhe të parevokueshmërisë së urdhëresës së bartjes;

5) plan me afat sipas të cilit punon sistemi i pagesave;

6) valutat për të cilat mund të bazohen urdhëresat për bartje në sistemin e pagesave;

7) procedurën për llogaritjen e detyrimeve financiare që rrjedhin nga urdhëresat e bartjes, bazuar në kliringun dhe/ose shlyerjen ndërmjet pjesëmarrësve në sistemin e pagesave dhe për njoftimin e pjesëmarrësve për kliringun dhe/ose shlyerjen dhe

8) rregullat për menaxhimin e rreziqeve operative, rrezikut të sigurisë së sistemeve informative, rrezikut të shlyerjes dhe rreziqeve të tjera në sistemin e pagesave.

Qasja në sistemet e pagesave

Neni 135

(1) Sistemi i pagesave nëpërmjet rregullave nga neni 134 paragrafi (1) i këtij ligji duhet të sigurojë kushte objektive, jodiskriminuese dhe proporcionale për qasje të pjesëmarrësve në sistemin e pagesave, pavarësisht nëse janë pjesëmarrës të drejtpërdrejtë apo pjesëmarrës indirekt në sistemin e pagesave. Qasja mund të kufizohet vetëm për qëllimin e mbrojtjes ndaj rrezikut të shlyerjes, rrezikut operativ dhe rrezikut afarist, si dhe për shkak stabilitetit financiar dhe operativ të sistemit të pagesave.

(2) Sistemi i pagesave nuk guxon t'u vendosë kushte pjesëmarrësve në sistemet e pagesave, përdoruesve të shërbimeve të pagesave ose sistemeve të tjera të pagesave me të cilat:

1) kufizohet pjesëmarrja në sistemet e tjera të pagesave;

2) bëhet dallimi ndërmjet ofruesve të shërbimeve të pagesave në lidhje me të drejtat, detyrimet dhe kompetencat e tyre dhe

3) bëhen kufizime në bazë të statusit institucional.

(3) Dispozitat nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni nuk i referohen:

1) sistemeve të pagesave nga neni 152 i këtij ligji, dhe

2) sistemeve të pagesave të përbëra ekskluzivisht nga ofruesit e shërbimeve të pagesave nga neni 9 paragrafi (1) i këtij ligji që i përkasin të njëjtit grup.

(4) Nëse pjesëmarrësi në sistemin e pagesave sipas paragrafit (3) pika 1 të këtij neni, ofruesit të shërbimeve të pagesave i cili nuk është pjesëmarrës në sistemin e pagesave i mundëson ekzekutimin e urdhërësive për bartje nëpërmjet sistemit të pagesave, ku është i detyruar që të ofrojë të njëjtën mundësi në mënyrë objektive, proporcionale dhe jodiskriminuese, edhe ofruesve të tjerë të shërbimeve të pagesave nëse ata e kërkojnë këtë.

(5) Në rast se pjesëmarrësi në sistemin e pagesave sipas paragrafit (3) pika 1 të këtij neni refuzon të ekzekutojë urdhëresën për bartje të ofruesit tjetër i shërbimeve të pagesave i cili ka kërkuar ekzekutimin e urdhëresës për bartje, është i detyruar t'i dorëzojë ofruesit të shërbimit të pagesave arsyetimin e arsyeve për refuzim, me shkrim ose me anë të postës elektronike.

(6) Operatori i sistemit të pagesave është i detyruar për çdo ndryshim të kompensimeve të paguara nga pjesëmarrësit në sistemin e pagesave t'i njoftojë më së voni dy muaj para datës së fillimit të zbatimit të ndryshimit.

Klasifikimi dhe mbikëqyrja e sistemeve të pagesave

Neni 136

(1) Banka Popullore përcakton sistemet e pagesave të rëndësishme, sistematike të rëndësishme dhe të tjera në bazë të kriterëve të klasifikimit.

(2) Këshilli i Bankës Popullore, me akt nënligjor më hollësisht i përcakton:

- kriteret për klasifikimin e sistemeve të pagesave sipas paragrafit (1) të këtij neni dhe standardet për punën e tyre nëpërmjet zbatimit të standardeve të miratuara nga trupat *undernплатувае* dhe/ose europiane;

- kufirin e sipërm të vlerës së pagesave me vlerë të ulët të realizuara ndërmjet ofruesve të shërbimeve të pagesave dhe

- llojin e raporteve për punën e sistemeve të pagesave, si dhe mënyrën dhe afatet e dorëzimit të tyre.

Kapitulli II

Lëshimi i lejes për operator të sistemit të pagesave

Kushtet e punës së operatorit të sistemit të pagesave

Neni 137

(1) Shoqëria tregtare mund të menaxhojë sistemin e pagesave vetëm nëse ka leje nga Banka Popullore për operator të sistemit të pagesave.

(2) Shuma e vlerës kontabël të kapitalit dhe rezervave nga bilanci i gjendjes së operatorit të sistemit të pagesave, me të cilat duhet të jenë vazhdimisht në dispozicion të operatorit të sistemit të pagesave, nuk mund të jenë më pak se vlera e kapitalit fillestar nga neni 138 paragrafi (2) pika 2 e këtij ligji.

(3) Dispozitat e Kapitullit II të Pjesës së pestë të këtij ligji, me përjashtim të nenit 150 të këtij ligji, nuk zbatohen nëse operator i sistemeve të pagesave është Banka Popullore.

(4) Me përjashtim të paragrafit (1) të këtij neni, nuk nevojitet miratim lidhur me punën e operatorit të sistemit të pagesave nga vendi anëtar ose nga një vend i tretë përgjegjës për funksionimin e skemës së pagesave me kartelë.

Parashtrimi i kërkesës për marrjen e lejes për operator të sistemit të pagesave

Neni 138

(1) Shoqëria tregtare e cila synon të kryejë veprimtarinë e operatorit të sistemit të pagesave paraqet kërkesë në Bankën Popullore për marrjen e lejes për operator të sistemit të pagesave (në tekstin e mëtejshëm të Kapitullit II Pjesa e pestë e këtij ligji: parashtruesi i kërkesës).

(2) Bashkë me kërkesën sipas paragrafit (1) të këtij neni, parashtruesi i kërkesës veçanërisht dorëzon:

1) adresë të selisë dhe dëshmi se shoqëria është e regjistruar si shoqëri aksionare në Regjistrin tregtar që mbahet në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut, jo më të vjetër se 30 ditë nga dita e paraqitjes së kërkesës;

2) dëshmi se posedon kapital fillestar prej së paku 7.800.000 denarë vetëm në formë financiare dhe të paguhet në tërësi, me çka kapitali fillestar i paguar në tërësi shënohet si kryeqi në regjistrin tregtar që udhëhiqet nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut;

3) statut të shoqërisë;

4) plan afarist për veprimtarinë e operatorit të sistemit të pagesave, i përshtatshëm për krijimin e kushteve për punë stabile dhe të sigurtë të sistemit të pagesave dhe vlerësimin e ndikimit në veprimtarinë e operatorit të sistemit të pagesave nga veprimtari tjetër që kryen ose do ta kryejë shoqëria tregtare që synon të kryejë veprimtarinë e operatorit të sistemit të pagesave;

5) propozim rregulla për punën e sistemit të pagesave, në përputhje me nenin 134 të këtij ligji, me projekt marrëveshje bilaterale ose marrëveshje shumëpalëshe me të cilat themelohet sistemi i pagesave, në përputhje me nenin 132 paragrafi (1) të këtij ligji;

6) përshkrim të sistemit të menaxhimit, i cili në veçanti përfshin sistemin e kontrollit të brendshëm;

7) përshkrim të kushteve organizative, kadrovike dhe teknike të përshtatshme për kryerjen e veprimtarive si operator i sistemit të pagesave;

8) përshkrim të sistemeve, politikave dhe procedurave për menaxhimin e rreziqeve operative, financiare dhe të tjera në sistemin e pagesave;

9) për personat që janë anëtarë të këshillit drejtues, përkatësisht anëtarë ekzekutiv të këshillit të drejtorëve tek parashtruesi i kërkesës;

- dëshmi të identitetit,
- dëshmi të kompetencës profesionale dhe
- dëshmi të reputacionit nga neni 19 paragrafi (5);

10) për personat të cilët nëpërmjet personave me të cilët kanë marrëdhënie të ngushta posedojnë pjesëmarrje të kualifikuar në shoqërinë tregtare që paraqet kërkesë, të paktën këto të dhëna:

- a. për personin juridik:
 - forma juridike,
 - struktura e pronësisë,
 - lidhje të ngushta,
 - gjendja financiare dhe
 - dëshmitë për reputacionin nga neni 19 paragrafi (6) i këtij ligji;

- b. për personin fizik:
 - identiteti,
 - personat me të cilët ka marrëdhënie të ngushta,
 - eksperiencë profesionale,
 - gjendja pronësore,
 - burimet e të ardhurave dhe
 - dëshmi për reputacionin nga neni 19 paragrafi (5);

11) listën e personave me të cilët parashtruesi i kërkesës ka marrëdhënie të ngushta dhe përshkrimi i mënyrës së lidhjes.

(3) Kërkesa sipas paragrafit (1) të këtij neni dhe provat sipas paragrafit (2) pikat 1 dhe 9 alinea 3, 10 nënpikat a) alinea 1, 2 dhe 5 dhe b) alinea 6 e këtij neni mund të parashtrohen drejtpërdrejt në arkivin e Bankës Popullore, me postë të rekomanduar ose në formë elektronike duke përdorur mjet identifikimi elektronik nëpërmjet Portalit Nacional të Shërbimeve Elektronike.

(4) Në rast të ndërprerjes teknike të funksionimit të Portalit Nacional të Shërbimeve Elektronike, kërkesa sipas paragrafit (1) të këtij neni dhe dëshmitë sipas paragrafit (2) pika 1 dhe 9 alinea 3, 10 nënpikat a) alinea 1, 2 dhe 5 dhe b) alinea 6 të këtij neni dorëzohen në adresën e vlefshme të postës elektronike të Bankës Popullore në formë të dokumentit elektronik nëpërmjet dorëzimit të kualifikuar elektronik të rekomanduar.

(5) Personi i autorizuar zyrtar nga Banka Popullore i cili vepron ndaj kërkesës sipas paragrafit (1) të këtij neni, është i detyruar në afat prej pesë ditësh nga dita e pranimi të kërkesës, dokumentet sipas paragrafit (2) pika 1 dhe 9 alinea 3, 10 nënpikat a) alinea 1, 2 dhe 5 dhe b) alinea 6 e këtij neni, me anë të detyrës zyrtare t'i kërkojë nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(6) Personi i autorizuar zyrtar nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut është i detyruar që dokumentet sipas paragrafit (2) pika 1 dhe 9 alinea 3, 10 nënpikat a) alinea 1, 2 dhe 5 dhe b) alinea 6 e këtij neni, t'i dorëzojë në Bankën Popullore në afat prej tre ditëve nga dita e pranimi të kërkesës sipas paragrafit (5) të këtij neni.

(7) Kërkesa sipas paragrafit (5) të këtij neni mund të parashtrohet, ndërkaq dokumentet sipas paragrafit (2) pika 1 dhe 9 alinea 3, 10 nënpikat a) alinea 1, 2 dhe 5 dhe b) alinea 6 e këtij neni mund të ndërmerren në formë elektronike duke përdorur mjet identifikimi elektronik nëpërmjet Platformës Nationale të Ndërveprueshmërisë.

(8) Në rast të ndërprerjes teknike të funksionimit të Platformës Nationale të Ndërveprueshmërisë, kërkesa sipas paragrafit (5) të këtij neni dorëzohet në adresën elektronike të Regjistrat Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe dokumentet sipas paragrafit (2)

pika 1 dhe 9 alinea 3, 10 nënpikat a) alinea 1, 2 dhe 5 dhe b) alinea 6 e këtij neni, dorëzohen në adresën e vlefshme të postës elektronike të Bankës Popullore në formë të dokumentit elektronik nëpërmjet dorëzimit të kualifikuar elektronik të rekomanduar.

(9) Përveç dokumenteve sipas paragrafit (2) të këtij neni, Banka Popullore mund të kërkojë edhe dokumente, të dhëna dhe/ose informata shtesë nga shoqëria që e parashtron kërkesën.

10) Nëse institucioni i pagesave, përkatësisht institucioni i parasë elektronike paraqet kërkesë për marrjen e lejes për operator të sistemit të pagesave, është i detyruar të paraqesë vlerësim për ndikimin e veprimtarisë së re në gjendjen e tij financiare, strukturën organizative, sistemit të kontrollit të brendshëm dhe sistemit të mbrojtjes së mjeteve të përdoruesve të shërbimeve të pagesave.

(11) Këshilli i Bankës Popullore, me akt nënligjor, në mënyrë të hollësishme i përcakton dokumentet, të dhënat dhe/ose informatat sipas paragrafit (2) të këtij neni, mënyrën e dorëzimit të tyre, si dhe procedurën e vlerësimit të tyre.

Vendimmarrja sipas kërkesave për marrjen e lejes për operatorin e sistemit të pagesave

Neni 139

(1) Guvernatori, sipas kërkesës nga neni 138 të këtij ligji, miraton aktvendim për dhënien e lejes për operator të sistemit të pagesave ose aktvendim për refuzimin e kërkesës, në afat prej 90 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës së plotë.

(2) Nëse kërkesa nuk është e kompletuar, Banka Popullore do ta njoftojë parashtruesin e kërkesës nga neni 138 paragrafi (1) që të dorëzojë dokumentet, të dhënat dhe/ose informatat në afat prej 30 ditësh.

(3) Në afatin sipas paragrafit (1) të këtij neni nuk llogaritet afati i paragrafit (2) të këtij neni.

(4) Guvernatori lëshon leje për operatorin e sistemit të pagesës nëse vlerëson se janë plotësuar kushtet në vijim:

1) me kërkesën dorëzohet dokumentacioni i plotë nga neni 138 paragrafët (2), (9) dhe (10) të këtij ligji;

2) personat të cilët nëpërmjet personave që kanë marrëdhënie të ngushta, posedojnë pjesëmarrje të kualifikuar te personi juridik janë të përshtatshëm, që veçanërisht përfshin gjendjen e mirë financiare dhe reputacionin;

3) personat që janë anëtarë të organit drejtues të personit juridik kanë reputacion dhe kompetencë profesionale që siguron menaxhim të qëndrueshëm, të sigurt dhe efikas të sistemit të pagesave;

4) parashtruesi i kërkesës është i organizuar në pajtim me këtë ligj, përkatësisht janë siguruar kushtet për funksionimin e sistemit të pagesave të parapara me këtë ligj ose rregulloret e miratuara në bazë të këtij ligji;

5) parashtruesi i kërkesës ka strukturë të qartë menaxhuese që përfshin:

- strukturë organizative me kompetenca dhe përgjegjësi të përcaktuara qartë,
- procedura të duhura për identifikimin, monitorimin dhe raportimin e të gjitha rreziqeve ndaj të cilave sistemi i pagesave është ose mund të ekspozohet, dhe

- sistemet e kontrollit të brendshëm, duke përfshirë procedurat administrative dhe kontabiliste, si dhe planin për vazhdimësinë e punës, të cilat janë të përshtatshme dhe proporcionale me natyrën, vëllimin dhe ndërlikueshmërinë e aktiviteteve të sistemit të pagesave, dhe

6) rregullat për punën e sistemit të pagesave janë në përputhje me nenin 134 paragrafi (2) të këtij neni.

(5) Vlerësimi i kushtit të reputacionit sipas paragrafit (4) pika 2 dhe 3 të këtij neni, bëhet në pajtim me nenin 19 paragrafët (5) dhe (6) të këtij ligji.

(6) Leja sipas paragrafit (1) të këtij neni nuk mund t'u bartet personave të tjerë në procedurë për ndryshimet e statusit.

(7) Operatori i sistemit të pagesave është i detyruar që në vazhdimësi t'i plotësojë kushtet sipas paragrafit (4) të këtij neni dhe nga neni 137 paragrafi (2) të këtij ligji.

(8) Operatori i sistemit të pagesave është i detyruar që menjëherë ta njoftojë Bankën Popullore për çdo ndryshim në dokumentet, të dhënat dhe/ose informatat në bazë të të cilave është lëshuar leja.

Pëlqimi për ndryshim dhe/ose plotësim të rregullave për punën e sistemit të pagesave

Neni 140

(1) Operatori i sistemit të pagesave është i detyruar të paraqesë kërkesë për marrjen e pëlqimit paraprak nga Guvernatori për të gjitha ndryshimet dhe/ose plotësimet e rregullave për funksionimin e sistemit të pagesave në pajtim me dispozitat e nenit 138 paragrafi (3) dhe (4) të këtij ligji.

(2) Bashkë me Kërkesën sipas paragrafit (1) të këtij neni dorëzohet edhe propozimi për ndryshim dhe/ose plotësim të rregullave për punën e sistemit të pagesave me arsyetim për të njëjtën.

(3) Ndaj kërkesës për marrjen e pëlqimit sipas paragrafit (1) të këtij neni, guvernatori miraton aktvendim për lëshimin e pëlqimit ose për refuzimin e kërkesës më së voni 30 ditë nga dita e parashtrimit të kërkesës.

(4) Nëse kërkesa nuk është e kompletuar, Banka Popullore do ta njoftojë parashtruesin e kërkesës t'i dorëzojë dokumentet, të dhënat dhe/ose informatat, më së voni në afat prej 15 ditësh.

(5) Në afatin sipas paragrafit (3) të këtij neni nuk llogaritet afati sipas paragrafit (4) të këtij neni.

(6) Guvernatori e refuzon kërkesën sipas paragrafit (1) të këtij neni, nëse vlerëson se ndryshimet dhe/ose plotësimet e propozuara lidhur me rregullat për punën e sistemit të pagesave janë në kundërshtim me nenin 134 paragrafi (2) të këtij ligji ose rrezikojnë sigurinë, stabilitetin dhe efikasitetin e punës së sistemit të pagesave.

(7) Këshilli i Bankës Popullore, me akt nënligjor, nga neni 138 paragrafi (14) të këtij ligji, në mënyrë të hollësishme i përcakton dokumentet, të dhënat dhe/ose informatat për marrjen e pëlqimit sipas paragrafit (2) të këtij neni, mënyrën e dorëzimit të tyre, si dhe procedurën e vlerësimit të tyre.

Ndryshimet ndaj lëshimit të lejes për operatorin e sistemit të pagesave

Neni 141

(1) Operatori i sistemit të pagesave është i detyruar t'i dorëzojë njoftim Bankës Popullore gjatë:

1) rritjes së kapitalit fillestar të operatorit të sistemit të pagesave;

2) ndryshimin e strukturës së pronësisë mbi 5% të numrit të përgjithshëm të aksioneve, përkatësisht nga numri i përgjithshëm i aksioneve të lëshuara me të drejtë vote të operatorit të sistemit të pagesave, pavarësisht nëse aksionet janë fituar gradualisht ose menjëherë, me përjashtim të rastit të fitimit të pjesëmarrjes së kualifikuar;

3) ndryshimit të marrëveshjeve me të cilat është themeluar sistemi i pagesave dhe emri i sistemit të pagesave;

4) ndryshimit të statutit të operatorit të sistemit të pagesave;

5) themelimit të filialit, ose fitimit të pjesëmarrjeve të kualifikuara në shoqëri të tjera tregtare, në Republikën e Maqedonisë së Veriut ose jashtë vendit;

6) ndryshimit të anëtarit të këshillit mbikëqyrës, e anëtarëve joekzekutivë të këshillit të drejtorëve, e personave me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta të cilët janë të punësuar në operatorin e sistemit të pagesave dhe nëse është e zbatueshme, anëtarëve të këshillit të revizionit dhe anëtarëve të këshillit të shpërblimit dhe

7) përkeqësimit të gjendjes financiare të personave të cilët nëpërmjet personave me të cilët kanë marrëdhënie të ngushta posedojnë pjesëmarrje të kualifikuar në operatorin e sistemit të pagesave ose ndonjë informatë tjetër se këta persona nuk i plotësojnë më kushtet sipas nenit 139 paragrafi (4) pika 2 të këtij ligji, nëse operatori i sistemit të pagesave në çfarëdo mënyre e ka marrë këtë informacion.

(2) Me njoftimin sipas paragrafit (1) të këtij neni dorëzohen edhe dokumente, të dhëna dhe/ose informata përkatëse në përputhje me paragrafin (3), (4), (5), (6), (7) dhe (8) të nenit 138 të këtij ligji.

(3) Operatori i sistemit të pagesave është i detyruar që ta dorëzojë njoftimin sipas paragrafit (1) të këtij neni në afat prej pesë ditë pune, nga dita e miratimit të vendimit për ndërmarrjen e veprimit, përkatësisht nga njohuritë e marra në lidhje me paragrafin (1) pika 2 dhe 7 të këtij neni.

Pëlqimi për anëtarët e këshillit drejtues, përkatësisht anëtarëve ekzekutivë të këshillit të drejtorëve

Neni 142

(1) Operatori i sistemit të pagesave është i detyruar të parashtrojë kërkesë për marrjen e pëlqimit paraprak nga guvernatori për çdo emërim të anëtarëve të Këshillit drejtues, përkatësisht anëtarëve ekzekutivë të Këshillit të drejtorëve në pajtim me dispozitat të nenit 138 të këtij ligji.

(2) Anëtari i këshillit drejtues, përkatësisht anëtari ekzekutiv i këshillit të drejtorëve të operatorit të sistemit të pagesave mund të jetë person i cili ka kompetencë profesionale.

(3) Anëtari i këshillit drejtues, përkatësisht anëtari ekzekutiv i këshillit të drejtorëve të operatorit të sistemit të pagesave, nuk mund të jetë person:

1) që është anëtar i Këshillit të Bankës Popullore ose person i punësuar në Bankën Popullore;

2) që nuk ka reputacion, në pajtim me nenin 19 paragrafi (5), pikat dhe 3);

3) i cili nuk ka respektuar dhe/ose zbatuar dispozitat e këtij ligji dhe rregulloret e miratuara në bazë të këtij ligji dhe/ose nuk ka zbatuar ose nuk zbaton dhe/ose ka vepruar ose vepron në kundërshtim me masat ndaj subjekteve mbikëqyrëse të shqiptuara nga guvernatori, me çka është rrezikuar stabiliteti, siguria dhe efikasiteti në punën e sistemit të pagesave;

4) me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta në operator tjetër të sistemit të pagesave, operator të sistemit të shlyerjes së letrave me vlerë, palë kontraktuese qendrore ose person i punësuar në to;

5) anëtari i këshillit mbikëqyrës, anëtar i këshillit drejtues ose anëtar i këshillit të drejtorëve të pjesëmarrësit në sistemin e pagesave dhe

6) i cili ka kryer funksionin e personit me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta në operatorin e sistemit të pagesave, operatorin e sistemit të shlyerjes së letrave me vlerë, palën kontraktuese qendrore, pjesëmarrësin në sistemin e pagesave ose personin tjetër juridik ku është vendosur administrata ose mbi të cilën është hapur procedura e likuidimit ose e falimentimit, përveç nëse Banka Popullore pamëdyshje, në bazë të dokumenteve dhe të dhënave në dispozicion, konstaton se personi nuk ka kontribuar në krijimin e kushteve për vendosjen e procedurës së administrimit, likuidimit ose falimentimit ose e ka kryer funksionin menjëherë para ose pas shfaqja e arsyeve që rezultoi në vendosjen e administrimit, hapjen e procedurave të likuidimit ose falimentimit.

(4) Anëtar i këshillit drejtues, përkatësisht anëtari ekzekutiv i këshillit të drejtorëve të operatorit të sistemit të pagesave njëkohësisht mund të jetë edhe anëtar i këshillit mbikëqyrës, përkatësisht anëtar joekzekutiv i këshillit të drejtorëve më së shumti në dy shoqëri tregtare vendase ose jashtë saj.

(5) Anëtar i këshillit drejtues, përkatësisht anëtar ekzekutiv i këshillit të drejtorëve të operatorit të sistemit të pagesave nuk mund të jetë edhe personi i cili është anëtar i këshillit drejtues ose anëtar ekzekutiv i këshillit të drejtorëve në çdo shoqëri tregtare vendase ose të jashtë saj.

(6) Kufizimet sipas paragrafit (3) pika 6 dhe paragrafët (4) dhe (5) të këtij neni nuk kanë të bëjnë me anëtarësimin në organet e organizatave jofitimprurëse në baza vullnetare.

(7) Anëtarët e këshillit drejtues ose anëtarët ekzekutivë të këshillit të drejtorëve të operatorit të sistemit të pagesave duhet të kenë njohuri dhe përvojë profesionale në fusha të ndryshme që janë të nevojshme për menaxhimin e pavarur të operatorit të sistemit të pagesave, e veçanërisht për të kuptuar aktivitet e kryera nga operatori i sistemit të pagesave dhe rregullat e punës së sistemit të pagesave, ku së paku njëri prej anëtarëve duhet ta njohë gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj kirilik dhe të ketë vendbanim të përhershëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

(8) Operatori i sistemit të pagesave duhet të sigurojë shumicë të anëtarëve të këshillit drejtues, ose anëtarëve ekzekutivë të këshillit të drejtorëve të jenë në dispozicion me kërkesë të Bankës Popullore.

(9) Banka Popullore zhvillon intervistë me anëtarët e propozuar të këshillit drejtues, përkatësisht anëtarët ekzekutivë të këshillit të drejtorëve të operatorit të sistemit të pagesave.

(10) Ndaj kërkesës për marrjen e pëlqimit sipas paragrafit (1) të këtij neni, guvernatori miraton aktvendim për dhënien e pëlqimit ose për refuzimin e kërkesës në afat prej 60 ditë nga dita e parashtrimit të kompletuar kërkesë.

(11) Nëse kërkesa nuk është e kompletuar, Banka Popullore do ta njoftojë parashtruesin e kërkesës që të dorëzojë dokumentet, të dhënat dhe/ose informatat më së voni në afat prej 30 ditësh.

(12) Në afatin sipas paragrafit (10) të këtij neni nuk llogaritet afati sipas paragrafit (11) të këtij neni.

(13) Guvernatori refuzon kërkesën për pëlqim sipas paragrafit (1) të këtij neni, nëse:

1) kërkesa përmban të dhëna dhe informacione të pasakta, të pavërteta ose jo të plota;

2) personi i propozuar nuk i plotëson kushtet e nevojshme për emërimin e tij në pajtim me paragrafët (2), (3), (4), (5) dhe (7) të këtij neni të ligjit.

(14) Me vendimmarjen për dhënien e pëlqimit sipas paragrafit (1) të këtij neni, guvernatori vlerëson kompetencën profesionale dhe reputacionin e anëtarëve të propozuar të këshillit drejtues ose anëtarëve ekzekutivë të këshillit të drejtorëve të operatorëve të sistemit të pagesës.

(15) Vlerësimi i kushtit të reputacionit sipas paragrafit (3) pika 4 të këtij neni, bëhet në pajtim me nenin 19 paragrafi (5) të këtij ligji.

(16) Këshilli i Bankës Popullore, sipas aktit nënligjor të nenit 138 paragrafi (11) të këtij ligji, në mënyrë të hollësishme i përcakton dokumentet, të dhënat dhe/ose informatat për marrjen e pëlqimit sipas paragrafit (1) të këtij neni dhe mënyrën e dorëzimit të tyre, si dhe procedurën e vlerësimit të tyre.

Refuzimi i kërkesës për marrjen e lejes për operator të sistemit të pagesave

Neni 143

(1) Guvernatori me aktvendim refuzon kërkesën për marrjen e lejes për operator të sistemit të pagesave nga neni 138 paragrafi (1) i këtij ligji, nëse:

1) nuk plotësohet një nga kushtet sipas nenit 139 paragrafi (4) të këtij ligji;

2) kërkesa përmban të dhëna dhe informacione të pasakta, të pavërteta;

3) vlerëson se për shkak të ekzistimit të marrëdhënieve të ngushta të parashtruesit të kërkesës me persona të tjerë juridikë dhe/ose fizikë, dhe të shënuar në listën nga neni 138 paragrafi (2) pika 11 të këtij ligji, mbikëqyrja mbi operatorin e sistemit të pagesave në përputhje me këtë ligj do të pamundësohej ose do të rëndohej dukshëm;

4) vlerëson se për shkak të kryerjes së shërbimeve dhe/ose veprimtarive të tjera të parashtruesit të kërkesës që nuk kanë të bëjnë me aktivitetet si operator i sistemit të pagesave, do të rrezikohej siguria, stabiliteti dhe efikasiteti i punë së sistemit të pagesave ose se për shkak të këtyre veprimtarive, mbikëqyrja mbi operatorin e sistemit të pagesave në përputhje me këtë ligj do të pamundësohej ose do të pengohej ndjeshëm dhe

5) vlerëson se rregulloret dhe praktikat e shtetit të huaj që zbatohen për personat juridikë dhe/ose fizikë me të cilët parashtruesi i kërkesës ka marrëdhënie të ngushta dhe të shënuara në listën nga neni 138 paragrafi (2) pika 11 të këtij ligji, do të bënin të pamundur mbikëqyrjen e operatorit të sistemit të pagesave dhe do t'i vështirësonin ato në mënyrë të konsiderueshme.

(2) Në rast se kërkesa për marrjen e lejes për operator të sistemit të pagesave refuzohet për arsyet e cekura në paragrafin (1) pika 4 të këtij neni, guvernatori në arsyetimin e aktvendimit me të cilin refuzohet kërkesa, do t'i sugjerohet parashtruesit të kërkesës, mundësia e themelimit të shoqërisë tregtare të veçantë dhe paraqitjes së kërkesës së re për marrjen e lejes për operator të sistemit të pagesave për këtë shoqëri tregtare.

Ndërprerja e punës së operatorit të sistemit të pagesave

Neni 144

(1) Operatori i sistemit të pagesave të rëndësishëm ose sistematikisht të rëndësishëm është i detyruar në formë të shkruar në paragrafin (3),(4),(5),(6),(7) dhe (8) të nenit 138 të këtij ligji ta njoftojë Bankën Popullore për qëllimin që të miratojë vendim për ndërprerjen e punës.

(2) Guvernatori me aktvendim jep pëlqim për ndërprerjen e punës nëse vlerëson se operatori i sistemit të pagesave sipas paragrafit (1) të këtij neni ka ndërmarrë masat dhe aktivitetet e nevojshme me qëllim të ndërprerjes së tij si operator i sistemit të pagesave të mos të ndikojë në stabilitetin financiar dhe në stabilitetin dhe sigurinë e pjesëmarrësve në sistemin e pagesave dhe të sigurojë përmbushjen e plotë dhe në kohë të detyrimeve të ndërmarra në lidhje me transaksionet e pagesave të kryera nëpërmjet sistemit të pagesave.

(3) Operatori i sistemit të pagesave sipas paragrafit (1) të këtij neni nuk mund të ndërpres punën para marrjes së pëlqimit paraprak sipas paragrafit (2) të këtij neni.

Pjesëmarrje e kualifikuar në operatorin e sistemit të pagesave

Neni 145

Për pjesëmarrjen e kualifikuar në operatorin e sistemit të pagesave në mënyrë të përshtatshme zbatohen nenet 23, 24, 25, 169 dhe 170 të këtij ligji.

Organet e operatorit të sistemit të pagesave të rëndësishme ose sistemikisht të rëndësishme

Neni 146

(1) Organet e operatorit të sistemit të pagesave të rëndësishëm ose sistemikisht të rëndësishëm, të përcaktuara në pajtim me aktin nënligjor të nenit 136 paragrafi (2) i këtij ligji, janë:

- 1) Këshilli drejtues dhe këshilli mbikëqyrës ose këshilli i drejtorëve;
 - 2) Këshilli i menaxhimit me rreziqet i përbërë nga të paktën tre, por jo më shumë se nëntë anëtarë;
dhe
 - 3) këshillet tjera, të përcaktuara në pajtim me statutin e operatorit të sistemit të pagesave.
- (2) Anëtarët e këshillit të menaxhimit me rreziqe përzgjedhen nga radhët e personave me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta të cilët janë të punësuar në operatorin e sistemit të pagesave.
- (3) Së paku njëri nga anëtarët e këshillit të menaxhimit me rreziqe është nga radhët e anëtarëve ekzekutivë të këshillit të drejtorëve ose nga radhët e anëtarëve të këshillit drejtues së operatorit të sistemit të pagesave, i cili është edhe kryetar i këtij këshilli.
- (4) Anëtarët joekzekutivë të këshillit të drejtorëve, anëtarët e këshillit mbikëqyrës, anëtarët e këshillit për menaxhim me rreziqet përveç kushteve nga neni 142 paragrafi (2) pika 1 dhe 2 dhe paragrafi (3) pikat 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6 të këtij ligji, duhet të kenë njohuri për punën e sistemit të pagesave dhe për rreziqet ndaj të cilave është i ekspozuar operatori i sistemit të pagesave.
- (5) Me statutin e operatorit të sistemit të pagesave, operatori i sistemit të pagesave në mënyrë të hollësishme do të përcaktojë numrin, përbërjen, kompetencat, të drejtat, detyrat, përgjegjësitë dhe mënyrën e punës së organeve të menaxhimit të operatorit të sistemit të pagesave, si dhe numrin, afatin e caktuar kohor, kompetencat, të drejtat, përgjegjësitë dhe kushtet për emërimin e personave me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta të cilët janë të punësuar në operatorin e sistemit të pagesave.

Regjistri i operatorëve të sistemit të pagesave

Neni 147

- (1) Banka Popullore është e detyruar të mbajë regjistër të operatorëve të sistemit të pagesave për të cilët ka lëshuar leje.
- (2) Regjistri sipas paragrafit (1) të këtij neni mbahet në formë elektronike, është publik dhe është i disponueshëm në faqen e internetit të Bankës Popullore dhe përditësohet në bazë të rregullt.
- (3) Këshilli i Bankës Popullore sipas aktit nënligjor të nenit 138 paragrafi (11) i këtij ligji në mënyrë të hollësishme do të përcaktojë përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrit sipas paragrafit (1) të këtij neni, si dhe mënyrën e fshirjes së të dhënave nga regjistri.

Librat tregtare, raportet financiare dhe revizioni

Neni 148

Për librat tregtare, raportet financiare dhe revizioni i operatorit të sistemit të pagesave, në mënyrë përkatëse zbatohet neni 33 paragrafët (1),(2) dhe (3), 34, 35 paragrafët (1), (2) dhe (3) pika 1, 2, 3, 4, 5, 6 dhe 8 dhe 36 të këtij ligji.

Përdorimi i shërbimeve nga persona të huaj

Neni 149

Për shfrytëzimin e shërbimeve nga persona të huaj te operatori i sistemit të pagesave në mënyrë përkatëse zbatohet neni 40 i këtij ligji.

Mbrojtja e të dhënave personale dhe sekreti i afarist

Neni 150

(1) Operatori i sistemit të pagesave përpunimin e të dhënave personale e kryen në pajtim me Ligjin e Mbrojtjes së të Dhënave Personale.

(2) Operatori i sistemit të pagesave ndërmerr veprime dhe aktivitete për mbrojtjen e të dhënave personale të personave fizikë, tek të cilët ka qasje me anë të urdhërësave për bartje që ofruesit e shërbimeve të pagesave ia dorëzojnë operatorit të sistemit të pagesave, i përpunon dhe/ose i ruan dhjetë vjet më vonë, pas skadimit të vitit kalendarik në të cilin ka pasur qasje në të dhënat personale. Të dhëna personale konsiderohen: emri dhe mbiemri i personit që është pagues ose pranues, numri amë i qytetarit, adresa si dhe të dhëna të tjera nëpërmjet të cilave personat mund të identifikohen në mënyrë të drejtpërdrejt ose indirekt.

(3) Dokumentet, të dhënat dhe/ose informacionet të cilat i ka fituar operatori i sistemit të pagesave gjatë përpunimit të urdhërësave për bartje paraqesin sekret afarist dhe mund të përdoren ekskluzivisht për qëllimet për të cilat janë marrë.

(4) Dokumentet, të dhënat dhe/ose informacionet sipas paragrafit (3) të këtij neni operatori i sistemit të pagesave në mënyrë përkatëse do t'i zbatojë dispozitat e nenit 128 paragrafët (2), (3) dhe (4) të këtij ligji.

Kapitulli III

Rregullat e finalizimit të shlyerjes

Përfshirja

Neni 151

Kapitulli III i Pjesës së pestë i referohet sistemeve të pagesave për të cilat zbatohen rregullat e finalizimit të shlyerjes.

Përcaktimi i sistemeve të pagesave

Neni 152

(1) Banka Popullore përcakton sistemet e pagesave për të cilat zbatohen rregullat e finalizimit të shlyerjes.

(2) Sistemet e pagesave sipas paragrafit (1) të këtij neni, Banka Popullore i përcakton në bazë të vëllimit dhe vlerës së urdhërësave të bartjes që shlyhen në sistemin e pagesave dhe pjesëmarrjes së sistemeve të tjera të pagesave, sistemeve të shlyerjes së letrave me vlerë ose palës kontraktuese qendrore që shlyen transaksionet në sistemin e pagesave.

(3) Këshilli i Bankës Popullore sipas aktit nënligjor të nenit 136 paragrafi (2) i këtij ligji më hollësisht i përcakton kriteret sipas paragrafit (2) të këtij neni.

(4) Agjent për shlyerjen e sistemeve të pagesave të përcaktuara në pajtim me paragrafin (1) të këtij neni është Banka Popullore.

(5) Banka Popullore i njofton trupat kompetente europiane të tregjeve financiare për sistemet e përcaktuara të pagesave sipas paragrafit (1) të këtij neni.

Mekanizmi i garancisë

Neni 153

(1) Operatori i sistemit të pagesave i përcaktuar në pajtim me nenin 152 paragrafi (1) të këtij ligji, i cili bën klering të urdhërësave të bartjes, është i detyruar që të krijojë mekanizëm garantues për punë të qëndrueshme dhe të sigurt të sistemit të pagesave.

(2) Mekanizmi i garancisë sipas paragrafit (1) të këtij neni përbëhet nga mjete financiare dhe/ose letra me vlerë dhe/ose aranzhmanet e dakorduara për shpërndarjen e humbjeve ndërmjet pjesëmarrësve në sistemin e pagesave nëse njëri prej tyre nuk është në gjendje të përmbushë detyrimet për të shlyer urdhëresat e bartjes.

(3) Këshilli i Bankës Popullore sipas aktit nënligjor të nenit 136 paragrafi (2) i këtij ligji në mënyrë të hollësishme përcakton krijimin e mekanizmit të garancisë.

Vendosja e urdhëresës për bartje

Neni 154

(1) Rregullat për punën e sistemit të pagesave e përcaktojnë momentin e momentin e vendosjes së urdhëresës së bartjes në sistemin e pagesave.

(2) Në rastin e sistemeve të ndërveprueshmërisë, çdo sistem i pagesës në rregullat e tij përcakton momentin e vendosjes së urdhëresës për bartje në sistem, në mënyrë që do të sigurojë shkallën më të lartë të mundshme të harmonizimit me rregullat e të gjitha sistemeve të përfshira të ndërveprueshmërisë në lidhje me momentin e vendosjes.

(3) Rregullat për punën e sistemeve të pagesave të cilat përcaktojnë momentin e vendosjes së urdhëresës së bartjes nuk varen nga rregullat për funksionimin e sistemeve të tjera me të cilat ai sistem është i interoperabil, përveç kur ekzistimi i ndërvarësisë përcaktohet shprehimisht nga rregullat e të gjitha sistemeve, që marrin pjesë në sisteme ndërvepruese.

Parevokueshmëria e urdhëresës së bartjes

Neni 155

(1) Me rregullat për punën e sistemit të pagesave përcaktohet momenti në të cilin urdhëresa e bartjes që është e vendosur në sistem nuk mund të revokohet nga asnjë pjesëmarrës në sistemin ose nga personi i tretë.

(2) Në rastin e sistemeve të ndërveprueshmërisë, çdo sistem pagese do të përcaktojë në rregullat e tij momentin e ndërveprueshmërisë së urdhëresave të bartjes në sistem, në mënyrë që do të sigurojë shkallë më të lartë të mundshme të harmonizimit të rregullave e të gjitha sistemeve të përfshira të ndërveprueshmërisë në lidhje me momentin e parevokueshmërisë.

(3) Rregullat për punën e sistemit të pagesave me të cilat përcaktohet momenti i parevokueshmërisë së urdhëresës për bartje nuk varen nga rregullat e sistemeve të tjera me të cilat ai sistem është interoperabil, përveç kur ekzistimi i ndërvarësisë përcaktohet shprehimisht nga rregullat e të gjitha sistemeve, që janë pjesë e sistemeve të Ndërveprueshmërisë.

Zbatimi i urdhëresave për bartje dhe netimi në rast falimentimi

Neni 156

(1) Në rast të procedurës së falimentimit mbi pjesëmarrësin në sistemin e pagesave ose në sistemin e Ndërveprueshmërisë ose mbi operatorin e sistemit të Ndërveprueshmërisë që nuk është pjesëmarrës, urdhëresat e bartjes dhe netimi do të konsiderohen ligjërisht të detyrueshme dhe nuk mund të kundërshtohen nga palët e treta, me kusht që urdhëresat e bartjes të vendosen në sistem para momentit të hapjes së procedurës së falimentimit nga neni 157 paragrafi (1) i këtij ligji.

(2) Me përjashtim të paragrafit (1) të këtij neni, urdhëresat e bartjes vendosen në sistemin e pagesave pas momentit të hapjes së procedurës së falimentimit ndaj pjesëmarrësit në sistemin e pagesave ose sistemin interoperabil dhe ekzekutohen në një ditë pune të përcaktuar nga sistemi

afatshkurtër i planit të pagesave, në të cilin hapet procedura e falimentimit, konsiderohen ligjërisht të detyrueshme dhe nuk mund të kundërshtohen nga palët e treta vetëm nëse operatori i sistemit të pagesave mund të dëshmojë se në momentin kur urdhëresat për bartje janë bërë të parevokueshme, ai nuk e ka ditur dhe as mundet ta dinte për hapjen e procedurës së falimentimit.

(3) Në rast të hapjes së procedurës së falimentimit ndaj pjesëmarrësit në sistemin e pagesave ose në një sistem të Ndërveprueshmërisë, mjetet e disponueshme në llogarinë e shlyerjes së pjesëmarrësit mund të përdoren për përmbushjen e detyrimeve të pjesëmarrësit në sistemin e pagesave ose në sistemin e Ndërveprueshmërisë gjatë ditës së punës së hapjes së procedurës së falimentimit.

(4) Zhvleftësimi ose refuzimi i marrëveshjeve dhe/ose transaksioneve të lidhura para momentit të hapjes së procedurës së falimentimit ndaj pjesëmarrësit në sistemin e pagesave ose ndaj operatorit të sistemit ndërveprues, nuk do të çojë në tërheqje, zhvleftësim ose anulim të netimit.

Procedura e falimentimit

Neni 157

(1) Momenti i hapjes së procedurës së falimentimit është dita dhe ora e përcaktuar në aktvendimin e gjykatës kompetente për hapjen e procedurës së falimentimit ndaj pjesëmarrësit në sistemin e pagesave.

(2) Gjykata kompetente ia dorëzon menjëherë aktvendimin sipas paragrafit (1) të këtij neni Bankës Popullore.

(3) Banka Popullore e njofton menjëherë operatorin e sistemit të pagesave, pjesëmarrësit të të cilit i referohet aktvendimi sipas paragrafit (1) të këtij neni.

(4) Banka Popullore e njofton menjëherë Këshillin European për rreziqet sistemike, vendet tjera anëtare dhe trupat kompetente të themeluara në përputhje me rregulloret e miratuara nga Parlamenti European dhe nga Këshilli.

(5) Banka Popullore, njoftimin për hapjen e procedurës së falimentimit ndaj pjesëmarrësit në sistemin e pagesave të pranuar nga vendi tjetër anëtar menjëherë e përcjellë tek operatori i sistemit të pagesave të cilit i referohet raportimi.

(6) Të drejtat dhe detyrimet e pjesëmarrësve që dalin ose lidhen me pjesëmarrjen e tij në sistemin e pagesave, të krijuara para momentit të hapjes së procedurës së falimentimit të pjesëmarrësit në sistemin e pagesave, nuk mund të anulohen.

(7) Dispozitat sipas paragrafit (6) të këtij neni zbatohen edhe për të drejtat dhe detyrimet e pjesëmarrësit në sistemin interoperabil ose të operatorit të sistemit ndërveprues i cili nuk është pjesëmarrës në sistem.

Mbrojtja e mjeteve të sigurisë

Neni 158

(1) Mjetet e sigurisë që i jepen operatorit të sistemit të pagesave, pjesëmarrësit në sistemin e pagesave dhe Bankës Popullore në lidhje me pjesëmarrjen në sistemin e pagesave ose sistemin interoperabil nuk hyjnë në masën e falimentimit në procedurën e falimentimit të hapur mbi:

1) pjesëmarrësin në sistemin e pagesës osesistemin ndërveprues, i cili ka dhënë mjetet për siguri;

2) operatorin e sistemit ndërveprues që nuk është pjesëmarrës;

3) palën kontraktuese të Bankës Popullore pjesëmarrëse në sistemin e pagesave dhe

4) personat e tretë që kanë dhënë mjete sigurie.

(2) Në rast të hapjes së procedurës së falimentimit, mjetet e sigurimit sipas paragrafit (1) të këtij neni mund të konvertohen për shkak përmbushjes së detyrimeve që dalin nga pjesëmarrja në sistemin e pagesave ose në sistemin interoperabil.

(3) Në rast se operatori i sistemit të pagesave ka dhënë mjete për sigurimin e operatorit tjetër të sistemit të pagesave në lidhje me sistemin interoperabil, mjetet për sigurimin e operatorit të sistemit të pagesave që i ka siguruar këto mjete nuk hyjnë në masën e falimentimit në procedurën e falimentimit të operatorit të sistemit të pagesave që ka pranuar mjete për sigurim.

(4) Dispozitat e këtij neni zbatohen edhe për mjetet që përbëjnë mekanizmin garantues nga neni 153 i këtij ligji.

Pjesa e gjashtë **MBIKËQYRJA**

Dispozita të përgjithshme

Neni 159

(1) Banka Popullore mbikëqyr punën e ofruesve të shërbimeve të pagesave nga neni 9 paragrafi (1) pikat 1, 2, 3, 5 dhe 7 të këtij ligji dhe emetuesve të parasë elektronike nga neni 9 paragrafi (2) pikat 1, 2, 3 dhe 5 të këtij ligji, agjentëve të tyre, operatorëve të sistemeve të pagesave nga neni 133 paragrafi (1) pika 7 dhe personave të jashtëm në mënyrë dhe procedurë të përcaktuar me këtë ligj (në tekstin e mëtejshëm: subjekti/dhe i mbikëqyrjes).

(2) Nëpërmjet mbikëqyrjes sipas paragrafit (1) të këtij neni, Banka Popullore verifikon harmonizimin e subjekteve mbikëqyrëse me dispozitat e këtij ose të ligjit tjetër dhe/ose rregulloret e miratuara në bazë të tyre sipas së cilave Banka Popullore mbikëqyr punën e subjekteve të mbikëqyrjes.

(3) Shpeshësia dhe përfshirja e mbikëqyrjes kryhet në varësi të llojit, vëllimit dhe ndërlikueshmërisë së aktiviteteve që realizojnë subjektet mbikëqyrëse, si dhe rreziqet ndaj të cilave janë të ekspozuara në punën e tyre.

Mënyra e kryerjes së mbikëqyrjes

Neni 160

(1) Banka Popullore mbikëqyrjen e kryen nëpërmjet:

1) monitorimit jashtë terrenit të punës së subjekteve mbikëqyrëse duke mbledhur dhe analizuar raportet dhe të dhënat e dorëzuara nga subjektet e mbikëqyrura në Bankën Popullore;

2) mbikëqyrjes së plotë ose të pjesshme në terren në subjektet e mbikëqyrjes;

3) shqiptimit të masave ndaj subjekteve të mbikëqyrjes dhe

4) mbajtjes së kontakteve me anëtarët e organeve të subjekteve të mbikëqyrura dhe me shoqëritë e tyre të revizionit.

(2) Mbikëqyrjen e bëjnë personat zyrtarë në Bankën Popullore të autorizuar nga guvernatori.

(3) Me përjashtim të paragrafit (2), Banka Popullore mund që për realizimin e aktiviteteve të caktuara gjatë mbikëqyrjes në terren, të autorizojë revizorë të certifikuar, shoqëri të revizionit ose persona tjerë të autorizuar.

(4) Personat nga paragrafët (2) dhe (3) të këtij neni, gjatë kryerjes së mbikëqyrjes, në mënyrë të përshtatshme i zbatojnë kërkesat për informacionet dhe/ose të dhëna të besueshme në pajtim me Ligjin për Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(5) Këshilli i Bankës Popullore me akt nënligjor më hollësisht e përcakton mënyrën e kryerjes së mbikëqyrjes sipas paragrafit (1) të këtij neni.

Mbikëqyrja në terren

Neni 161

(1) Banka Popullore kryen mbikëqyrje të plotë ose të pjesshme në terren sipas planit të mbikëqyrjes së përcaktuar më parë dhe sipas nevojës.

(2) Subjekti i mbikëqyrjes është i detyruar që personave të autorizuar nga neni 160 paragrafët (2) dhe (3) të këtij ligji t'u mundësojë kryerjen e pandërprerë të mbikëqyrjes në terren, kushte të përshtatshme për kryerjen e mbikëqyrjes dhe kontrollit në të gjithë dokumentacionin, përfshirë librat tregtare, aktet e brendshme dhe regjistrimet kontabilistike në formë letre ose elektronike.

(3) Personat e autorizuar nga neni 160 paragrafët (2) dhe (3) të këtij ligji përgatisin raport me konstatimet nga mbikëqyrja e kryer në terren.

(4) Subjekti i mbikëqyrjes ka të drejtë të kundërshtojë raportin sipas paragrafit (3) të këtij neni.

Bashkëpunimi dhe shkëmbimi i informacionit

Neni 162

Për qëllime të mbikëqyrjes, Banka Popullore mund të bashkëpunojë dhe shkëmbejë të dhëna dhe informacione me organet kompetente të vendit dhe të huaja.

Masat ndaj subjekteve të mbikëqyrjes

Neni 163

Në varësi të llojit, rëndësisë dhe shpeshtësisë së dobësisë së përcaktuar, mosharmonizimit dhe/ose mosrespektimit të dispozitave të këtij ligji, guvernatori mund subjekteve të mbikëqyrjes:

- t'i lëshojë rekomandim me shkrim,
- t'i lëshojë paralajmërim me shkrim,
- të miratojë aktvendim me të cilin shqiptohet një ose më shumë masa nga neni 166 i këtij ligji ose
- të heqë lejen që është e lëshuar në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

Rekomandim

Neni 164

(1) Guvernatori lëshon rekomandim me shkrim subjektit të mbikëqyrur nëse në procedurën e mbikëqyrjes konstatohen dobësi, mosharmonizime dhe/ose mosrespektim të dispozitave të këtij ligji, të cilat nuk paraqesin rrezik të rëndësishëm në punën e subjektit në mbikëqyrje.

(2) Në rekomandimin me shkrim sipas paragrafit (1) të këtij neni përcaktohen afatet për eliminimin e dobësive, parregullsive dhe/ose mosrespektime të përcaktuara të dispozitave të këtij ligji, si dhe afatin në të cilin subjekti i mbikëqyrur është i detyruar ta njoftojë Bankën Popullore për të vepruar ndaj rekomandimit me dëshmi të dokumentuar.

Paralajmërim me shkrim

Neni 165

(1) Guvernatori jep paralajmërim me shkrim subjektit të mbikëqyrjes nëse:

1) në procedurën e mbikëqyrjes janë përcaktuar dobësi, mosharmonizime dhe/ose mospërputhje me dispozitat e këtij ligji, të cilat mund të paraqesin rrezik të konsiderueshëm nëse nuk eliminohen ose

2) nuk vepron në përputhje me rekomandimin nga neni 164 i këtij ligji.

(2) Në rekomandimin me shkrim sipas paragrafit (1) të këtij neni përcaktohen afatet për largimin e dobësive, mosharmonizimeve dhe/ose mosrespektimeve të dispozitave të këtij ligji, si dhe afatin në të cilin subjekti i mbikëqyrjes është i detyruar ta njoftojë Bankën Popullore për të vepruar ndaj rekomandimit me dëshmi të dokumentuar.

Aktvendim për shqiptimin e masave

Neni 166

(1) Guvernatori miraton aktvendim për shqiptimin e masave nëse:

1) në procedurën e mbikëqyrjes së subjektit të mbikëqyrjes konstatohen dobësi, mosharmonizime dhe/ose mosrespektim të dispozitave të këtij ligji të cilat vënë në rrezik serioz punën e subjektit,

2) subjekti i mbikëqyrjes i përsërit dobësitë mosharmonizimet dhe/ose mosrespektimin e dispozitave të konstatuara paraprake të këtij ligji ose

3) subjekti i mbikëqyrjes nuk vepron në bazë të rekomandimit, paralajmërimit me shkrim ose masës së shqiptuar paraprake,

2) Me aktvendimin sipas paragrafit (1) të këtij neni institucioni i pagesës ose institucioni i parave elektronike mund t'i detyrojë:

1) të harmonizojë punën e tij me dispozitat e këtij ligji dhe rregulloret e miratuara në bazë të këtij ligji;

2) përkohësisht që të ndërpresë ofrimin e një ose më shumë shërbimeve pagesore dhe/ose emetimin e parave elektronike;

3) të mos aprovojë kredi përderisa nuk harmonizohet me nenin 12 paragrafi (2) i këtij ligji;

4) ndryshimin e mënyrës së mbrojtjes së mjeteve në para të përdoruesve të shërbimeve të pagesave në pajtim me nenin 31 paragrafi (2) të këtij ligji ose

5) ndërprerjen e marrëveshjes me personin e jashtëm të cilit pjesërisht ose plotësisht i është bartur kryerja e funksioneve operative lidhur me ofrimin e shërbimeve të pagesave.

(3) Në rast se vlera e mjeteve personale të institucionit të pagesës ose institucionit të parave elektronike është më e vogël se vlera e llogaritur në pajtim me nenin 29 paragrafi (1) dhe nenin 30 paragrafi (1) të këtij ligji ose mjetet personale nuk janë përkatëse në krahasim me vlerën e përgjithshme të kredive të miratuara në pajtim me nenin 12 paragrafi (2) të këtij ligji, guvernatori me aktvendim për shqiptimin e masave mund:

1) ta detyrojë institucionin e pagesës dhe institucionin e parave elektronike të miratojë dhe të sigurojë realizimin e planit të masave për sigurimin e vlerës së mjeteve personale të përlllogaritura në pajtim me dispozitat e nenit 29 paragrafi (2) dhe të nenit 30 paragrafet (2), (3) dhe (4) të këtij ligji;

2) ta detyrojë që të miratojë dhe zbatojë plan të masave për sigurimin e mjeteve personale përkatëse në lidhje me vlerën e përgjithshme të kredive të miratuara në pajtim me nenin 12 paragrafi (2) të këtij ligji;

3) ta detyrojë që të miratojë vendim dhe të kryejë rritje të kapitalit ose

4) përkohësisht tia ndalojë pagesën e fitimeve.

(4) Me aktvendim sipas paragrafit (1) të këtij neni operatorit të sistemit të pagesave mund ta detyrojë:

1) ta harmonizojë punën e tij me dispozitat nga ky ligj dhe rregulloret e miratuara në bazë të këtij ligji;

2) të përjashtojë një pjesëmarrës të caktuar në sistemin e pagesave, nëse pjesëmarrësi nuk i përmbush kushtet ose rregullat e punës në sistemin e pagesës;

- 3) t'i ndryshojë marrëveshjet me të cilat është themeluar sistemi i pagesës dhe/ose statuti;
- 4) t'i ndryshojë rregullat e punës së sistemit të pagesës;
- 5) ta ndryshojë vlerën e mekanizmit garantues nga neni 153 të këtij ligji ose
- 6) ndërprerjen e marrëveshjes me personin e jashtëm të cilit pjesërisht ose plotësisht i është bartur kryerja e funksioneve operative lidhur me ofrimin e shërbimeve të pagesave;
- (5) Guvernatori miraton aktvendim nëse duhet ta detyrojë subjektin e mbikëqyrjes që të mos kryejë shërbime dhe/ose aktivitete të tjera nga neni 11 paragrafët (2) dhe (3) ose neni 132 paragrafi (2) të këtij ligji në kuadër të personit të njejtë juridik.
- (6) Shqiptimi i masave të përcaktuara me këtë ligj nuk përjashton shqiptimin e masave të Bankës Popullore në bazë të ligjeve tjera.

**Heqja e lejes për ofrimin e shërbimeve të pagesave
përkatësisht lejen për dhënien e parasë elektronike dhe regjistrimin në regjistrin e
institucioneve të pagesave**

Neni 167

(1) Guvernatori me aktvendim i heq lejen për ofrimin e shërbimeve të pagesave dhe/ose dhënien e parasë elektronike para nëse institucioni i pagesës, përkatësisht institucioni i parave elektronike:

- 1) nuk fillon ofrimin e shërbimeve të pagesave, përkatësisht emetimin e parave elektronike në afat prej 12 muajsh nga dita e miratimit të aktvendimit nga neni 19 paragrafi (1) i këtij ligji;
- 2) ndërpret ofrimin e shërbimeve të pagesave, përkatësisht emeton para elektronike në mënyrë të vazhdueshme për një periudhë më të gjatë se gjashtë muaj;
- 3) aktvendimi për dhënien e lejes është miratuar në bazë të dokumenteve, të dhënave dhe informacioneve të pasakta ose të pavërteta;
- 4) nuk i plotëson më kushtet në bazë të të cilave është miratuar aktvendimi për dhënien e lejes;
- 5) ofron shërbime të pagesave për të cilat nuk ka marrë leje nga Banka Popullore;
- 6) të bëjë ndryshime të statusit pa leje nga Banka Popullore;
- 7) nuk vepron sipas masave nga neni 166 paragrafi (2), (3) dhe (5) të këtij ligji;
- 8) dorëzon kërkesë me shkrim në Bankën Popullore se dëshiron të ndërpresë ofrimin e shërbimeve të pagesave, përkatësisht emetimin e parave elektronike;
- 9) Me ofrimin e mëtejshëm të shërbimeve të pagesave, përkatësisht emetimin e parave elektronike, rrezikon stabilitetin, sigurinë dhe efikasitetin e sistemit të pagesave në Republikën e Maqedonisë së Veriut;
- 10) në çfarëdo mënyre pamundëson ose ndërlikon mbikëqyrjen e Bankës Popullore mbi institucionin e pagesave dhe/ose institucionin e parasë elektronike;
- 11) nuk i përmbush detyrimet për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në pajtim me Ligjin e Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit ose
- 12) është hapur procedura për likuidim ose falimentim.

(2) Guvernatori me aktvendim e ndalon regjistrimin e ofruesit të shërbimeve të pagesave i cili ekskluzivisht i ofron shërbimet e pagesave nga neni 8 paragrafi (1) pika 8 të këtij ligji në regjistrin nga neni 27 paragrafi (2) të këtij ligji në rastet sipas paragrafit (1) pikat 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10 dhe 12 të këtij neni.

(3) Banka Popullore është e detyruar që menjëherë t'ia dorëzojë aktvendimin nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, institucionit të pagesave, përkatësisht institucionit të parave elektronike, për të njoftuar publikun në faqen e internetit për heqjen e lejes, përkatësisht regjistrimin dhe të përditësojë regjistrin përkatës nga neni 27 i këtij ligji. Aktvendimet dorëzohen edhe në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Heqja e lejes për operatorin e sistemit të pagesave

Neni 168

(1) Guvernatori me aktvendim e heq lejen për operatorin e sistemit të pagesave nëse:

1) sistemi i pagesave nuk ka filluar të funksionjë në afat prej 12 muajve nga data në të cilën është miratuar aktvendimi për operator të sistemit të pagesave;

2) sistemi i pagesave ka ndërprerë funksionimin e tij në mënyrë të vazhdueshme për një periudhë më të gjatë se gjashtë muaj;

3) aktvendimi për dhënien e lejes është miratuar në bazë të dokumenteve, të dhënave dhe informacioneve të pasakta ose të pavërteta;

4) operatori i sistemit të pagesave nuk i plotëson më kushtet në bazë të të cilave e ka marrë lejen;

5) operatori i sistemit të pagesave nuk ka marrë pëlqim të parakohshëm nga guvernatori për të gjitha ndryshimet dhe plotësimet e rregullave për funksionimin e sistemit të pagesave në pajtim me nenin 140 të këtij ligji.

6) sistemi i pagesave mund të rrezikojë sigurinë e transaksioneve të pagesave të realizuara nëpërmjet tij, ose ndonjë nga proceset që kanë të bëjnë me pranimin, përpunimin, kleringun, shlyerjen ose regjistrimin e transaksioneve të pagesave;

7) operatori i sistemit të pagesave me kryerjen e mëtutjeshme të veprimtarisë së operatorit të sistemit të pagesave rrezikon stabilitetin, sigurinë dhe efikasitetin e sistemit të pagesave të Republikës së Maqedonisë së Veriut;

8) operatori i sistemit të pagesave në çfarëdo mënyre e pamundëson ose e vështirëson mbikëqyrjen e Bankës Popullore mbi operatorin;

9) nuk vepron sipas masave nga neni 166 paragrafi (4) dhe (5) të këtij ligji;

10) është dhënë pëlqimi paraprak për ndërprerjen e punës së operatorit të sistemit të pagesave në pajtim me nenin 144 paragrafi (2) të këtij ligji ose

11) është hapur procedurë për likuidim ose falimentim mbi operatorin e sistemit të pagesave.

(3) Banka Popullore është e detyruar menjëherë t'ia dorëzojë aktvendimin sipas paragrafit (1) të këtij neni, operatorit të institucionit të pagesave, për ta njoftuar publikun në faqen e tij të internetit për heqjen e lejes dhe të përditësojë regjistrin përkatës nga neni 147 të këtij ligji. Aktvendimi dorëzohet edhe në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Tërheqja e pëlqimit

Neni 169

Guvernatori me aktvendim e tërheq pëlqimin për emërimin e udhëheqësit, anëtarit të Këshillit drejtues, përkatësisht anëtarit ekzekutiv të Këshillit të drejtorëve, përkatësisht marrjen e pjesëmarrjes së kualifikuar të lëshuar në përputhje me dispozitat e këtij ligji nëse:

1) pëlqimi është marrë në bazë të dokumenteve, të dhënave dhe/ose informacioneve të pasakta ose të pavërteta ose

2) udhëheqësi, anëtari i Këshillit drejtues, përkatësisht anëtari ekzekutiv i Këshillit të drejtorëve, përkatësisht personi fizik ose personi juridik i cili ka fituar pjesëmarrje të kualifikuar në subjektin e mbikëqyrjes nuk i plotëson më kushtet në bazë të të cilave i është dhënë pëlqimi.

Kufizimi I të drejtave të aksioneve ose të pjesëmarrjeve

Neni 170

Nëse personi juridik ose fizik fiton pjesëmarrje të kualifikuar pa marrë pëlqimin e Bankës Popullore ose pëlqimi për marrjen e pjesëmarrjes së kualifikuar është tërhequr në përputhje me nenin 169 të këtij ligji, guvernatori miraton aktvendim me të cilin kufizon të drejtën e votës së aksioneve përkatësisht të drejtën e disponimit të pjesëmarrjes dhe detyron pronarin e aksioneve, përkatësisht pjesëmarrjen që t'i tjetërsojë të njëjtat në afat jo më të gjatë se 180 ditë.

Raporte

Neni 171

(1) Subjektet e mbikëqyrjes janë të detyruara që Bankës Popullore t'i dorëzojnë të dhëna dhe informacione për qëllime mbikëqyrëse lidhur me instrumentet e pagesave, transaksionet e pagesave, paratë elektronike, mjetet personale dhe mbrojtjen e mjeteve financiare.

(2) Institucioni i pagesave, përkatësisht institucioni i parasë elektronike, që kryen transaksione të pagesave ndërkufitare të njehershme në bazë të dërgesave financiare është i detyruar që Bankës Popullore t'i dorëzojë raporte mujore për transaksionet individuale të pagesave në afat prej pesë ditëve pune nga përfundimi i periudhës së raportimit, duke përfshirë të dhënat për dërgesat financiare nëpërmjet agjentëve.

(3) Këshilli i Bankës Popullore me akt nënligjor më hollësisht përcakton llojin dhe mënyrën e dorëzimit të raporteve në Bankën Popullore dhe përmbajtjen e raporteve nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni.

Pjesa e shtatë

DISPOZITA TË VEÇANTA

Kapitulli I

Shërbimet e pagesave dhe aktivitetet e tjera që sigurohen nga Banka Popullore, Thesari dhe Thesari i Fondit

Banka Popullore si operator i sistemit të pagesave dhe ofrues i shërbimeve të pagesave

Neni 172

(1) Banka Popullore mund të themelojë dhe menaxhojë sistemet e pagesave dhe të marrë pjesë në këto sisteme në mënyrë dhe kushte të përcaktuara me Ligjin e Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, si dhe të përcaktojë rregulla për sistemet e pagesave me të cilat menaxhon në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

(2) Banka Popullore mund të shfrytëzojë dhe t'u mundësojë ofruesve të shërbimeve të pagesave qasje në sistemet e huaja të pagesave me qëllim të ofrimit të shërbimeve të pagesave ndërkufitare.

(3) Banka Popullore ka të drejtë diskrecioni për hapjen dhe mbajtjen e llogarive për shlyerjen e pjesëmarrësve në sistemet e pagesave me të cilat udhëheq.

(4) Banka Popullore si ofrues i shërbimeve të pagesave mund të kryejë transaksione të pagesave për personat në vijim:

1. organet e pushtetit shtetëror dhe ndërmarrjet publike të themeluara nga Republika e Maqedonisë së Veriut;

2. bankat qendrore të huaja dhe bankat e huaja,

3. institucionet financiare ndërkombëtare,

4. qeveritë e vendeve të tjera dhe organizatat ndërkombëtare që nuk janë institucione financiare, dhe

5. personat e tjerë juridikë të cilëve në pajtim me ligjin u lejohet të hapin llogari të pagesës në Bankën Popullore.

(5) Banka Popullore si ofrues i shërbimeve të pagesave nuk mund të hapë llogari pagese të personave që nuk janë të shënuar në paragrafin (4) të këtij neni

(6) Banka Popullore i ekzekuton urdhërpagesat për arkëtim të detyrueshëm në lidhje me llogaritë që i hap dhe i posedon, me përjashtim të llogarisë së Thesarit dhe llogarisë së Thesarit shëndetësor.

(7) Këshilli i Bankës Popullore me akt nënligjor i përcakton kushtet dhe procedurën për hapjen dhe mbylljen e llogarive të shlyerjes sipas paragrafit (3) të këtij neni, si dhe llogaritë e pagesave të personave sipas paragrafit (4) të këtij neni.

Shërbimet e pagesave dhe aktivitetet e tjera që i kryen Thesari

Neni 173

(1) Kur Thesari ofron shërbime të pagesave në kuadër të kompetencave të tij ekskluzive në bazë të rregullores së veçantë, do të zbatohen dispozitat e Pjesës së katërt të këtij ligji, përveç nëse shprehimisht ndryshe nuk është paraparë me këtë ligj apo me rregullore tjetër.

(2) Përveç shërbimeve të pagesave sipas paragrafit (1) të këtij neni, Thesari kryen edhe këto punë:

1) mban regjistrin e shfrytëzuesve të buxhetit dhe llogaritë e tyre të pagesave në denarë;

2) hap dhe mban në sistemin e llogarive të pagesave të Thesarit në denarë të shfrytëzuesve të buxhetit që e përbëjnë llogarinë e Thesarit;

3) pranon dhe përpunon udhëzime për pagesën për debitimin e llogarive të pagesave në denarë të shfrytëzuesve të buxhetit të përcaktuara me rregullat e veçanta sipas paragrafit (4) të këtij neni të nxjerra nga ministri i Financave;

4) i debiton llogaritë e pagesave në denarë shfrytëzuesve të buxhetit në bazë të autorizimeve kontraktuale;

5) i debiton llogaritë e pagesave në denarë të shfrytëzuesve të buxhetit në rast të gabimit të bërë nga Thesari gjatë kryerjes së pagesës;

6) kryen punë të tjera të ofruesit të shërbimeve të pagesave të shfrytëzuesve të buxhetit në pajtim me këtë ligj;

7) përgatit dhe vë në dispozicion informacionet për llogaritë e pagesave në denarë të shfrytëzuesve të buxhetit të kërkuara me ligj ose rregullore të miratuar nga ministri i Financave.

(3) Shfrytëzuesi i buxhetit, llogaria e pagesës në denarë e të cilit mbahet në sistemin e Thesarit dhe llogaria e pagesës në denarë e të cilit është e bllokuar, nuk mund t'i shlyejë detyrimet me llogaritje.

(4) Mënyrën dhe rregullat e veçanta për funksionimin e Thesarit si ofrues i shërbimeve të pagesave për shfrytëzuesit buxhetor, përfshirë formën dhe përmbajtjen e urdhërpagesave/udhëzimeve të pagesave që përdorin këta shfrytëzues, i përcakton Ministri i Financave.

Shërbimet e pagesave dhe aktivitetet e tjera të kryera nga Thesari i Fondit

Neni 174

(1) Kur Thesari i Fondit jep shërbime të pagesave në kuadër të kompetencave të veta ekskluzive në bazë të dispozitave të veçanta, zbatohen dispozitat e pjesës së katërt të këtij ligji, përveç nëse me këtë ligj ose me rregull tjetër shprehimisht nuk është paraparë ndryshe

(2) Përveç shërbimeve të pagesave sipas paragrafit (1) të këtij neni, Thesari i Fondit kryen edhe këto punë:

1) mban regjistrin e institucioneve publike shëndetësore dhe llogaritë e tyre të pagesave në denarë

2) hap dhe mban në sistemin e Thesarit të Fondit llogaritë e pagesave në denarë të institucioneve publike shëndetësore që përbëjnë llogarinë e Thesarit të Shëndetësisë;

3) pranon dhe përpunon udhëzimet për pagesë për debitimin e llogarive të pagesave në denarë në institucionet publike shëndetësore të përcaktuara me rregullat e veçanta sipas paragrafit (4) të këtij neni të lëshuara nga ministri i Financave;

4) debiton llogaritë e pagesave në denarë të institucioneve publike shëndetësore në bazë të autorizimeve kontraktuale;

5) debiton llogaritë e pagesave në denarë në kornizë të Thesarit të Shëndetësisë në rast të gabimit të bërë nga Thesari i Fondit gjatë kryerjes së pagesës;

6) kryen punë të tjera të ofruesit të shërbimeve të pagesave të institucioneve publike shëndetësore në përputhje me këtë ligj;

7) përgatit dhe vë në dispozicion informacionet për llogaritë e pagesave në denarë të institucioneve publike shëndetësore që kërkohen me ligj ose me rregull tjetër të miratuar nga Ministri i Financave.

(3) Institucioni publik shëndetësor, llogaria e pagesës në denarë e të cilit mbahet në sistemin e Thesarit të Fondit dhe llogaria e pagesës në denarë e cila është e bllokuar, nuk mund t'i shlyejë detyrimet e tij me llogaritje.

(4) Mënyrën dhe rregullat e veçanta për funksionimin e Thesarit të Fondit si ofrues i shërbimeve të pagesave për institucionet publike shëndetësore, përfshirë formën dhe përmbajtjen e urdhërpagesave/udhëzimeve të pagesave që i përdorin këto institucione, i përcakton Ministria e Financave.

Kapitulli II **Regjistri i vetëm i llogarive**

Krijimi dhe mirëmbajtja e regjistrit të vetëm të llogarive

Neni 175

(1) Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut e krijon dhe mirëmban Regjistrin e vetëm të llogarive (në tekstin e mëtejshëm: RVL) për kryerjen efikase të transaksioneve të pagesave, hapjen e llogarive të pagesave me funksione bazë, monitorimin e llogarive joaktive, zbatimin e urdhërpagesave për arkëtim të detyrueshëm, zbatimin e aktiviteteve për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit dhe ekzekutimin e detyrave statistikore dhe mbikëqyrëse, si dhe fitimin e qasjes deri te informacionet dhe të dhënave në RVL për realizimin e pandërprerë dhe në kontinuitet të aktiviteteve të organeve kompetente në kuadër të kompetencave të tyre të përcaktuara me ligj.

(2) Ofruesit e shërbimeve të pagesave që hapin dhe mbajnë llogari të pagesave, depozitave ose llogari të tjera, përfshirë edhe llogaritë joaktive dhe të bllokuara të pagesave dhe/ose lëshojnë kasaforta, janë të detyruar të krijojnë dhe mbajnë regjistrat e tyre të brendshëm të pagesave, depozitave ose llogarive të tjera dhe kasafortave.

(3) Ofruesit e shërbimeve të pagesave nga neni 9 paragrafi (1) pikat 1, 2, 3, 9, 10 dhe 11 të këtij ligji janë të detyruar t'i dorëzojnë RVL-së informacione dhe të dhëna nga regjistrat e brendshëm të llogarive dhe kasafortave, si dhe çdo ndryshim të tyre, për regjistrim në Regjistrin.

(4) Dispozita sipas paragrafit (3) të këtij neni zbatohet edhe për ofruesit e shërbimeve të pagesave nga neni 9 paragrafi (1) pika 5 dhe 7 të këtij ligji, nëse hapin dhe mbajnë llogari të pagesave të përdoruesve të shërbimeve të pagesave.

(5) Ofruesit e shërbimeve të pagesave nga paragrafët (3) dhe (4) të këtij neni janë përgjegjës për saktësinë e të dhënave dhe/ose informacioneve dhe dorëzimit të tyre të rregullt në RVL, kurse Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut është përgjegjëse për ruajtjen e besueshme të të dhënave dhe informacioneve të parashtruara.

(6) Përdoruesi i shërbimeve të pagesave është i detyruar që në afat prej shtatë ditësh nga dita e ndryshimeve t'i njoftojë ofruesit e shërbimeve të pagesave të cilët ka llogari të pagesave, depozitave ose llogari të tjera ose kasaforta për të gjitha ndryshimet statusore ose të tjera.

(7) Drejtoria e të Hyrave Publike e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Fondi i Sigurimit Pensional dhe Invalidor i Republikës së Maqedonisë së Veriut janë të detyruar për llogaritë e pagesave me të hyra të rregullta mujore të dorëzojnë në bazë të rregullt deri te RVLI të dhëna dhe/ose informacione për numrin e llogarisë së pagesës dhe numrin amë të qytetarit - poseduesit të llogarisë.

(8) Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut mund të përdorë të dhënat nga Regjistri Qendror i popullsisë, regjistri tregtar dhe regjistri i personave të tjerë juridikë për nevojat e mirëmbajtjes së RVLI-së.

(9) Të dhënat nga RVLI-së ruhen përgjithmonë, përveç të dhënave për llogaritë e mbyllura të pagesave, depozitat ose llogaritë e tjera dhe për kasafortat që nuk shfrytëzohen dhe të cilat ruhen dhjetë vjet pas mbylljes ose përfundimit të llogarisë së përdorimit të kasafortës.

(10) Këshilli i Bankës Popullore me akt nënligjor në mënyrë të hollësishme e përcakton përmmbajtjen e RVLI-së.

(11) Ministri i Financave të Republikës së Maqedonisë së Veriut, me propozim të Regjistrat Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut, me akt nënligjor në mënyrë të hollësishme përcakton formën, mënyrën dhe afatet për dorëzimin e informacioneve dhe të dhënave nga në paragrafët (2) dhe (7) të këtij neni në RVLI.

Qasja në informacionet dhe të dhënat nga RVLI

Neni 176

(1) Informacionet dhe të dhënat nga RVLI mund të përdoren në kushte të përcaktuara me këtë ose me ligj tjetër.

(2) Informacionet dhe të dhënat për llogaritë e pagesave nga RVLI që u referohen personave juridikë, tregtarëve individualë dhe personave fizikë që kryejnë veprimtari janë në dispozicion dhe mund të merren në bazë të kërkesës së parashtruar deri te Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(3) Informacionet dhe të dhënat nga RVLI që u referohen personave fizikë dhe informacionet dhe të dhënat për depozitat ose llogaritë tjera dhe kasafortat e personave juridikë, tregtarëve individualë dhe personave fizikë që kryejnë veprimtari janë të besueshme dhe mund të merren në bazë të kërkesës së parashtruar deri te Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut nga:

1. pronarët e llogarive dhe kasafortave, pronarët e vërtetë të llogarive dhe/ose kasafortave, përfaqësuesit ligjorë dhe/ose personat e autorizuar për të punuar me llogaritë dhe kasafortat;

2. gjykata kompetente ose prokuroria publike për udhëheqjen e procedurave që janë në kompetencat e tyre;

3. personat që kanë të drejtë të zbatojnë ekzekutim, në përputhje me ligjin;

4. noterët, në lidhje me kryerjen e aktiviteteve për udhëheqjen e procedurës së verifikimit, në përputhje me ligjin;

5. Operatori i sistemit të shlyerjes së letrave me vlerë, shtëpia e likuidimit, agjenti i shlyerjes dhe pala qendrore kontraktuese, në lidhje me kryerjen e aktiviteteve nga neni 3 paragrafi (1) pika 9 të këtij ligji, në përputhje me ligjin;

6. ofruesit e shërbimeve të pagesave dhe operatorët e sistemit të pagesave, për informacionet dhe të dhënat për llogaritë e pagesave, në përputhje me këtë ligj;

7. Fondi i Sigurimit të Depozitave, në lidhje me kryerjen e kompetencave të tij, në përputhje me ligjin;

8. Drejtoria e Policisë Financiare, në lidhje me kryerjen e kompetencave të saj, në përputhje me ligjin;

9. Drejtoria e Doganave për udhëheqjen e procedurave që janë në kompetencë të saj, në përputhje me ligjin;

10. Agjencia e Administrimit të Pronës së Konfiskuar, në lidhje me kryerjen e kompetencave të saj, në përputhje me ligjin;

11. Ministria e Punës dhe e Politikës Sociale, në përputhje me ligjin;

12. Inspektorati Shtetëror i Devizave për kontrollin e punës devizore, në përputhje me ligjin;

13. Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, në përputhje me ligjin;

14. Byroja Kreditore për Informacionet dhe të dhënat për llogaritë e bllokuara të pagesave, në përputhje me ligjin;

15. Ministria e Punëve të Brendshme, në përputhje me ligjin;

16. Ministria e Financave, në përputhje me ligjin

17. Banka Popullore për kryerjen e detyrave të përcaktuara me Ligjin e Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut;

18. Drejtoria e të Hyrave Publike, në përputhje me ligjin;

19. Fondi i Sigurimit Pensional dhe Invalidor i Republikës së Maqedonisë së Veriut, në përputhje me ligjin dhe

20. Fondi i Sigurimit Shëndetësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut, në përputhje me ligjin.

21) Ministria e Bujqësisë, e Pylltarisë dhe e Ekonomisë së Ujërave, në pajtim me ligjin.

(4) Drejtoria e Zbulimit Financiar, në përputhje me ligjin, ka të drejtë në qasje direkte, pa vonesë ose kufizim, në të gjitha informacionet dhe të dhënat nga RVLL-ja. Drejtoria e Zbulimit Financiar, në përputhje me ligj, ka të drejtë t'i bartë informacionet dhe të dhënat nga RVLL-ja tek organet kompetente në shtetet e tjera.

(5) Ministria e Financave, Banka Popullore, Drejtoria e të Hyrave Publike dhe Drejtoria e Zbulimit Financiar kanë të drejtën e qasjes pa pagesë deri te të gjitha informacionet dhe të dhënat nga RVLL-ja për kryerjen e kompetencave të tyre.

(6) Kërkuesit e informacioneve dhe të dhënave nga paragrafët (2), (3), (4) dhe (5) të këtij neni nuk kanë të drejtë t'ua bartin informacionet dhe të dhënat personave të tjerë, përveç nëse të njëjtat i bartin në përputhje me ligjin.

(7) Me përjashtim të paragrafit (6) të këtij neni, me qëllim të ekzekutimit efikas të transaksioneve të pagesave, operatori i sistemit të pagesave ka të drejtë t'i transferojë informacionet dhe të dhënat për llogaritë e pagesave deri te ofruesit e shërbimeve të pagesave që janë pjesëmarrës në sistemin e pagesave.

(8) Operatori i sistemit të pagesave sipas paragrafit (7) të këtij neni mund të arkëtojë kompensime për transferimin e informacioneve dhe të dhënave për llogaritë e pagesave te ofruesit e shërbimeve të pagesave, të cilët janë pjesëmarrës në sistemin e pagesave, në shumën e shpenzimeve të bëra realisht, të cilat obligohet t'i publikojë në ueb - faqen e operatorit të sistemit të pagesave..

(9) Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut mund të arkëtojë kompensime për përdorimin e informacioneve dhe të dhënave nga RVLL në shumën e shpenzimeve të bëra reale, të cilat është i detyruar t'i publikojë në faqen e internetit të Regjistrat Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(10) Ministri i Financave i Republikës së Maqedonisë së Veriut, me propozim të Regjistrat Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut, sipas aktit nënligjor të nenit 175 paragrafi (11) i këtij ligji, më hollësisht e përcakton formën dhe përmbajtjen e kërkesës për të dhënat dhe/ose informacionet nga RVLL, si dhe kushtet, formën, mënyrën dhe afatet për marrjen e të dhënave dhe/ose informacioneve nga RVLL-ja.

Mbrojtja e të dhënave dhe/ose informacioneve të përfshira në RVLl

Neni 177

Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut ndërmerr masa dhe aktivitete për mbrojtjen e të dhënave personale të personave fizikë që ofruesit e shërbimeve të pagesave janë të detyruar t'i dorëzojnë deri te RVLl-ja. Të dhëna personale konsiderohen: emri dhe mbiemri i personit që është posedues i llogarisë së pagesës, depozitës ose llogarisë tjetër dhe/ose kasafortës, pronari i vërtetë i llogarisë dhe/ose kasafortës, përfaqësuesi ligjor dhe/ose personi i autorizuar për të punuar me llogarinë dhe/ose kasafortën, shtetësinë e tyre, vendbanimin dhe/ose vendqëndrimin, numrat amë të qytetarëve, si dhe të dhëna të tjera nëpërmjet të cilave personat mund të identifikohen drejtpërdrejt ose tërthorazi.

Kapitulli III

Arkëtim i detyrueshëm

Kufizimi i dispozicionit të mjeteve financiare

Neni 178

(1) Pas pranimit të urdhërpagesës për arkëtim të detyrueshëm, nga data e valutës së debitimit të shënuar tek ofruesi i njëjtë i shërbimeve të pagesave nuk do të lejojë përdoruesin e shërbimeve të pagesave - debitorin që të disponojë me mjetet financiare që i ka te ai ofrues i shërbimeve të pagesave deri në vlerën e urdhërpagesës për arkëtim të detyrueshëm.

(2) Ekzekutimi i transaksionit të pagesës në bazë të urdhërpagesës për arkëtim të detyrueshëm të mjeteve të shfrytëzuesve buxhetorë dhe institucioneve publike shëndetësore bëhet në përputhje me këtë ligj vetëm nëpërmjet llogarisë së Thesarit në denarë, përkatësisht llogarisë së Thesarit të Shëndetësisë në denarë.

(3) Ministri i Financave i Republikës së Maqedonisë së Veriut e përcakton mënyrën dhe procedurën për zbatimin e urdhërpagesave për arkëtim të detyrueshëm me të cilët debitohet llogaria e Thesarit në denarë ose llogaria e Thesarit të Shëndetësisë në denarë, përkatësisht llogaria e pagesës së shfrytëzuesit buxhetor të shërbimeve të pagesave - debitori i cili menaxhon me llogarinë e Thesarit në denarë, përkatësisht Institucionit Publik Shëndetësor - debitori i cili menaxhon me llogarinë e Thesarit të Shëndetësisë në denarë.

(4) Ekzekutimi i transaksionit të pagesës në bazë të urdhërpagesës për arkëtim të detyrueshëm të mjeteve të personit juridik që është operator i sistemit të pagesave ose operator i sistemit të shlyerjes së letrave me vlerë nuk mund të kryhet nga llogaria e tij për shlyerje në denarë në Bankën Popullore.

Procedura e arkëtimit të detyrueshëm

Neni 179

(1) Në procedurën për arkëtim të detyrueshëm në përputhje me kapitullin III, pjesën e shtatë të këtij ligji, marrin pjesë ofruesit e shërbimeve të pagesave, të cilët kanë numër referencues të caktuar nga Banka Popullore.

(2) Ekzekutuesi ose organi tjetër kompetent në përputhje me ligjin, urdhërpagesën për arkëtim të detyrueshëm nëpërmjet sistemit elektronik për arkëtim të detyrueshëm e dorëzon te ofruesi i shërbimeve të pagesave ku përdoruesi i shërbimeve të pagesave - debitori ka llogari të pagesës në denarë, kurse në rast se përdoruesi i shërbimeve të pagesave - debitori i cili është konsumator ka llogari të pagesës me të ardhura të rregullta mujore e dorëzon urdhërpagesën për arkëtim të detyrueshëm te ofruesi i shërbimeve të pagesave i cili mban llogarinë e pagesës

(3) Urdhërpagesa për arkëtim të detyrueshëm dorëzohet më së voni një ditë pune para datës së debitimit të valutës të përcaktuar në të, ndërkaq pranimi në sistemin elektronik për arkëtim të detyrueshëm konfirmohet me nënshkrim elektronik dhe vulë elektronike të kohës.

(4) Ofruesi i shërbimeve të pagesave urdhërpagesat për arkëtim të detyrueshëm i kryen në datën e debitimit të valutës së përcaktuar në urdhëresë, sipas datës dhe kohës së pranimit të tyre të regjistruar në sistemin elektronik për arkëtim të detyrueshëm.

(5) Në urdhërpagesën për arkëtim të detyrueshëm shënohet numri i dokumentit për arkëtim të detyrueshëm, numri i llogarisë së pagesës në denarë të përdoruesit të shërbimeve të pagesave - debitor në përputhje me paragrafin (2) dhe vlera e transaksionit të pagesës që ekzekutohet me atë urdhërpagesë në të cilën detyrimisht përfshihet borxhi kryesor, interesi dhe kompensimet dhe shpenzimet tjera lidhur me ekzekutimin nëse llogariten dhe paguhen.

(6) Ofruesi i shërbimeve të pagesave e ekzekuton urdhërpagesën për arkëtim të detyrueshëm nga të gjitha mjetet në dispozicion për arkëtim të detyrueshëm tek ai ofrues i shërbimeve të pagesave.

(7) Nëse përdoruesi i shërbimeve të pagesave - debitori nuk ka mjete në dispozicion për arkëtim të detyrueshëm në denarë për ekzekutimin e plotë të transaksionit të pagesës në bazë të urdhërpagesës për arkëtim të detyrueshëm, ofruesi i shërbimeve të pagesave kryen konvertim valutor në denarë të mjeteve të tij të disponueshme për arkëtim të detyrueshëm në valutë tjetër me zbatimin e kursit të mesëm të Bankës Popullore i cili vlen në ditën e transaksionit deri në vlerën e nevojshme për ekzekutimin e plotë të transaksionit të pagesës në bazë të urdhërpagesës për arkëtim të detyrueshëm dhe i bartë në llogari të pagesës në denarë te përdoruesi - debitor i shërbimit të pagesave.

(8) Nëse mjetet në dispozicion për arkëtim të detyrueshëm nuk janë të mjaftueshme për ekzekutimin e plotë të transaksionit të pagesës në bazë të urdhërpagesës për arkëtim të detyrueshëm, ofruesi i shërbimeve të pagesave e ekzekuton transaksionin e pagesës deri në vlerën e parave të disponueshme për arkëtim të detyrueshëm, e bllokoi llogarinë e pagesës dhe me dorëzimin e numrit amë të qytetarit për përdoruesin i cili është konsumator, përkatësisht numrin e vetëm tatimor për përdoruesit e tjerë të shërbimeve të pagesave - debitorët dhe vlerën e nevojshme për ekzekutimin e plotë të transaksionit të pagesës nëpërmjet sistemit elektronik për arkëtim të detyrueshëm i njofton ofruesit e tjerë të shërbimeve të pagesave se nuk duhet të ekzekutojnë transaksione të pagesave nga mjetet në dispozicion për arkëtim të detyrueshëm të përdoruesit të shërbimeve të pagesave - debitorit, përveç transaksionit të pagesës së iniciuar për shkak të bartjes së mjeteve në dispozicion për arkëtim të detyrueshëm të përdoruesit të shërbimeve të pagesave - debitorit të llogarisë së pagesës tek ofruesi i shërbimeve të pagesave ku është pranuar urdhërpagesa për arkëtim të detyrueshëm.

(9) Ekzekutuesi ose organi tjetër kompetent në përputhje me ligjin mund të dorëzojë urdhërpagesë për arkëtim të detyrueshëm te ofruesit e tjerë të shërbimeve të pagesave sipas paragrafit (8) të këtij neni me qëllim të bartjes së vlerës së mjeteve që është bazë për bllokim te ofruesi i shërbimeve të pagesave, sipas paragrafit (2) të këtij neni te i cili është dorëzuar urdhërpagesa për arkëtim të detyrueshëm.

(10) Ofruesit e shërbimeve të pagesave janë të detyruar të bëjnë bartjen e mjeteve në përputhje me paragrafin (9) të këtij neni nga llogaritë e pagesave në denarë të përdoruesit të shërbimeve të pagesave - debitorit, ndërkaq në favor të llogarisë së tij të pagesave te ofruesi i shërbimeve të pagesave sipas paragrafit (2) të këtij neni, te i cili urdhërpagesa është dorëzuar për pagesë të detyruar, përkatësisht veprojnë në përputhje me paragrafin (7) të këtij neni nëse përdoruesi i shërbimeve të pagesave - debitori nuk ka mjete në dispozicion për arkëtim të detyrueshëm në denarë për ekzekutimin e plotë të transaksionit të pagesës në bazë të urdhërpagesës për arkëtim të detyrueshëm.

(11) Ofruesit e shërbimeve të pagesave që evidentojnë mjete në dispozicion për arkëtim të detyrueshëm dhe hyrjet në llogari të bllokuar të pagesave të përdoruesit të shërbimeve të pagesave - debitorit janë të detyruar që më së voni deri në fillimin e ditës së ardhshme të punës nëpërmjet sistemit elektronik për arkëtim të detyrueshëm ta njoftojnë për këtë ekzekutuesin ose organin tjetër kompetent në përputhje me ligjin, i cili mund ta bartë vlerën e mjeteve në përputhje me paragrafin (9) të këtij neni.

(12) Pas shlyerjes së plotë të vlerës sipas paragrafit (5) të këtij neni, ofruesi i shërbimeve të pagesave e zhbllokon llogarinë e pagesës së përdoruesit të shërbimeve të pagesave - debitorit dhe për atë nëpërmjet sistemit elektronik për arkëtim të detyrueshëm i njofton ofruesit e tjerë të shërbimeve të pagesave.

(13) Ofruesi i shërbimeve të pagesave mund të ekzekutojë transaksion të pagesës për përdoruesin e shërbimeve të pagesave - debitorin nëse për përdoruesin nuk janë evidentuar urdhërpagesa të tjera të parealizuara për arkëtim të detyrueshëm.

(14) Dispozitat nga paragrafët (1), (3), (4) dhe (5) të këtij neni kanë të bëjnë edhe me procedurën për zbatimin e urdhërpagesës për arkëtim të detyrueshëm në raport me shfrytëzuesit buxhetorë dhe institucionet e shëndetit publik, të cilat e debitojnë Llogarinë e thesarit në denarë përkatësisht Llogarinë e thesarit të Shëndetësisë në denarë.

(15) Shtëpia e kliringut në të cilën marrin pjesë shumica e ofruesve të shërbimeve të pagesave sipas paragrafit (1) të këtij neni, është e detyruar të krijojë dhe mirëmbajë sistem elektronik për arkëtim të detyrueshëm.

(16) Shtëpia e kliringut sipas paragrafit (15) të këtij neni është e detyruar që të përgatisë udhëzim për përdorim dhe njoftim nëpërmjet sistemit elektronik për arkëtim të detyrueshëm.

(17) Shtëpia e kliringut dhe ofruesve të shërbimeve të pagesave sipas paragrafit (1) të këtij neni, të cilët qasen të dhënat personale të cilat dorëzohen me urdhërpagesë për arkëtim të detyrueshëm nëpërmjet sistemit elektronik për arkëtim të detyrueshëm, i përpunojnë të dhënat personale të personave fizikë dhe i ruajnë dhjetë vjet pas përfundimit të vitit kalendarik në të cilin kanë pasur qasje deri të njëjtat. Të dhëna personale konsiderohen: numri amë i qytetarit, emri dhe mbiemri, numri i llogarisë së pagesës si dhe të dhëna të tjera nëpërmjet të cilave personat mund të identifikohen drejtpërdrejt ose tërthorazi

(18) Ofruesi i shërbimeve të pagesave dhe gjykata ose organi tjetër kompetent, në bazë të vendimeve gjyqësore dhe akteve të tjera, mund të shkëmbejnë ndalesat për disponimin me mjetet në llogari të përdoruesit të shërbimeve të pagesave të ofruesi nëpërmjet sistemit elektronik për arkëtim të detyrueshëm sipas paragrafit (2) i këtij ligji.

Veprimi me mjetet e depozituara gjatë pagesës së detyruar

Neni 180

(1) Ofruesi i shërbimeve të pagesave nuk duhet të vazhdojë marrëveshjen për afatizim të mjeteve financiare të përdoruesit të shërbimeve të pagesave - debitorit, llogaria e pagesës së të cilit është e bllokuar.

(2) Për përdoruesin e shërbimeve të pagesave - debitorin të cilit i është bllokuar llogaria e pagesës, nuk zbatohen dispozitat e marrëveshjes për afatizim të mjeteve me të cilat depozitimi vazhdon me automatizëm edhe pas skadimit të afatit të depozitimit.

(3) Në ditën e skadimit të marrëveshjes për afatizim të mjeteve ofruesi i shërbimeve të pagesave i bartë mjetet dhe interesat e grumbulluara në bazë të mjeteve të depozituara në llogarinë e bllokuar të pagesës së përdoruesit të shërbimeve të pagesave - debitorit deri në ekzekutimin e vlerës së plotë të transaksionit i të pagesës në bazë të urdhërpagesës për pagesë të detyruar.

Kompensime për ekzekutimin e urdhërpagesës për arkëtim të detyrueshëm

Neni 181

(1) Nëse ofruesi i shërbimeve të pagesave paguan nga përdoruesi i shërbimeve të pagesave - debitori i cili është konsumator kompensim për ekzekutimin e urdhërpagesës për arkëtim të detyrueshëm, i njëjti duhet të jetë në vlerën e shpenzimeve reale të bëra nga ofruesi i shërbimeve të pagesave.

(2) Nëse shtëpia e kliringut sipas paragrafit (15) i nenit 179 të këtij ligji paguan nga ofruesi i shërbimeve të pagesave, ekzekutuesi ose organi kompetent në përputhje me ligjin kompensim për përdorimin e sistemit elektronik për arkëtim të detyrueshëm, i njëjti duhet të jetë në vlerën e shpenzimeve reale të bëra nga shtëpia e kliringut.

Kapitulli IV

Mbrojtja e të dhënave personale të cilat ka pasur qasje Banka Popullore

Neni 182

Banka Popullore ndërmerr aktivitete për mbrojtjen e të dhënave personale të personave fizikë tek të cilët ka pasur qasje në lidhje me nenin 16, 17, 18, 23, 26, 39, 138, 141 dhe 142 të këtij ligji, i përpunon dhe/ose ruan për dhjetë vjet pas skadimit të vitit kalendarik në të cilin ajo ka pasur qasje të të dhënave personale. Të dhëna personale konsiderohen: emri dhe mbiemri i personit, numri amë i qytetarit, adresa, arsimi, statusi pronësor, numri i llogarisë së pagesës, shteti si dhe të dhëna të tjera nëpërmjet të cilave personat mund të identifikohen drejtpërdrejt ose tërthorazi.

Kapitulli V

Ekzekutimi i pagesave specifike

Pagesat me para në dorë dhe pagesat me përllogaritje

Neni 183

(1) Për pagesat me para në dorë, personi juridik mund të mbajë para në arkën e tij deri në vlerën e maksimumit të arkës.

(2) Maksimumin e arkës e përcakton personi juridik me akt të veçantë.

(3) Personi juridik është i detyruar t'i paguajë të gjitha mjetet nga tregu ditor mbi maksimumin e përcaktuar të arkës të pranuar në para të gatshme në çfarëdo baze më së voni ditën tjetër të punës në llogarinë e tij të pagesës.

(4) Personi juridik është i detyruar ti siguroj paratë e ruajtura në arkën e tij, së paku deri në maksimumin e arkës, me ç'rast marrëveshja për sigurimin detyrues do të mbulojë dëmet në rast zjarri, vërshimi dhe vjedhjeje.

(5) Detyrimi sipas paragrafit (4) të këtij neni nuk ka të bëjë me personat juridikë, maksimumi i arkës së të cilëve është deri në 20.000 denarë.

(6) Pagesa për produkte dhe shërbime nga ana e personave juridikë nuk mund individualisht të jetë më shumë se 6.000 denarë dhe nuk mund të kalojë vlerën e përgjithshme prej 60.000 denarë gjatë muajit kalendarik.

(7) Personi juridik nuk mund të kryejë pagesë me llogaritje nëse ka llogari të pagesës së bllokuar.

(8) Shfrytëzuesit buxhetorë, individët përdoruesit dhe përdoruesit e tjerë të cilët kanë llogari të pagesës në llogarinë e thesarit nuk mund të kryejnë pagesë me përllogaritje nëse kanë llogari të pagesës së bllokuar.

(9) Institucionet Shëndetësore Publike të cilat kanë llogari të pagesës në Llogarinë e thesarit shëndetësor nuk mund të kryejnë pagesa me përlllogaritje nëse kanë llogari të pagesës së bllokuar.

Kapitulli VI

Të dhëna për qëllime statistikore dhe krahasuese

Të dhëna për statistikat e pagesës dhe për krahasimin e shërbimeve më përfaqësuese

Neni 184

(1) Ofruesit e shërbimeve të pagesave dhe operatorët e sistemeve të pagesave janë të detyruar t'i dorëzojnë Bankës Popullore të dhëna dhe informacione për qëllime statistikore në lidhje me llogaritë e pagesave, llojin, vëllimin dhe kompensimet për transaksionet e kryera të pagesave, shërbimet e pagesave, instrumentet e pagesave, si dhe për vlerën e kompensimit për shërbimin e shitësit, kompensimin e zëvendësimit ndërmjet ofruesve të shërbimeve të pagesave dhe kompensimin për skemën e pagesës me kartelë gjatë transaksioneve të pagesave me kartelë.

(2) Këshilli i Bankës Popullore me akt nënligjor, e përcakton hollësisht përmbajtjen, mënyrën, formën dhe afatet për dorëzimin e të dhënave dhe/ose informacioneve sipas paragrafit (1) të këtij neni.

(3) Të dhënat dhe/ose informacionet për qëllime statistikore për shërbimet dhe transaksionet e pagesave për të cilat nuk zbatohen dispozitat e ligjit në përputhje me nenin 3 të këtij ligji dorëzohen vetëm me kërkesë të Bankës Popullore.

(4) Banka Popullore përcakton listën prej së paku 10, kurse më së shumti 20 shërbimeve më përfaqësuese lidhur me llogari të pagesës që i jep të paktën një ofrues i shërbimeve të pagesave në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe për të cilën paguhet kompensim. Lista përmban terma dhe përkufizime të standardizuara të shërbimeve më përfaqësuese të lidhura me llogarinë e pagesës.

(5) Banka Popullore në faqen e saj të internetit publikon të dhëna krahasuese nga ofruesi individual i shërbimeve të pagesave për llojin dhe vlerën e kompensimeve që llogariten dhe paguan nga ofruesit individual të shërbimeve të pagesave, edhe atë për secilën nga shërbimet që janë përcaktuar si më përfaqësuese për llogarinë e pagesës së konsumatorëve.

(6) Banka Popullore në çdo katër vjet pas publikimit të listës së shërbimeve më përfaqësuese sipas paragrafit (4) të këtij neni bën vlerësim dhe nëse është e nevojshme e përditëson listën.

(7) Këshilli i Bankës Popullore me akt nënligjor e përcakton listën sipas paragrafit (4) të këtij neni dhe përcakton më hollësisht mënyrën, formën dhe afatet për dorëzimin e të dhënave dhe/ose informacioneve lidhur me listën nga ofruesit e shërbimeve të pagesave.

(8) Ofruesi i shërbimeve të pagesave është i detyruar që në faqen e tij të internetit të ketë lidhje për qasje në faqen e internetit sipas paragrafit (5) të këtij neni.

(9) Banka Popullore e njofton Komisionin European dhe Trupin Mbikëqyrës Bankar European për rezultatet e vlerësimit sipas paragrafit (6) të këtij neni dhe nëse është e zbatueshme, për listën e përditësuar të shërbimeve më përfaqësuese të lidhura me shërbimet e pagesave.

(10) Banka Popullore ndërmerr veprime dhe aktivitete për mbrojtjen e të dhënave personale të personave fizikë që ofruesit e shërbimeve të pagesave janë të detyruar t'i dorëzojnë në përputhje me paragrafin (1) të këtij neni. Të dhëna personale konsiderohen: numri amë i qytetarit – poseduesit të llogarisë së pagesës, instrumenti i pagesës dhe shenja e vetme identifikuese e llogarisë së pagesës.

(11) Të dhënat sipas paragrafit (10) të këtij neni ruhen pesë vjet pas skadimit të vitit kalendarik në të cilën janë dorëzuar.

Kapitulli VII

Veprimi me llogaritë e pagesave të përdoruesit që ka përfunduar së ekzistuari si person juridik

Mbyllja e llogarisë së pagesës së subjektit të fshirë

Neni 185

Ofruesi i shërbimit të pagesave e mbyll llogarinë e pagesës së përdoruesit të shërbimeve të pagesave nëse përdoruesi i shërbimeve të pagesave, fshirja e të cilit është në përputhje me ligjin, është publikuar në faqen e internetit të Regjistrat Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Mbyllja e llogarisë së pagesës së personit juridik që ka përfunduar së ekzistuari

Neni 186

(1) Nëse përdoruesi i shërbimeve të pagesave përfundon së ekzistuari si subjekt juridik në bazë të ligjit, vendimit të gjykatës ose me urdhëresë të organit kompetent, ofruesi i shërbimeve të pagesave e mbyll llogarinë e pagesës së personit juridik.

(2) Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut kur e fshin subjektin sipas paragrafit (1) të këtij neni, për këtë menjëherë, nëpërmjet RVLL-së, i njofton të gjithë ofruesit e shërbimeve të pagesave.

Kapitulli VIII

Kompensim për zotërimin e lejes

Kompensim për zotërimin e lejes

Neni 187

(1) Për zotërimin e lejes për ofrimin e shërbimeve të pagesave, përkatësisht lejes për operatorin e sistemit të pagesave, ofruesit e shërbimeve të pagesave nga neni 9 paragrafi (1) pika 1, 2, 3, 5 dhe 7 të këtij ligji, si dhe operatorët e sistemit të pagesave paguajnë kompensime.

(2) Këshilli i Bankës Popullore me akt nënligjor përcakton në mënyrë të hollësishme bazën e përlllogaritjes, shumën, mënyrën e përlllogaritjes dhe mënyrën e pagesës së kompensimit për dhënësit e shërbimeve të pagesave nga neni 9 paragrafi (1) pika 1, 2, 3, 5 dhe 7 të këtij ligji dhe për operatorët e sistemeve të pagesave.

Kapitulli IX

Llogaritë joaktive

Zbatimi i dispozitave

Neni 188

(1) Dispozitat e Kapitullit IX, pjesa e shtatë e këtij ligji zbatohen në llogaritë e pagesave dhe depozitave (në tekstin e mëtejme Kapitulli IX Pjesa e shtatë e këtij ligji: llogaria) që janë të hapura dhe mbahen te ofruesit e shërbimeve të pagesave nga neni 9 paragrafi (1) pikat 1, 2, 3, 5 dhe 7 të këtij ligji.

(2) Llogaria e bllokuar nuk konsiderohet llogari joaktive.

(3) Statusi i llogarisë joaktive ndërpritet me ekzekutimin e transaksionit të radhës dalës së autorizuar nga konsumatori ose transaksionin e pagesës hyrëse që janë ndryshme nga llogaritja dhe pagesa/arkëtimi e/i interesit dhe/ose transaksioni tjetër i pagesës i ekzekutuar në favor të

ofruesit të shërbimeve të pagesave, ose duke realizuar komunikim të dokumentuar me shkrim, elektronik dhe/ose telefonik të regjistruar në lidhje me llogarinë ndërmjet ofruesit të shërbimeve të pagesave dhe konsumatorit ose personave të autorizuar për punën lidhur me llogarinë ose përfaqësuesin e tij ligjor.

(4) Nëse konsumatori ka më shumë llogari të njëjti ofrues i shërbimeve të pagesave, nëse të paktën njëra prej tyre është aktive, konsiderohet se janë aktive edhe llogaritë e tjera të tij.

(5) Mjetet në të cilat depozitohen paratë e gatshme që shërbejnë si siguri financiare e kredisë nuk konsiderohen si llogari joaktive.

Statusi i llogarisë joaktive

Neni 189

(1) Ofruesit e shërbimeve të pagesave janë të detyruar të sigurojnë sistem për identifikimin e llogarive joaktive të konsumatorëve të cilëve u referohen llogaritë e tilla, si dhe të formojnë evidencë të veçantë për llogaritë joaktive dhe për konsumatorët të cilëve u referohen këto llogari.

(2) Me krijimin e statusit të llogarisë joaktive nuk ndërpritet e drejta e pronësisë mbi paratë financiare të konsumatorit, duke përfshirë nënlojet e së drejtës së pronësisë dhe të drejtave të tjera që rrjedhin nga pronësia.

(3) Ofruesi i shërbimeve të pagesave është i detyruar që të vazhdojë me llogaritjen e interesit të saldosit pozitive të mjeteve financiare në llogarinë joaktive në përputhje me marrëveshjen që i referohet llogarisë.

(4) Ofruesi i shërbimeve të pagesave është i detyruar t'i paraqesë mjetet në llogaritë joaktive si detyrim në raportet e tij financiare në përputhje me standardet ndërkombëtare të raportimit financiar dhe nuk guxon të evidentojë rritje të të ardhurave të tij për shkak të zvogëlimit të mjeteve financiare nga llogaritë joaktive.

(5) Ofruesi i shërbimeve të pagesave nuk duhet të ndërmarrë asnjë veprim, duke përfshirë përlllogaritjen dhe pagimin e kompensimeve për zotërimin e llogarive joaktive ose kompensimeve të ngjashme, ta zvogëlojë vlerën e mjeteve nga llogaritë joaktive, përveç për llogaritjen dhe pagimin e kompensimeve në vlerën e shpenzimeve reale të kryera për komunikimin e dokumentuar, në formë elektronike dhe/ose telefonike të regjistruar me konsumatorin në lidhje me llogarinë dhe në rast të vendimit gjyqësor të plotfuqishëm ose dokumenteve përmbartuese në përputhje me ligjin.

(6) Krijimi i statusit të llogarisë joaktive nuk ndryshon të drejtat që kanë dhe mbajnë llogaritë dhe/ose pronarët e tyre, në rast falimentimit ose likuidimit të ofruesit të shërbimeve të pagesave. Në rast të heqjes së lejes të njërit prej ofruesve të shërbimeve të pagesave nga neni 9 paragrafi (1) pikat 1, 2 ose 3 të këtij ligji, Fondi i Sigurimit të Depozitave bën kompensim të dëmit të mjeteve në para financiare të llogarive joaktive sipas kushteve dhe procedurave të njëjta si dhe për llogaritë që nuk kanë statusin e llogarisë joaktive.

Veprimi me llogaritë joaktive nga ofruesit e shërbimeve të pagesave

Neni 190

(1) Ofruesi i shërbimeve të pagesave është i detyruar të bëjë përpjekje që të kontaktojë dhe njoftojë konsumatorin për mundësinë e ndryshimit të statusit të llogarisë së tij në llogari joaktive, për gjendjen e mjeteve financiare në të, duke përdorur mjetet dhe mënyrën e komunikimit të përcaktuar në marrëveshjen, në muajin e fundit para krijimit të statusit të llogarisë joaktive.

(2) Ofruesi i shërbimeve të pagesave mund t'i mbyllë llogaritë e pagesave joaktive tek të cilët gjendja e mjeteve financiare në momentin e krijimit të statusit joaktiv është e barabartë me zero, me kusht që llogaria e pagesës të mos jetë e bllokuar.

Qasja në informacionet për llogaritë joaktive

Neni 191

Qasja në informacione për ofruesin e shërbimeve të pagesave tek i cili mbahen llogaritë joaktive realizohet nëpërmjet faqes së internetit të Regjistrat Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut duke vendosur numrin amë të qytetarit - përdoruesit që është posedues i llogarisë joaktive.

Pjesa e tetë

E DREJTA E MBROJTJES GJYQËSORE

Procedura e mbrojtjes gjyqësore

Neni 192

(1) Kundër aktvendimeve të guvernatorit ose të Bankës Popullore të miratuara në bazë të këtij ligji, mund të ngrihet kontest administrativ, në përputhje me dispozitat e Ligjit të Kontesteve Administrative, përveç nëse ndryshe nuk është rregulluar me këtë ligj.

(2) Padia nuk e parandalon realizimin e aktvendimit të guvernatorit ose të Bankës Popullore kundër së cilëve është parashtruar.

Pjesa e nëntë

OFRIMI I SHËRBIMEVE NDËRKUFITARE TË PAGESAVE DHE EMETIMI I PARAVE ELEKTRONIKE

Kapitulli I

Ofrimi i shërbimeve të pagesave në territorin e shtetit tjetër anëtar

Mbikëqyrja

Neni 193

Banka Popullore kryen mbikëqyrjen e punës së ofruesve të shërbimeve të pagesave nga neni 9 paragrafi (1) pikat 4, 6 dhe 8 të këtij ligji në mënyrën dhe procedurën e përcaktuar me këtë ligj.

Mënyra e ofrimit të shërbimeve të pagesave

Neni 194

(1) Institucioni i pagesës me leje për ofrimin e shërbimeve të pagesave në përputhje me dispozitat e këtij ligji, në territorin e shteteve të tjera anëtare nëpërmjet filialeve ose agjentit ose në mënyrë të drejtpërdrejtë mund t'i ofrojë të njëjtat shërbime të pagesave të theksuara në lejen.

(2) Institucioni i pagesës që ofon shërbime të pagesave nëpërmjet agjentit në territorin e shteteve të tjera anëtare dhe i cili është i detyruar të caktojë një pikë qendrore kontakti, detyrohet që për caktimin e pikës qendrore të kontaktit ta njoftojë Bankën Popullore.

Përmbajtja e njoftimit për Bankën Popullore

Neni 195

(1) Institucioni i pagesës i cili ka për qëllim të ofrojë shërbime të pagesave në territorin e shtetit tjetër anëtar, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose nëpërmjet filialit ose agjentit, është i detyruar që ta njoftojë Bankën Popullore për qëllimin.

(2) Njoftimi sipas paragrafit (1) të këtij neni, në veçanti duhet të përfshijë:

1) emrin dhe adresën e institucionit të pagesave dhe numrin e aktvendimit për dhënien e lejes për ofrimin e shërbimeve të pagesave;

2) emrin zyrtar të shtetit anëtar ose shteteve anëtare në territorin e të cilit ka për qëllim ofrimin e shërbimeve të pagesave dhe

3) shërbimet e pagesave që institucioni i pagesës ka për qëllim t'i ofrojë në territorin e secilit prej shteteve anëtare.

(3) Nëse institucioni i pagesës ka për qëllim në shtetin – anëtar - nikoqir të ofrojë shërbime të pagesave nëpërmjet filialit, njoftimi sipas paragrafit (1) të këtij neni, përveç informacioneve sipas paragrafit (2) të këtij neni, përfshin edhe:

1) emrin dhe selinë e filiales;

2) përshkrimin e strukturës organizative të filialit, listën me emrin, mbiemrin dhe adresën e personave të cilat do të jenë përgjegjës për menaxhimin e filialit;

3) planin afarist, duke përfshirë edhe projektimin e raporteve financiare për tre vitet e para të punës, në bazë të të cilit mund të nxirret përfundimi se personi juridik do të sigurojë përmbushjen e kushteve përkatëse organizative, kadrovike dhe teknike për punë të qëndrueshme dhe të sigurt dhe

4) përshkrimin e sistemit të menaxhimit me autorizime dhe përgjegjësi të përcaktuara qartë, sistemet e kontrollit të brendshëm, duke përfshirë edhe procedurat administrative, procedurat e brendshme të menaxhimit me rreziqet dhe procedurat e kontabilitetit.

(4) Nëse institucioni i pagesës ka për qëllim në shtetin - anëtar nikoqir që të ofrojë shërbime të pagesave nëpërmjet një agjenti, njoftimi sipas paragrafit (1) të këtij neni, përveç informacioneve sipas paragrafit (2) të këtij neni, përfshin edhe:

1) listën me emrat, mbiemrat dhe adresat e personave që do të jenë përgjegjës për punën e agjentit, si dhe emrin dhe selinë, numrin amë të agjentit;

2) përshkrimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm që do të përdorë agjenti me qëllim të përmbushjes së detyrimeve ligjore lidhur me parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;

3) të dhënat dhe dokumentet e identitetit, kompetenca profesionale për personat që janë anëtarë të organit udhëheqës të agjentit, kur agjenti është ofrues i shërbimeve të pagesave. Në rast kur agjenti nuk është ofrues i shërbimeve të pagesave, dorëzohen të dhëna dhe dokumente për identitetin, kompetencën profesionale dhe reputacionin e anëtarëve të organit drejtues dhe

4) listën e shërbimeve të pagesave që institucioni i pagesës ka për qëllim t'i ofrojë nëpërmjet agjentit.

(5) Në rast se institucioni i pagesës ka për qëllim t'ua bartë realizmin e funksioneve operative lidhur me ofrimin e shërbimeve të pagesave të personave të jashtëm në shtetin - anëtar nikoqir, të njëjtin e shënon në njoftimin sipas paragrafit (1) të këtij neni.

Procedura e njoftimit

Neni 196

(1) Banka Popullore dorëzon njoftimin me informacionet nga neni 195 të këtij ligji te organi kompetent i shtetit anëtar -nikoqir në afat prej një muaji nga dita e pranimi të njoftimit me dokumentacion të plotë.

(2) Në afat prej një muaji nga marrja e njoftimit të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, organi kompetent i shtetit - anëtar nikoqir vlerëson informacionet e marra nga njoftimi dhe vlerësimi, së bashku me informacionin në lidhje me shërbimet e pagesave që kërkohet të kryhen nëpërmjet filialit ose agjentit, dhe në veçanti nëse ekziston dyshimi i bazuar se ofrimi i shërbimeve të pagesave nëpërmjet filialit ose agjentit është i lidhur me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit i dorëzon në Bankën Popullore.

(3) Banka Popullore mund të pajtohet me vlerësimin e organit kompetent të shtetit - anëtar nikoqir.

(4) Nëse Banka Popullore nuk pajtohet me vlerësimin e organit kompetent të shtetit - anëtar nikoqir sipas paragrafit (2) të këtij neni ose me njoftimin sipas paragrafit (12) të këtij neni, do ta njoftojë organin kompetent të shtetit - anëtar nikoqir dhe t'i shënojë arsyet se pse nuk pajtohet.

(5) Në bazë të vlerësimit sipas paragrafit (2) të këtij neni dhe dokumentacionit nga neni 195 i këtij ligji, guvernatori në afat prej 90 ditësh nga dita e pranimi të njoftimit me dokumentacionin e plotë do të miratojë aktvendim:

1. për regjistrimin e agjentit ose filialit në regjistrin përkatës nga neni 27 i këtij ligji.
2. për refuzimin e regjistrimit të agjentit ose filialit në regjistrin përkatës nga neni 27 i këtij ligji.

3. për dhënien e pëlqimit për ofrim të shërbimeve direkte të pagesave ose

4. me të cilin nuk jep pëlqim për ofrim të shërbimeve të direkte të pagesave.

(6) Banka Popullore dorëzon aktvendim sipas paragrafit (5) të këtij neni institucionit të pagesave dhe lidhur me të e njofton organin kompetent të shtetit - anëtar nikoqir.

(7) Institucioni i pagesës mund të fillojë ofrimin e shërbimeve të pagesave nëpërmjet filialit ose agjentit në shtetin - anëtar nikoqir me datën e regjistrimit në regjistrin përkatës nga neni 27 i këtij ligji, dhe në rast të ofrimit të shërbimeve të direkte të pagesave me datën e miratimit të aktvendimit sipas paragrafit (5) pika 3 të këtij neni.

(8) Institucioni i pagesave është i detyruar që ta njoftojë Bankën Popullore për datën e fillimit të ofrimit të shërbimeve direkte të pagesave ose nëpërmjet filialit apo agjentit në shtetin - anëtar nikoqir.

(9) Banka Popullore njoftimin sipas paragrafit (8) të këtij neni, ia dorëzon organit kompetent të shtetit - anëtar nikoqir.

(10) Institucioni i pagesave është i detyruar që menjëherë ta njoftojë Bankën Popullore për çdo ndryshim të të dhënave nga neni 195 i këtij ligji, duke përfshirë çdo filial të ri, agjent të ri ose persona të jashtëm, të cilëve u bartet realizimi i aktiviteteve operative në shtetin - anëtar nikoqir në të cilën ofrohen shërbimet e pagesave.

(11) Në rast të njoftimit sipas paragrafit (10) të këtij neni, zbatohen dispozitat e paragrafëve (1), (2), (3), (4), (5), (6), (7), (8) dhe (9) të këtij neni.

(12) Nëse pas regjistrimit sipas paragrafit (7) të këtij neni në bazë të njoftimit të organit kompetent të shtetit - anëtar nikoqir vlerësohet se ekziston dyshim i bazuar se ofrimi i shërbimeve të pagesave nëpërmjet filialit ose agjentit është i lidhur me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit ose se janë shkelur ligjet e shtetit - anëtar nikoqir, guvernatori miraton aktvendim për shfuqizimin e aktvendimit për regjistrim në regjistrin e institucioneve të pagesave nga neni 27 të këtij ligji.

(13) Banka Popullore menjëherë e dorëzon aktvendimin për fshirje nga regjistri sipas paragrafit (12) të këtij neni në organin kompetent të shtetit - anëtar nikoqir dhe në institucionin e pagesave.

Kapitulli II

Ofrimi i shërbimeve të pagesave nga shteti anëtar në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut

Neni 197

(1) Institucioni i pagesave nga shteti anëtar në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut mund të ofrojë shërbime të pagesave për të cilat ka leje në shtetin amë anëtar, në mënyrë direkte ose nëpërmjet filialit ose agjentit.

(2) Organi kompetent i shtetit amë anëtar do të dorëzojë njoftimin në pajtim me nenin 195 të këtij ligji.

(3) Banka Popullore i vlerëson informacionet e marra me njoftimin sipas paragrafit (2) të këtij neni dhe vlerësimin e dorëzon në organin kompetent të shtetit amë anëtar në afat prej një muaji nga dita e marrjes së njoftimit me dokumentacionin e plotë.

(4) Vlerësimi sipas paragrafit (3) të këtij neni përfshin informacione relevante lidhur me ofrimin e planifikuar të shërbimeve të pagesave në mënyrë direkte ose nëpërmjet filialit ose agjentit nga institucioni i pagesave dhe veçanërisht për dyshimin e bazuar se ofruesi i shërbimeve të pagesave nëpërmjet filialit ose agjentit lidhet me pastrimin e parave ose financimin e terrorizmit në lidhje me planifikimin.

(5) Dispozitat nga paragrafët (2), (3) dhe (4) të këtij neni zbatohen dhe në rast se Banka Popullore merr njoftim nga organet kompetente të shtetit amë anëtar për ndryshime në lidhje me ofrimin e shërbimeve të pagesave nga institucioni i pagesave nga shteti amë anëtar në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

(6) Institucioni i pagesave nga shteti anëtar fillon dhënien e shërbimeve të pagesave në Republikën e Maqedonisë së Veriut nëpërmjet filialit ose agjentit me regjistrimin e filialit ose agjentit në regjistrin që mbahet nga organi kompetent i shtetit amë anëtar, dhe në rast të ofrimit të shërbimeve direkte të pagesave nga institucioni i pagesave nga shteti anëtar pas dorëzimit të njoftimit në Bankën Popullore nga organi kompetent i shtetit amë anëtar.

(7) Institucioni i pagesave nga shteti anëtar që në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut ofron shërbime të pagesave nëpërmjet agjentëve, cakton pikë qendrore të kontaktit për shkak të sigurimit të komunikimit të duhur dhe njoftimit për harmonizimin e dispozitave të Pjesës së tretë dhe Pjesës së katërt të këtij ligji, pa qenë e njëjta në kundërshtim me rregulloret e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit dhe të lehtësohet mbikëqyrja nga organet kompetente të shtetit amë anëtar dhe të shtetit – anëtar nikoqir, nëpërmjet sigurimit të dokumenteve dhe informacioneve me kërkesë të organeve kompetente.

(8) Institucioni i pagesave e njofton Bankën Popullore për caktimin e pikës qendrore për kontakt sipas paragrafit (7) të këtij neni.

(9) Agjenti i institucionit të pagesave nga shteti anëtar është i detyruar t'i njoftojë përdoruesit e shërbimeve të pagesave se shërbimet e pagesave i ofron në emër dhe për llogari të atij institucioni të pagesave si agjent i tij.

Kapitulli III
Emetimi i parave elektronike
në territorin e shtetit tjetër anëtar dhe nga shteti tjetër anëtar në territorin e Republikës së
Maqedonisë së Veriut

Neni 198

Nenet 193, 194, 195, 196 dhe 197 të këtij ligji zbatohen përkatësisht edhe për emetimin e parave elektronike nga territori i Republikës së Maqedonisë së Veriut në shtetin tjetër anëtar dhe nga shteti tjetër anëtar në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Kapitulli IV
Ofrimi dhe përdorimi ndërkufitar i shërbimeve të pagesave

Neni 199

Rezidentët e Republikës së Maqedonisë së Veriut mund të përdorin para elektronike nga emetuesit e parave elektronike të cilët kanë marrë leje ose lloj tjetër miratimi nga organi përkatës kompetent i vendit të tretë.

Kapitulli V
Zbatimi ndërkufitar i shërbimit të bartjes

Neni 200

(1) Ofruesi i shërbimeve të pagesave është i detyruar me kërkesë të konsumatorit i cili ka llogari të hapur të pagesave t'i mundësojë përdorimin e shërbimit për bartje të llogarive të pagesave të ofruesi i shërbimeve të pagesave në shtetin tjetër anëtar.

(2) Ofruesi i shërbimeve të pagesave që kryen bartjen në llogarinë e pagesave është i detyruar:

1) pa kompensim t'i sigurojë konsumatorit:

- listën e të gjitha urdhërësive rrjedhëse aktive për transferet e kredisë dhe autorizimet e debitimit direkt për të cilat paguesi ka dhënë pëlqimin dhe
- informacione të disponueshme për transferet periodike të kredive hyrëse dhe debitimet direkte për të cilat paguesi ka dhënë pëlqim për pranuesin ose ofruesin e shërbimeve të pagesave për pranuesin, të cilat janë realizuar në llogarinë e pagesave të konsumatorit në 13 muajt e paraprak dhe

2) të bartë saldon pozitive nga llogaria e pagesave të konsumatorit në llogarinë e pagesës së hapur ose në llogarinë që ka tek ofruesi i shërbimeve të pagesave që pranon bartjen në llogarinë e pagesës, me kusht që kërkesa të përfshijë të gjitha të dhënat që mundësojnë identifikimin e ofruesit të shërbimeve të pagesave që pranon bartjen e llogarisë së pagesës dhe llogarisë së pagesës së konsumatorit tek ofruesi i shërbimeve të pagesave që pranon bartjen e llogarisë së pagesës dhe/ose mbylljen e llogarisë së pagesës së konsumatorit.

(3) Ofruesi i shërbimeve të pagesave i cili pranon bartjen e llogarisë së pagesës është i detyruar t'i ofrojë shërbimet sipas paragrafit (2) të këtij neni, nëse të njëjtat nuk i ka ofruar më parë.

(4) Nëse konsumatori nuk ka detyrime të papaguara të llogarisë së pagesës, ofruesi i shërbimeve të pagesave ku konsumatori e ka atë llogari të pagesës vepron në përputhje me paragrafin (2) të këtij neni.

(5) Data sipas paragrafit (4) të këtij neni duhet të jetë së paku gjashtë ditë pune nga dita kur ofruesi i shërbimeve të pagesave që kryen bartjen e llogarisë së pagesës ka pranuar kërkesën e konsumatorit, përveç nëse ndryshe është dakorduar ndërmjet palëve.

(6) Nëse në llogarinë e pagesës tek ofruesi i shërbimeve të pagesave i cili kryen bartjen e llogarisë së pagesës konsumatori ka detyrime të papaguara që pengojnë mbylljen e llogarisë së pagesës, ofruesi i shërbimit të pagesave që kryen bartjen e llogarisë së pagesës nuk e mbyll llogarinë e pagesës dhe për të njëjtën menjëherë pas parashtrimit të kërkesës sipas paragrafit (1) të këtij neni njofton konsumatorin.

Kapitulli VI

Bashkëpunimi me organet kompetente, mbikëqyrja, masat dhe zgjidhja e kontesteve

Bashkëpunimi me organet kompetente

Neni 201

(1) Banka Popullore bashkëpunon me organet kompetente të shteteve anëtare dhe me ta shkëmben informacione, në veçanti informacione në lidhje me parregullsitë e kryera dhe/ose paligjshmërinë ose dyshimin për parregullsinë dhe/ose paligjshmërinë e kryer nga institucioni i pagesave që ofron shërbime të pagesave nëpërmjet filialit ose agjentit në territorin e shtetit anëtar dhe nëse parregullsia ose paligjshmëria është kryer në kontekstin e lirisë për ofrim të shërbimeve.

(2) Banka Popullore, me iniciativën e saj ose me kërkesën e organit kompetent të shtetit - anëtar nikoqir, i jep të gjitha informacionet e nevojshme për realizmin e kompetencave të saj në lidhje me mbikëqyrjen mbi zbatimin e dispozitave të ligjit nacional me të cilin rregullohet puna e filialit ose agjentit të institucionit të pagesave që ofron shërbime pagesash në territorin e shtetit - anëtar nikoqir.

(3) Banka Popullore me iniciativë personale ose me kërkesë të organit kompetent të shtetit - anëtar nikoqir, përveç informacioneve sipas paragrafit (2) të këtij neni, do të dorëzojë edhe informacione tjera të rëndësishme, si dhe informacione nëse selia e administratës dhe selia e regjistruar e institucionit të pagesave janë vendosur në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe nëse shërbimet e pagesave ofrohen në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(4) Banka Popullore vlerëson informacionet e marra nga organi kompetent i shtetit - anëtar nikoqir, që i dorëzon me iniciativë të tij dhe deri te organi kompetent i shtetit - anëtar nikoqir mund të dorëzojë kërkesë për parashtrimin e informacioneve shtesë që janë me rëndësi për realizmin e mbikëqyrjes në përputhje me këtë ligj.

Mbikëqyrja e agjentëve ose filialeve në shtetin - anëtar nikoqir

Neni 202

(1) Banka Popullore bashkëpunon me organin kompetent të shtetit - anëtar nikoqir gjatë mbikëqyrjes së agjentit ose filialit të institucionit të pagesave me leje për themelimin dhe punën në përputhje me dispozitat e këtij ligji, përkatësisht që drejtpërdrejt ofron shërbime të pagesave në territorin e shtetit - anëtar nikoqir.

(2) Banka Popullore e njofton organin kompetent të shtetit - anëtar nikoqir kur ka për qëllim të realizojë mbikëqyrje në terren të filialeve ose agjentit të institucionit të pagesave në territorin e shtetit - anëtar nikoqir.

(3) Banka Popullore me iniciativë të saj ose me kërkesë të organit kompetent të shtetit anëtar i ofron të gjitha informacionet lidhur me konstatimet nga mbikëqyrja e realizuar sipas paragrafit (2) të këtij neni, veçanërisht për parregullsitë dhe/ose paligjshmëritë e konstatuara ose për ekzistimin e dyshimit për parregullsitë dhe/ose paligjshmëritë e kryera.

(4) Banka Popullore mund t'i bartë organit kompetent të shtetit - anëtar nikoqir ekzekutimin e mbikëqyrjes në terren të agjentit apo filialit sipas paragrafit (2) të këtij neni, nëse bartja mundëson kryerjen e ekzekutimit të mbikëqyrjes në terren në mënyrë të thjeshtë, më efikase, në periudhë më të shkurtër kohore ose me shpenzime më të ulëta.

(5) Organi kompetent i shtetit amë anëtar njofton Bankën Popullore kur ka për qëllim zbatimin e mbikëqyrjes në terren të filialit ose agjentit të institucionit të pagesave që ofron shërbime të pagesave në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(6) Banka Popullore, me kërkesë të organit kompetent të shtetit amë anëtar, mund të kryejë mbikëqyrje në terren ndaj agjentit ose filialit të institucionit të pagesës nga shteti amë anëtar.

(7) Banka Popullore mund të kërkojë nga institucionet e pagesave ose institucionet për para elektronike nga shtetet tjera anëtare që ofrojnë shërbime të pagesave nëpërmjet agjentëve ose filialeve në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut t'i dorëzojnë raporte dhe të dhëna.

(8) Banka Popullore raportet dhe të dhënat sipas paragrafit (7) të këtij neni do t'i shfrytëzojë për qëllime informative dhe statistikore dhe/ose për qëllime të kryerjes së mbikëqyrjes së dispozitave nga Pjesa e tretë dhe e katërt e këtij ligji dhe me të dhënat e pranuar vepron në pajtim me nenin 160 paragrafi (4) të këtij ligji.

Masat

Neni 203

(1) Nëse Banka Popullore merr njoftim nga organi kompetent i shtetit - anëtar nikoqir se institucioni i pagesave me leje në pajtim me dispozitat e këtij ligji që ofron shërbime të pagesave nëpërmjet agjentit ose filialit në shtetin - anëtar nikoqir nuk punon në përputhje me dispozitat e ligjit nacional të shtetit - anëtar nikoqir me të cilin rregullohet puna, vlerëson informacionet e marra nga njoftimi i marrë.

(2) Guvernatori, në bazë të vlerësimit sipas paragrafit (1) të këtij neni, menjëherë ndërmerr dhe/ose shqipton masa dhe cakton afate për zbatimin e tyre me qëllim të mënjanimin të parregullsisë dhe/ose paligjshmërisë nga institucioni i pagesave.

(3) Banka Popullore për masat e ndërmarra menjëherë njofton organin kompetent të shtetit - anëtar nikoqir dhe organet kompetente të të gjitha shteteve tjera anëtare të involvuara për masat e ndërmarra.

Masat parandaluese

Neni 204

(1) Nëse është e nevojshme që urgjentisht të mbrohen përdoruesit e shërbimeve të pagesave në Republikën e Maqedonisë së Veriut nga kërcënime serioze ndaj interesave të përbashkëta të tyre, Banka Popullore mund të ndërmarrë masa parandaluese ndaj institucionit të pagesave që ofron shërbime të pagesave nëpërmjet agjentit ose filialit në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në pritje të masave nga organet kompetente të shtetit amë anëtar në përputhje me nenet 200 dhe 202 të këtij ligji.

(2) Masat parandaluese sipas paragrafit (1) të këtij neni duhet të jenë të përshtatshme dhe proporcionale me nevojën për të siguruar mbrojtje nga kërcënime serioze për interesat e përbashkëta të përdoruesve të shërbimeve të pagesave dhe nuk duhet t'i sjellin në pozitë më të favorshëm përdoruesit e shërbimeve të pagesave të institucioneve të pagesave me leje për themelimin dhe punën në pajtim me dispozitat e këtij ligji lidhur me përdoruesit e shërbimeve të pagesave në shtetet e tjera anëtare.

(3) Masat parandaluese sipas paragrafit (1) të këtij neni janë të përkohshme dhe Banka Popullore do t'i shfuqizojë ato menjëherë pasi të ndalojë kërcënimi serioz ndaj interesave të përbashkëta të përdorueseve të shërbimeve të pagesave në Republikës së Maqedonisë së Veriut, pavarësisht nëse kërcënimi ka ndaluar me aktivitetin e organeve kompetente të shtetit amë anëtar ose Organit Bankar European.

(4) Banka Popullore e njofton organin kompetent të shtetit amë anëtar, organet e involvuara kompetente të shteteve tjera anëtare, Komisionin European dhe Organin European Bankar për veprime bankare për ndërmarrjen e masave sipas paragrafit (1) të këtij neni dhe për arsyet e tyre për ndërmarrjen e tyre para shqiptimit të masave dhe nëse kjo nuk mundësohet menjëherë pas shqiptimit të tyre.

Zgjidhja e kontesteve ndërmjet organeve kompetente

Neni 205

(1) Nëse Banka Popullore vlerëson se në një rast të caktuar bashkëpunimi ndërkufitar me organet kompetente të një shteti anëtar nuk është në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenet 196, 197, 200, 201 dhe 209 të këtij ligji, lënda drejtohet në Organin Bankar European.

(2) Nëse Banka Popullore vepron në pajtim me paragrafin (1) të këtij neni ose nëse organi kompetent i shtetit anëtar e parashtron lëndën në Organin Bankar European sepse konsideron se bashkëpunimi ndërkufitar me Bankën Popullore nuk i plotëson kushtet e përcaktuara në nenet 196, 197, 200, 201 dhe 202 të këtij ligji, Banka Popullore do ta shtyjë miratimin e vendimit deri në miratimin e vendimit të Organit Bankar European.

Pjesa e dhjetë

DISPOZITA PËR KUNDËRVAJTJE

Neni 206

(1) Për kundërvajtjet e përcaktuara me këtë ligj, procedurë për kundërvajtje udhëheq dhe sanksion për kundërvajtje shqipton gjykata kompetente.

(2) Për kundërvajtjet e kryera nga ky ligj, personat e autorizuar nga guvernatori për mbikëqyrje janë të detyruar që kryerësit të kundërvajtjes t'i propozojnë procedurën e barazimit me lëshimin e urdhërpagesës për kundërvajtje, në pajtim me Ligjin e Kundërvajtjeve.

(3) Këshilli i Bankës Popullore, me akt nënligjor përcakton formën dhe elementet e detyrueshme të urdhërpagesës për kundërvajtje.

Neni 207

(1) Gjobë në vlerë prej 3.000 deri 5.000 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet ofruesit të shërbimeve të pagesave nëse:

- 1) nuk i shpalos kompensimet dhe kursin devizor (neni 45 paragrafi (3) i këtij ligji);
- 2) nuk i shpall publikisht kurset devizore (neni 45 paragrafi (4) i këtij ligji);
- 3) realizon konvertimin e valutës pa pëlqimin e paguesit (neni 45 paragrafi (5) i këtij ligji);
- 4) nuk e njofton shfrytëzuesin e shërbimeve të pagesave për kompensimin për përdorimin e instrumentit të caktuar të pagesës para inicimit të transaksionit të pagesës (neni 46 paragrafi (1) i këtij ligji);
- 5) nuk i përmbahet kufizimeve për transaksionet njëhershme të pagesës (neni 48 paragrafët (3) dhe (4) të këtij ligji);

6) me inicimin e pagesës nuk i ofron dhe as nuk i vë në dispozicion paguesit dhe marrësit informacionet nga neni 50 paragrafi (1) i këtij ligji;

7) ofruesit të shërbimeve të pagesave që mban llogari të pagesës nuk ia jep shenjën referente për transaksionin e pagesës (neni 50 paragrafi (2) i këtij ligji);

8) menjëherë pas pranimit të urdhërpagesës nuk i jep dhe as nuk i vë në dispozicion paguesit informacionet në pajtim me nenin 51 të këtij ligji;

9) menjëherë pas realizimit të transaksionit të pagesës nuk i jep dhe as nuk i vë në dispozicion pranuesit informacionet në pajtim me nenin 52 të këtij ligji;

10) nuk i jep konsumatorit dokumentin informativ për kompensimet dhe fjalorthin e termave të mënyrës dhe përmbajtjes në përputhje me nenet 54 dhe 55 të këtij ligji;

11) nuk e njofton konsumatorin për mundësinë e hapjes dhe përdorimit të llogarisë së pagesës veçmas nga produktet dhe shërbimet e tjera dhe nuk jep informacione për të gjitha kompensimet dhe shpenzimet që lidhen me secilin prej produkteve dhe/ose shërbimeve në përputhje me nenin 57 të këtij ligji;

12) para lidhjes së marrëveshjes kornizë nuk ia jep informacionet në mënyrën e përcaktuar me nenin 58 paragrafët (1), (2), (3) dhe (4) të këtij ligji;

13) me kërkesë të përdoruesit të shërbimeve të pagesave, nuk ofron kushtet e kontraktuara nga marrëveshja kornizë (neni 58 paragrafi (5) i këtij ligji);

14) nuk e njofton menjëherë përdoruesin e shërbimeve të pagesave për ndryshimet në vlerën e normës së interesit në pajtim me nenin 59 paragrafi (6) të këtij ligji;

15) me kërkesë të paguesit nuk ia ofron informacionet nga neni 61 i këtij ligji;

16) menjëherë pas debitimit të llogarisë së pagesës ose pas marrjes së urdhërpagesës, paguesit nuk i ka dhënë informacionet për mënyrën dhe afatet në pajtim me nenin 62 të këtij ligji;

17) menjëherë pas realizimit të transaksionit të pagesës, pranuesit nuk i jep informacionet për mënyrën dhe afatet në pajtim me nenin 63 të këtij ligji;

18) nuk përdor terma dhe përkufizime të standardizuara në pajtim me nenin 66 të këtij ligji;

19) nuk i përdor brendet e pagesave sipas të kushteve nga neni 66 paragrafët (2) dhe (3) të këtij ligji;

20) nuk konfirmon menjëherë që në llogarinë e pagesës së poseduar nga paguesi është e disponueshme vlera e nevojshme për të realizuar transaksionin e pagesës e bazuar në kartelë (neni 80 paragrafi (1) i këtij ligji);

21) nuk e njofton paguesin për identitetin e ofruesit të shërbimeve të pagesave që ka lëshuar instrumentin e pagesës (neni 80 paragrafi (6) i këtij ligji);

22) nuk e heq bllokimin ose nuk e zëvendëson instrumentin e bllokuar të pagesës me një të ri në pajtim me nenin 83 paragrafi (4) të këtij ligji;

23) nuk e njofton paguesin për refuzimin e qasjes në llogarinë e pagesës dhe arsyet për këtë dhe nuk siguron qasje pas përfundimit të arsyeve të refuzimit në përputhje me nenin 84 paragrafët (2) dhe (3);

24) nuk njofton Bankën Popullore për refuzimin e qasjes në llogarinë e pagesës (neni 84 paragrafi (4) i këtij ligji);

25) nuk i përmbush detyrimet lidhur me instrumentin e pagesës nga neni 86 i këtij ligji;

26) nuk e njofton përdoruesin e shërbimit të pagesave për refuzimin e realizimit të urdhërpagesës ose inicimin e transaksionit të pagesës në pajtim me nenin 95 paragrafët (1), (2) dhe (4) të këtij ligji;

27) llogarit dhe arkëton kompensimin në kundërshtim me dispozitat e nenit 95 paragrafi (3) të nenit 96 paragrafi (7) dhe nenit 101 paragrafi (7) të këtij ligji;

28) Nuk e paraqet në mënyrë të plotë vlerën e transaksionit të pagesës dhe vlerën e llogaritur dhe të arkëtuar të kompensimeve në pajtim me nenin 97 paragrafi (4);

29) nuk e kryen transaksionin e pagesës brenda afateve nga neni 99 paragrafët (1), (2), (3), (4), (5), (6), (7), (9), (10) dhe (11) të këtij ligji;

30) pagesit nuk ia dorëzon të gjitha informacionet që disponon për nevojat e kthimit të mjeteve të pagesave (neni 101 paragrafi (6) i këtij ligji);

31) nuk ka vënë në dispozicion ose nuk i ka dhënë konsumatorit informacionet në lidhje me shërbimin e bartjes (neni 109 i këtij ligji);

32) fillon me zbatimin e shërbimit të bartjes pa pëlqim të qartë për bartjen e llogarisë së pagesës në formë dhe përmbajtje në pajtim me nenin 110 të këtij ligji;

33) në procedurën për zbatimin e shërbimit të bartjes ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 111 të këtij ligji;

34) në lidhje me shërbimin e bartjes llogarit dhe paguan kompensimet në kundërshtim me dispozitat e nenit 112 të këtij ligji;

35) nuk i ka dorëzuar informacionet me kërkesë të Bankës Popullore (neni 115 paragrafi (3) i këtij ligji);

36) nuk llogarit dhe paraqet kompensimet për transaksionet e pagesave në bazë të kartelave në pajtim me nenin 118 të këtij ligji;

37) kushtëzjnë pranimin e instrumenteve të pagesës me kartelë me pranimin e instrumenteve të tjera të pagesës (neni 119 paragrafi (1) i këtij ligji);

38) pas realizimit të transaksionit të pagesës në bazë të kartelës, nuk i jep pranuesit informacionet nga neni 121 paragrafi (1) i këtij ligji;

39) nuk e ruan dokumentacionin brenda afateve nga neni 127 i këtij ligji;

40) nuk mbrojnë dhe ruajnë zotërimin e dokumenteve, të dhënave dhe/ose informacioneve që kanë të bëjnë me shërbimet e pagesave në pajtim me nenin 128 të këtij ligji;

41) nuk përcakton procedura për zgjidhjen e kundërshtimeve nga përdoruesit e shërbimeve të pagesave dhe nuk i dorëzon përgjigje përdoruesit për kundërshtimin (neni 129 paragrafët (2), (4), (5) dhe (6) të këtij ligji);

42) nuk i siguron informacionet ose refuzon të marrë pjesë në procedurën jashtëgjyqësore për zgjidhjen e kontesteve të filluara nga konsumatori (neni 131 paragrafët (1) dhe (3) të këtij ligji);

43) nuk krijon regjistër të brendshëm të llogarive të pagesave dhe kasafortave, nuk i dorëzon RVLL-së informacionet dhe të dhënat nga regjistrat e brendshëm ose nuk dorëzon të dhëna të pasakta (neni 175 paragrafët (2), (3), (4) dhe (5) të ky ligji);

44) nuk vepron në pajtim me nenin 179 paragrafët (4), (6), (8), (9), (10) dhe (11) të këtij ligji;

45) vazhdon marrëveshjen e afatizimit me afat të shërbimit të pagesave të përdoruesit - debitorit, llogaria e pagesës e të cilit është e bllokuar ose pas skadimit të marrëveshjes nuk i bartë mjetet financiare në llogarinë e bllokuar të pagesës (neni 180 i këtij ligji);

46) pagon kompensim për realizimin e urdhërpagesës në vlerë më të madhe se shpenzimet e realizuara në të vërtetë (neni 181 i këtij ligji);

47) nuk dorëzon të dhëna dhe informacione për qëllime statistikore (neni 184 paragrafët (1) dhe (2) të këtij ligji) dhe nuk ka krijuar lidhje për qasje në faqen e internetit (neni 184 paragrafi (8) i këtij ligji) dhe

48) nuk mbyll llogarinë e pagesave të përdoruesit të shërbimeve të pagesave i cili ka përfunduar së ekzistuari si person juridik në përputhje me nenet 185 dhe 186 të këtij ligji.

(2) Gjobë në vlerë prej 200 deri 300 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet përgjegjësit të ofruesi i shërbimeve të pagesave për kundërvajtjen sipas paragrafit (1) të këtij neni.

Neni 208

(1) Vlerë në vlerë prej 7.000 deri 10.000 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet ofruesit të shërbimeve të pagesave nëse:

1) përdoruesit të shërbimeve të pagesave i llogaritet dhe paguan kompensim për sigurimin e informacioneve që është i detyruar t'ia japë ose t'ia vë në dispozicion (neni 44 paragrafi (1) i këtij ligji);

2) paguan kompensim që nuk është në vlerën e shpenzimeve reale të realizuara (neni 44 paragrafi (3) i këtij ligji);

3) nuk i jep ose nuk i vë në dispozicion informacionet dhe kushtet paraprake për kryerjen e transaksioneve të njëhershme të pagesës në përputhje me nenin 49 paragrafët (2), (3) dhe (4) të këtij ligji;

4) para lidhjes së marrëveshjes kornizë nuk ia jep informacionet nga neni 56 paragrafi (1) i këtij ligji;

5) marrëveshja kornizë nuk përfshin informacione në përputhje me nenin 56 paragrafi (2) dhe nenin 92 paragrafi (2) të këtij ligji;

6) ndryshimet në marrëveshjen kornizë nuk i propozon në mënyrën dhe afatet në përputhje me nenin 59 paragrafi (1) të këtij ligji;

7) e ndërpret marrëveshjen kornizë dhe për të njëjtën merr kompensim në kundërshtim me nenin 60 të këtij ligji;

8) nuk i jep raport për kompensimet e llogaritura në mënyrën dhe afatet nga neni 64 i këtij ligji dhe me përmbajtje në përputhje me nenin 65 të këtij ligji;

9) përdoruesit të shërbimeve të pagesave i paguan kompensime që nuk përfshihen në marrëveshje dhe nuk janë në vlerën e shpenzimeve reale të realizuara (neni 77 paragrafi (1) i këtij ligji);

10) në bazë të konfirmimit të mjeteve në dispozicion kryen rezervimin e mjeteve në llogarinë e pagesës së paguesit (neni 80 paragrafi (5) i këtij ligji);

11) vepron në kundërshtim me nenin 81 paragrafi (3) të këtij ligji;

12) nuk ia mundëson paguesit të drejtën për ta përdorur shërbimin për iniciimin e pagesave në përputhje me nenin 81 paragrafi (4) të këtij ligji;

13) vepron në kundërshtim me nenin 82 paragrafi (3) të këtij ligji;

14) nuk komunikon në përputhje me standardet e komunikimit dhe nuk vepron sipas kërkesës për dhënie të informatave për llogarinë e pagesës në mënyrë identike (neni 82 paragrafi (4) i këtij ligji);

15) gjatë bllokimit të instrumentit të pagesës, nuk e informon paguesin për bllokimin dhe arsyet e bllokimit (neni 83 paragrafi (3) i këtij ligji);

16) në rast të transaksionit të kryer të paautorizuar të pagesës nuk vepron në përputhje me nenin 89 të këtij ligji;

17) nuk i kthen mjetet nëse janë plotësuar kushtet sipas nenit 93 paragrafët (1), (3), (4) (5), (6), (7) (8) dhe (9) të këtij ligji;

18) nuk e bartë vlerën e transaksionit të pagesës në përputhje me nenin 97 paragrafët (1), (2), (3), (5) dhe (6) të këtij ligji;

19) llogarit dhe paguan kompensim shumëpalësh të zëvendësimit nga ofruesit e tjerë të shërbimeve të pagesave në kundërshtim me nenin 98 të këtij ligji;

20) miratimi i llogarisë së pagesës së pranuesit nuk është në përputhje me dispozitat e nenit 100 të këtij ligji;

21) për mosekzekutim, ekzekutim jo të drejtë ose ekzekutim me vonesë të transaksionit të pagesës nuk vepron në përputhje me nenin 102 paragrafët (5), (6), (7), (8) dhe (9), nenin 103 dhe nenin 104 paragrafi (1) i këtij ligji;

22) konsumatorit nuk i mundëson përdorimin e shërbimit të bartjes ose e kushtëzon përdorimin me përdorimin e produkteve dhe/ose shërbimeve tjera (neni 108 paragrafët (2) dhe (4) të këtij ligji);

23) llogarit dhe paguan kompensimin të zëvendësimit në kundërshtim me nenin 115 paragrafët (1) dhe (2) të këtij ligji;

24) nuk i dorëzon Bankës Popullore vlerësim të përditësuar dhe gjithëpërfshirës për ekspozimin ndaj rreziqeve operative dhe të sigurisë (neni 122 paragrafi (3) i këtij ligji);

25) nuk e njofton Bankën Popullore për incident të rëndësishëm dhe operativ të sigurisë dhe nuk i dorëzon të dhëna statistikore për mashtrimet e kryera (neni 123 paragrafët (1) dhe (7) të këtij ligji);

26) nuk zbaton autentifikim të përforcuar për klientin dhe nuk vendos masa sigurie për mbrojtje në përputhje me nenin 124 paragrafët (1), (2) dhe (3) të këtij ligji;

27) nuk kanë kanal komunikimi që mundëson lidhje dhe komunikim të sigurt gjatë transaksioneve të pagesave të bazuara në kartela (neni 125 paragrafi (1) i këtij ligji);

28) nuk mundëson autentifikimin nëpërmjet standardeve të përgjithshme, të sigurta dhe të hapura për komunikim në mënyrë në përputhje me nenin 125 paragrafi (2) të këtij ligji;

29) nuk siguron sistem për identifikimin e llogarive joaktive të konsumatorëve dhe nuk formon evidencë të veçantë (neni 189 paragrafi (1) i këtij ligji);

30) evidenton rritje të të ardhurave si rezultat i zvogëlimit të mjeteve nga llogaritë joaktive (neni 189 paragrafi (4) i këtij ligji);

31) e zvogëlon vlerën e mjeteve nga llogaritë joaktive në kundërshtim me nenin 189 paragrafi (5) të këtij ligji;

32) nuk i publikon ndryshimet e marrëdhënieve kontraktuale duke i publikuar informacionet nga neni 54, 55 dhe 56 në hapësirat e tij të punës ku përdoruesi ka qasje për qëllime të përdorimit të shërbimeve të pagesave dhe në faqen e tij të internetit në përputhje me nenin 223 paragrafi (3) dhe

33) me kërkesë të përdoruesit të shërbimeve të pagesave nuk lidh marrëveshje kornizë në përputhje me nenin 222 paragrafi (4).

(2) Gjjobë në vlerë prej 350 deri 500 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet përgjegjësit të ofruesi i shërbimeve të pagesave për kundërvajtjen sipas paragrafit (1) të këtij neni.

Neni 209

(1) Gjjobë në vlerë prej 3.000 deri 5.000 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet ofruesit të shërbimeve të pagesave nga neni 9 paragrafi (1) pika 1, 2 dhe 3 nëse:

1) nuk e njofton Bankën Popullore për refuzimin e kërkesës për hapjen dhe përdorimin e llogarisë së pagesës (neni 10 paragrafi (2) i këtij ligji);

2) në ofertën për shërbime të pagesave deri te konsumatorët nuk përfshin llogari të pagesës me funksione bazë ose hapjen dhe përdorimin e llogarisë së pagesave me funksionet bazë e kushtëzon me përdorimin e shërbimeve dhe/ose produkteve shtesë (neni 71 paragrafët (1) dhe (2) të këtij ligji);

3) konsumatorit nuk i vë në dispozicion informacionet për veçoritë e llogarisë së pagesës me funksionet bazë, kushtet e përdorimit dhe vlerën e kompensimeve që llogariten dhe paguhen për llogarinë e pagesave me funksione bazë (neni 71 paragrafi (3) të këtij ligji);

4) nuk e hap ose nuk e refuzon kërkesën për hapjen e llogarisë së pagesës me funksione bazë në afatin nga neni 72 paragrafi (2) dhe (10) të këtij ligji;

5) nuk e njofton organin kompetent për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit për refuzimin e kërkesës për llogari të pagesës me funksione bazë në përputhje me nenin 72 paragrafi (5) të këtij ligji;

6) nuk e njofton konsumatorin për refuzimin e kërkesës për hapjen e llogarisë së pagesës me funksione bazë në përputhje me nenin 72 paragrafi (6) dhe (7) të këtij ligji;

7) në lidhje me llogarinë e pagesave me funksione bazë, paguan kompensime në kundërshtim me nenin 74 të këtij ligji dhe

8) nuk e njofton konsumatorin për ndërprerjen e njëanshme të marrëveshjes në mënyrën dhe afatin nga neni 75 paragrafi (4) i këtij ligji.

(2) Gjobë në vlerë prej 200 deri 300 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet përgjegjësit të ofruesi i shërbimeve të pagesave për kundërvajtjen sipas paragrafit (1) të këtij neni.

Neni 210

1) Gjobë në vlerë prej 3.000 deri 5.000 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet institucionit të pagesës, përkatësisht institucionit të parave elektronike nëse:

1) nuk njofton për ndikimin e veprimtarive të reja (neni 11 paragrafi (4) i këtij ligji);

2) themelon filial jashtë Republikës së Maqedonisë së Veriut në kundërshtim me nenin 17 paragrafi (6) dhe nenin 18 paragrafi (6);

3) nuk e njofton Bankën Popullore për ndryshimet në përputhje me nenin 39 paragrafi (7) të këtij ligji;

4) nuk e njofton Bankën Popullore për bartjen e kryerjes së funksioneve operative të personat e jashtëm (neni 40 paragrafi (1) i këtij ligji), përkatësisht nuk e njofton për çdo ndryshim lidhur me përdorimin sa i përket personave të jashtëm (neni 40 paragrafi (5) i këtij ligji) dhe

5) nuk e njofton Bankën Popullore për ndërmartjen e kryerjes së funksioneve operative nga persona të tjerë (neni 40 paragrafi (6) i këtij ligji).

(2) Gjobë në vlerë prej 200 deri 300 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet përgjegjësit në institucionin e pagesës, përkatësisht institucionin për para elektronike për kundërvajtjen sipas paragrafit (1) të këtij neni.

Neni 211

(1) Gjobë në vlerë prej 7.000 deri 10.000 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet institucionit të pagesës, përkatësisht institucionit të parave elektronike nëse:

1) ofron shërbime të pagesave që nuk janë të cekura në lejen (neni 11 paragrafi (1) dhe paragrafi (3) pika 1 të këtij ligji);

2) miraton linjë kreditore në kundërshtim me nenin 12 të këtij ligji;

3) mbledh depozita ose burime të tjera të kthyeshme të mjeteve nga publiku dhe kryen reklamimin e atyre aktivitete (neni 15 paragrafi (1) i këtij ligji);

4) emëron anëtar të organit drejtues pa marrë pëlqimin paraprak nga guvernatori (neni 23 paragrafi (1) i këtij ligji);

5) hap filial në shtetin e tretë pa pëlqimin e guvernatorit (neni 26 paragrafi (2) i këtij ligji);

6) nuk siguron mbrojtjen e mjeteve financiare (neni 31 paragrafët (2), (3), (8) dhe (9) dhe neni 32 paragrafi (1) dhe (2) të këtij ligji);

7) nuk e njofton Bankën Popullore për ndryshimet në mënyrën e mbrojtjes së mjeteve në afatin nga neni 31 paragrafi (10) i këtij ligji;

8) nuk dorëzon raporte në përputhje me nenin 33 paragrafët (3) dhe (4) dhe nenin 171 paragrafi (2) të këtij ligji;

9) nuk siguron që agjentët t'i informojnë përdoruesit e shërbimeve të pagesave (neni 37 paragrafi (3) i këtij ligji) përkatësisht përdoruesit e parave elektronike (neni 38 paragrafi (2) i këtij ligji);

10) lejon ofrimin e shërbimeve të pagesave, përkatësisht shpërndarjen dhe blerjen e parave elektronike nëpërmjet agjentit që nuk është i regjistruar në regjistrin përkatës (neni 39 paragrafët (1), (3), (6) dhe (7) të këtij ligji) dhe

11) nuk kryen kontroll në terren në përputhje me nenin 41 paragrafi (3) të këtij ligji.

(2) Gjobë në vlerë prej 350 deri 500 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet përgjegjësit në institucionin e pagesave, përkatësisht institucionin për para elektronike për kundërvajtjen sipas paragrafit (1) të këtij neni.

Neni 212

(1) Gjobë në vlerë prej 7.000 deri 10.000 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet emetuesit të parave elektronike nëse:

1) nuk lëshon ose nuk kryen blerje me vlerë nominale të vlerës me para të parave elektronike në përputhje me nenin 13 paragrafit të këtij ligji;

2) llogarit dhe paguan interes ose ofron ndonjë përfitim tjetër lidhur me periudhën kohore të zotërimit të parasë elektronike (neni 15 paragrafi (4) i këtij ligji);

3) emeton para elektronike nëpërmjet agentit (neni 38 paragrafi (3) i këtij ligji);

4) nuk lidh marrëveshje për emetimin e parave elektronike me përmbajtje dhe kushte në përputhje me nenin 67 të këtij ligji dhe

5) nuk kryen blerje të vlerës me para të parave elektronike në përputhje me nenin 68 paragrafi (2) pika 1 të këtij ligji ose të mjeteve me para të cilat poseduesi i ka kërkuar në pajtim me nenin 68 paragrafin (2) pikën 2 të këtij ligji ose për blerjen e parave elektronike llogarit dhe arkëton kompensime në kundërshtim me nenin 68 paragrafi (3) të këtij ligji.

(2) Gjobë në vlerë prej 350 deri 500 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet përgjegjësit të emetuesi i parave elektronike për kundërvajtjen sipas paragrafit (1) të këtij neni.

Neni 213

(1) Gjobë në vlerë prej 7.000 deri 10.000 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet operatorit të sistemit të pagesave nëse:

1) nuk e njofton Bankën Popullore para fillimit të kryerjes së veprimeve tjera dhe para ndërprerjes së kryerjes së veprimeve tjera (neni 132 paragrafët (3) dhe (5) të këtij ligji);

2) kufizon qasje të sistemi i pagesave në kundërshtim me nenin 134 paragrafët (1) dhe (4) të këtij ligji;

3) pjesëmarrësve në sistemet e pagesave, përdoruesve të shërbimeve të pagesave ose sistemeve të tjera të pagesave u vendos kushte në kundërshtim me nenin 135 paragrafi (2) të këtij ligji;

4) nuk parashtron arsyetim për shkaqet e refuzimit të urdhëresave për bartje (neni 135 paragrafi (5) i këtij ligji);

5) nuk e njofton Bankën Popullore për ndryshimet në dokumentet, të dhënat dhe/ose informacionet (neni 139 paragrafi (8) dhe neni 141 i këtij ligji);

6) kryen ndryshim të rregullave të punës së sistemit të pagesave pa marrë pëlqim të parakohshëm nga guvernatori (neni 140 paragrafi (1) i këtij ligji);

7) emëron anëtarë të këshillit drejtues ose anëtarë ekzekutiv të këshillit të drejtorëve pa marrë pëlqim të parakohshëm nga guvernatori (neni 142 paragrafi (1) i këtij ligji);

8) ndërpret punën pa marrë pëlqim të parakohshëm nga guvernatori (neni 144 paragrafi (2) i këtij ligji);

9) nuk përgatit dhe dorëzon raporte financiare në përputhje me nenin 148 të këtij ligji;

10) nuk e njofton Bankën Popullore për bartjen e kryerjes së shërbimeve operative të personat e jashtëm në përputhje me nenin 40 paragrafi (1) të këtij ligji ose nuk e njofton për çdo ndryshim lidhur me përdorimin e personave të jashtëm në përputhje me nenin 40 paragrafi (5) i këtij ligji, ose nuk e njofton për ndërmarrjen e kryerjes së funksioneve operative nga persona të jashtëm në përputhje me nenin 40 paragrafi (6) të këtij ligji (neni 149 i këtij ligji);

11) nuk e mbrojnë dhe ruajnë përdorimin e dokumenteve, të dhënave dhe/ose informacione në përputhje me nenin 128 paragrafët (2) dhe (3) të këtij ligji (neni 150 paragrafi (4) i këtij ligji);

12) nuk vendos mekanizëm garantues (neni 153 paragrafi (1) i këtij ligji);

13) paguan kompensim për ekzekutimin e urdhërpagesës për arkëtim të detyrueshëm në vlerë më të madhe se shpenzimet reale të realizuara (neni 181 i këtij ligji) kur vepron si shtëpi krliringu;

14) nuk i dorëzon informacionet dhe të dhënat për llogaritë e pagesave nga RVLL deri te ofruesit e shërbimeve të pagesave të cilët janë pjesëmarrës në sistemin e pagesave (neni 176 paragrafi (7) i këtij ligji) dhe

15) arkëton kompensim për transmetim të informatave dhe të dhënave në llogaritë e pagesave nga RVLL tek ofruesit e shërbimeve të pagesave, të cilët janë pjesëmarrës në sistemin e pagesave, në lartësi më të madhe se shpenzimet reale të bëra dhe/ose nuk i publikon kompensimet për transferimin dhe përdorimin e informatave dhe të dhënave në ueb faqen e saj (neni 176 paragrafi (8) i këtij ligji).

(2) Gjobë në vlerë prej 350 deri 500 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet përgjegjësit në operatorin e sistemit të pagesave për kundërvajtjen sipas paragrafit (1) të këtij neni.

Neni 214

(1) Gjobë në vlerë prej 7.000 deri 10.000 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet ofruesit të shërbimeve të pagesave nga neni 9 paragrafi (1) pika 1, 2, 3, 5 dhe 7, emetuesit të parave elektronike nga neni 9 paragrafi (2) pikat 1, 2, 3 dhe 5 dhe operatorit të sistemit të pagesave, agjentit ose personit të jashtëm nëse nuk mundëson kryerjen e mbikëqyrjes në terren në përputhje me nenin 161 paragrafi (2) të këtij ligji.

(2) Gjobë në vlerë prej 350 deri 500 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet përgjegjësit te ofruesi i shërbimeve të pagesave, emetuesi i parave elektronike, operatori i sistemit të pagesave, agjenti ose personi i jashtëm për kundërvajtjen sipas paragrafit (1) të këtij neni.

Neni 215

(1) Gjobë në vlerë prej 3.000 deri 5.000 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet pjesëmarrësit në sistemin e pagesave nëse nuk e njofton përdoruesin e pagesave për sistemin e pagesave në të cilin ai merr pjesë dhe nuk jep informacione për rregullat e punës së sistemit të pagesave në përputhje me nenin 133 paragrafi (6) të këtij ligji.

(2) Gjobë në vlerë prej 200 deri 300 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet përgjegjësit te pjesëmarrësi i sistemit të pagesave për kundërvajtjen sipas paragrafit (1) të këtij neni.

Neni 216

(1) Gjobë në vlerë prej 3.000 deri 5.000 euro do t'i shqiptohet shoqërisë për revizion nëse nuk e njofton dhe nuk dorëzon dokumentacion deri te Banka Popullore në përputhje me nenin 35 paragrafët (2), (3) dhe (4) të këtij ligji.

(2) Gjobë në vlerë prej 200 deri 300 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet përgjegjësit në shoqërinë për revizion për kundërvajtjen sipas paragrafit (1) të këtij neni.

Neni 217

(1) Gjobë në vlerë prej 500 deri 1.000 euro në kundërvlerë denari për tregtar mikro nga 1.000 deri 2.000 euro në kundërvlerë denari për tregtar të vogël, nga 3.000 deri 6.000 euro në kundërvlerë denari për tregtar të mesëm dhe nga 7.000 deri 10.000 euro në kundërvlerë denari për tregtar të madh do t'i shqiptohet për kundërvajtje nëse:

- nuk parashtron kërkesë në përputhje me nenin 3 paragrafët (3), (6) dhe (7);
- ofron shërbime të pagesave pa marrë leje nga guvernatori, përkatësisht nuk është regjistruar në Regjistrin e institucioneve të pagesave (neni 6 paragrafi (1) i këtij ligji);
- emeton para elektronike pa leje të marrë nga guvernatori (neni 6 paragrafi (2) i këtij ligji);
- në emër të shoqërisë tregtare përdor fjalë në kundërshtim me nenin 7 paragrafi (1) të këtij ligji;

- fiton pjesëmarrje të kualifikuar në institucionin e pagesave, institucionin e parave elektronike ose operatorin e sistemit të pagesave pa pëlqimin e guvernatorit (neni 23 paragrafët (3), (4) dhe (5) dhe 145 të këtij ligji);

së paku 30 ditë para realizimit të zvogëlimit të pjesëmarrjes së kualifikuar në institucionin e pagesave, institucionin e parave elektronike ose operatorin e sistemit të pagesave nuk e njofton Bankën Popullore për pjesëmarrjen e tij të kualifikuar para dhe pas zvogëlimit (nenet 25 dhe 145 të këtij ligji) dhe

- ofron zbritje për pagesë në para të gatshme, paguan kompensim për përdorimin e instrumentit të caktuar të pagesës të bazuar në kartelë ose paguan kompensime shtesë (neni 77 paragrafët (5), (6) dhe (7) të këtij ligji).

(2) Përveç gjobës sipas paragrafit (1) të këtij neni, tregtarit i shqiptohet sanksion kundërvajtës, ndalim për kryerjen e veprimtarisë në kohëzgjatje prej tre muajsh deri në dy vjet.

(3) Gjobë në vlerë prej 300 deri 500 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet përgjegjësit te tregtari për kundërvajtje sipas paragrafit (1) të këtij neni.

(4) Përveç gjobës sipas paragrafit (3) të këtij neni, përgjegjësit te tregtari do t'i shqiptohet sanksion për kundërvajtje, ndalim për kryerjen e detyrës në kohëzgjatje deri në një vit.

Neni 218

(1) Gjobë në vlerë prej 50 deri 250 euro në kundërvlerë denari për tregtar mikro, nga 250 deri 750 euro në kundërvlerë me denarit për tregtar të vogël, nga 750 deri 1.500 euro në kundërvlerë denari për tregtar të mesëm dhe nga 1.500 deri 3.000 euro në kundërvlerë denari për tregtar të madh do t'i shqiptohet për kundërvajtje nëse:

- nuk i informon konsumatorët për mospranimin e të gjitha kartelave apo instrumenteve të tjera të pagesës në përputhje me nenin 119 paragrafi (4) të këtij ligji;

- nuk e siguron parën e gatshme të cilën e mban në arkë (neni 183 paragrafi (4) i këtij ligji);

- i paguan prodhimet dhe shërbimet me para të gatshme në vlerë individuale mbi 6.000 denarë ose në vlerë të përgjithshme mbi 60.000 denarë gjatë një muaji kalendarik (neni 183 paragrafi (6) i këtij ligji) dhe

- kryen pagesën me përllogaritje nëse ka llogari të bllokuar të pagesës (neni 183 paragrafi (7) i këtij ligji).

(2) Përveç gjobës sipas paragrafit (1) të këtij neni, tregtarit i shqiptohet sanksion për kundërvajtje, ndalim për kryerjen e veprimtarisë në kohëzgjatje prej tre muajsh deri në dy vjet.

(3) Gjobë në vlerë prej 200 deri 300 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet përgjegjësit te tregtari për kundërvajtjen sipas paragrafit (1) të këtij neni.

(4) Përveç gjobës sipas paragrafit (3) të këtij neni, përgjegjësit te tregtari do t'i shqiptohet sanksion për kundërvajtje, ndalim për kryerjen e detyrës në kohëzgjatje deri në një vit.

Neni 219

Gjobë në vlerë prej 250 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit fizik nëse:

- fiton pjesëmarrje të kualifikuar në institucionin e pagesave, institucionin e parave elektronike ose operatorin e sistemit të pagesave pa pëlqimin e guvernatorit (nenet 23 paragrafët (3), (4) dhe (5) dhe 145 të këtij ligji) dhe

- të paktën 30 ditë para se ta realizojë zvogëlimin e pjesëmarrjes së kualifikuar në institucionin e pagesave, institucionin e parave elektronike apo operatorin e sistemit të pagesave nuk e njofton Bankën Popullore për pjesëmarrjen e tij të kualifikuar para dhe pas zvogëlimit (nenet 25 dhe 145 të këtij ligji).

Neni 220

(1) Nëse Banka Popullore ose organi i autorizuar për kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese në pajtim me ligjin ka njohuri se personat juridikë dhe fizikë ofrojnë shërbime të institucionit të pagesave, institucionit të parave elektronike ose operatorit të sistemit të pagesave pa leje nga Banka Popullore, njofton menjëherë Drejtorinë e Policisë Financiare.

(2) Drejtoria e Policisë Financiare është e detyruar që menjëherë pas marrjes së njoftimit sipas paragrafit (1) të këtij neni, ta kontrollojë punën e personave sipas paragrafit (1) të këtij neni dhe të ndërmarrë masa në kuadër të kompetencave të saj.

Neni 221

(1) Gjobë në vlerë prej 3.000 deri 5.000 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet Regjistrin Qendror nëse në Regjistrin tregtar dhe Regjistrin e personave tjerë juridikë dhe regjistron shoqëri tregtare ose person tjetër juridik dhe pjesët e tyre organizative në kundërshtim me nenin 7 paragrafi (2) të këtij ligji.

(2) Gjobë në vlerë prej 200 deri 300 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet përgjegjësit në Regjistrin Qendror për kundërvajtjen sipas paragrafit (1) të këtij neni.

Pjesa e njëmbëdhjetë

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 222

(1) Personat juridikë të cilët deri në ditën e zbatimit të këtij ligji kanë ofruar shërbime të pagesave nga neni 8 i këtij ligji, përveç bankave me leje për themelim dhe punën e guvernatorit, janë të detyruar që në afat prej 12 muajsh nga dita e zbatimit të këtij ligji, në Bankën Popullore të parashtrojnë kërkesë për marrjen e lejes për institucionin e pagesave ose për institucionin e parave elektronike në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

(2) Personi juridik sipas paragrafit (1) të këtij neni i cili nuk do të parashtrojnë kërkesë në afatin sipas paragrafit (1) të këtij neni ose kërkesa e të cilit do të refuzohet nga Banka Popullore, nuk do të ofrojë shërbime të pagesave.

(3) Operatori i rrjeteve të komunikimeve elektronike ose ofruesi i shërbimeve të komunikimeve elektronike i cili mundëson kryerjen e transaksioneve të pagesave nga neni 3 paragrafi (1) pika 12 të këtij ligji është i detyruar që ta njoftojë Bankën Popullore në afat prej 12 muajsh nga dita e zbatimit të këtij ligji për kryerjen e transaksioneve të pagesave përkatëse.

(4) Personat juridik, përveç Bankës Popullore, të cilët deri në ditën e zbatimit të këtij ligji kanë menaxhuar dhe udhëhequr sistemin e pagesave në pajtim me dispozitat e Ligjit për qarkullimin e pagesave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 113/07, 22/08, 159/08, 133/09, 145/10, 35/11, 11/12, 59/12, 166/12, 170/13, 153/15, 199/15, 193/17, 7/19 dhe 31/20) dhe rregulloret e miratuara në bazë të atij ligji, janë të detyruar që në afat prej 12 muajsh nga dita e zbatimit të këtij ligji, në Bankën Popullore të parashtrojnë kërkesë për marrjen e lejes për operator të sistemit të pagesave në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

(5) Personi juridik sipas paragrafit (4) të këtij neni i cili nuk do të parashtrojnë kërkesë në afatin sipas paragrafit (4) të këtij neni ose kërkesa e të cilit do të refuzohet nga Banka Popullore, nuk guxon të menaxhojë me punën e sistemit të pagesave.

(6) Personi juridik i cili ka parashtruar kërkesë në pajtim me paragrafin (1) dhe/ose paragrafin (4) të këtij neni, vazhdon të punojë në pajtim me dispozitat e rregulloreve përkatëse me të cilat është rregulluar puna e tij para hyrjes në fuqi të këtij ligji, deri në ditën e dorëzimit të aktvendimit të guvernatorit me të cilin vendoset sipas kërkesës së dorëzuar.

Neni 223

(1) Marrëdhëniet kontraktuale lidhur me ofrimin e shërbimeve të pagesave të lidhura para fillimit të zbatimit të këtij ligji do të mbeten në fuqi edhe pas fillimit të zbatimit të këtij ligji dhe do të zbatohen sipas kushteve të këtij ligji.

(2) Dispozitat e këtij ligji që rregullojnë përmbajtjen e marrëveshjeve kornizë me ditën të fillimit të zbatimit të këtij ligji janë pjesë përbërëse e marrëveshjeve sipas paragrafit (1) të këtij neni dhe plotësojnë ose zëvendësojnë dispozitat kontraktuale që nuk janë në përputhje me to.

(3) Ofruesit e shërbimeve të pagesave janë të detyruar për ndryshimin e detyrimeve kontraktuale sipas paragrafit (2) të këtij neni t'i njoftojnë përdoruesit e shërbimeve të pagesave dy muaj para fillimit të zbatimit të këtij ligji, duke i publikuar informacionet nga neni 56 të këtij ligji dhe më së voni në afat prej 15 muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji duke publikuar informacionet nga nenet 54 dhe 55, në hapësirat e tyre të punës ku përdoruesit kanë qasje për përdorimin e shërbimeve të pagesave dhe në faqen e tyre të internetit.

(4) Me përjashtim të dispozitave sipas paragrafit (1) dhe paragrafi (2) të këtij neni, me kërkesë të përdoruesit të shërbimeve të pagesave, dhënësi i shërbimeve të pagesave është i detyruar që në afat jo më të gjatë se 30 ditësh nga parashtrimi i kërkesës të lidhë marrëveshje kornizë, në përputhje me Pjesën e tretë të këtij ligji.

Neni 224

Urdhëresa e bartjes e vendosur në sistemin e pagesave para ditës së zbatimit të këtij ligji, i cili do të shlyhet pas ditës së zbatimit të këtij ligji, do të konsiderohet si urdhëresë e bartjes në kuptim të këtij ligji.

Neni 225

(1) Ofruesit e shërbimeve të pagesave janë të detyruar të harmonizojnë vlerën e kompensimit të zëvendësimit nga neni 115 paragrafi (1) pika 1) me këtë dinamikë:

1) më 1 janar 2023 jo më shumë se 1.00% e vlerës së transaksionit të kryer të pagesës;

1) më 1 korrik të vitit 2023 jo më shumë se 0.80% e vlerës së transaksionit të kryer të pagesës;

3) më 1 korrik të vitit 2024 jo më shumë se 0.50% e vlerës së transaksionit të kryer të pagesës dhe

4) më 1 janar 2025 jo më shumë se 0,20% e vlerës së transaksionit të kryer të pagesës.

(2) Dhënësit e shërbimeve të pagesave janë të detyruar që të arrijnë shumën e kompensimit të zëvendësimit nga neni 115 paragrafi (1) pika 2) me këtë dinamikë:

1) më 1 janar 2023 jo më shumë se 1.00% e vlerës së transaksionit të kryer të pagesës;

2) më 1 korrik të vitit 2023 jo më shumë se 0.80% e vlerës së transaksionit të kryer të pagesës;

3) më 1 korrik të vitit 2024 jo më shumë se 0.50% e vlerës së transaksionit të kryer të pagesës;

4) më 1 janar të vitit 2025 jo më shumë se 0.30% e vlerës së transaksionit të kryer të pagesës;

Neni 226

(1) Dispozitat e neneve 4, 9 paragrafi (1) pikat 4, 6, 8 dhe 12 dhe paragrafi (2) pikat 4, 6 dhe 8, 12 paragrafi (2) pika 2, 27 paragrafi (6), 99 paragrafët (4), (5), (6) dhe (7), 102 paragrafi (2), 123 paragrafët (3), (5), (6) dhe (8), 129 paragrafi (3), 130 paragrafët (11) dhe (13), 131 paragrafi (7), 152 paragrafët (5), 157 paragrafët (4) dhe (5) dhe 184 paragrafi (9) dhe dispozitat e Pjesës së nëntë Kapitujt I, II, III, V, VI dhe VII të këtij ligji do të fillojnë të zbatohet nga dita e anëtarësimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut në Bashkimin Europian.

(2) Dispozitat e nenit 99 paragrafi (3) të këtij ligji shfuqizohen me ditën e pranimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut në Bashkimin Europian.

Neni 227

Dispozitat e neneve 56 paragrafi (1) pika 7) nënpika b, alinea 3, 72 paragrafi (7) pika 3, 75 paragrafi (5) pika 3, 109 paragrafi (1) pika 5) nënpika v, 129 paragrafi (6), 130 paragrafi (8) dhe 131 të këtij ligji do të fillojnë të zbatohen nga 1 janari i vitit 2026.

Neni 228

Dispozitat e nenit 72 paragrafët (3) dhe (4) pika 4) e këtij ligji shfuqizohen në ditën e zbatimit të Pjesës së shtatë Kapitullit II, në pajtim me nenin 234 paragrafi (3) të këtij ligji.

Neni 229

(1) Aktet nënligjore që dalin nga ky ligj do të miratohen në afat prej nëntë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(2) Aktet nënligjore që dalin nga Ligji i Qarkullimit të Pagesave, Ligji i Punës Devizore dhe Ligji i Kryerjes së Shërbimeve të Transferit të Shpejtë të Parave zbatohen deri në ditën e zbatimit të akteve nënligjore përkatëse të miratuara në bazë të këtij ligji.

Neni 230

(1) Periudha prej 24 muajsh, përkatësisht dhjetë vjet për përcaktimin e statusit së llogarisë joaktive pagesore, përkatësisht llogarisë joaktive depozituese, fillon të konsiderohet nga dita e transaksionit të fundit të autorizuar të pagesës dalëse ose hyrëse, me përjashtim të përlllogaritjes dhe pagesës/arkëtimit të interesit dhe/ose çdo transaksion tjetër të pagesës së kryer në favor të ofruesit të shërbimit të pagesave, ose nga data e komunikimit të fundit të dokumentuar me shkrim, elektronike dhe/ose lidhje telefonike të regjistruar lidhur me llogarinë ndërmjet ofruesit të shërbimeve të pagesave dhe konsumatorit ose përfaqësuesit të tij ligjor.

(2) Dispozitat e nenit 191 të këtij ligji do të fillojnë të zbatohen në afat prej 20 muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 231

(1) Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut është i detyruar që ta themelojë regjistrin e vetëm të llogarive në afat prej 20 muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(2) Operatori i sistemit të pagesave do të filloj t'i arkëtojë kompensimet për bartjen e informatave dhe të dhënave për llogaritë e pagesave nga neni 176 paragrafi (8) i këtij ligji pas kalimit të 24 muaj nga dita e vendosjes së regjistrit të vetëm të llogarive sipas paragrafit (1) të këtij neni.

(3) Regjistri Qendror do të filloj t'i arkëtojë kompensimet për shfrytëzimin e informatave dhe të dhënave për llogaritë e pagesave nga RVLl nga operatori i sistemit të pagesave pas kalimit të 24 muajve nga dita e vendosjes së regjistrit të vetëm të llogarive sipas paragrafit (1) të këtij neni.

(4) Personi juridik nga neni 179 paragrafi (15) është i detyruar që të themelojë sistemin elektronik për arkëtim të detyrueshëm dhe të mundësojë shkëmbimin e informacioneve në afat prej 22 muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 232

(1) Ofruesit e shërbimeve të pagesave janë të detyruar t'i zbatojnë dispozitat nga neni 179 paragrafi (9), (10), (11), (12), (13) dhe (14) të këtij ligji në aktvendimet për arkëtim të detyrueshëm në pajtim me nenin 21 dhe 22 të Ligjit të Qarkullimit të Pagesës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.113/2007, 22/2008, 159/2008, 133/2009, 145/10, 35/11, 11/12, 59/12, 166/12, 170/13, 153/15, 199/15, 193/17, 7/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ numër 31/20 dhe 39/22) të pranuar deri në ditën e fillimit të zbatimit të Pjesës së shtatë të Kapitullit të III-të të këtij ligji.

(2) Ofruesit e shërbimeve të pagesave janë të detyruar që në sistemin elektronik për arkëtim të detyrueshëm që është e vendosur dhe poseduar nga shtëpia e kleringut nga neni 179 paragrafi (15) të regjistrojnë rendin e ekzekutimit të aktvendimeve për arkëtim të detyrueshëm në pajtim me nenet 21 dhe 22 të Ligjit të Qarkullimit të Pagesave („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 113/07, 22/08, 159/08, 133/09, 145/10, 35/11, 11/12, 59/12, 166/12, 170/13, 153/15, 199/15, 193/17, 7/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 31/20 dhe 39/22) që nuk janë ekzekutuar deri në ditën e fillimit të zbatimit të Pjesës së shtatë të Kapitullit të III-të të këtij ligji.

Neni 233

(1) Me ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji, pushojnë të vlejnjë Ligji i Kryerjes së Shërbimeve të Transferit të Shpejtë të Parave („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 77/2003, 54/2007, 48/10, 67/10, 17/11, 135/11, 187/13, 154/15 dhe 23/16) dhe Ligji i Qarkullimit të Pagesave („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 113/2007, 22/2008, 159/2008, 133/2009, 145/10, 35/11, 11/12, 59/12, 166/12, 170/13, 153/15, 199/15, 199/15, /17, 7/19 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut numër 31/20 dhe 39/22).

(2) Me përjashtim të dispozitave të paragrafit (1) të këtij neni:

- dispozitat e neneve 2 paragrafi (1) pikat 4, 19 dhe 20, 5 paragrafi (1) pikat 9 dhe 11, 6 paragrafi (1) pika 2, 7 paragrafi (1) pika 2, 7-a paragrafi (1) pika 2, 9, 10 paragrafi (1), 15, 16, 49 paragrafi (2), 50 paragrafi (1) pikat 2 dhe 6 dhe 54 paragrafi (1) pikat 1 dhe 2 të Ligjit të Qarkullimit të Pagesave („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 113/07, 22/08, 159/08, 133/09, 145/10, „35/11, 11/12, 59/12, 166/12, 170/13, 153/15, 199/15, 193/17, 7/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ numër 31/20 dhe 39/22) zbatohen deri në ditën e fillimit të zbatimit të Pjesës së shtatë Kapitullit II të këtij ligji;

- dispozitat e neneve 2 paragrafi (1) pikat 5, 10 dhe 17, 21, 22, 23, 24 dhe 50 paragrafi (1) pikat 10, 11 dhe 12 të Ligjit të Qarkullimit të Pagesave („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.113/07, 22/08, 159/08, 133/09, 145/10, 35/11, 11/12, 59/12, 166/12, 170/13, 153/15, 199 /15, 193/17, 7/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ numër 31/20 dhe 39/22) zbatohen deri në ditën e fillimit të zbatimit të Pjesës së shtatë të Kapitullit III të këtij ligji dhe

- dispozitat e nenit 17 paragrafi (3) të Ligjit të Qarkullimit të Pagesave („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.113/07, 22/08, 159/08, 133/09, 145/10, 35/11, 11/12, 59/12, 166/12, 170/13, 153/15, 199 /15, 193/17, 7/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ numër 31/20 dhe 39/22) zbatohen deri në ditën e fillimit të zbatimit të nenit 42 paragrafi (9) pika 3 të këtij ligji.

Neni 234

(1) Dispozitat e nenit 42 paragrafi (9) pika 3, 54 dhe 55 të këtij ligji do të fillojnë të zbatohen në afat prej 15 muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(2) Dispozitat e nenit 184 paragrafi (5) dhe (8) të këtij ligji do të fillojnë të zbatohen në afat prej 16 muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(3) Dispozitat e Pjesës së shtatë të Kapitullit II dhe Pjesës së katërt të Kapitullit IV të këtij ligji do të fillojnë të zbatohen në afat prej 20 muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(4) Dispozitat e Pjesës së shtatë të Kapitullit III të këtij ligji do të fillojnë të zbatohen në afat prej 24 muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(5) Dispozitat e nenit 183 paragrafi (7) të këtij ligji do të fillojnë të zbatohen nga 1 janari i vitit 2024.

Neni 235

Ofruesit e shërbimeve të pagesave janë të detyruar të harmonizohen me nenet 49 paragrafi (3), 50, 79 paragrafi (6), 81, 82, 84, 87 paragrafi (3), 88 paragrafi (2), 89 paragrafi (5), 96, 104 dhe 124 paragrafët (4) dhe (5) të këtij ligji në afat prej 22 muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 236

Ky ligj hyn në fuqi tetë ditë pas botimit në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut“ dhe do të fillojë të zbatohet nga 1 janari i vitit 2023.